

ENVER HOXHA

VITE TË RINISË

Korça zë një vend të veçantë e të preferuar në jetën time. Në Gjirokastrë lindi e kalova fëmijërinë, argasa këmbët në rrugët e rrugicat e saj të gurta e të dashura, hapa sytë e mora mësimet e para për atdheun, për njerëzit e për jetën. Kurse Korça është qyteti i rinisë sime dhe rinia është mosha kur formohet karakteri e përcaktohet rruga e njeriut në jetë.

Atje fillimisht shkova për të përfunduar tre vjetët e liceut, vite nga më të bukurat e më të paharruarat e jetës sime, e më vonë, pas gjashtë vjetësh largimi erdha përsëri në Korçë, tash profesor në po atë lice ku isha diplomuar edhe vetë.

Kanë kaluar tridhjetë-dyzet vjet qysh atëherë dhe sot e kam të vështirë të them se ç'më bëri përshtypje më fort në këtë qytet, cila ishte gjëja më me vlerë që mësova e fitova atje, ndaj kujt duhet të drejtohem me nderimin e konsideratën më të thellë.

Liceu i atjeshëm ishte në ato kohë, pa dyshim, shkolla e mesme më e njohur dhe më e kualifikuar dhe unë, si ish-nxënës i saj, gjithmonë kam kujtuar e do të kaitoj me mirënjohje e respekt gjithçka na dha kjo shkollë mua dhe brezit tim në fushën e dijes e të kulturës.

Por Korça nuk ishte vetëm liceu. Çdo gjë e saj, që nga planimetria e rrugëve, e rrugicave dhe arkitektura e ndërtesave, që nga historia e lashtë dhe e re e qytetit e gjer te jeta e përditshme e tij, te zakonet dhe sjelljet e njerëzve, te hallet dhe përpjekjet e tyre, të gjitha u bënë për mua e shokët e mi dritare të reja, më të mëdha për njohjen dhe kuptimin më të thellë të jetës. E quaj fat të madh që më takoi të mësoj e të jetoj në Korçë tamam në ato vite kur atje, më qartë se kudo në Shqipërinë e asaj periudhe, kishte nisur të lëshonte rrënjët e para e të hidhte hapat e parë një ideologji e lëvizje e re, ideologjia e lëvizja komuniste. Të etur jo vetëm për të mësuar e për të zgjeruar dijet vetjake, por sidomos të dëshiruar e të preokupuar për t'i shërbyer sadopak atdheut e popullit që vuante në mjerim e kërkonte rrugë shpëtimi, ne, të rinjtë e asaj kohe, do ta ndienim shpejt erën e re që kishte nisur të frynte në Korçë e do të jepeshim me të gjitha forcat e pasionet pas saj. E për këtë u kam qenë e do t'u jem mirënjohës gjer në fund korçarëve punëtorë, të civilizuar e përparimdashës, sidomos pjesës më të përparuar të tyre, proletarëve korçarë. Nuk e teproj kur them se ata i dhanë rinisë sonë drejtimin e duhur në jetë, nuk e kam thënë për t'u bërë qejfin, kur kam theksuar se ata ishin mësuesit tane të parë të komunizmit. Ata proletarë të ndershëm, të sflitur nga puna e mundimet e që po kalitëshin si luftëtarë për një botë të re, i kujtoj gjithmonë me respekt të thellë e me mall të veçantë, ashtu sic kujtoj me respekt e mall gjithë ç'pashë, njoha, mësova në Korçë në vitet e para të rinisë sime.

Siç kam treguar me hollësi edhe gjetkë, për herë të parë në këtë qytet shkova në vjeshtën e vitit 1927 për të kryer tre vjetët e fundit të shkollës së mesme në liceun e atjeshëm.

Dite e nate me radhë në Gjirokastrë zjeu shtëpia nga përgatitjet për nisjen. Sa më shumë a fronte çasti i ndaries aq më shumë mallëngjehesha, por dëshira për t'u nisur për në Korçë zotëronte mbi të gjitha. Dhe më në fund, një mëngjes herët, pasi u putha e u ngalasa me anenë, xhaxhain, Sanon, farefisnin e shokët, i hipëm «fluturidhës» bashkë me shokët dhe u nisëm.

Rruga nga Gjirokastra për në Korçë është e gjatë dhe në ato kohë ajo bëhej në dy etapa, duke qëndruar një natë në Përmet. Udhëtimin e bënim me një kamion të vjetër, i cili prishej shumë herë rrugës dhe shoferi e ndalonte në çdo krrua për t'i hedhur ujë radiatorit, që e shfrynte avullin si një

plak kur i zihet fryma. Neve nuk na durohej sa të arrinim në Korçë, por edhe gëzim kishim që ndalonim rrugës, pse soditnim vendin, qytetet dhe fshatrat që na dilnin gjatë udhëtimit.

Ishte hera e pare që bëja rrugën Gjirokastër-Përmet-Leskovic-Ersekë-Korçë. Sa gjëra të bukura do të shikoja! Ja, urën e lumit, ku aq herë kisha kaluar me shokët e vegjëlisë sime e lamë pas. Lamë, gjithashtu, pas bregun e «Baba Manes», ku luanim dhe thithnim si bletët lulet e verdha të sfakave. Ja edhe Viroi me ujin e tij të ftohtë. Më tutje, i rrethuar me kavakë, na shfaqet mulliri i Dino Çiços. Ky mulli ishte kufiri deri ku ne, të rinjtë, ecnim me këmbë; Dino Çiçoja ishte «fundi i dynjasë».

Ai ishte për ne një njeri misterioz, i marre apo i ditur, pse flitej që mbyllej në ode dhe diçka bënte. Kynjeri pa shkollë mudohej të shpikte një makinë, që «dotë lëvizte pa u ndalur kurrë». Këtë makinë ai dhe njerëzit e tij e quanin «Devri daim»*. *(Nga turqishtja, ekuivalente e shprehjes latine perpetuum mobile. Në rastin konkret me kuptimin: makinë në lëvizje të përhershme, që ecën në tokë, fluturon në ajër, lundron në det etj) Kjo «e famshme» makinë, të cilën e bënte vetëm me dru që e gdhendte vetë me një biçak prej çobani, që «të punonte, të fluturonte, apo të notonte», sipas tij, nuk kishte nevojë as për ajër, as për benzinë, as për naftë! Dinoja rrinte në lagjen Hazmurat, atë e shihnim rrallë të dilte, vishej me poture të zeza, me qylaf të bardhë dhe me shark të bardhë.

- Mirëmëngjesi, xha Dino, - i thoshim ne, nxënësit, kur e takonim në rrugë, - kur do ta nxjerrësh «Devri daimin»?

Ai na përgjigjej

- Durim, mor djem, pa do ta shihni.

Po «Devri daimin» ne s'e pamë kurrë, megjithëse edhe në Vjenë e shpunë Dino Çiçon. Ai shkoi vetë atje i shoqëruar me «të famshmin» Xhevat Kallajxhinë (Hundashin), po u kthyen andej pa zhurmë, pse «shpikja» e tij nuk ishte veçse një mekanizëm i thjeshtë sahati prej druri.

Shoferin, që kënaqej nga këngët tona, të cilat basñkoheshin me zhurmën e madhe të automobilit karakatinë, e lutëm të na ngrinte mushamanë e karrocërisë. Kështu që «u kënaqëm» nga dielli që na binte në kokë dhe nga pluhuri që na bënte si «millona», sidomos kur makina ndalej. Por ne, të rinjtë, s'donim t'ia dinim prej tyre, mjaft të ngopnim sytë me malet dhe me fshatrat e Labëricë, me Mashkullorën e Çerçizit, urën e Kardhiqit, Picarin e Çelos, e matanë me malet e Lunxhërisë dhe fshatrat që na kalonin përpara syve njëri pas tjetrit, siç na kalonin në mendje, kur na i mësonte mësuesi, zoti Arshi.

Kamioni dridhej në kthesat përmbi Drinon plak, që ne e njihnim mirë, por që nuk e dinim të ishte kaq i bukur sa e shihnim në këto anë. Këtej lumi kalonte në mes rrapesh plot hije, uji i tij kishte një ngjyrë blu të thellë. Në këto anë kishte «ingjirë» të bukur, sigurisht plot me peshq. Xha Haxhiu (Shurdhi) me siguri këtu vinte i zinte peshqit që na shiste.

Ja, më në fund dhe Uji i Ftohtë i Tepelenës. Pushim bëri makina, pushim bëmë edhe ne, udhëtarët; «pinte ujë makina», pinim edhe ne, por ne të paktën shkundnim pluhurin e rrobave, lanim fytyrën, kurse makina vetëm sa hante në turi ndonjë kovë me ujë që iu hidhte shoferi.

- Mos u mërzitni, djema, - na thoshte ai. - Do të keni kohë edhe për t'u mërzitur pse kemi akoma rrugë për të bërë.

Vazhduam rrugën dhe më pas u futëm në grykën e Mezgoranit e të Këlcyrës. Kjo grykë, rrethuar nga të dyja anët me male të larta na dukej pa fund. Vjosa rrëshqiste poshtë rrugës e qetë, kurse ne ecnim pa mbarim në drejtim të kundërt të saj. Nuk na durohej sa të shihnim «qytetin» e Këlcyrës.

Më në fund, automobili ynë u ndal me rënkime të mëdha, në mes një pluhuri të dendur, përpara një dyqani të vjetër.

- Kush të dojë, le të zbresë, - bërtiti shoferi. Vizitoni djema qytetin! - thoshte ai me ironi, pse, në fakt, këtu nuk kishte veçse ca dyqane të vjetra, një han pis dhe disa shtëpiza. Vetëm një shtëpi ishte atje e madhe, ajo e xhaxhait të Ali bej Këlcyrës, një tirani të poshtër për fshatarët.

- I shikoni atje lart ato gërmadha? - na thoshte shoferi me zë të ulët se mos e dëgjonte beu i Këlcyrës. - Atje kanë qenë sarajet e bejlerëve. Ja, andej ata i hidhnin fshatarët në Vjosë.

- Po mirë, - e pyeti shoferin një shok, - si bëhet që Ali Këlcyra është demokrat, kundër Zogut dhe në arrati?

Shoferi, më kujtohet si sot, fshiu djersën e fytyrës me kasketë dhe na tha

- T'ëmën Ali beut, bir kurve është edhe ai, mos u besoni kurrë atyre qëne, se derrat një turi kanë. Pasi hëngrëm ca bukë, ia hipëm përsëri kamionit dhe u nisëm për në Përmet. Rruga këtu ishte e drejtë, se kalonte nëpër një fushë. Larg dukeshin malet e Dhëmbelit e të Nemërçkës. E dinim se matanë Dhëmbelit binte Zagoria, vendlindja e Cajupit, poet i dashur i neve të rinjve. Papritur automobili u ndal.

- Ç'ngjau? - pyetëm.

- U ça goma, - tha ndihmësi i shoferit, Çomja. Ky ishte një shoku im i mëhallës, i cili e kishte shtëpinë afër Çoro Kasapit, që shiste mish «në këmbë», kasap pa dyqan, siç i thoshin në Gjirokastrë. Çoroja ishte i këputur; «kripë e Sajadhës», ai i shiste herë pas here plakut ndonjë paça ose zorrë. Mua më kujtohet që zorrën aneja na e gatuate duke e mbushur me oriz; ishte «bumbari», siç i thoshim. Çomja nuk erdhi kurrë në shkollë, ai kishte pasionin e automobilin. Që në vegjëli vente pas shoferëve, Arshiut, Pandeliut, Arapit dhe u shërbente. Çomen e shihje mbi kamionë e nën kamionë, duke i grasatuar dhe dulce u hedhur atyre ujë, frynte gomat etj. Ishte djalë i shkathët, plot humor, «shakaxhi», siç e quanim, po kurdoherë ishte i rreckosur, i vajosur dhe kasketën pis e mbante mbi sy.

- Çome, zbrit! - briti shoferi.

Dhe Çomja në këmbë.

- Sa do të vonohemi, Çome? - e pyetnim ne.

- Dhjetë minuta, - përgjigjej ai, por kjo punë zgjaste një orë e gjysmë. Kur bëhej gati të fuste krikon për të ngritur makinën Çomja bërtiste:

- Ej, po ju, o dembelat e hanit, atje sipër mbi automobil do të më rrini? Pa zbritni një çikë dhe më jepni një ndihmë.

Ne bënim sikur e ndihmonim, por ruanim me kujdes rrobat se mos na bëheshin me graso. Më në fund Boma u ngjit, u vu në vend trova me ujë e radiatorit. Çomja mori pastaj manivelën, e futi në motor, e vërtiti me forcë shumë herë dhe makina u ndez.

- Forca Arshi! - i bërtiti Çomja shoferit. - Shkelja gazin, se na pret rakia në Përmet!

Çomja ia dinte huqet shoferit, i cili, si gjithë shoferët në atë kohë, e kishte qejf rakinë, po sidomos birrën me meze.

Më në fund, në të ngrysur, u duk Guri i qytetit, u duk Përmeti përtej Vjosës. Kapërcyem urën dhe u futëm në qytet. U ndalëm në një hotel të vjetër. Do të flinim atje atë natë dhe të nesërmen do të niseshim për në Korçë. Futëm shpejt valixhet në dhomë dhe dolëm të shihnim qytetin rr eth e qark, sa kishte akoma dritë. Shoferi ia shtroi rakisë, kurse Çomja zbriste thasët nga makina. Përmeti më pëlqeu, se i ngjiste Gjirokastrës, me rrugë e me dyqane të vogla, me kalldrëme, ku të mbaj tura mirë dhe ku të prishura e me gropa me ujë. Ishim kuriozë, donim të shihnim çdo gjë dhe pyetnim: «A do ta shohim burimin e Vjosës? A kalohet këndeje për në Zagori? Si e quajnë atë majë?» Po kjo ishte një copë herë e vogël, se erdhi nata dhe na mblodhi hoteli, u bashkuam me shokët në një dhomë dhe hapëm kartën e bukës për të ngrënë ato që na kishin mbetur. Në restorant nuk mund të shkonim, se kushtonte shtrenjtë dhe ato pak lekë që kishim, i ruanim si sytë e ballit që t'i kishim për në Korçë.

- E mor studentë, - na thoshte i zoti i hotelit, - nuk do të na bëni ndonjë çikë spezë këtu, apo jeni «kripë e Sajadhës»?

Në qoftë se ne ishim «kripë e Sajadhës», edhe dhoma ku fjetëm e krevatet ku u shtrimë ishin pis. Kushedi sa kohë kishin çarçafët pa u ndërruar, kushedi sa veta kishin fjetur mbi ta njëri pas tjetrit. Sidoqoftë, lodhja na i mbylli sytë. Në mëngjes u çuam herët, lamë faqet në çezmën e përbashkët të hanit dhe përsëri dolëm në rrugën e pazarit. Çomja nuk ishte zgjuar akoma, ai po flinte në automobil.

- Çome, kur do të nisemi? - e pyetëm.

- Ç'më çani kokën, lërmëni të fle!

- Çome, kur do të nisemi? - i thamë prapë ne, se po vjen dreka.

- Për një çerek ore, - na u përgjigj Çomja, po çereku i orës ishte një orë e gjysmë në mos dy.

Më në fund u nisëm dhe u futëm në luginë. Rruga gjarpëronte, edhe Vjosa gjarpëronte e ne pyetnim:

- Ku është kufiri grek? A arrijmë shpejt në Meso Ura*? *(Kështu e duanin në Jug pikën kufitare të LeskoviRut mbi Çanshovë («Tri Urat»), ku në vitet 30-të ndodhej një rrugë kalimi mes Shqipërisë dhe Greqisë)

Ja më në fund dhe toka gr eke matanë. Arritëm në Meso Ura, ku automobili u ndal dhe dëgjuam shoferin që bërtiti

- Tungjatjeta xha Nuri, si je, si shkon?

Xha Nuriu (Nuri Cuçi) ishte nëpunës i doganës. Në urë pamë një xhandar «gushëkuq» në anën tonë dhe matanë një korofillak. Ura në mes ishte e ndarë me një tra.

Vazhduam rrugën dhe afër drekës, duke kaluar male e kodra, arritëm në Leskovik. Zbritëm, blemë disa kumbulla, pak rrush, u ulëm te rrapi dhe pritnim sa të mbaronte Arshi shoferi rakinë dhe Comja mos gjente ndonjë udhëtar për Ersekë dhe Korçë. Mbi ne qëndronte mali i Melesinit, për të cilin më kujtoheshin vargjet:

*«Melesini maja, maja
Gjëmon topi e kumbaraja...»*

Së shpejti, në rrugën për në Korçë, ne do të kalonim nga Barmashi, nga Poda. Gjithë rrugës në këto vende koka më ziente nga Brama «Fe e kombësi» e Kristo Floqit që kishim shfaqur në Gjirokastër, në të cilën unë kisha luajtur rolin e Zylyftar Podës. U recitoja shokëve në automobil pjesë. Çomja hapte sytë, dëgjonte me vërejtje, nganjëherë psherëtinte dhe bërtiste:

- More, ç'na kanë bërë këta turq dhe këta grekë!

Nganjëherë thoshte:

- Ama, trima janë këta kolonjarët o Enver!

Në Ersekë s'ndenjmë shumë, hodhëm sytë andej-këndej, s'pamë gjë përveç një kazërme, ca dyqaneve dhe shtëpive të vogla. Fusha atje na pëlqeu, sidomos malet rreth e rrotull, Gramozi, Qafa e Kazanit.

U nisëm për në Korçë, dolëm në Qafën e Qarrit, pas së cilës u shfaq fusha e madhe dhe e bukur e Korçës. Ne u habitëm. Ishim kuriozë të shihnim Kor çën e bukur. për të cilën kishim thurur kaq ëndrra të gëzuara.

- Ja, ja Boboshtica, ja Drenova, ja dhe Korça! - na thoshin gjithë gëzim ata që kishin kaluar edhe herë tjetër në këto rrugë.

Si hymë në qytet, u ndalëm në agjenci, ku kishte plot njerëz. Ambienti këtu na dukej krejt ndryshe nga Gjirokastra. Rrugët ishin shesh, njerëzit sikur ecnin më shpejt, kishte më shumë dritë elektrike. Natën e parë fjetëm në një han dhe të nesërmen që në mëngjes një pjesë nga ne do të par aqiteshim në internat si bursistë që ishim.

Dy objektet më të rëndësishme që ne dëshironim të shikonim e të njiheshim me to sa më parë, ishin internati dhe liceu. Që pa gdhirë lamë hanin dhe me valixhe në duar u nisëm për në internat, në shtëpinë tonë, ku do të jetonim tre vjet me radhë. Ishte një ndërtesë «e madhe» me dy kate, e rrethuar me mure të larta. Dera e saj rrinte kurdoherë mbyllur. Duhej të trokisje, pa të hyje, se për të dalë duhej të tregojë se kishe leje nga kujdestarët e internatit. I ramë derës me zemër të gëzuar, por edhe me kureshtje, pse nuk dinim si do të na pritnin, në ç'dhomë do të na vinin, me cilët shokë të rinj e të panjohur do të caktoheshim.

Na hapi derën një plak i shkurtër me fytyrë të ngrysur, me qepalla të trasha, me vetulla plot qime e mustaqe të bollshme. Ai na pyeti i vrenjtur:

- Ç'doni? Kë kërkoni?

Kur iu përgjigjëm se jemi bursistë, vijmë nga Liceu i Gjirokastrës, ai na tha:

- Hyni.

Ky portier ishte Guri. Dukej i vrenjtur, po nuk ishte burrë i keq. Gjatë tre vjetëve që ndenjëm në internat nuk u zemëruam, as u grindëm ndonjëherë me të. Ai na tregoi shkallët, duke na thënë:

- Ngjitni shkallët dhe nga e djathta është drejtorja. Paraqituni atje.

I ramë derës së drejtorit. Ishim edhe kur iozë. por edhe me zemër të dridhur ca, pse nuk dinim çfarë njeriu ishte. Hymë brenda dhe përshëndetëm. Përpara kishim një burrë me leshra të thinjura, fytyrë të verdhë. të hollë dhe me cigare në gojë. Ne kujtuam se ishte drejtori.

- Unë s'jam drejtori, po ekonomi Pero, - na tha ai.

U shkrifëruam ca. «Ky do të na ushqejë», thamë me vete. Na mori emrat, na regjistroi në një defter të zi, të madh, na tregoi rregullat e inter natit, na këshilloi si të silleshim dhe, gasi mbaroi me këto formalitete që i dinte përmendsh dhe, si duket, ua përsëriste të gjithëve, i r a ziles. Hyri menjëherë një djalë i gjatë, i hollë, me një fytyrë gjysmëkali e me sy të kuq. Njërin nga kapakët e syrit e kishte të përveshur ca.

- Ilo, i tha Peroja, - merri djemtë dhe çoji disa në këtë dhomë, të tjerët në atë dhomë.

Mua më vuri në një dhomë të katit të parë, përballë drejtorisë, ngjitur me «kabinën» e kujdestarit.

Dhoma me penxhere të mëdha mund të kishte nja dhjetë a pesëmbëdhjetë krevate. Më pëlqeu. Në mes çdo dy krevateve kishte nga një dollap me dy kate me çelësa. Unë zgjodha një krevat pranë penxheres hapa valixhen, nxora teshat dhe i vura në dollapin tim. Krevatin afër meje e zuri Selami Xhaxhiu. U gëzova shumë. Më vonë dhoma jonë u mbush. Më kujtohet që në atë dhomë kishte shokë që ishin në klasën e dytë, të parë dhe ndonjë në atë të filozofisë. Ismail Topçiu, Shaqir Gjebreja, Vehap Ciu, Lezo Cami, Epaminonda Bulka, Anton Mazreku e disa të tjerë, që nuk më kujtohen, flinin në një dhomë me ne. Më vonë u njohëm mirë me njëri-tjetrin dhe me të gjithë shokët e internatit.

Vizituam pastaj dhomat e tjera, sipër. Ato ishin shumë të mëdha, me dy sërë krevatesh dhe me një rrugicë në mes, sic ishte dhe jona. Sipër rrinin më të vegjlit, që nga klasa e tetë e liceut dhe devi tek e katërta dhe e treta. Ky kat ishte si një pazar i madh kur hynin liceistët të flinin, kurse dhomat tona ishin më të mbledhura. Një dhomë përmbri nesh ishte më e vogël, ajo ishte për shokët më të vjetër në internat. Më vonë atë dhomë e laknomm. pse ishte dhoma e muhabetëve pas studimeve, dhoma e diskutimeve letrar-politike. dhoma ku hynin më pak kujdestarët, pse kishte disa shokë që tymosnin ilegalisht, apo si me thënë gjysmlegalisht. Poshtë katit të parë ishin dhoma e Peros, ekonomatit. depoja e ushqimeve, salla e ngrënies pa penxhere fare, vetëm me një derë në krye dhe me dritë, të cilën e hapnim dhe e mbyllnim kur hynim dhe dilnim. Dyshemeja e saj ishte me cemento, në mes kishte një sobë, tavolina e stola të gjatë dhe asgjë tjetër. Në krah të saj gjendej një dhomë me musllukë në mure, ku laheshim. Kuzhina ishte jashtë, përmbri, e veçuar. Nga pas internatit, në fund të një oborri të vogël ishin një sërë nevojtoresh me radhë. Në krahun e hyrjes së oborrit, shtruar me pllaka guri, ishte studioja, një sallë e madhe me banka nga të dyja anët, që kishte në mes një sobë, ndërsa përballë hyrjes, pranë murit ndodhej tryeza e ngritur e kujdestarit.

Shkurt ky ishte internati ku jetova tre vjet, për të cilin në përgjithësi ruaj kujtime të mira. Disa prej tyre do t'i përmend më poshtë.

Gjëja tjetër më e rëndësishme dhe gëzimi im më i madh ishte të shikoja liceun, të regjistrohesha. Dhe kështu bëmë. Në radhë, me dëftesat e shkollës me vete, të gjithë ne, internatistët, shkuam në lice. Ishim të gëzuar, qeshnim dhe këndonim rrugëve, të cilat i shihnim me kujdes. Shikonim me kureshtje njerëzit, të rinjtë e të rejtat, shtëpitë, dyqanet. Dolëm në një shesh të vogël. Përpara nesh ngrihej kinemaja «Mazhestik». një ndërtesë e përçmuar me cemento, pastaj morëm nga e djathta dhe u futëm në një rrugicë të vogël e të ngushtë me kalldrëm. Në të dyja anët e rrugës kishte shtëpiza të vogla si vila, të pastra. me penxhere me perde të bardha. Edhe kopshtet e tyre ishin të pastra dhe plot me lule. Nuk ecëm shumë. kur në të majtë na u shfaq ndërtesa e liceut, porta e madhe e tij me dy kolona. Më bëri shumë përshtypje dhe ndieja kënaqësi të madhe që do të mësoja në këtë institucion me emër dhe nga më seriozët e shkollave të mesme të vendit tonë.

U futëm brenda. Një korridor i gjatë hapej para nesh dhe një palë shkallë në krye. Nga të dyja anët e korridorit kishte klasa. Ne shikonim me vërejtje tabelat e klasave. Unë interesohesha të shikoja klasën time, klasën e dytë. Siç dukej ajo do të ishte në katin e dytë dhe në fakt atje ishte, sapo ngjitje shkallët. Në krah të klasës ishte drejtorja dhe pranë saj sekretaria. Ne u drejtuam në sekretari. Aty

do të hynim një nga një të regjistroheshim. Gjatë kësaj kohe, sa të më vinte radha, vizitova klasën ku do të punoja dhe do të mësoja një vit të tërë. Ishte dhomë e bukur, me katër penxhere të mëdha plot dritë, bankat ishin radhitur në dy sërë, me një korridor në mes. Në një qoshe ishte dërrasa e zezë dhe përballë bankave tona ndodhej tavolina e ngritur e profesorit.

Në katin e dytë ishin të gjitha klasat e larta të liceut, salla e fizikës, e kimisë, që përdorej edhe për korin e për muzikën. Po në këtë kat ndodhej dhe një «furriçkë»* *(Këtu në kuptimin dhomë shumë e vogël.) për kryekujdestarin e liceut. Më erdhi radha për t'u futur në sekretari. Më ranë menjëherë në sy regjistrat e mëdhenj. Aty çdo gjë ishte e pastër, në rr egull, sido që dhoma ishte e vogël. Në tryezë, përpara regjistrave, qe ulur një mesoburrë, i gjatë, dukej i hollë, me një fytyrë karakteristike, me preka në fytyrë dhe me leshra të kuqe dhe të dredhura. Ky ishte Poçi, «i famshmi» sekretar i liceut që kur ky u çel dhe derisa e mbyllën italianët, pasi pushtuan Shqipërinë. Poçi, me një zë karakteristik të hollë, më tha:

- Më jep dëftesën!

E mori, e lexoi, hapi një regjistër dhe më porositi:

- Të mësosh mirë !

- S'ka asnjë dyshim - ia ktheva unë.

Pasi më regjistroi, më zgjati dëftesën dhe më tha:

- Merre dëftesën e Liceut të Gjirokastrës.

- Zoti Poçi, - e pyeta, - kur do të vijmë të marrim librat?

- Për ju, internatistët, nesër pasdreke.

Marrja e librave ka qenë gëzim i madh për mua.

Më në fund çdo gjë u rregullua. Dita e parë e hapjes së shkollës erdhi. Rrugët ishin plot me nxënës, sidomos sheshi i «Mazhestikut» dhe ulica e liceut. Të gjithë profesorët francezë kishin ardhur. Kur afroi ora tetë u radhitëm të tërë përpara derës së madhe dhe pritnim se do të na fliste drejtori francez i liceut. Atë e quanin Baji Komt (Baylli Comte). Ishte një burrë i shkuar, me flokë të bardha, me një mjekër të vogël, me fytyrë shumë simpatike, po ishte i çalë dhe ecte me shkop. Ai doli në krye të shkallës tok me disa profesorë, shqiptarë dhe francezë, fytyra të gjitha të reja për mua. Baji Komti na përshëndeti me zë të lartë, na uroi punë të mbarë e na këshilloi të mësonim me kujdes. Ne e duartrokitem dhe pastaj të impresionuar u futëm nëpër klasa. Filluan kështu për mua, si për gjithë shokët, mësimet e para në Liceun e Korçës.

Ne, që vinim nga Liceu i Gjirokastrës, për sa u përket mësimëve nuk patëm asnjë vështirësi, pse programet ishin të njëjlojta, si në çdo lice francez. Kështu që çdo gjë filloi mirë. Ndryshonin vetëm profesorët, por edhe me këta u njohëm gjatë javës së parë e shpejt u simpatizua me ta. Vura gjithë përpjekjet e mia që të dilja mirë me mësimet. Isha i kujdesshëm në çdo drejtim, si në shkollë, edhe në internat. Përveç teksteve shkollore, që na i dhanë të gjitha në lice, në çdo klasë kishim biblioteka me libra të ndryshëm letrarë, të zgjedhur posaçërisht dhe me kujdes nga profesorët francezë. Të gjithë këta libra na ndihmuan shumë të zhvillonim më tej kulturën tonë, njohjen më mirë të literaturës franceze dhe botërore dhe të praktikoheshim më mirë në mësimin e gjuhës frënge.

Unë isha një lexues i madh jo vetëm i librave të klasës sime, por edhe të klasave të tjera, më të ulëta dhe më të larta. Veç këtyre huaja edhe nga shokët që sillnin libra nga Franca ose që i blinin në librarinë e Pepos. Brenda tre vjetëve që qëndrova në Liceun e Korçës, mund të kem lexuar me qindra libra letrarë, shumë romane dhe libra shkencorë që plotësonin mësimet e klasave. Librat i këndoja me kujdes, mbaja shënime, frazat dhe vargjet që më pëlqenin i mësoja përmendsh. Çdo fjalë që nuk e kuptoja, nuk e lija pa e gjetur në diksionerin «Petit Larousse» (që e ruaj si relike edhe sot në bibliotekë) dhe e përsëritja vazhdimisht derisa më ngulej në kokë. Kisha edhe një bllok, ku i shkruaja këto fjalë. Një studim i tillë i kujdesshëm i gjuhës më ndihmoi shumë jo vetëm që të dilja shumë mirë në gjuhën frënge, por të kuptoja mirë edhe lëndët e tjera, edhe ato më të rëndat.

Në frëngjisht isha nga më të mirët e klasës. Në hartim, në këndim, në komentimin e teksteve dhe në recitim isha, gjithashtu, nga nxënësit më të mirë në klasë.

Profesori i frëngjishtes në klasën e dytë ishte francezi Delion (Deslion), një mesoburrë i trashë, me fytyrë të rr umbullakët, mjekrosh me syze dhe gjysmëtullac. Ishte një burrë i shkuar, i sjellshëm, i

dashur me ne, por edhe ne e donim dhe e respektonim. Meqë ishte i trashë dhe mjekrosh, ne e quanim «Tarrtarin», të influencuar nga romani* *(«Tartarini i Taraskonit» - roman i shkrimtarit francez Alfons Dode.) i Dodesë dhe jo pse ishte egzuberant* *(Nga frëngjishtja, këtu në kuptimin e njeriut tepër të gjallë, gazmor e disi të hazdisur) si ai, por se kur shpjegonte, kishte disa manira të atilla pr e *bonhomme**, *(Frëngjisht - bablok, babaxhan.) që na bënë të qeshnim.

Shumë herë unë i kërkoja shpjegime për librat që lexoja. Ai nuk mungonte të me përgjigjej herë në klasë, herë kur mbaronte ora e mësimit. Ndalej në pupitrin* *(Nga frëngjishtja - bankë shkolle.) dhe më shpjegonte çka i kërkoja, herë-herë edhe duke zbritur shkallët me çantën plot me libra dhe me fletoret tona që mbante nën sqetull. I mjeri Delion vdiq në Korçë po atë vit. U hidhëruam shumë, vëmë e varrosëm me shkollën e me ceremoni në varrezat e ushtarëve francezë të Luftës së Parë Botërore 1914-1918. Varri i tij, si kurdoherë, edhe tash ndodhet atje. Si duket s'ka pasur njeri të tij që të interesohej për Via tërhequr eshtrat në atdhe.

Po atë vit vdiq edhe drejtori i liceut, Baji Komti. Dhe ky ishte një burrë i mirë, që e donim dhe e respektonim. Në vend të tij na erdhi Viktor Kutani, drejtori i Liceut të Gjirokastrës. Kjo na gëzoi shumë ne, nxënësit e tij të vjetër, që shkuam e pritëm dhe i uruam mirëseardhjen. Ai u gëzua. Siç dukej Liceun e Gjirokastrës po e varfëronte regjimi nga profesorët francezë, pse Kutani hoqi pas vetes André Brezhonë, Garigun e disa të tjerë. Por edhe drejtor Kutani, kur shkoi për pushime në Francë, vdiq dhe në vend të tij, kur kalova në klasën e parë, erdhi një drejtor i ri që quhej Leon Pere. Ai erdhi me gruan dhe me djalin e tij, Rozhenë, i cili ishte në një klasë me mua.

Liceu ishte një qendër arsimore me shumë rëndësi për Shqipërinë dhe në veçanti për Korçën, sidomos në ato kohë të regjimit feudal të satrapit Ahmet Zog. Programet e kësaj shkolle ishin të njëllojta me ato të të gjitha liceve të Francës dhe regjimi i Zogut nuk kishte të drejtë të ndërhynte për Vi ndryshuar, ose të cungonte lëndët që jepeshin atje. Regjimi i Zogut nuk e kishte të gjatë dorën kundër profesorëve francezë, pse ata kishin ardhur me kontratë e në bazë marrëveshesh të rregullta, prandaj s'i pushonte dot, ndryshe detyrohej të paguante dëmshpërblimet. Kështu që pikëpamjet me të cilat pajiseshin nxënësit në këtë shkollë, pavarësisht se atje jepej një kulturë borgjeze dhe profesorët, borgjezë me origjinë, qenë me tendencë politike të ndryshme, që nga ato ruajaliste dhe deri në socialiste, prapëseprapë ishin si nata me ditën në krahasim me pikëpamjet feudale të regjimit të Zogut. Për ne, në ato kohë, Liceu i Korçës ishte një qendër përparimtare dhe revolucionare. Them përparimtare, pse nga çka mësonim dhe lexonim atje, ne armatoseshim kundër regjimit feudal ,dhe, nga

ana tjetër, nëpërmjet liceut, hcrë fshehur e herë gjysmëlegalisht, na vinte edhe literaturë me të vërtetë progresiste, revolucionare dhe komuniste. Këtë literaturë të fundit ne e qarkullonim fshehurazi në shokë të besuar dhe e lexonim kurdoherë jashtë, në kodrat rreth Korçës dhe kurrë në internat, se mund të na diktonin. Kështu unë kam lexuar që në atë kohë disa pjesë të shkëputura të veprës së Leninit «Shteti dhe revolucioni», disa fjalime të Stalinit, disa përkthime të vogla nga libra të Karl Marksit dhe «Nënë» e Gorkit, e cila në atë kohë ishte e ndaluar dhe akoma e papërkthyer. Studimi në hollësi i Revolucionit Francez, i revolucioneve të tjera në Francë dhe në vendet e tjera, - dori te Revolucionit i Tetorit, që edhe ky trajtohej në mënyrën borgjeze, prapëseprapë neve na hapte horizonte të reja mendimesh, të cilat i plotësonim dhe i sqaronim me lexime të shumta të veçanta historike dhe letrare.

Historia e Francës ishte shumë e pasur në evenimente, por edhe me literaturë që i trajtonte këto evenimente. Në bibliotekën e liceut, përveç teksteve zyrtare, vinte jo vetëm literaturë klasike, por edhe literaturë sipas prirjeve dhe tendencave politike të profesorëve. Kështu, për shembull, unë, që në lice, përveç historisë zyrtare mbi Revolucionin Francez studioja dhe veprat e shumta historike rreth këtij revolucioni të shkruara në periudha të ndryshme nga Lavisi, Mishëleja, Matiezi, Madëleni, Maleja dhe Isaku, fjalimet e Dantonit, diskutet e zjarr ta të Robespierit, të Sen Zhystit e kështu me radhë.

Natyrisht, për ne djemtë e popullit, pikënisja dhe qëllimi ishin lufta kundër Zogut dhe përmbysja e regjimit të tij antipopullor, prandaj merret me mend sa me kujdes dhe çfarë interpretimelesh u bënim në kokat dhe në zemrat tona atyre çka mësonim në lice. Më kujtohet sa u gëzova kur këndova për

herë të parë Ronsarin, tek i cili gjeta një sonet për trimëritë e Skënderbeut. Na gufonin zemrat, si mua dhe shokëve të mi kur recitonim në frëngjisht e pastaj, të përkthyer nga ne vetë edhe në shqip, vargjet për heroin tonë lavdimadh:

*«O ti, nder i këtij shekulli O shqiptar i shënuar prej fatit Dora jote mundi turqit njëzet e dy herë Shtire tmerrin në radhët e tyre I bëre të lënë eshtrat në muret e kështjellës!»** *(Kur ishim në lice, secili i përkthente vargjet e të madhit Ronsar sipas aftësisë dhe prirjeve. Ishte vërtet kënaqësi të dëgjoje Epaminonda Bullcën, kur e deklamonte sonetin, gjithë gjeste e pasion me zërin e tij të mprehtë e me fytyrën që i bëhej prush e kuqe. Tash që po hedh këto kujtime, përkthimin po e citoj sipas Nondës. (Shënim i autorit.)

Përmbajtja e thellë e sonetit, arti me të cilin qe shkruar na ngazëllenin dhe akoma më të fuqishme bëheshin këto ndjenja kur mësonim se autori i tyre, Ronsari, ishte një nga poetët më të mëdhenj të Francës, bile udhëheqësi i Plejadës frënge. Me kohë iu futëm më me zell studimit e kërkimit dhe e festonim si ngjarje të vërtetë çdo «zbulim» të ri që bënim për Shqipërinë e shqiptarët në krijimtarinë e autorëve të shquar ose edhe më pak të njohur të Francës. Ngazëlleheshim kur lexonim se edhe Volteri i madh kishte shkruar për Skënderbeun e familjen e tij, kurse libri disavëllimësh i Lamartinit me titullin «Historia e Turqisë», na mbushte me krenari për pasazhet e gjata e kapitujt e tërë ku flitej me fjalë të zjarrta e vlerësime të mëdha për shqiptarët, për Skënderbeun, për virtytet e larta të popullit tonë, për luftërat e trimëritë e pareshtura e famëmëdha të shqiptarëve. Edhe më vonë e kam shfletuar këtë libër dhe pavarësisht nga mangësitë shkencore, kufizimet ideore e të meta të tjera të kuptueshme (Lamartini mbi të gjitha ishte poet), duhet të them se fjalët e konsideratat e tij për shqiptarët e virtytet e tyre, jo vetëm janë nga më të lartat që ka shkruar në shekullin e kaluar një pene e huaj, por edhe shprehin të vërtetën. Këto lexime më nxitën të këndoja shumë shkrimtarë të tjerë francezë, veçanërisht autore të shquar të Plejadës franceze. Edhe leximi i Montenjit, filozofit udhëtar, më solli kënaqësi të madhe, kur, që në fillim të «Eseve» të tij, merrte si shembull virtytet e larta të Skënderbeut tonë të famshëm. Gjithçka që shkruhej për Shqipërinë, dhe e vërteta është se shkruhej pak, ne e gjurmonim; pyetnim dhe profesorët francezë mos dinin se ku shkruhej më shumë për të.

Ne komentonim në klasë, lexonim jashtë klasës, recitonim dhe trajtonim tema kompozicionesh nga të gjithë klasikët e mëdhenj të shekujve që nga Klement Maro, Dy Belei, Kornei, Rasini, Molieri. Bualoi e të tjerë. Ne u hodhëm nga gëzimi kur profesori që na bënte «Andromakën» e Rasinit na tha se skenat e tragjedisë zhvilloheshin në Butrint të Shqipërisë. Kjo më bëri që të lexoja me kujdes të gjitha dramat e Rasinit, megjithëse nuk më pëlqenin dhe aq shumë. Edhe letrat e Madame de Sevignes nuk më bënin shumë përshtypje, pse, megjithëse ishin shkruar bukur dhe lidhur e thurur me mjeshtëri, ishin tipike të një gruaje llafazane, të papunë, që mban vesh andej-këndej ç'tuhet dhe ua fillon thashethemeve. Natyrisht, ato kanë vlerë si kronikë e shekullit kur ajo jetoi.

Komeditë e Molierit më pëlqenin më shumë, pse ato jo vetëm ishin shkruar bukur, ishin plot me *espri**, *(Nga frëngjishtja - këtu në kuptimin shprehje të mprehta, mendjeholla.) por të bënin edhe të mendoje për t'i kuptuar, edhe të reflektoje për të nxjerrë konkluzione mbi jetën, zakonet dhe mendimet e shekullit të tij. Në Gjirokastër, se në Korçë nuk kishte organizime të studentëve, kam luajtur në disa pjesë të Molierit që pasi i përkthenim, i interpretonim vetë në skenë.

Fabulat e La Fontenit, zinin natyrisht, një vend të rëndësishëm në orët e letërsisë franceze. Shumë prej tyre i dinim përmendsh. Maksimet e La Roshëfukosë më pëlqenin, por duhej të vrisje mendjen shumë për t'i kuptuar. Profesori i letërsisë, si duket, meqë e pëlqente, kishte një të keqe: na jepte për teme kompozicioni (hartim mujor e tremujor), një nga ato maksime. Edhe Bualoi më pëlqente për kritikën e tij therëse, të thata dhe të ftohta si thika.

Kur filluam studimin e fazës së Revolucionit Francez, epoka më e rëndësishme dhe më interesante e historisë franceze, kujdesi e vëmendja jonë ishin shumë të mëdha. E ndiqja zhvillimin e tij me pasion të veçantë jo vetëm nga librat e historisë, por edhe nga shpjegimet që na bënte profesori dhe nga materialet që ai na rekomandonte të lexonim jashtë teksteve. Kështu që e dija mirë lëvizjen e fraksioneve të ndryshme që përplaseshin, që nga zhirondinët, montanjarët, fejtantët dhe jakobinët.

Dija më shumë se në libër ç'ishte Miraboja, ç'liste dhe ç'bënte ai prapa shpinës së revolucionit. Po kështu më pëlqente shumë e më rrëmbente figura e shquar e Maratit. Më pëlqente thirrja e Dantonit «*de l'audace, encore de l'audace et toujours de l'audace*»*. *(Frëngjisht - guxim, prapë guxim dhe gjithmonë guxim.) Kështu na duhet të tregohemi edhe ne për të rrëzuar monarkinë e urryer të Zogut, i thosha shokut tim të asaj kohe, Enver Zazanit, kur shëtitnim në vreshtat e Shëndëllisë.

Ndiqja me mendje kokat, që nga ajo e Luigjit të 16-të dhe deri te koka e revolucionarit, të pakorruptueshmit Robespier, që ua priste gijotina dhe binin në shportë. Përshtypje më bënin fjalët e fundit të Dantonit, kur i kërkoi xhelatit ta lejonte që të puthte shokun e tij për herë të fundit. Xhelati nuk e lejoi dhe Dantoni i tha fjalët e famshme: «Megjithatë, ti nuk do të na ndalosh dot të puthemi në shportë». Por mbi të gjithë une doja jakobinët, Robespierin e Sen Zhystin, pse ishin të drejtë, patriotë e të rreptë kundër feudalizmit dhe monarkisë, të rreptë kundër fraksioneve reaksionare të borgjezisë që po ngjitej. Ata ishin mjeshtër për ndërtimin e një ushtrie revolucionare dhe të një politike revolucionare si brenda, ashtu edhe kundër koalicionit të mbretërve rreth e rrotull Francës. Me këtë rast më kujtohet një moment prekës për mua. Isha kthyer nga Korça për pushime në Gjirokastër dhe një ditë pyeta:

- Ku është Vehip Qorri, miku im i mjerë?

Më thanë se ishte i sëmurë. I kërkova plakut (babait) disa lekë, bleva një çyrek bukë të bardhë, një copë djathë dhe një shishe me qumësht dhe shkova të shihia Vehipin në haurin e tij të mjeruar. Vehipit nuk kisha nevojë t'ia thosha emrin, se më njihje nga zëri. Hapa derën e haurit, ku, në një qoshe i shkreti Vehip, ishte mbuluar me brucë.

- Xha Vehip, mirë se të gjeta, - i thashë me zë të lartë, - të jenë të shkuara!

Vehipi hoqi brucën, lëvizti me mundim dhe foli me bejte, siç bënte ngahera. Afërsisht ai më tha këto:

«U gëzova shumë që më erdhe ti, Erësi e sive m'u duk se m'u fshi, Fyelli i Vehipit këndon përsëri O i ziu unë që s'të shoh me si Po ti je Enveri, shoku im i ri».

U ula afër tij, më përqafoi, i ngroha qumështin në një okare të vjetër që kishte, ia bëra përshesh dhe filluam muhabetin. Më pyeste për shkollën, për mësimet dhe thoshte:

- O i ziu unë që s'kam si e s'mësova kurrë.

Për t'i ngritur kurajën i thashë:

- Edhe të tjerë njerëz të mëdhenj kanë pësuar fatkeqësi trupore, - dhe i tregova se ishte një muzikant i madh me emrin Bethoven, që luante në piano, i këndonte Revolucionit Francez, pastaj u bë shurdh.

- Ti je qorr, por ti i bie curles me mjeshtëri të madhe, i këndon popullit që do të ngrihet një ditë në revolucion, - i thashë pastaj Vehipit.

Vehipi, ngriti ata sy pa jetë dhe më pyeti:

- Po ç'do të thotë revolucion?

Unë fillova t'ia shpjegoj, i fola për Robespierin dhe më në fund i thashë:

- Do të vijë dita, që popullin do ta ngremë me armë

në dorë dhe do t'ua hamë kokën mbretit dhe agallarëve. Vehipi me lugë në dorë dhe me fytyrë të ndezur nga

ethet më tha

- Ma thuaj dhe një herë emrin e atij francezit!

- Robespier, - iu përgjigja dhe Vehipi e thuri bej

ten zjarr për zjarr:

*«Nur o Robespier, as të njihja kurrë,
Po Enveri sot më tha se ishje burrë
Trim i papërkulur, që s'u theve kurrë...»*

Kur u ndava me Vehip Qorri ky më pyeti:

- A do ta arrij unë revolucionin?

- Po, do ta arrish dhe do të gëzosh frytet e tij, pse atëherë do të vijë populli në fuqi, - i thashë.

Pas Qirimit, kur shkova në Gjirokastrë, më doli Vehipi përpara. Shokët ishin kujdesur për të. Ai më përqafoi dhe më tha:

- Enver, e mbajte fjalën, tani le të vdes.

- Jo, - i thashë, - xha Vehip, tani duhet të rrosh, pse duhet t'u këndosh me fyell heroizmave të popullit, të Partisë, të partizanëve.

Ai jetoi i përtëritur dhe i gëzuar, derisa vdiq, në azilin e pleqve të Gjirokastrës.

Por, gjersa erdhi dita që edhe Vehip Qorri në Gjirokastrë të shihte triumfin e revolucionit tonë, kishin rrjedhur shumë ujëra e qenë rrokullisur shumë ngjarje nga ato vite të rinisë sime, kur unë vetë në Korçë isha futur gjithë zell në libra e diskutime që të mësoja ç'ishin revolucioni e revolucionarët. Në ato vite për mua kishte rëndësi jo vetëm si u rrokullisën ngjarjet e revolucionit, por edhe si u përgatit ai. Prandaj lexoja me etje enciklopedistët, veprat e Didëmit që nga «Nipi i Ramoit» dhe devi të «Murgësia» e «Letrat e D'Alamberit». Këndoja «Kontratën sociale» dhe «Emilin» e Rusoit, vepra të shumta të Volterit si: «Anet filozofike», «Diksioneri», «Kandidi». «Historia e Kalasit» dhe deri të «Karnavalet e Venecias».

lië kujtohet një shok që kishim në lice nga Gjirokastra, Vehap Ciu. Ishte një klasë më lart se unë. matematicien shumë i zoti; zgjidhjet e problemeve të tij ishin aq origjinale, saqë shtypeshin në analet e matematikës në Francë krahas për krahas me ato të liceistëve francezë. Vehapi flinte në një dhomë me mua. Ai edhe të hante harronte; djathi që i dërgonin nga Gjirokastra i qelbej në dollap e binte erë dhoma.

Një natë kur shkuam në dhomën e gjumit dhe filluam diskutimet filozofike, sic. e kishim zakon, i them Vehapit:

- A mundet, Vehap, të më zgjidhësh këtë problem të pakuptueshëm për mua? Në një vend, ku janë mbledhur mbretërit e Volterit, në «Karnavalet e Venecias», është një kolltuk bosh (këtë e stisja unë). Nuk e kuptoj pse e ka lënë bosh Volteri?

Vehapi më thotë:

- Më bëj pyetje për ndonjë teoremë gjeometrike të të përgjigjem, se këto që më thua ti, s'i marr vesh.

Kërceu një shok tjetër dhe më pyeti:

- Po pse e ka lënë bosh, Enver ?

- E ka lënë që të vejë mbreti Zog, - i them, pse do të vijë dita që edhe ai, si mbret i shkurorëzuar. do të vejë në «Karnavalet e Venecias»...

Kur një nga profesorët e mi francezë më dha historinë e Matiezit dhe atë të Zhoresit mbi revolucionin, atëherë unë i kuptova akoma më mirë ngjarjet, rolin e masave të borgjezisë. të revolucionarëve dhe përleshjen e ideve të tyre.

Një sërë romanesh të Dymasit (atit). të Viktor Hygoit, të Anatol Fransit, më plotësonin dijet e mia. Dymasin e përpija, Anatol Fransi më pëlqente shumë. Viktor Hygoi ishte poeti im më i preferuar. Gati të gjitha veprat e tij në prozë. në dramë dhe sidomos në vargje. i thithja me etje të madhe. Me mijëra vargje të veprave të tij i dija përmendsh. Viktor Hygoi e doja dhe e mbroja.

Profesori i letërsisë frënge. Maravali. që nuk e donte aq shumë Hygoi. më filloi një ditë:

- Të mungojnë leshrat e gjata dhe jeleku flambua jant* *(Nga frëngjishtja: r - i kuq si flaka.) si i Teofilit*, *(Teofil Gutie - Strikrintar francez, një nga përkrahësit më të zjarrtë të Viktor Hygoit në betejën letrare për «Hernanin» - më 1830.) për të mbrojtur Hygoi.

Në provimin e bakaloratit të parë më ra pikërisht një temë për Hygoi. Pyetjet vinin në zarf me dyllë që nga Parisi dhe ishin të njëllojta për të gjitha licetë e Francës. Natyrisht unë e dhashë provimin e frëngjishtes shumë mirë. Më ndihmoi Viktor Hygoi.

Periudha e historisë së Napoleonit (*Premier Empire*) ishte, gjithashtu, interesante. Atë e mësonim në lice gati në detaje; c.do betejë e tij shoqërohej me harta të vec.anta, deri në atë shkallë sa dinim edhe emrat e çdo mareshali, forcat që komandonte dhe në c.'pozicione qëndronte në beteja. Sidoqoftë, ne mësuam se si terrori termidorian mbyti revolucionin, se si borgjezia që po ngjitej vendosi diktaturën e saj të egër dhe solli në fuqi një diktator, një despot, që e transformoi republikën në një perandori. Ne e admironim Napoleonin nga gjenia e tij ushtarake, nga shkathësia në beteja, ku binte si rufë dhe i mundte koalicionet e armiqve. Por, pavarësisht se Napoleoni ishte një reformator, një organizator i madh, një administrator i shquar dhe se ushtritë e tij, dulce zaptuar vende, dulce rrëzuar frone, c.onin kudo ku shkelnin frymën e revolucionit në Evropë. ai vetë ishte një despot, një tiran. një skllavërues i popullit francez dhe i popujve të tjerë. Shumë libra e romane kam pasë kënduar për këtë periudhë. që. natyrisht. plotësonin kulturën time dhe më forconin urrejtjen për tiranët. por njëkohësisht mësoja nga veprimet e tyre. nga zhvillimet shoqërore, nga idetë që shtjelloheshin. Të gjitha këto më përgatitnin politikisht për të dalluar më mil-ë rrugët e vështira të jetës. Përmes të cilave duhej ecur në ato vite shumë të zymta për atdheun tonë dhe për ne, djalërinë.

Periudha e mëvonshme e historisë së Francës dhe e asaj botërore, domethënë historia moderne dhe ajo kontemporane, siç i quanim dhe që na i zhvillonin në klasën e parë dhe në atë të filozofisë, na çeli horizonte dhe perspektiva të reja. Një ditë profesori, kur na fliste për Napoleonin e 3-të ose «Napoléon le Petit», për Sedanin, për Versajën, për Tierin dhe Bismarkun, na foli edhe për Komunën e Parisit dhe për komunarët. Ne ishim të parapërgatitur, prandaj ngritëm veshët. Ai për herë të parë foli për Karl Marks dhe për «Manifestin Komunist». Unë fshehurazi kisha siguruar nga Franca «Histoire des luttes des classes en France», por «Manifestin» akoma nuk e kisha dhe s'e kisha lexuar. Ngrita gishtin dhe e pyeta profesorin:

- Po kush ishte Karl Marksi dhe ç'donte të bënte ai?

Profesori u përgjigj

- Unë s'jam marksist dhe është e ndaluar të flas këtu për të, megjithatë, mund t'ju them disa gjëra.

Dhe na tha me të vërtetë disa gjëra të çala, duke e denigruar Marks.

Për sa i përket «Manifestit», ky më ra në dorë në mënyrë ilegale. Kisha një vit në Korçë, njihja mjaft shokë nga qyteti, njihja edhe disa punëtorë. Një të diel, kur po shëtitnim nga Mitropolia, një punëtor nga Korça, më i ri se une, që nuk ia mbaj mirë mend emrin, megjithëse mund të ishte Foni Thanoja, më tha:

- Hajde të hamë një pastë te Koci Bakoja.

Hymë atje dhe i kërkuam Kocit nga një pastë. Koci i tha Fonit

- Ç'e ke këtë student?

- Është yni, - iu përgjigj Foni.

- Po dilni edhe kënde, o studentë, - më tha Koci, - se mos i bën pastat më të mira pasticeria «Stambolli»! Apo atje ka pasqyra rreth e rrotull!

Fjalët e Kocit më dogjën. Të tretën herë që shkova te Koci, s'kishte njeri. Ai m'u afrua, më solli pastën e zakonshme dhe më tha:

- Pasta bën një lek, por kjo që do të të jap, është shumë më e ëmbël dhe pa para. Këndoje, përktheje, mbaje fshehur dhe ma kthe prapë.

Ishte «Manifesti»! E futa në gji, i shtrëngova dorën Kocit dhe ika. Rugës për në internat më dukej sikur njerëzit më shikonin dhe më pyetnin: «Ç'ke në gji?».

Në gjuhën e letërsinë shqipe, e vetmja lëndë kryesore që në lice bëhej në gjuhën e mëmës, kishim si profesor Kostaq Cipon. Ishte një nga profesorët më të zotë, në mos më i zoti në gjithë Shqipërinë. Cipoja kishte një autoritet

të madh në lice, ne e donim dhe e respektonim shumë. Letërsinë shqipe e njihje, si i thonë fjalës, në gishta. Por, natyrisht, ai ishte i zoti edhe në gramatikë e në sintaksë.

Kishte, nga ana tjetër, një kulturë të gjerë, dinte mirë latinishten, italishten, gjermanishten, frëngjishten, greqishten, mundet dhe gjuhë të tjera. Me ne, nxënësit, Cipoja

sillesh shumë mirë, na donte dhe ne e donim, pse na mbronte në çdo rast. Unë ndiqja me vëmendje shumë të madhe kurset e zotit Cipo, i cili na fliste me mjaft kompetencë për letërsinë tonë, për rilindësit, për arbëreshët. Fare pak ose

aspak nuk fliste për kalemxhinjtë e regjimit, të cilin nuk e donte, si demokrat përparimtar që ishte. Ne e ndienim që ai ishte antizogist, por ruhej shumë të fliste, bënte vetëm aluzione ironike. Ne kishim pak tekste letrare në shqip dhe ata libra të Naimit, të Çajupit etj., që ishin botuar, zor t'i gjeje t'i blije; regjimi i kalbur i Zogut as që kishte ndonjë plan botimi për ta.

Shumë gjëra, bile më të shumtat, Cipoja na i shpjegonte me gojë, na i diktonte ose na i jepte t'i kopjonim në shtëpi. Kur fliste, qoftë në klasë, qoftë jashtë, Cipoja ngrinte kokën dhe sytë i mbante në tavan, ose mbi kokat tona; nuk të shikonte në sy. Në shqip, unë isha nga nxënësit më të mirë të klasës; në hartimet që na jepte, dilja

kurdoherë mirë dhe isha shumë i kënaqur që kisha estimën e profesor Cipos. Në rast se nuk gabohem, Cipoja kishte mësuar në Itali dhe andej kishte kaluar nga arbëreshët, prandaj kishte një pasion të veçantë për literaturën arbëreshe. Ne, natyrisht, i kishim arbëreshët në program.

por kur vinte radha e tyre, Cipoja shkrihej nga qejfi. Ai na bënte të donim De Radën e «Milosao» e tij, të cilin e dinte gati përmendsh dhe na e recitonte pjesë-pjesë në të folmen arbëreshe. Ne këtë të folme e kuptonim ca me zor, por me ndihmën e Cipos iu futëm punës dhe na u bënë të dashur ashtu si De Rada edhe Zef Serembja, Gavril Dara, Zef Skiroi. Në çdo mësim Cipoja kalonte edhe nga një temë në tjetrën, bënte edhe shaka që na nxitnin të qeshnim, por me «tertipe». Shumë herë Cipoja edhe na ironizonte ne, nxënësit, por asnjëherë me zemërligësi. Fishtë, Faikun (Konicën) dhe Nolin, Cipoja na i shpjegonte mirë, megjithëse ishte antifetar. Për Fishtë ai na thoshte:

- Të përpiqemi të kuptojmë ç'ka burrnore brenda tij, restin hidheni në lumë!

Faikun e mburrte si shkrimtar erudit e si polemist. Nolin po ashtu, sidomos përkthimet e tij. Vjershat e Nolit i dëgjonim rrallë nga goja e Cipos, por ne i mësonim vetë, sidomos ato me të cilat godiste në kokë Zogun. Natyrisht unë kisha mësuar elegjinë për Bajram Currin, atë për Luigj Gurakuqin e plot të tjera, të cilat më pëlqenin shumë edhe për faktin se Noli ishte një njeri i shquar, demokrat, antizogist. Nëpër studentët flitej që. «pavarësisht se është prift, Fan Noli është komunist, ka vajtur në Rusi» etj.

Cipoja, me dashurinë e tij për letërsinë shqipe, natyrisht, nuk mund të neglizhonte edhe folklorin e pasur të vendit tonë. Shumë herë ne i kërkonim shpjegime kur lexonim nga thesari i krijimtarisë popullore ndonjë pjesë që ishte shkruar në një të folme të rëndë, të veçuar të rralësisë. Ishte në ato vite njëfarë autori nga Veriu, i cili në shkrimet e tij nuk kuptohej fare. jo vetëm nga ne të Jugut, por as edhe nga shokët e Veriut. Kur e pyetnim Cipon të na shpjegonte fjalë nga të këtij autori, ai na përgjigjej me ironi:

- Nuk ekzistojnë në diksionerin e gjuhës gjermane!

Cipoja kishte admirim për albanologët, sidomos për ata gjermanë dhe austriakë, por dashuria e tij për ta nuk ishte idolatri, siç ishte për ndonjë tjetër. Cipoja i dente në përgjithësi autorët e mëdhenj gjermanë, ai ishte i zoti edhe në letërsinë gjermane, lëndë të cilën na e zhvillonte, pse ishte në programet e klasës së filozofisë, në qoftë se nuk gabohem. Sidoqoftë, unë që në lice këndoja me etje Gëten dhe dramën e Shilerit. Cipoja na recitonte «Nibelungët», «Ulenshpigelin» e shumë pjesë nga autorë gjermanë, sidomos romantikë. Ai i njihte këta autorë ndoshta edhe ngaqë ia kërkonte programi i lëndës që jepte, por përshtypja ime ishte se Cipoja kishte më simpati për literaturën gjermane, pa qenë «gjermanofil». Ai e donte edhe literaturën italiane, por pak na fliste për të.

Ishte koha kur në Itali kishte ardhur në pushtet fashizmi, koha kur Zogolli po futej gjithnjë e më tepër nën frerët e Italisë e po shiste Shqipërinë dhe, kuptohet, këto, veç arsyeve të vjetra, bënë që populli, djalëria, njerëzit përparimtarë të mos kishin dëshirë të flitej për italianët. Për pipinot, mandolinat tona binin në akord të plotë me atë të Cipos.

Cipoja, si i dashuruar pas folklorit, na jepte detyra jashtë shkollës për ta ndihmuar. Mua më vuri detyrë që, kur të kthehesha nga pushimet në Gjirokastër, Vi përshkruaja në hollësi më të plota «dasmën gjirokastrite».

Më kujtohet që ia plotësova me kujdes të madh këtë detyrë, duke shënuar si zakonet, ashtu dhe një numër të madh këngësh që këndoheshin në dasma. I mbusha nja tri fletore shkoile dhe ia çova kur u kthyem në vjeshtë në lice. Cipoja mbeti shumë i kënaqur nga puna ime, nga pasioni im për folklorin. Këtë e kisha vënë re edhe në porositë që më jepte sa herë shkoja me pushime në Gjirokastër. Më thërriste dhe më thoshte me atë zë të hollë dhe të zgjatur, duke i ngritur sytë në tavan dhe duke i lëvizur dendur qepallat:

- Pa hajde ti, Hoxha, ç'do të na sjellësh të re nga Gjirokastra! Më grumbullo këto, ato etj.

Dhe unë kurrë nuk i mungova detyrës. E respektoja dhe e doja shumë këtë profesor të gjuhës së mëmës, që më kaliti dashurinë për gjuhën. për thesaret e atdheut, që na orientonte kurdoherë drejt në rrugën patriotike dhe demokratike.

Më vonë, kur u emërova profesor në Korçë, u bëra koleg i tij. Pas Çlirimit të Shqipërisë, kur ish-ministri i Arsimit Gjergj Kokoshi u dënua për veprimtarinë e tij armiqësore, e thirra profesorin tim të vjetër dhe i propozova të bëhej ministër i Arsimit. Ai e pranoi propozimin dhe qoftë si ministër, qoftë si gjuhëtar punoi me ndërgjegje të lartë, derisa vdiq nga kanceri. Më erdhi shumë keq kur vdiq Cipoja, pse ruaja kujtimet e mira të jetës së shkollës, kujtoja brengat dhe gëzimet kur dhamë bakaloreatin e parë, provime shumë të rënda, dhe kur Cipoja, duke kaluar në korridor më tha:

- Hoxha, më ke bërë një hartim shumë të mirë!

Por, le të kthehemi përsëri në internat, se atje kam kaluar një pjesë të mirë të jetës sime shkollore. Nga internati ruaj kujtime të mira, por edhe disa jo të mira. Kujtimet jo të mira kanë të bëjnë me burokracinë e internatit, kurse nga jeta në shoqëri ruaj plot kujtime të bukura. Kurdoherë në jetën time kam qenë optimist, i hapët, i sigurt dhe i dashur me njerëzit dhe me shokët. Përnjëherë lidhesha me ta, shoqëroheshja. Kështu që, me të filluar shkolla, filloi jeta e rregullt «familjare» në internat. Ishim me të vërtetë si një familje e madhe, të përzier nga të gjitha krahinat e vendit, veç korçarëve. Në internat kishte shokë nga Shkodra, Mirdita, Mati, Peshkopia, Kosova, Vlorë, Tirana, Elbasani. Gjirokastrë. Mund të bëheshim mbi 150 veta dhe çdo vit vinin të rinj, vinin edhe të rritur, në klasat e mesme të liceut. por edhe në klasat e para të tij. Në internat pranoheshin nganjëherë edhe jobursistë.

Sido që kishte edhe të meta. jeta në internatin tonë ishte normale, kishte atje disa rregulla të brendshme që atëherë na dukeshin disi rigorozë, por. duke i gjykuar më mirë, shumë prej tyre ishin të doinoshme. Në mëngjes ne ngriheshim herët, me zile, së cilës i binte Iloja dhomë më dhomë. Kjo ishte ca e mërzitshme, por e domosdoshme. Ilon dhe Gurin, që na shurdhonorin me zile, ngandonjëherë edhe i sikter ishim pa të keq, por dhe ata s'mungonin të na përgjigjeshin në të folmen e kripur korçare. Çdo veprim në internat bëhej me zile, kështu që kjo na u bë zakon. Dimër-behar, sa ngriheshim nga krevati; edhe në dimër kur bënte ftohtë e binte borë, me të dëgjuar zihen shkonim jashtë në banjat për të zënë r'adhën, pastaj prapë me vrap ktheheshim me sapunin personal në dorë e me peshqir në qafë (furçën e dhëmbëve nuk e njihnim në fillim) dhe futeshim e lanim fytyrën, kriheshim në dhomë, visheshim dhe drejt e në studio. Atje bënim një orë e gjysmë studim të detyruar. Duhet të ishte puntual,* *(Nga frëngjishtja - i përpiktë.) se merrje dënim dhe dënimi më i rëndë për ne ishte të mos dilje të dielën në qytet. Kjo ishte «vdekje»!

Pas studimit të mëngjesit, shkonim hanim bukë.

Mëngjeseve zakonisht hanim djathë me çaj ose qumësht me marmelatë, asnjëherë gjellë. Gjellë kishim në drekë dhe në darkë.

Si hanim mëngjesin, merrnim librat, viheshim kurdoherë në radhë dhe shkonim në lice. Me ne vinte çdo ditë kujdestari që na shoqëronte; rrallë e tek i bënim bisht radhës. Pesë ose dhjetë minuta para se të fillonim mësimet, ne ose futeshim në oborrin e vogël të shkollës, ose vërtiteshim në rrugicë derisa binte zilja, këtë herë jo nga Guri, por nga portieri i shkollës, «i famshmi» Nisi. Kur mbaronim mësimet, sidomos të pasdrekes, po edhe në mëngjes kur mungonte ndonjë profesor, duhej të shkonim përsëri në radhë në internat. Në kthim bëheshin edhe orvatje nga ndonjëri që t'i shpëtonte radhës, me leje e pa leje. Në këto raste kishin vend edhe gënjeshtret e vogla ndaj kujdestarit, edhe grindjet dhe marifetet që përdornim kundër portierit Nisi. Na shtynte instinkti i natyrshëm i lirisë, i pavarësisë, lufta e nxënësve kundër disiplinës burokratike. Tani atë shoqërim

me rojë në çdo hap e kujtoj me humor, por fakt është se në atë kohë, kur qemë të rinj, as unë, as shokët e tjerë s'e duronim dot, na krijonte vazhdimisht një ndjenjë e gjendje të pakëndshme, gjer revoltuese. Por rregulli ishte rregull e duhej zbatuar. Ndryshe të fluturonin.

Pasi hanim drekën, vinim rrotull nëpër oborr të internatit, derisa vinte koha e shkollës, se, siç thashë, kurdoherë kishim mësim edhe pasdreke. Kishim të drejtë të hynim kur të donim vetëm në studio, kurse në dhoma që të shtriheshim ose të çlodheshim në mesditë nuk na lejohej. Ato ishin mbyllur me çelës dhe hapeshin vetëm kur vinte ora e gjumit të natës. Kur ktheheshim pasdreke nga shkolla, prapë vinim rrotull në oborr, luanim, këndonim, bënim muhabete e diskutime, derisa hynim një orë e gjysmë të detyruar në studio para se të hanim darkën dhe pasdarke përsëri, pas një pushimi të vogël, bënim edhe dy orë të tjera studim dhe vetëm atëherë hapeshin dhomat e gjumit dhe mund të veje të flije. Kush dëshironte të mësonte mund të rrinte në studio edhe më vonë. Ky ishte në përgjithësi orari i ditës në internat.

Orari i studimit ishte i organizuar mirë dhe e respektonin gati të gjithë. Kjo na ndihmonte shumë në mësim. Me të rënë zilja, të gjithë futeshim në studio dhe studionim, në qetësi të plotë. Ishte bërë zakon i mirë që ndonjë që hynte më vonë në studio, hapte derën me kujdes dhe në majë të këmbëve shkonte ngadalë në vendin e tij. Gjatë kohës së studimit bisedimet me njëri-tjetrin, se rrinim nga dy veta në një bankë, bëheshin me zë të ulët. Kur kishe nevojë të dilje, do të merrje leje nga kujdestari, i cili kurdoherë rrinte me ne në studio dhe, ngandonjëherë, kur i duhej të largohej, në vend të vet linte një nga të rr iturit. Veçanërisht në dimër, kur jashtë bënte kallkan, studioja ishte e ngrohtë nga soba, por sidomos nga frymët tona, pse, edhe kur bëheshin orët e pushimit, s'kishim ku venim dhe qëndronim brenda, diskutonim ose këndonim këngë të krahinave nga vinim.

Grindje e mëri në mes të shokëve në internat nuk mbaj mend asnjëherë. Përkundrazi, të gjithë ishim shumë të lidhur me njëri-tjetrin dhe nuk ekzistonte aspak midis nesh fryma e ngushtë e lokalizmit, nuk shikoje kurrë veç gjirokastritët, veç shkodranët, veç shokët e malësisë, veç delvinjotët e kështu me radhë. Bile ky solidaritet internati manifestohej jashtë, ngandonjëherë edhe me violencë kundër korçarëve, sidomos në lojërat e futbollit. Ne të internatit kishim ekipin tonë. Unë nuk luaja, por luanin të tjerë, sidomos disa shokë nga Veriu. Kishim mes tyre lojtarë të mirë dhe të pasionuar, si: Anton Mazrekun, Rifat Jolldashin, Zef Mirditën e të tjerë.

Një ditë ekipi ynë luajti me ekipin «Skënderbeu» të Korçës. Dhe ata kishin lojtarë të zotë, si: Pilo Peristerin, Teli Samsurin e të tjerë. Më duket se në ndeshje ne fituam, por nga mbarimi i lojës, s'di pse, gjakrat u nxehën dhe tanët u goditën me grushte me korçarët. Ne, tifozët e internatit, në bllok u vërsulëm në fushë, mirëpo në të njëjtën kohë u vërsulën edhe tifozët e Korçës dhe filloi një përleshje «e bukur», me grushte e me shkelma në mes nesh, saqë vetëm errësira e natës na ndau. U kthyem në internat kush me sy të nxirë, kush duke çaluar, kush me këmishë të çjerrë ose pa kopsa në xhaketa. Natyrisht, kjo u bë çështje në internat dhe në shkollë na qortuan, por masa nuk u morën kundër askujt. Gjakrat u qetësuan shpejt dhe më pas këtë grindje e kujtonim me shaka si «përgatitje për betejë».

Asnjëherë nuk ngjau që të na humbiste ndonjë send në internat nga dollapët e gjithsecilit. Kjo ishte një karakteristikë e lartë. Gjithashtu, nuk kishte nxënës që, po t'i ndodhej diçka për të ngrënë dhe t'ia kërkoje, të mos ta jepte.

Nga krahina e Gjirokastrës ishim një grup shokësh, si Eqrem Hadoja, Epaminonda Bulka, Feim Çarçani, Myslim Çarçani, Selami Xhaxhiu, Enver Zazani, Stavro Gjollma e të tjerë. Unë, që kisha qejf të këndoja labçe në kohën e pushimit, bashkohesha me Eqr emin, me Feimin, me Kadri Babocin dhe me Abdulla Ramin e ia merrnim këngës.

Tipa të çuditshëm nga më të ndryshmit shihje në internat dhe, po kështu, në mënyra të ndryshme mbaruan ata në jetë. Epaminonda Bulka kishte prirje që në atë kohë për vjersha dhe shkrime. Atë e quanim: «Bilbili i Përmetit». Ishte i sjellshëm, i drejtë, i dashur, optimist dhe demokrat në shpirt. I tillë mbeti ai gjithë jetën. E doja shumë Nondën që në atë kohë dhe këtë dashuri e kisha në përgjithësi për përmetarët, si Sotir Angjelin dhe të tjerë, emrat e të cilëve nuk më kujtohen. Kurse delvinjotët ishin ca fodullë dhe ambiciozë, por, në përgjithësi, mësonin mirë. Mësonte mirë Eqremi; Feimi ishte i zoti në matematikë, Myslimi ishte shumë i thjeshtë dhe i zoti, gjithashtu, në

matematikë. Ndonjë prej delvinjotëve simpatizoi më v onë Ballin, por nuk u hodh me armë kundër nesh. Abdulla Rami mbaroi në burg si ballist, ai ishte kokëngjeshur dhe i prapë, nga ata që populli i quan martallozë.

Shkodranët ishin shokë të mirë, nuk shkëlqenin në mësim, po ishin të gojës dhe i donin sportin e humorin. I tillë ishte Anton Mazreku, të cilin e kishim oratorin e internatit dhe tifoziin e topit. Kurse Tef Jakova ishte një tip i heshtur. Ai më shumë rrinte në krevat, sesa vinte në shkollë. Kurdoherë që hynim në dhomën e tij që ishte afër sobës, atë dhe Nazmi Uruçin (që më pas u bë oficer e mbaroi keq) i gjeje në dhomë, shtrirë në krevat, jo se ishin sëmurë, po bëheshin si të sëmurë. Kjo dhomë ishte e famshmeja «dhomë e veteranëve» të internatit, dera e së cilës mbyllej nga brenda dhe hyhej me parulla. Kjo ishte dhoma e diskutimeve filozofike, politike e letrare. Këtu flinte Rasim Bako nga Kosova, në klasën e filozofisë, një shok shumë i mirë, i qeshur, i thellë (por nuk di ç'është bërë); aty flinte gjithashtu Shefqet Shkupi, edhe ky në klasën e filozofisë. Me të ishim edhe në Francë; ishte një djalë kosovar shumë i mirë, i ndershëm e patriot, që më pas u bë gjykatës në Vlorë. Në këtë dhomë vajti më vonë Nonda Bulka, pastaj vajta edhe unë. Nga kjo dhomë unë kam kujtime nga më të mirat. Atje vinin edhe shokë nga jashtë që na vizitonin, si Aqif Selfoja, Sinan Imami e të tjerë. Brenda saj lëvonin muhabeti dhe cigarja. Më në fund përzihej me ne edhe kujdestari i internatit, Hasan Rami. Tef Jakova pinte me llullë dhe, kur vinte kontrolli i drejtorit të internatit, llullën e ndezur Tefi e fshihte nën jorgan për respekt, por kontrollorët i thoshin me të qeshur:

- Tef, të paktën mos na i qelb jorganët.

- Jo allahile, - thoshte Tef Jakova, - do e pres, se më ka helmue !

Kur vinte doktori dhe kontrollonte kush ishte sëmurë në internat, sa shkonte tek Tefi, e pyeste:

- Ç'ke Tef?

Ai i përgjigjej

- Për at zot, doktor, më dhemb tapanxha e kresë!

Në të vërtetë Tefi nuk kishte asgjë dhe kjo u bë një «frazë» e kuptueshme për doktor Hakiun, një burrë plak e patriot, i cili, kur na pyeste «çfarë ke?» dhe ne i thoshim «më dhemb tapanxha e kresë», kalonte pa na mjekuar.

Mirëpo një ditë, kur isha në klasën e pare, ose në klasën e filozofisë, ndihesha shumë sëmurë, me ethe të madhe, kisha humbur edhe ndjenjat. Kur erdhi doktor Hakiu, si më zbuloi kokën nga jorgani, më tha duke kaluar:

- Si kurdoherë, tapanxha?

Në të vërtetë unë isha shumë sëmurë dhe i bërtita, kurse ai vazhdoi të ikte. Atëherë unë mora shishen e ujit në penxhere dhe e vërvita për t'i tërhequr vëmendjen. U alar mua i shkreti, u kthye dhe tha «ta kurojmë shpejt djalin». Në internat nuk kishte infermieri në kuptimin e vërtetë të fjalës, kështu që erdhi më mori kujdestari im, patrioti Ramiz Shehu, miku i babait tim, më çoi në shtëpinë e tij, ku ndenja disa javë, sa u shërova. Kur u çova, shkova i kër-kova ndjesë dhe e falënderova doktor Haki Mborjen.

Rasim Bakoja ishte organizatori kryesor i diskuti meve që bënim në dhomë. Një pasdreke, «Kapsulli» (ishte nofka e Nazmi Uruçit) na zuri njërin pas tjetrit ne të dhomës dhe na laj mëroi se natën vonë, në orën 10 do të ketë debate dhe do të referojë Rasimi. U mblodhëm në dhomë. Si zakonisht Rasimi ishte shtrirë, Tefi po ashtu.

Të gjithë ne të tjerët lamë studion dhe hymë te «veteranët». Debatet filluan. Rasimi e mori fjalën dhe gjatë një çerek ore filloi të flasë me terma pesimistë mbi jetën, mbi kotësinë e sai e të tjera pikëpamje të tilla, që në të vërtetë nuk përputheshin me mendimet e tij. Ne guditeshim nga i nxirrte Rasimi këto pikëpamje, qfarë ndryshimi kishte ngjarë tek ai. Gjatë diskutimit Rasimi, që ta ilustronte mendimin e vet, futi edhe çështjen e robërimit të Kosovës nga serbët, foli për vuajtjet dhe mjerimet e kosovarëve. Tef Jakova thithte llullën dhe thoshte herë pas here:

- Jam dakord me Rasimin.

Kur mbaroi Rasimi, e morëm fjalën të gjithë ne, njëri pas tjetrit.

- Jam dakord me ty në disa qështje që shtrove për Kosovën, - i them Rasimit kur mora fjalën, - por nuk jam dakord me pikëpamjet e tua filozofike mbi jetën. Nuk e kuptojmë metamorfozën tënde në mendime, vazhdova unë. Apo mos vallë po studion Ovidin? Ne për qudi sot po konstatojmë se i shikon gjër at më errët se Shopenhaueri. Jeta, natyrisht, është e vështirë, gjendja e rëndë, por meriton të jetohet. Njeriu nga natyra është një krijesë e gëzueshme, optimiste etj.

Pas meje folën shokë të tjerë, pastaj e mori fjalën Nonda Bulka. Ai ishte dakord me ne dhe tha

- S'jam dakord fare me ty, Rasim. Ç'kërkon të na bësh këtu, skëterrë? Kur të dëgjova ty, m'u duk sikur dëgjova filozofin e pesimizmit e të kotësisë, Leopardin. Je në të? Jeta është e gëzuar dhe ne duhet ta gëzojmë atë. Mos i merrni gjërat me një kuptim të tillë të trishtuar. Ti, ashtu si më rri shtrire në krevat, natyrisht, nuk e shijon jetën. Vërtet ke nostalgji për Kosoven, ku serbët po bëjnë batërdinë me vëllezërit tanë, por as dhimbja për kosovarët, as dhimbja për mjerimet që shohim, nu_k duhet të të qojnë në dëshpërim. Unë e gëzoj jetën, - vazhdoi Nonda dhe ia filloi nga tiradat e tij romantike. Filloi të flasë për Përmetin e lulëzuar, për fshatin e tij të bukur, Leusën me lule, me qershi, nuk harroi të zërë në gojë edhe një vajzë anonime leshverdhë, por që në fakt ne e njihnim, pse Nonda «digjej» pas sai.

«Na mori në qafë Nonda, - thashë me vete, na futi në të thella», kur zuri të flasë edhe për vajzat...

- Mjaft Nonda, - bërtiste Tefi, - se do të flasim të gjithë.

- Mos ma pre fjalën, - i përgjigjej Nonda. - Ti thith llullën, pse më je bërë si Volteri kur shkonte të flinte.

Në fakt, Tefi kishte nxjerrë këllëfin e jastëkut, e kishte vënë mbi kokë dhe trupin e kishte mbështjellë me çarçaf të bardhë. Dhe ia filloi:

- Unë jam një zog Shkodre, sido që emrin e kam Jakova, por nuk kam të bëj me Rasim «Sokratini» që foli para nesh.

Ne ia dhamë gazit, kur Tefi i vuri Rasimit për nof kë emrin e filozofit të lashtësisë greke, kurse Rasimi zjarr për zjarr tha:

- «Kapsull», përgatitme kupën e helmit, se, me të mbaruar Tefi homelinë, do ta pi dhe të vdes!

Filloi gazi përsëri. Tefi vazhdoi:

- Rasimi është mysliman, elhamdulillah, kurse unë jam katolik, më bekoftë Vatikani dhe, si katolik që jam, u njoh priftërinjve dhe xhakonëve dhëmbë e dhëmballë, u njoh dhëmballët kur bluajnë tërë ato të mira në kisha, në kuvende e në qela; u njoh dhëmbët që kafshojnë popullin dhe grabitin pasuritë, kur vdesin njerëzit. Duke qenë zog Vatikani, jam dakord me mendimet e errëta të Rasimit. Unë, - vazhdoi Tefi, - do t'ju flas mbaskëndeje me vjersha, si imzot Fishta OFM*, *(Iniciallet e fjalëve latine Ordinis fratrum minorium (Rendi i fretërve të vegjël), emri zyrtar i franceskanëve) qoftë i bekuem nga Vatikani dhe nga Duçja, dhe këtej e tutje mos me quani më Tef Jakova, por Tef Llazari, pse Fishta OFM më ringjalli, më nxori nga varri, për t'i bërë homazhet e duhura një kolegut të tij, vjershëtar me famë.

Dhe filloi Tefi recitimin:

*«Krimba ju të egër
Që hani njerinë
Ju që n'errësirë
Trupin na dërrmoni...»*

Nondës kjo i dogji, fap u ngrit në këmbë dhe, duke lëshuar një gaz të madh, ashtu siç e kishte zakon, ky shok kaq simpatik, bërtiti:

- Ah, ç'ma punuat, Rasim! Po ti, mor Tef, je i lig, më ke hapur dollapin dhe më ke grabitur fletorkën e vjer shave.

S'na mbahej gazi. Tani e morëm vesh pse e kurdisi Rasimi debatin; ai donte të vinte në kontradiksion mendimet optimiste e realiste të Nondës, me momentet pesimiste që i shkaktonte mosardhja në pikëpjekje e vajzës leshverdhë.

Ja, të tilla debate organizonim ne në dhomën e «veteranëve», herë duke marrë shkas nga ndonjë problem që rrihej në opinion, herë duke u kapur pas ndonjë «dobësie» të dikujt prej shokëve tanë. Humori e shakatë nuk mungonin, por fakt është, se edhe kur donim «të vinim me shpatulia për muri» njërin ose tjetrin për ndonjë «dobësi» të vogël, siç qe rasti që përmenda, përmes humorit e shakasë rrihim probleme me theks politik, filozofik, moral, artistik etj.

Një natë referova unë mbi liritë më të gjera që duhej të gëzonin studentët. Çështja ishte që të dilnim më lirisht nga internati. Mirëpo këtë e pleksa me parimet e zhvillimit të lirë të njerëzve e të mendimeve. Diskutuan të gjithë shokët dhe Rasimi u vuri kapakun diskutimeve mbi të cilat ne rrihim çekanët.

- Unë jam dakord me mendimet tuaja, - tha Rasimi; - por si t'ua bëjmë Vasos dhe kujdestarëve të tjerë, këtyre «xhelatëve tanë» ose më mirë «tuajve», se unë nuk dal nga dhoma dhe, kur dal, s'guxojnë të më flasin, pse jam «kokëkrisur», siç thonë. Pastaj, - vazhdoi Rasimi, - edhe po të më dënojnë, s'kanë ku të më dërgojnë, s'kam as familje dhe as një lek në xhep. Këto debate, përfundoi Rasimi, - janë të mira, ne jemi dakord në mendime, por ato janë pa fryt, në rast se nuk futim në vathën e mendimeve tona një nga kujdestarët tanë, dhe më i përshtatshmi është Hasan Rami.

Hasan Rami ishte një mësues i ri, i dalë nga Normalja e Elbasanit. Ai sillej mirë me internatistët, ishte i qeshur dhe i shoqërueshëm me ne. Ai na përkrahu kurdoherë në kërkesat tona dhe, kur i kërkonim leje, nuk na refuzonte kurrë. Ishte më i miri nga kujdestarët tanë, për të mos folur për Koçon, i cili ishte shoku ynë nga Korça, që u emërua kujdestar, kur ishim në vitin e fundit të liceut.

Kujdestarët e tjerë ishin të poshtër e të këqij. Më të shumtët prej tyre, në mos qenë agjentë të xhandarmërisë, ishin njerëzit më servilë të drejtorit të liceut dhe të drejtorit të internatit. "ë tillë ishin njëfarë Vasili, njeri i keq, grindavec, spiun i ndyrë; njëfarë Rali, i gjatë si një kavak, që as shqipen nuk e fliste mirë, hipokrit, i lig nga shpirti, që çdo gjë ia raportonte drejtorisë; njëfarë Xheladin Nushi, që, më vonë, siç thuhej, shkoi në Tiranë si «hamshor» i princeshave, motrave të Zogut. Ky ishte budallë i madh, një zogist gomar. Ne atë, sdi pse e si e quanim «Kamona». Por, më i ligu, më i poshtri dhe më i rrezikshmi nga ata ishte Ahmeti, një anadollak, spiun i policisë, njeri i keq në shpirt, i zi në fytyrë dhe me sy si të gjarprit. Më vonë ky u bë një ballist i egër dhe mbaroi në burg.

Përgjegjësit e tjerë të internatit, me përjashtim të Hasanit e të Koços, në përgjithësi ishin tipa të përsosur të kurnacit, të hipokritit dhe të dallaveraxhiut që manipulonin edhe me ushqimet e internatistëve. Njëri nga ata çdo veprim tonin e stër hollonte dhe e bënte problem të madh. Ishte një burrë i gjatë, mbi 50 vjeç, vishej me të zeza, me një pallto të zezë të gjatë, mbante kurdoherë në kokë kapelë «Borsalino» të zezë. Ecte si një stap, pa e kthyer kokën as andej, as këndeje, por me gojë, kur bisedonte, edhe kur donte të të hante të gjallë, të thoshte «djali im». Ky dilte rrallë nga zyra e tij, ku manipulonte regjistrat, defterët, llogaritë. Punën e kishte me ekonomin Pero dhe e detyronte të merreshin vesh mirë bashkë. Ai rregullonte kontratat me furnitorët jashtë. Në të gjitha këto open acione ai grabiste me zotësi dhe pa skrupull në kurriz të ushqimeve tona. Më në fund ne ramë në konflikt me të. Ai i fshihte kusaritet me një mënyrë dhelparake. Hiqej si ekonom, si i kursyer, «i arsyeshëm» dhe, për të qenë në sy të mirë dhe në rregull me Ministrinë e Arsimit, nga të gjitha ato që vidhte, një të njëzetën e dërgonte në ministri si «kursime», kurse restin e fuste në xhep. Kështu që atij i kishte dalë nami si një funksionar me «ndërgjegje» për regjimin. Pati vendosur edhe një rregull të tillë: çdo ditë ninternat duhej të kishte një kujdestar-dite nxënës, kuptohet, nga ne të klasave të larta, i cili duhej të kishte syrin mbi çdo veprim të brendshëm në internat, të merrte ushqimet në dorëzim nga Peroja, t'i kontrollonte këto ushqime në ishin të mira. të kontrollonte kuzllinën, të kontrollonte dhomat në mbaheshin pastër apo jo, të interesohej për shokët e sëmurë, të organizonte turnetë e shokëve që do të venin në banjat e qytetit etj. Ditën që kishte kujdestarinë, nxënësi nuk shkonte në klasë.

Shumë herë ne grindeshim, pse gjellët nuk na gatuheshin si duhet, disa herë ushqimet nuk dilnin me cilësi të mirë, disa herë na vinte sasia e paktë. Prandaj krijuam një delegacion, mes të cilëve isha dhe unë, shkuam në drejtori të internatit dhe u qamë. «Stapi», sipas zakonit, na trajtoi «si djemtë e tij», por «e keni gabim që qaheni, na tha, - se ju hani shumë mirë, s'keni ngrënë kurrë kështu në

shtëpitë tuaja; ju jeni bursistë, mbr eti bën sakrifica për ju» e të tjera profka dhe kërcënime. Na futi kështu edhe mbretin në mes. Një herë, dy herë, pastaj një ditë organizuarn grevën. Isha unë kujdestar i ditës. Vajta mora në dorëzim ushqimet dhe konstatova se mi shi dhe djathi binin erë, gjalpi ishte i paktë. I them Peros

- Nuk i marr në dorëzim!

- Je në vete! - më tha. - Do t'i marrësh medoemos !

- Urdhëroj unë këtu dhe jo ti! - ia ktheva me inat.

- Këtu urdhëron drejtori dhe jo ti! - kërceu ai. - Do të shkoj në drejtori!

- S'ke shkuar te djalli vetë, unë nuk i marr në dorëzim! - përfundova.

Më thirrën në drejtori dhe «Stapi» sic e kishte zakon, dulce më hedhur sytë e gjarprit, m'u drejtua:

- Djali im, ti e ke gabim, mishi është i mirë, duhet të jeni të disiplinuar, ushqimi duhet të vejë sa më parë në kuzhinë, se do të vijnë djemtë nga shkolla, do të mbeten pa ngrënë dhe ti ke përgjegjësi për këtë, do të marrim masa të rënda etj.

Iu përgjigja aty për aty:

- Lutem, mos më kërcënoni ! Unë nuk marr në dorëzim për shokët veçse ushqime jo të prishura.

- Pero ! - e pr eu ai bisedën, - çoj i ushqimet në kuzhinë vetë, kurse ti, - m'u drejtua mua, - dil jashtë.

U largova i inatosur, shkova në shkollë dhe bisedova me shokët kryesor ë të internatit, me të cilët vendosëm që në drekë të bojkotonim ushqimin e përgatitur. U ktheva më përpar a në internat dhe prisja shokët. Kur të gjithë u futëm në oborr, hipa në shkallë dhe u fola internatistëve për gjendjen. Shokët bërtitën:

- Nuk e hamë gjellën e qelbur!

Nga drejtorja vëzhgonin nga dritarja dhe dëgjonin të bërtiturat dhe zallamahinë e madhe, u frikësuan dhe mbyllën derën me çelës, se mos u hynim brenda. Si duket, lajmëruan me telefon komandantin e xhandarmërisë, pse nuk kaluan dhjetë minuta dhe ai erdhi me xhandarë, hyr i brenda, duke lënë xhandarët jashtë dhe shkoi drejt e në drejtori. Ne po bërtitnim edhe më keq jashtë. Pas ca kapitene i xhandarmërisë doli me një letër në dorë, ku ishin shkruar emri im në ballë dhe i tre shokëve të tjerë. Na arrestoi. Shokët bërtitnin, u shtua krahura në oborr, hynë xhandarët dhe, në mes të një zallamahie të madhe, na çuan në xhandarmëri. Nisën të na marrin në pyetje, po ne protestuam me forcë.

- More djema, - thoshte kapiteni, - pse bëheni rebelë?

- Ne jemi në të drejtën tonë, me ç'të drejtë na ar r estuat? - iu përgjigja. S'kemi ne të drejtë të mbrohem nga kusarët që na vjedhin bursën që na ka caktuar shteti? Ne nuk pranojmë të hamë mish të qelbur. Ju me këtë që bëtë, doni të bëheni or takë me kusarët.

- Hë, mor, mbyll gojën ti! - briti oficeri.

- S'kam pse e mbyll gojën, - i thashë, - bëmë çfarë të duash.

Çështja u përhap në qytet, profesorët e liceut u alarmuan, lëvoi telefoni, sigurisht me prefektin dhe pas katër orësh na liruan. U kthyem në internat, ku shokët na pritën me gëzirn.

Tri ditë pas kësaj ngjarjeje erdhi nga Tirana sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Luigj Shala. Na mori në pyetje, natyrisht na qortoi, por nuk u mor asnjë masë kundër nesh. Masa u mor kundër Peros, me demek, «u gjend fajtori» dhe me dinakëri ia hodhën fajin ekonomit Pero! Mirëpo këtej e tutje myteberët e drejtorisë bënë shumë kujdes me ne. Ne fituam, ata humbën.

Gjëja më e mërzitshme në internat ishte qepja e teshave, kur na çirreshin ose kur na këputej ndonjë pullë. Këtë punë e bënim vetë, se s'na e bënte kush. Dy-tri gra që ishin në internat, vetëm sa i lanin teshat tona, por as qepnin dhe as hekurosnin. Mërzitja e parë në këtë punë ishte se duhej t'i bëje numrin tënd çdo ndërrese që të mos përziheshin e të gjendeshin lehtë kur i çonim për t'i larë dhe, e dyta, ishte të qepje çorapet, të cilat na çirreshin shpesh, sidomos në thembrat. Ne shikonim me zili në këtë zanat njëfarë Shaqir Gjebreja, të cilin e thërritnim «arbitri i elegancës». Shaqiri i arnonte çorapet si çupat e mamasë, me një vezë druri, kurse rrobat i kishte kurdoherë të hekurosura, sepse shkonte i hekuroste në qytet te ndonjë i njohur. Ne të tjerët, përgjithësisht ndiqnim rrugën më «praktike» e shfrytëzonim «mjetet rrethore»: i vinim pantallonat nën çarçaf ose nën stromë. Në të dy rastet pantallonat na dilnin si mos më keq: në rastin e parë dilnin të zhubrosura dhe jo me një,

por me dy-tri vija; në rastin e dytë, mbi pantallona «stampoheshin» format e sustës së krevatit! Kjo mënyrë e «hekurosjes» bëhej sidomos të shtunave mbrëma, për të qenë gati për shëtitjen e zakonshme që bënim të dielën në bulevard dhe ulica. Shaqiri ishte, gjithashtu, mjeshtër i dansit i dhomës sonë. Na mësonte «çarlestonin»! Të gjithë ne të dhomës mbaheshim në këmbët e krevateve dhe hidhnim «çarlestonin», kurse Shaqiri vetë rrinte në krye të dhomës, kërcente pa u mbështetur si ne, dhe këndonte «...Bebi çarleston», me të cilën shoqëroheshin kërcimet tona duke hedhur sa andej-këndej fundet e gjera të pantallonave.

Shumë gjëra kishte parë dhoma jonë: zënkat e Akil Sakiqit (që u bë oficer i Zogut dhe vazhdoi si i tillë edhe në kohën e okupacionit fashist) me Ismail Topçinë; lojën e 31-shit të Lezo Çamit (edhe ky mbaroi në burg si ballist), lojë që e fillonte, siç thonë korçarët, në Shënvasil* *(Festë fetare, përkon me natën e vitit të Ri.) (natyrisht fshehur azi) dhe e mbaronte para provimeve.

Kurse shoku im i vjetër, Selami Xhaxhiu, me të cilin flinim afër e afër, kishte sëmurdjen e pagjumësisë. Si rronte ai njeri! Nuk flinte veçse një orë, e shumta një orë e gjysmë në natë! Në çdo kohë që të të dilte gjumi, Selamiun e gjeje zgjuar:

- Selami, - e pyesje, - sa është ora? - dhe ai nxirrte një sahat xhepi të trashë e me kapakë dhe ta tregonte kohën.

Megjithatë, Selamiu ishte shumë i qetë, kërciste vetëm dhëmbët tërë natën, po edhe këta i kishte të prishur i ziu! Ngandonjëherë, për të qeshur, kur thellë në mëngjes e pyesja Selamiun për orën, ai më thoshte:

- Ç'të duhet ora, dëgjo Selman Rizën që psall përposh në oborr dhe do ta marrësh me mend se sa është!

Selman Riza ishte një shoku vnë nga Kosova dhe mund të them nga më të zotët e klasës sonë. Ai dilte shumë mirë në të gjitha lëndët, mësonte derrçe. Ngrihej që me natë, dimër-behar dhe në oborr nën penxheret tona, bënte mësimet duke lexuar ose dulce i përsëritur me zë të lartë. Kishte një zë që të çirrte veshët dhe bënte gr invasa të tilla kur fliste, sa shkuleshim gazit.

Dëfrimi tjetër për ne internatistët ishte kinemaja. Kur afr ohej e shtuna, atëherë visheshim e viheshim në lëvizje. Të gjithë të vegjlit vinin na luteshin neve, të klasave të larta, që të bindnim kujdestarin. Kujdestarët, Abedin Shkëmbi, «Kamona», o Hasani, edhe vetë donin të vinin në kinema, por bënin ca naze për Vi lutur. Kishte në internat tifozë kinemaje deri në atë pikë, sa bënin koleksione me kartolina artistësh. I tillë ishte një bir beu i dekluar, Hilmi Frashëri, të cilin kurdoherë do ta shihje me kartolina artistësh në duar tek bënte tratativa: «dy Gari Kuper, një Greta Garbo». Ai na informonte me kohë c'do të luhej në «Mazhestik» ose në «Lluku», pse kishte lidhje me Petin e Koci Çalos, një tjetër tifoz ky, që hiqej edhe si artist.

Në kinema shkonim në radhë, por unë kisha dhe një bela tjetër: duhej t'ia shpjegoja Abedin Shkëmbit filmin, kur ishte frëngjisht. Në rastet e tjera angarinë e merrnin shokët e tjerë. Në kinema zhurmën më të madhe e bënin të vegjlit, sidomos kur filmi ishte me kauboj. Atëherë fillonin britmat: «forca Godi!»*. *(Personazh filmash kauboj.) Kurse kur venim në kinemanë «Lluku», kur atje luheshin filma pa zë, dhe më të shumtët të tillë ishin, dilte një avaz tjetër: filmat i shoqëronte një pianist në piano. Ishte një burrë i shastisur nga dashuria dhe nga kokaina, dinte të luante vetëm disa pjesë në piano dhe vazhdimisht atyre u binte. Ne ato i kishim mësuar përmendsh. Ngandonjëherë pianistin e zinte gjumi, atëherë ne fillonim britmat:

- Bjeri, Metaksa, bjeri!

Herët e tjera, kur qe i përgjumur, i binte pjesës përcart dhe ne i thërritnim:

- Falsari, Metaksa* ! *(Fallco, Metaksa!)

Tjetër distraksion në internat nuk kishim veç dyqanit të Xhavit Leskovikut, te këmba e Urës aty afër. Ne venim përher a në dyqan, blinim nga një dardhë, qershi, arra, gjilpëra, deftera, kalema etj. Ishte dyqan i varfër, por Xhaviti ishte burrë shumë i mirë dhe shumë i urtë, ai kurrë nuk fitoi nga ne, nxënësit, bile mundet që humbiste. Prandaj të gjithë e donim, kurrë s'i bëmë hile e s'e gënjem Xhavitin. Kur nuk kishim lekë t'i paguanim, ai na thoshte:

- Mbani mend vetë, se unë nuk mbaj defterë si të bakallit dhe, kur t'ju vijnë të hollat, mi paguani.

Kur ne kishim nga ndonjë lek, të parin borxh që lanim, ishte ai që kishim te Xliaviti. Përkrah dyqanit të tij ishte dyqani i këpucarit që na mballoste këpucët, i cili u kalonte nga një gjilpërë, ose u fuste nga një gozhdë.

Unë mbahesha pastër, një herë në javë veja bëja banjë, rrobat nuk i kisha të reja, por i ruaja. Megjithatë, sado që i ruaja, ato m'u vjetruan, se një palë kisha. I kërkova xhaxhait një herë para të blija një pulovër për dimër dhe një palë këpucë. Ishte gjë shumë e rëndë për të, po xhaxhai bëri si bëri dhe më dërgoi të bëja edhe një palë rroba. Ishte gëzim i madh për mua. Shkova zgjedha copën, një copë bezhë e hapur, më kujtohet, që e cova për ta prerë te rrobaqepësi i «Pallasit», i cili kishte nofkën «Kallaco».

- Kallaco, - i thashë, - ma pr e bukur.

- Mos ki merak, spic do të ta bëj, o student, që, kur të dalësh në bulevard, të mos mbetet çupë pa të bërë sehir !

Sa të më qepej kostumi, po atje pranë, porosita te Garoja, siç e quanin, pulovrën. Garoja kishte një punishte dhe i thurte vetë trikot. Zgjodha një kuti-kuti bojë kafë me njolla të kuqe të errëta. Vajta porosita dhe këpucët.

- Ç'bojë e do lëkurën? - më pyeti këpucari.

- Të verdhë.

- Mos e do bojë «tango»?

- Jo po bojë «çarleston», - ia ktheva me të qeshur.

- I do me shollë poshtë apo me dhjamë peshku?

- Me dhjamë peshku.

Ky i famshmi «dhjamë peshku» ishte i modës atëherë, tre gishtërinj i trashë ishte, të bënte më të gjatë dhe nuk kishte nevojë për galloshe në dimër. Bëra pra një udhë e dy punë. Kështu që brenda dy javësh u veshja nga koka në këmbë, u pispillova, u shikova në pasqyrën e «Kallacos», i veshur komplet dhe... «forca bulevardit». Duke parë sot albumet me këto rroba të reja, më kujtohet se tok me Elmaz Konjarin dhe me një shok tjetër korçar, shkuam bëmë një fotografi, te «Venetiku», afër Shëngjergjit. Atë fotografi ua dërgova anesë dhe xhaxhait që të shihnin djalin me kostum të ri*... *(Në origjinal shoku Enver Hoxha, ndërsa hidhte këto kujtime, ka shtuar këtë shënim: «Të gjitha këto dhe të tjera që do të të tregoj, e dashura Nexhmije, janë gjëra të vogla, por m'i kërkove dhe unë po t'i shkruaj, ashtu siç kanë ngjarë, me ato përshtypje që më kanë bërë atëherë, me atë vend dhe preokupacion që kishin në jetën time të rinisë. Jam përpjekur t'i kujtoj gjërat ashtu si ishin, realisht dhe shpirtërisht, dhe të t'i shkruaj këtu ashtu siç kanë ngjarë, pa i lustruar. Nuk di t'i lustror, por edhe po ta bëja një gjë të tillë, kujtimet do ta humbisnin tërë kuptimin dhe atëherë më mirë të mos i shkruash fare. Por meqë këto që po shkruaj janë vetëm për ty dhe për fëmijët, s'ka rrezik që të tjerë të qeshin me to dhe të thonë: «Ç'vogëlsira! Deri te sholla e «dhjami i peshkut» i këpucëve ka shkruar!». Duken vërtet kështu, por të rinjtë duhet të dinë se në ato kohë për ne, të bëje një palë këpucë të reja, ose të blije një pulovër, ishte një eveniment me rëndësi në jetën e të riut!»)

Si këto ka dhe shumë gjëra të tjera të jetës trevjeçare të internatit, që edhe më kujtohen, por disa edhe nuk më kujtohen mirë. Sido që jeta në internat zakonisht, siç thonë disa, është monotone, për mua ka qenë e gëzueshme, pse e doja shoqërinë, e doja jetën e përbashkët dhe ruaj kujtimet më të mira nga shokët e mi të asaj kohe, që nga Selamiu, Rasimi dhe deri te Dhimitër Shuteriqi, që ishte shumë më i vogël nga ne dhe ndiqte klasat e para të liceut.

Interesante ishte jeta në internatin tonë nga përbërja shoqërore. Atje nuk kishte djem nga shtresat e pasura, pse ishim gati të gjithë bursistë, por kishte edhe nga ata, prindërit e të cilëve ishin në gjendje jo të keqe ekonomike, kishte bij funksionarësh, siç kishte edhe të varfër, kishte jo vetëm me origjinë qytetarë të mesëm dhe të varfër, por edhe me origjinë punëtorë, zanatçinj e fshatarë. Kishte kosovarë të emigruar e të varfër, kishte edhe shokë që vinin nga shkolla jetimore. Me gjithë këto ndryshime në përbërjen shoqërore të nxënësve, karakteristikë e veçantë ishte se në jetën tonë kolektive nuk bëhej asnjë dallim; ekzistonte dhe krijohej midis internatistëve një dashuri e sinqertë dhe një thjeshtësi e madhe në marrëdhëniet reciproke e kolektive. Rrallë shikoje ndonjë nxënës që të mburrej për origjinën e tij borgjeze, ose për jetesën e mirë në shtëpinë e tij. Rrallë e tek familjet u dërgonin djemve të internatit ndonjë gjë për të ngrënë, kurse mua asnjëherë, dhe kur ndonjërit i vinte ndonjë ëmbëlsirë nga shtëpia, ajo do të ndahej me shokët e afërt.

Më kujtohet një mbrëmje në studio se si një djalë që quhej Hysen Janina bërtiti: «Unë jam i zoti të ha xham!». Gabuar mos qofsha, po mbaj mend se e kam parë me sytë e mi tek bluante xham në gojë. Mirëpo kërceu një shok nga Fieri dhe i tha:

- Aman, Hysen, mos ha xham, se do të na pësosh ndonjë gjë! Na, ha nga këto ëmbëlsirat që më ka dërguar mamaja!

Askush nuk merrte nga prindërit para xhepi me shumicë dhe të harxhonte pa llogari. Po t'i kërkoje ndonjë shoku ndonjë lek dhe, po të kishte, do të të jepte. Shoku--shokun e qortonim pa të keq dhe pa zemërim, kur ndodhte diçka.

Në internatin tonë kishte djem që vinin nga familje të feve myslimane, katolike, ortodokse (nuk më kujtohet nëse kishte ndonjë çifut), por ishte karakteristike se, qysh në atë kohë asnjeri nuk besonte, asnjeri nuk bënte kryq, asnjeri nuk vinte në kishë o në xhami, asnjeri s'mbante kreshmë o ramazan. Me një fjalë feja nuk ndihej fare në internatin tonë antifetar, derisa nuk ekzistonte dhe nuk shfaqej asnjë ndikim i saj. Sigurisht për këtë ndikonte edhe laiciteti borgjez i liceut francez.

Fryma përparimtare e liceut kishte influencën e vet edhe në qytet, pse, megjithëse Korga konsiderohej si një nga qytetet me popullsinë më përparimtare të Shqipërisë, ekzistonte e ndjeshme edhe fryma e fesë, qoftë aero ortodokse, qoftë aero myslimane. Mitropolia e Korgës, me kishat e shumta në qytet dhe në fshatra, influenconte në ruajtjen e në zhvillimin e riteve dhe të zakoneve fetare, sidomos tek të moshuarit. Kjo nuk donte të thoshte se të rinjtë dhe të rejtat u kishin shpëtuar kthetrave të fesë. Sidomos kjo shikohej në pashkët, në ditët e tjera fetare, në festimin e emrit dhe në ditën e të vdekurve. Bile kur unë isha në lice, një pjesë e korit të liceut, drejtuar nga njëfarë Sotir Kozmo (që mbante në kokë një kapelë të zezë me strehë të gjerë dhe vinte në qafë një fjongo-kravatë të zezë aq të gjatë sa bishti i saj i vinte deri në bark), këndonte edhe këngë fetare si «Kolendrat, melendrat».

Ne, internatistët, kur vinte festa fetare kristiane e pashkës së madhe, na linin të lirë të dilnim deri në orën 12^{oo} të natës, pse në atë kohë sipas Ungjillit «ngjallej Krishti», ceremoni kur dilte gjithë priftëria veshur me rroba të qëndisura dhe besimtarët mbanin mbi supe, mbi një dërrasë, një «epitaf», të qëndisur me ar, që përfytyronte Krishtin të dergjur. Ky procesion në mes të popullit dilte nga kisha e Mitropolisë dhe mbaronte në kishën e Shëngjergjit. Kështu ngjiste edhe në ditën e «ujit të bekuar», një festë fetare që binte në ditët e para të janarit. Atë ditë mblidhej populli, në një të ftohtë acar, tek ura e vogël e Pandës dhe prifti, «dulce bekuar» ujin e qelbur të lumit, hidhte kryqin në të dhe pesë-gjashtë veta, kurdoherë të njëjtët njerëz, hidheshin në ujin e ftohtë për të peshkuar kryqin dhe për të marrë një pjesë të të hollave që mblidhte kisha me dhisk atë ditë. Kështu vepr ohej edhe për ditët e tjera të festave fetare. Mjerisht këto ditë ishin të shumta për ortodoksët.

Për myslimanët festat ishin më të kufizuara : ramazani, bajramet dhe ndonjë nevrus. Por në këto ditë edhe në lagjen e myslimanëve kishte festë anembanë.

Të krishterët thoshin se myslimanët janë më fanatikë, kurse myslimanët thoshin kështu për ortodoksët. Që të dyja palët në pretendimet e veta nuk binin poshtë dhe puna kishte ardhur deri atje sa të ekzistonte një mëri në mes tyre, ero gjithmonë e hapët, por sidoqoftë e dukshme në shumë raste. Vetë lagjet ku banonin ortodoksët dhe myslimanët ishin të ndara prej njëra-tjetrës nga lumi. Ne, internati dhe internatistët, ishim, si të thuash, diku, mbi kufi, mbi ur. Por më të preferuarat për ne ishin mëhallët e të krishterëve, ero pse atje ekzistonin kisha, të cilat ne në fakt i injoronim, por se kjo zonë ishte qendra e qytetit, atje ishin shkollat e dyqanet, atje bëhej tregtia, atje ishin rrugët me punishte, atje ishin punëtorët e zanatçinjtë kryesorë. Në këtë zonë jeta ishte më e gjallë, më e çlirët, me e përparuar.

Korça e asaj kohe konsiderohej, dhe në fakt ishte, një nga qytetet më të përparuara të Shqipërisë, aero ishte një qendër e madhe patriotike, qendër kulturore-arsimore nera më të vjetrat dhe më të shquarat. Dhe këto tradita të mëdha r uheshin, zhvilloheshin, kaliteshin vazhdimisht. Korça mbi të gjitha kishte zanatçinj dhe një klasë punëtore nga më të zhvilluarat për atë kohë ero vetëm nga numri e profesionet, por dhe nga më revolucionaret për Shqipërinë e atëherëshme. Kjo forcë përparimtare ero vetëm më vonë që do të luante një rol të rëndësishëm. por edhe në atë kohë kishte peshën e influencën e saj të konsiderueshme.

Borgjezia e re korgare, që ka pasur tradita relativisht të zhvilluara edhe më parë, në ato vite po nrihej. Aero ishte e dalë në Greqi e gjetkë, ishte zhvilluar në tregti dhe në fajdë, kishte filluar të bënte dhe investime në fabrika e në punishte. Sido që përpiquej të hiqej si përparimtare, në thelb ishte një borgjezi tradicionaliste, arrogante, e korruptuar, shumë meskine dhe konservatore në zakone, në jetën e përditshme dhe në jetën shoqëror e.

Korça, nga ana tjetër, kishte edhe një bujqësi nga më të përparuarat e vendit. Fshatarët korgarë, ortodoksë, apo myslimanë, ishin shumë punëtorë. Por vuajtjet e fshatarësisë ishin jo të pakta, ajo shtypej nga feudalët, sidomos nga bejlerët myslimanë, si Maliq bej Frashëri, bejlerët e Mborjes e të tjerë. Në fshat këta kishin më shumë influencë, kurse në qytet influencë më shumë kishin borgjezët ortodoksë.

Korçarët ishin konservatorë dhe lokalistë. Liceu i Korçës solli në këto drejtime mjaft freski dhe i përzjeu gjërat. Influenca e tij u ndje jo vetëm në lëmin e arsimit dhe të kulturës, jo vetëm në zhvillimin ekonomik-tregtar, por Bolli me vete edhe një numër të rinjsh të konsiderueshëm nga të gjitha anët e Shqipërisë. Në këtë qytet erdhën mësues e profesorë nga vende të ndryshme të atdheut, erdhën profesorë francezë dhe të gjithë së toku u përhapën nëpër Korcë, zunë dhoma me gira, u futën në familjet «e mbyllura korçare dhe përziën me ta frymën, mentalitetin dhe zakonet e mendimet e krahinave të tjera. Kështu Korga mori një gjallëri të mëtejshme si në zhvillimin ekonomik, ashtu dhe në atë kulturor-ar simor dhe, si konsekuencë e tyre, sidomos në zhvillimin shoqëror.

Me këto nuk kam ndër mend të bëj historikun e zhvillimit shoqëror të Korçës, pse në kohën e rinisë sime nuk i kuptoja thellë këto gjëra, sic i kuptoj sot dhe, po të flas me pjekurinë politike të sotme për problemet e asaj kohe, ekspozoja që bëj nuk do të jetë ekzakte. Do të dilja nga kuadri i kufizuar i mendimeve të mia prej studenti, sdo të ishte as reale, as e drejtë sikur të tregohem se që në atë kohë cdo gjë e kuptoja si tani. Kjo nuk është e drejtë dhe «retushe» të tilla s'më kanë pëlqyer kurrë. Ato që thashë më lart i shënova për të përshkruar shkurtimisht kuadrin ku vërtiteshim.

Unë, ashtu si dhe shokët e tjerë liceistë, u dashurova shumë me Korqën. Sido që ne, internatistët, nuk dilnim çdo ditë në qytet, shpejt i njoha anembanë rrugët e rrugicat, mëhallët e tij të mëdha, të sistemuara e karakteristike, sa vështirë se mund t'i gjesh gjetkë kaq të thjeshta, të bukura e kaq njerëzore, me atë shtrirjen e tyre të gjerë e harmonike, me ato lidhje kaq organike nga njëra shtëpi në tjetrën, me çatitë e tyre të kuqe, që, kur i sodisje nga kodrat në pranverë e në vjeshtë, të ngjanin si fusha me lulekuqe, me morinë e oxhakëve që lëshonin shtëllunga tymi vazhdimisht e që në vjeshtë, por sidomos në dimrin me borë, i jepnin qytetit një pamje të mrekullueshme, e vishnin me një tis gri, si në përralla.

Daljet tona të lira bëheshin çdo të diel pasdreke, në ditët e festave kombëtare, në ditët e pashkëve dhe të bajrameve (edhe këto ishin, gjithashtu, festa zyrtare), si dhe kur merrnim leje të veganta për njërën apo tjetrën arsye. Dy vjetët e fundit, kur vëmë në bakaloreat (të parin dhe të dytin, klasa e filozofisë) ne ishim më të privilegjuar në liralidje. Nuk na shtrëngonin shumë si në klasat e ulëta, ishim ca të lirë, pse tashmë konsideroheshim në moshë të pjekur dhe ishim r=ë klasat e larta të liceut. Në kohën kur përgatitnim provimet e bakaloreatit ishim pothuaj plotësisht të lirë, e shumta, me kërkesë të një leje formale mund të dilnim të mësonim në natyrë.

Por vitin e parë që shkuam në Korcë duhet thënë se për ne, internatistët, kur dilnim në qytet, ishte njësoj sikur lëshoheshim nga zinxlliri! U binim rrugëve rreth e rrotull, jo vetëm bulevardëve, por edhe ulicave, sic thonë korçarët. Të dielën në mëngjes laheshim, qepeshim, kriheshim bukur, ndonjëherë vinim edhe nga një çikë brilantinë në flokë, pantallonat po i hekurosdim në mënyrën që thashë diku më lart, këpucëve u vinim bojë, i fërkonim, i lustronim dhe, me të ngrënë bukën e drekës, dilnim. Kur bënte ftohtë, kur binte borë apo kur fillonte vapa (pse ne dilnim në qytet që në orën dy pasdreke kur të gjithë ishin brenda dhe rrugët bosh), shkonim në dhomat e shokëve gjirokastritë, që ndiqnin liceun me të hollat e tyre. Më shpesh shkoja te

dhoma e Aqif Selfos, të cilin e kishim më të vjetrin dhe më të pjekurin e shokëve. Aqifin e doja shumë jo vetëm se ishte njeri i drejtë e bujar, por e kisha edhe kushëri. Ai rrinte si qiraxhi te një

plakë, në kodrën në lindje të qytetit, diku afër kishës së Shënthanasit. Aqifi kishte blerë, më kujtohet, edhe një kamineto të vogël «automatike», që punonte me alkool dhe me të na bënte nga një kafe, gjë që na jepte edhe shkas për humor. Kishte vetëm një filxhan të cilin e lanim çdo herë për secilin dhe, kur mblidheshim shumë veta në dhomë, kuptohet, ky proces vazhdonte ndonjë orë. Aqifi ishte i rregullt d'ne ekonom, prandaj, kur mbeteshim pa lekë, i kërkonim dhe ai na jepte. Kur na vinte ndonjë lek nga shtëpia, ia linim Aqifit të na e mbante, sepse atë, si me thënë, e kishim «bankën» tonë.

Jashtë, në dhoma të veçanta, jetonin dhe shokë të tjerë si, Skënder Topulli, të cilin e doja shumë, Selahudin Kokona, Nedin Kokona (me të cilin ishim në një klasë), Hamit Kokalari e të tjerë. Nedin Kokona ishte «Ramon Novaroja»* *(Aktor filmash.) ynë. Kur shëtitnim me të nëpër bulevardet e ulica, vajzat nuk na shikonin ne, por atë, dhe neve na vinte inat. Cilido nga djemtë e liceut bënte nga një «zgjedhje» çupe, gjë që zakonisht përfundonte në «një djegie të kotë». Shkonim grumbull në rrugicat e saj, ajo rrinte te porta, na shikonte dhe, pasi ambientehej me «voztjet» tona, na buzëqeshte. Po kujt i buzëqeshte, nuk e merrnim dot vesh se ishim shumë! Duhej të specifikohesh adresat e buzëqeshjes. Që të arrihej kjo, secili djalë duhej të shkonte nga porta e saj shumë herë vetëm dhe kishte nga ata që i hynin kësaj «pune». Por vajza herë dilte, herë nuk dilte, herë qeshte, herë jo. Kështu që nuk ishim kurrë të sigurt, nëse vajza «digjej» për njërin apo për tjetrin. Brenda tre-katër orëve, dhe dulce bërë muhabet me shoqi-shoqin, u binim rrugëve dhe kudo ku dilnin vajzat në prag të portës, u hidhnim nga një fjalë:

- E me, korbeckë, ç'bën?

Si të ndodhte, ato ngandonjëherë qeshnin, ngandonjë herë na vinin përpara «shko, mor plehranik!», ose «e ke parë ndonjëherë fytyrën në pasqyrë?» etj. Kështu që «zjarri» i brendshëm shuhej me një dush. Por rrallë se fyhej apo dëshpërohej njeri nga këto. Ishin më tepër shaka e zbavitje mes shokësh liceistë, që ashtu siç studionin e lodheshin, kishin nevojë edhe të dilnin, edhe të qeshnin, edhe të bënin ndonjë shaka ose zullum të vogël. Këtë punë bënin të tërë studentët në kohën e shëtitjes dhe dy ishin «objektet» kryesore të shakave: vajzat dhe priftërinjtë!

Priftërinjtë i kishim shumë zët, sidomos njërin prej tyre që e quanin Kanxher. Ishte një prift «kiç», siç e thërritnin korçarët, i bukur, i ri, me një mjekër te zezë pis. Ishte i përhapur zakoni në atë kohë që, kur shihje një prift o një hoxhë në rrugë, «ia lije» shokut, dulce e prekur me dorë. Kjo ishte një ofezë për klerikët, ata zemëroheshin, na shanin, por s'kishin ç'të bënin. Një nga shokët tanë kishte një dhomë me dy dritare që binin mbi rrugë. Përballë shtëpisë së këtij shoku banonin dy-tri çupa dhe të dielën ato, tok me shoqet, dilnin te pragu i portës dhe fillonin muhabetin. Një ditë pamë prift Kanxherin të zbriste nga Mitropolia dhe të futet në rrugicë. Vajzat, pa vënë re se ne ishim pranë dritares filluan «t'ia lënë» priftin shoqja-shoqes. Kur u afrua tek ato, Kanxheri ndali këmbët dhe u tha:

- E moj, cila nga ju më mbeti mua?

Ne që po e ndiqnim këtë skenë, i bërtitëm:

- Mënë, prift mjekërderri!

Kanxheri ngriti kokën e bërtiti edhe ai

- Mënë, studentët i gjen kudo si djajtë!

Në këto shëtitje «erotike». Iodheshim fizikisht dhe, kur kishim ndonjë lek, ktheheshim në ëmbëltoresh «Stambolli», ku hanim nga një pastë me krem. Por atje ne venim më shumë jo se pëlqenim pastat e saj më mirë nga trigonat e Koci Çalos, porse nga të dyja anët e mureve të kësaj pasticerie kishte pasqyra, ku u hidhëm nga një sy fytyrave dhe u futnim nga një krehër flokëve, para se të vazhdonim baritjet. Në mbrëmje, kur ktheheshim në internat, ishim të këputur nga këmbët, nga stomaku, kurse këpucët merrnin të tatëpjetën, si lëkura e sipërme, si tabanet, por ne ishim të kënaqur, se kishim shëtitur.

Përveç të shtunave, kur venim me radhë në kinema. dhe me tarifa të reduktuara, qëllonte të shkonim edhe te dielave pasdreke kur kishte film të mirë. Nganjëherë filmi nuk dilte i mirë dhe atëherë fillonim të bërtiturat:

- Nasi, paratë, paratë !

Nasi, i zoti i kinemasë, bërtiste nga lozha:

- Hajdeni, mor qelbanikë, ç'para kërkoni? Ç't'i bëj unë filmit?

Një herë fillova të mësoja biçikletën. Dyqani i biçikletave ishte afër liceut dhe kinemasë «Mazhestik». Vajta deri në Debojë, duke u rrëzuar e duke u përplasur. Por, kur u ktheva, biçikletën e solla në krahë, pse i nxora rrotën. U detyrova të paguaj 15 lekë (shumë kjo tepër e madhe për mua), gjë që më bëri të mos zë biçikletë më me dorë.

Pazari i Kor çës ishte me emër në atë kohë. Atje kishte plot dyqanka zanatçinjsh të ndryshëm, që nga kapelëbërësi e deri te kovaçët. Këto dyqane ishin në rrugica të vogla, herë me kalldrëm, herë jo. Në dimër çdo pisllek mbulohej nga bora, e cila, kur shkrinte, shkaktonte një batak të madh, saqë të duhej një lundër të dilje matanë. Por në mes këtyre dyqaneve bakejsh, këpucarësh, kasapësh, kërnackash apo samarxhinjsh kishte edhe dyqane tregtarësh të mëdhenj, si: Turtujt, Ballaurët, Lakot, Rakot e të tjerë. Këta ishin padronët e mëdhenj të tregut të Korcës.

Disa herë venim edhe në pazar, kur kishim për të blerë ndonjë gjë që nuk e gjenim në dyqanin e Xhavitit që ndodhej afër internatit. Kështu shkonim te magazina e Merdanit ose e Rakos. Këta të dy ishin edhe furnitorët grosistë të dyqaneve të vogla si i Xhavitit, por shitnin edhe me pakicë, si për shembull brisqet «Poker». Në Korçë fillova të heq briskun e parë në faqe. Një herë, më kujtohet, shkova të blija një orë xhepi, ora e parë në jetën time. Shkova në magazinën e Rakos.

- Ç'urdhëron? - tha Rakoja (i vogli).

- Një orë xhepi, - i thashë.

Më çoi të zgjidhja një në një mijë. Ç'të shikoje, përdhë ishin dy sini plot me orë xhepi si qepë të thata. Unë kisha mendim tjetër për orët, se ato janë makina delikate, të vlefshme, të zgjuara. Pyeta për markën dhe Rakoja më tha:

- Janë ekstra, japoneze!

Ai i blinte ato me okë dhe na i fuste neve për orë.

- Zgjidh një dhe unë po të siguroj, - thoshte Rakoja, - se, po të doli e mirë, atëherë nuk ka mortje kurrë, student. Po s'doli gjë, s'kam ç'bëj, brenda s'jam. Unë nuk detyroj njeri të blejë me zor.

- Sa kushton? - i them.

- Një dollar (25 lekë), - m'u përgjigj ai. Po për studentët ka dy lekë skonto, 23 lekë.

Pas një pazarllëku ia mora për 20 lekë; po në fakt ai fitonte 15 lekë mbi njëzet. I bleva orës edhe një zinxhir të hollë dhe për disa javë me radhë e futja dhe e nxirrja me lezet nga xhepi, e shikoja sidomos në klasë në orët e mësimit. Po kjo «mburrje» nuk vazhdoi shumë.

- Më mbeti sahati, - i thashë Selamiut.

- Jepi ujë, - ma ktheu ai. E bëre hesap!

Për ta ndrequr atë kumborë, çdo ditë pagova gjysmë leku, kështu që, brenda 40 ditëve, vdiq sahati dhe ia vara maces. Kjo është historia e sahatit tim të parë.

Kur kishim për të blerë ndonjë këmishë për të qenë, ndonjë palë çorape o ndonjë kravatë, shkonim te dyqani i Kajnos. Ose kur blinim me shokë ndonjë çikë djathë kaçkavall o ullinj të mirë duhej të shkonim te Rrota. Atje, afër Rrotës, ishte një restorantinë e qelbur, ku hanin disa nga shokët tanë. Ishte restoranti i famshëm i Karamankës, një burrë i shkuar, jo i keq, zemërmirë, por që pinte gjithë ditën dhe, kur mbyllte restorantin, bëhej tapë, dilte rrugës për në shtëpi dhe bërtiste me sa kishte në kokë

- Unë jam Karamanka, s'ka si unë! Poshtë Turtujt, poshtë Ballaurët! - e të tjera sharje kundër pasanikëve.

Unë shkoja shpesh në dyqanin e vëllait të Ymer e të Xhavit Dishnicës, me të cilët ishim bashkënxënës. Ata e kishin dyqanin në pazarin e kuajve dhe atje njiheshim edhe

me fshatarë. edhe me çirakë të zanatçinjve, shokë tanë të njn-toshe. I pyetnim për shumë gjëra. se ishin kuriozë, donim diçka të vërtetonim riga ato që mësonim në lice tubi jetën e proletarëve dhe të fshatarëve.

U njoha kështu i -ne disa muratorë. kushërinj të usta. Lekos e të Mihal Dhimës. miqtë e familjes sonë në Gjirokastër. U shkoja shpesh në shtëpi dhe u miqesova me ta. Ishin të varfër si usta Lekoja,

por të dashur, të thjeshtdlie plot urrejtje për agallarët dhe zengjinët. Këta muratorë nuk gjenin kurdoherë punë dhe shumë herë. kur kaore ioja riga pazari, i gjeja në trotuar tek bisedonin me mistri në lhepin e futës.

- Djalë, - më thoshte një plak prej tyre, me origjinë riga Orgocka, - kjo që bëjmë ne është një jetë qeni, kurse të tjerë notojnë në flori.

Më pëlqenin shumë këta muratorë, ndoshta pse doja A'lihalin, por edhe vetë ata ishin të njerëzishëm, të donin, edhe pa të njohur kush ishe. Përballë kësaj bujarie e thjeshtësie më ka mbetur në mendje qëndrimi i disa shokëve të klasës riga Korga (më të shumtët pr ej tyre ishin qytetarë), djem të të pasurve, por edhe të mikroborgjezisë, të cilët s'të ftonin asnjëherë jo vetëm në shtëpitë e tyre. por rrallë shoqëroheshin me ne edhe në r rugë. Kurse punëtorët e Korgës ishin brumë tjetër dhe dashuria për ta shtohet vazhdimisht tek unë. E ndieja veten afër tyre që në bankat e Liceut të Korçës, që në vitin 1927 kur vajta për herë të parë në këtë qytet, i cili la mbresa të pashlyeshme n ë. Letën time shpirtërore. Më vonë, pas disa vjetësh, kur do të kthehesha në Korçë si mësues, të gjitha këto përshtypje, këto ndjenja, këto mendime, do t'i kisha tnë të qarta, më të klasifikuara në kokë.

Ne nuk shëtitnim vetëm në bulevarde. por dilnim edhe rreth qytetit. Ngjiteshim shpesh në Shënthanas. një bregore me disa pemë të rralla dhe me një kishë të vjetër në majë, afër së cilës qe një çezmë. Nga Shënthanasi qyteti dhe fusha kishin një patnj- shumë të bukur. Rrinim atje mbi bar ose në muret e kishës dhe njiheshim riga larg in- të gjitha qoshet e Korçës, e cila shtrihej përpara si në pëllëmbë. Andej zakonisht venim për në Shëndëlli, një tletër bregore në fund te qytetit. Ishte dhe kjo një kodër dminuese, me akacie dhe prapë me një kishë të vjetër në majë. Te gjitha majat dominuese i kishte zaptuar priftëria.

Në Sil zakonisht ngjiteshim riga bulevardi. Atje Ei, triheshim në, bar nën hije dhe soditnim sidomos fushën, fshatrat. Debojën dhe fundin e bulevardit. Në këto kodra tnerrim lexonim edhe libra, tekste mësimore ose r ornane. Nganjëzierë shkonim që këndeje edhe në fshatin Barç. Në Shënthanas e në Shëndëlli ngjiteshin zakonisht studentët. nxënësit e shkollave dhe qytetarë të tjerë, por stdomos ditën e festave të emrave të këtyre dy «shenjtorëve», ngjiteshin edhe gra me mesha në duar dhe vajza të reja. Në raste të tilla atje organizohej një lloj panairi.

`end tjetër ku shkonim në formë shëtitjeje ishin Drenova dhe Boboshtica, me ujë të ftohtë. me hije të bukura, me mana të kuq që ria pëlqenin shumë, por, për të shkuar atje. duhej të niseshe në mëngjes që të mos haje vapën si në vajtje, edhe në kthtm.

Kurse. kur venite te Guri i Capit dhe në Bozdovec e në Dardhë (një herë kam shkuar në këto vende sa isha student i liceut), ngriheshim thellë-thellë ne mëngjes. Në Dardhë shkohej me një kamion të vjetër. Atje bënim piknik. bukën e merrnim me vele.

Nga të gjitha shëtitjet ruaj kujtime të bukura për ato vende dhe kur vete në Korçë. shkoj i vizitoj. Nostalginë e viteve të rinisë e shton më tepër fakti që tash ato „anë zbukuruar. janë pyllëzuar e mbushur me pemë, shkon vetura, mes për mes tyre si dhe rreth e përqark.

Ndër vendet tnë të preferuara të miat dhe tee plot kujtime riga jeta e studentit ishin kafja e Pandës. e Shetros, kafja e Bilbilëve dhe një kafene tjetër e vjetër. që tash tnë duket është prishur. se në vend të saj është ndërtuar spitali. Këto vende edhe pse i quanin kafe. nuk ishin për ne si kafenetë e tjera. por si kopshte verore. Atje edhe tnund të porositje një kafe, një llokume o gliko që kushtonin zakonisht një «lopkë», por përgjithësisht liceistët nuk shkonin atje thjesht për kafe. Në këto vende zakonisht ne shkonim të mësonim gjatë javës, sidomos në pranverë dhe në verë, kur përgatitnim provimet e bakalor eatit të parë dhe të filozofisë.

Preferonim kafenenë e Pandës, pse ajo ishte me shumë trëndafila, me gjerdhe të gjelbëruara të ndara si kuti-kuti. Atje kishte shumë pemë, të cilat bënin hije që të freskonin e të çlodhnin, sidomos në zhegun e vapës. Shtriheshim ose në bar, ose kërkonim ndonjë fron a bankë dhe hapnim librat. Kurse përbri kafenesë-lulishte nuk kishte shumë bar e trëndafila, kishte vetëm pemë me hije të dendura dhe ishte më qetë. Kur shkonim atje, ngjiteshim në ballkonin e kafenesë dhe, nën degët e një arre të madhe, mësonim. Atje shërbente Llazoja, Llazo «kapetani», siç i thoshin. Ai ishte një burrë ndonja 40 vjeç, që s'i bëhej vonë ta lante a të mos e lante fytyrën kur zgjohej në mëngjes, rrobat i kishte të vjetra dhe i mbante si mos më keq, këmbët i hiqte zvarrë. Këtë zakon mundet që e kishte marrë nga

këpucët që i hiqte osh dlhe që dimër-behar i rrinin copë e çikë. Siç kishte zakon të hiqte osh këpucët, kishte zakon të lëshonte orë e çast fjalë skatologjike.

- Ç'kemi Llazo ! - e pyetnim.

- Ç'të kemi, një m. . . ! Dje i humba dhjetë lekët, m'i fitoi Vasili i Thinës! (Vasili i Thinës ishte shitësi i gazetave franceze nëpër bulevard.) Çfarë do të merrni? na pyeste pastaj Llazoja.

E porositim të na sillte nga një gliko dhe Llazoja, duke hequr osh këmbët, zbriste poshtë dhe na sillte me një tabaka filxhan kafeje, në një lugë një kokërr të vetme qershie.

- Po na «kanaqeps»! - i thoshim ne me ironi.

- S'dua t'ju prishet oreksi i bukës! - na e kthente Llazoja.

Glikoja kushtonte një «lopkë», domethënë një çerek leku. Korçarët e quanin «lopkë» këtë monedhë se në njërën anë të saj kishte një luan që i përngjiste lopës. Kur ne i jepnim nga një lek Llazos, domethënë një «lopkë» për glikonë dhe tre «loпка» peshqesh, ai nuk të falënderonte, por të thoshte:

- Mënë, sa xhomert studenti! Kot thonë se gjirokastritët lidhin macen kur hanë bukë.

Po kur nuk kishim t'i paguanim as «lopkën» i thoshim

- Mbaje mend, Llazo, ta paguajmë herë tjetër.

Llazoja na përgjigjej

- S'kam mend unë, veçse ta shkruaj në pllakën

e . . . - dhe i binte të pasmes . . . - Mënë, studentët ! Kur qenkeni kripë, ç'më Nani dlëe gliko ! Shkoni or pini ujë në çezmat e Shetros!

Ngandonjëherë, për të qeshur me Llazon, i thoshim:

- Llazo, mu në grykë e kemi qershinë tënde, bjena ore një gliko me çaçanik! (Çaçaniku ishte gliko me arrë, më e shtrenjtë.)

Llazoja atëherë na e kthente:

- Mënë, studentët, na dashkan edhe oreftiko! (Oreftiko donte të thoshte që të hapte oreksin.) Shkoni ore te Nanoja, ku venë Thimaqka i Calës dhe Petraqka i Katros, në doni të hani gliko me çaçanik !

Përballë kësaj kafe-lulishteje ishte spitali i Korçës, dhuratë e «filantropit» Thoma Turtulli. Thomai ishte më pasaniku i Korçës, tregtar spekulator i madh. Ai i bëri qytetit «peshqesh» një bibliotekë, furriçkë dhe regjimi zogist i jepte leje të sillte nga jashtë plaçka tregtie pa taksa e pa doganë, të cilat i sillnin një fitim sa për të bërë 15 biblioteka. Kështu ishte vepruar edhe për spitalin.

Kur Llazoja na sillte glikonë, e pyetnim:

- Kush e ka bërë këtë spital, o Llazo?

Ai vrenjtte vetullat dhe thoshte:

- Vëra e halesë!

- E or Llazo «kapetani», e shan Thomanë kështu se nuk të dëgjon, - e shpoja unë, i bindur se pas kësaj ai do të tregonte për të njëqindën herë historinë e kësaj nofke që e dinte gjithë Korça. Dhe Llazoja ia niste:

- Çfarë more, a e njihni ju kokën time?! Unë ia kam thënë atij në surrat! Para se të bëhesha garson, isha hamall te Thomai i Turtullit. Tërë ditën ngarko e shkarko thasë. Një ditë u lodha shumë, më kullonte djersa nga mafia e hundës, prandaj u unja dhe drodha një cingare. Thomai më pa

«Hë or, zvarrisu! - m'u hakërrua. - Ç'më pi cingare?».

«Dale, o Thomaqkë, - i them, - se jam lodhur».

«Hë or mbytu e mos folë, qelbanik, çohu e puno!» - më bërtiti Thomai. Mua më erdhi piperi në hundë dhe i thashë Thomait: «S'dua të çohem, o vërë e halesë!» Natyrisht për këtë ai më dëboi, por kush doli më i fituari? Le të krimbet në flori. Tërë dynjaja s'e njeh më për Thoma, por për vërë haleje!

Nganjëherë i bënim Llazos dhe shokut të tifi që e zëvendësonte nga një çikë propagandë, po Llazoja thoshte:

- S'kam kohë unë për ato gjëra! Për ndonjë të sharë dhe për ndonjë të bërtitur më kini mua, po ju, or ju mbylltë, ruhuni nga xhandarët se do t'ju futin në të Tralos (në burg).

Sotir Papakristoja, drejtori shqiptar i liceut, ishte ca i ashpër me ne, studentët, prandaj ngandonjëherë ne ia paguanim këtë sjellje të tifi me greva. Më kujtohet se një herë nuk na lejonin të venim të festonim kujtimin e dëshmorëve të Orman-Çifligut, pse, sipas tyre, ishte ditë mësimi. Oborri i liceut ziente nga protestat. Studentët dërguan delegacion te drejtorët. Më caktuan edhe mua nga klasa jonë. Në krye të delegacionit ishin dy-tre shokë më të rritur, të klasës së filozofisë dhe të matematikës dhe në krye fare ishte Xhelal Rusi. U kërkuan leje drejtorëve që rrinin të dy në një dhomë kundruall njëri-tjetrit. Francezi Kutun mbllaçitej, kurse Papakristoja refuzoi të na jepte leje. Atëherë ne zbritëm në oborr, i dhamë dudat Nisit, shërbyesit të liceut, thyem bravën e derës (pse derën e oborrit kurdoherë e mbyllte Nisi me bravë), dolëm jashtë dhe, dulce kënduar, zbritëm bulevardin «Themistokli Gërmenji» e drejt për në Orman-Çiflig. Drejtori s'na bëri dot gjë, u kënaq me një qortim, pse ishim shumë dhe, po të na dënonte ne të komisionit, e merrte me mend se do të fillonte greva e të gjithëve dhe të tilla manifestimeve ai u ruhej.

- Duhet të mësohemi të sulmojmë në barrikada! na thoshte në raste të tilla Xhelal Rusi, që ne e merrnim me mend se do të kishte lidhje me dikë nga «bolshevikët», siç quheshin me përbuzje nga arhondët e Korçës punëtorët revolucionarë.

Me Xhelalin organizonim edhe «mitingjet» për doktor Zografin. Ky ishte një burrë 55-60 vjeç, i shkurtër dhe i hollë nga fytyra dhe nga trupi. Kishte edhe një mjekër me majë, vishej me redingotë dhe me bombe, me pantallona me vija, kurse ditët e festave vinte një kapelë cilindër. Ishte qesharak dhe ca i lehtë, prandaj si borgjezia e Korçës, edhe autoritetet e vendit, e tallnin. Për të shëruar të sëmurët nuk e merrte njeri. Mirëpo doktori kishte një mani: donte të zgjidhej deputet dhe bile fio dosido, por deputet i opozitës. Ai hiqej dhe në të vërtetë ishte një demokrat liberal, ndjenja këto që i shfaqte haptazi. Doktori kishte maninë e fjalimeve, mirëpo në fjalime rrokulliste edhe shkëmbinj, fio haptazi për Zogun, po për gjithë njerëzit e tifi në Korçë. Kështu që rreth doktorit autoritetet dhe borgjezia kishin bërë karantinë. Ne, studentët e liceut me Xhelalin në krye, herë me shaka e herë me seriozitet, e ndihmonim doktorin në fliste. Kur vinte Dita e Flamurit, sidomos, autoritetet përgjonin se mos dilte doktori e niste nga të tizat. Doktori, nga ana e tifi, këto momente mezi i priste. Pispillosej me frak, me cilindër, me bastun dhe me një dekoratë, që nuk e mba j mend se kush ia kishte dhënë, dhe shkonte drejt ku mbahej mitingu, në ballkonin e shtëpisë së Sugarit, përballë Shëngjergjit. Rojat nuk e linin të hynte brenda, prandaj ai kacafytej me ta te dera. Në atë kohë, në mes të zallahisë, ndërhyrim ne, e rrëmbenim doktorin dhe fshehurazi ngjiteshim ca më lart në ballkonin e një kafeneje me bilardo, ku pritnim sa të mbaronte ceremonia zyrtare.. Me të mbaruar kjo, e nxirrnim doktorin në ballkon dhe ky ia fillonte fjalimit. Halli ishte se nuk e linte njeri të fliste, kush fërshëllente, kush bërtiste: «Ujë doktorit!»

Ky kundërpërgjigjej me britma e bot e sha. E gjithë puna kthehej në një të qeshur kolosal. Mirëpo një herë, e mbaj mend si tash, e patëm pisk, pse mend na e shtypën doktorin. Kur zbritëm nga kafja me të, na u qep populli nga pas dhe bërtiste:

- Fjalë doktor!

Po çfarë fjale! Doktor ziu ishte lodhur së shari e së çjerruri në ballkon, i binin djersët, mezi e mbanim nga krahu se mos binte, nga një anë une e nga një anë Xhelali. Mirëpo populli vazhdonte të bërtiste

- Fjalë doktor!

Më në fund e futëm në farmacinë e Lakçes, e rrethuam me studentë, derisa u largua populli.

Më vonë doktori desh na pësoi një fatkeqësi: për pak u mbyt në liqenin e Pogr adecit ! Vëllai i doktor Polenës, edhe ai doktor, u martua, bëri dasmë dhe po atë natë, ashtu të pirë siç ishin, morën edhe doktor Zografin dhe shkuan në Pogradec të vazhdonin ahengun. Ia hipën të tërë varkës dhe u mbytën. vetëm doktor Zografi shpëtoi për mr ekulli.

- S'e gjen gjë paranë kallp! - thoshin korçarët.

Të nesërmen e dasmës, natyrisht, ne, miqtë e doktorit, shkuan në shtëpinë e tij ta uronim që shpëtoi. Por ai ishte edhe komik në kulm. I kishte hipur një të verdhë në fytyrë dhe ashtu, si kokall që ishte, na doli vetëm me të mbathura dhe me një batanie të vjetër në krahe.

- Shyqyr që shpëtova, doktor! - i thamë.

- Nuk thoni shqyr që i shpëtoi Shqipërisë një njeri i madh! Ç'e do, - vazhdoi, - unë shpëtova, po dekorata vate, më ra në gjol dhe kjo më ka pikëlluar se nuk gjej dot kopje ta zëvendësoj!
- Nga frika doktorit i kishin ikur dhe ato pak tru që kishte.
- Mos u mërzit, - i tha Xhelali, - se kur të marrim ne fuqinë, do të të dekorojmë!
- Këtë e di, - ia priti ai, - por, kur të merrni fuqinë ju, mua do të më ketë mbirë bari mbi trup.

Korça dhe vendet rreth e rrotull saj nuk ishin të bukura vetëm në verë, por edhe në dimër. Në atë kohë,

28 Nëntori, Festa e Flamurit, do ta gjente Korçën të mbuluar me borë. Në dimër populli kishte shumë vështirësi për çështjen e ngrohjes. Drutë ishin të shtrenjta dhe në internat e në shkollë na i jepnin me shumë ekonomi. Sidomos në shkollë kishte ditë që plevitoseshim.

Nganjëherë i thoshim Aleko Turtullit (shok i klasës), djali i Vangjos dhe nipi i Thomait:

- Na sill ca dru nga shtëpia, o «viç i artë», se do t'i ftohesh mamasë, që të ka të vetëm!

«Viç i artë» ishte nofka e përshtatshme për atë djalë bullafiq, që rritej të trashëgonte pasuritë e Vangjos, të Thomait dhe më vonë, kur u martua, edhe të Lakos!

Mirëpo, nuk i trashëgoi dot, për arsye të Luftës sonë. Ai nuk doli hapur kundër nesh, por, kur u vendosën taksat e luftës për tregtarët e mëdhenj, natyrisht, për Turtujt nga të cilët kishte ngelur vetëm Lekoja, këtij iu caktuan

disa miliona. Alekoja pagoi një pjesë, kurse për tjetrën përpëlitej, bënte be e rrufe që nuk kishte më, po nuk e besonte kush. Kur po afrohej afati dhe në rast se nuk

do t'i paguante, do të shkonte drejt e në burg, më kujtohet që erdhi në Tiranë dhe kërkoi të piqej me mua, të më «qante hallin» si bashkënxënës që kishim qenë. I thashë:

- Leko, paguaja shpejt paratë popullit dhe shtetit, ndryshe nuk do të shpëtosh nga burgu!

Korça nën borë kishte bukurinë e saj, sidomos për ne, të rinjtë, që na vlonte gjaku. Veçanërisht ditët e para të borës ishin plot gjallëri në qytet. Lufta me topa bore fillonte që në oborrin e internatit, vazhdonte rrugës kur shkonim me radhë në shkollë dhe mbaronte në oborrin e liceut. Keq ishte në dimër kur frynte «Morava», pse bënte një i ftohtë i hidhur që të karkalloste, siç themi ne, gjirokastritët. Midis kaq e kaq episodesh nga lojërat dhe zbavitjet tona në ditët me borë më kujtohet edhe një rast kur në një shesh pranë liceut nisëm të bënim tre-katër njerëz prej bore. Në fillim kjo nisi si një zbavitje e zakonshme, por pastaj dikush gjeti një kapelë të vjetër xhandari, të tjerë sollën borsalina të vjetra e jelekë të mykur, u sajuan ca lloj spaletash e armësh prej drusi: u gjetën rripa të trashë, tespihe e nishane, u mbështollën këmbët me llastika e teneqe të hedhura e, na dolën ca koqe «nëpunësish» të dhjamur e «xhandarësh», të cilët vërtet prej bore, por s'u linin gjë mangët për nga grotesku nëpunësve të lartë e xhandarëve tipikë të regjimit.

Edhe qeshnim, edhe i shkelnim syrin njëri-tjetrit e shpejt e shpejt «u ngrit në këmbë» edhe kreu i kësaj tufe kukullash prej bore, një biçim burreci me një kurorë leckash mbi kokë, për ta bërë më të qartë aludimin me mbretin. Loja mori përmasa të ndjeshme, nisën të mblidhen të rinjtë të liceut e të mëhallëve rrotull, filluan shpotitë e thumbat dhe, ca për të mos lënë shteg që t'ia behte xhandarmëria, ca për ta çuar lodrën gjer në fund, u lëshuam mbi kukullat prej bore dhe ua këputëm kokat e krahët e ua rrëzuam nishanet.

Historia e kësaj loje ra erë, nisën të hetojnë se kush mori pjesë dhe a ishte e gjitha kjo një tallje e hapët ndaj njerëzve të regjimit, por s'nxorën gjë në shesh. Ndonjë «teprim» në veshjet e «zbukurimet» e kukullave prej bore e justifikuam me traditën e karnavaleve, të cilat në Korçë ishin shumë të përhapura dhe organizoheshin çdo vit. Në karnavalet merrte pjesë i gjithë qyteti, imitoheshin me lloj-lloj maskash e marifetesh të mirë e të ligj, por, kuptohet, në shenjë të humorit e të groteskut popullor viheshin sidomos pasanikët megalomanë e cingunë të qytetit, nëpunësit bataçinjtë, elementët e degjeneruar dhe gjithë soji e sorollopi i tyre. Populli i thjeshtë në ditët e karnavaleve edhe zbavitej, por, mbi të gjitha, gjente rastin të shfrente urrejtjen e neverinë e tij ndaj atyre që e mashtronin dhe i pinin gjakun.

Pikërisht me këtë zakon e lodër popullore u mbrojtëm kur na thirrën kujdestarët e na pyetën për njerëzit prej bore, dhe ngaqë nuk nxorën dot gjë në shesh, çështja u mbyll me një qortim e me «këshillën» që «karnavale të mos bëni më me dëborë, ndryshe do të përjashtoheni nga liceu». Ky ishte i vetmi «incident» në dimrat e paharruar korçarë, natyrisht pa folur për ato raste kur ndonjëri-terhiqej nga «fusha e betejës» me ndonjë rrufë ose ftohje të mirë, që e mbërthente dhjetë-pesëmbëdhjetë ditë në shtrat.

Por borës nuk donin t'ia dinin gratë e Korçës, të cilat ishin për t'u lavdëruar. E kam fjalën për pastërtinë. Ato dimër-behar çdo gjë e mbanin pastër, shtëpinë, jashtë shtëpisë (oborrit dhe paraportën në rrugë) veten dhe familjen e tyre. Të hyje në shtëpitë e korçareve, do t'i gjeje të pastra, sobalkat me çulle, rrugicat të shtruara me qilimka «pe shkoxce» që i bënin vetë me avlëmente, perdet në penxhere nuk mungonin. Të shtunën, në çdo stinë, çdo grua korçare do të bënte pastrimin e përgjithshëm të shtëpisë, të oborrit, të paraportës, ndërsa burrat bënin pazarin. Të nesërmen, të dielën, do t'i shihje të gjithë të pastër, të krehur; pleqtë e plakat venin në kishë, të tjerët bënin vizita te njëri-tjetri, kurse çupat në mëngjes dhe pasdreke ose dilnin te pragu i portës, ose sliëtitnin në bulevard nga katër, nga pesë, të veshura me fustanet e tyre më të bukura dhe të zëna nga krahu njëra me tjetrën.

Në Korçë, dhe kjo nuk ngjiste në ndonjë qytet tjetër të Shqipërisë në atë kohë, kishte bandë muzikore, kishte dhe disa orkestra që të dielat luanin në disa lulishte, sidomos në kafen e Bilbilëve në fund të bulevardit dhe te kafja e Pandës. Por kishte dhe grupe të rinjsh me kitara që formonin kore të vogla dhe dilnin natën, i binin kitarës dhe bënin serenata, në rrugë o nën penxheret e shtëpisë së ndonjë vajze. Ishin të gjithë korçarë, njerëz të mirë; zanatçinj artdashës. Ata këndonin këngë

patriotike dhe dashurie dhe më të mirët prej tyre aktivizoheshin në grupin artistik «Lira» që në ato vite ishte shumë i njohur në Korçë e jashtë saj. Një pjesë e mirë e djemve të atyre viteve, si Jorganxhiu, Moskoja e të tjerë, e ruajtën dhe e vazhdojnë edhe sot traditën e grupit «Lira». i cili, ngaqë pjesën më të madhe të këngëtarëve amatorë i ka të moshuar, tash quhet «Kori i pleqve».

Kur shkoj në Korçë, edhe une, edhe ata gëzohemi që piqemi së bashku. Ata organizojnë mbrëmje, ku marr pjesë edhe une dhe, pas koncertit që japin për nderin tim, fillojmë muhabetin për kohët e para, ndërsa të rinjtë dhe të rejtat kërcejnë përpara nesh të lumtur e të gëzuar për ditët plot punë dhe bare që u krijoi Partia.

Vitin e parë të shkollës në Korçë e mbarova me sukses. Kalova në klasën e parë të liceut. Dëftesën e kisha të mirë, me mensionin kënaqshëm. Mensionin ishte vlerësimi i punës së nxënësit që bënte vetë drejtori francez i liceut në dëftesë. Isha shumë i gëzuar. Ne, pasi merrnim dëftesën, rrinim edhe disa ditë dhe pastaj niseshim për në shtëpi. Ushqimi na pritej në vere, në internat qëndronin vetëm ata që ishin «muhaxhirë», ose që s'kishin fare familje. Këta zakonisht ishin shokët nga Kosova, disa nga Veriu dhe ata që vinin nga shtëpitë e jetimëve. Gati të gjithë ne që vinim nga Jugu ktheheshim në shtëpitë tona për pushime, që vazhdonin deri në vjeshtë, kur rihapej liceu. U nisëm me kamion për në Gjirokastrë, duke ndjekur përsëri rrugën e Përmetit. Prisja padurim sa të arrija në Gjirokastrë, pse më kishte marre malli për xhaxhain, anenë, Sanon, qytetin tim të lindjes.

Gëzimi në familje ishte i madh, pse u vajti djali i vetëm. Ç'të më bënte më parë aneja për të më kanaqepsur një çikë! Edhe xhaxhai nga ana e tij bëhej copë, shkonte dy-tri herë në pazar, blinte mish, zarzavate, sheqer etj., pse aneja duhej të na bënte nga ndonjë ëmbëlsirë, ose të na hollonte ndonjë byrek me djathë, që une e haja shumë. Xhaxhai nuk mungonte të më jepte edhe ndonjë lek si para xhepi, nga ato të pakta që kishte dhe që i mbante në një çantë me dy-tre xhepa, e që mbylley me një suste që kërciste. Në çantë ai i ndante të hollai pesëlekëshet veç, njëlekëshet veç, gjysmëlekëshet veç, edhe «groshet» veç. Ditët e para të pushimeve, nga mal: që e kishte marre për mua, ai m'i jepte lekët pa ia kërkuai Kur kalonin disa javë, atëherë duhej t'ia kërkoja dhe ai më jepte, duke më thënë vetëm: «Mos prish shumë» (Une nuk prishja veçse e shumta një lek në dite.) Por kur kalonte muaji dhe i kërkoja lekun e zakonshëm, mjepte me zor, veç ma jepte, duke e

shoqëruar me fjalët «Ma rrope lëkurën!». Kur hynte muaji i dytë, duhej edhe ndërhyrja e anesë që t'i nxirrja xhaxhait ndonjë lek ng çanta. Ai nuk ishte aspak i kursyer, por me të vërtetë, nuk kishte, ishim shumë hollë ekonomikisht.

Gjatë pushimeve. në Gjirokastër ne organizonim shëtitje me shokë. Çdo mëngjes dilja dhe me radhë u bëj; vizita në shtëpi shokëve dhe kushërinjve, kudo, në çdi mëhallë që jetonin. Më pëlqente shumë kjo gjë, por edhe kushërinjve e familjeve të shokëve u vinte mire. Pasdreki zakonisht nuk flija, por rrinim në minder poshtë në hajat nën shkallë. se bënte fresk dhe, kur nxeheshim, nxirrnim ujë me kovë nga stera, freskonim këmbët ose u hidhnin kokës dhe ,gjoksit nga një kovë ujë. Aneja thoshte:

- Enver, mos e harxho shumë ujin, se na mbarohe stera dhe mbetemi pa ujë, pse edhe di pëllëmbë ujë ka mbetur...

Na ishte bërë zakon që, kurdoherë që hidhnim kovër e thatë në sterë, të parën gjë që do të bënim ishte të matnim sa pëllëmbë ujë kishte akoma. Gjirokastra vuante për ujë të pijshëm. Nuk e di në e kam thënë më parë q~ stera jonë. ashtu si shumica e sterave të tjera, mbante dhe krimba të kuq, prandaj ujin e kullonim me buzël të bardhë, pastaj e përdornim.

Kur freskohej pasdreka, dilja në penxheret e odasë së madhe dhe vëreja xhadenë, kur dilnin shokët. Vërejtje me një dylbi të vjetër marine, të hollë. Kur ishte e mbyllur, ajo ishte ndonjë pëllëmbë e gjatë, po bëhej tri pëllëmbë kur e hapje për të parë. Ajo hapej me tri faza dhe çdo pjesë futej njëra tek tjetra kur mbarohe punë. Këtë dylbi, që kërciste si revolver kur e mbyllje, na e kishte dhënë nëndajkoja.

Në pushime, në Gjirokastër zhvillonim edhe aktivitete kulturore, riorganizonim orkestrën, luanim pjesë teatrale, komedi të Molierit etj., organizonim kore labçe dhe lexime librash. Librat edhe ne pushime unë nuk i hiqja nga dora. Sidomos romanet në frëngjisht i për pija. Muajin e fundit të pushimeve hapja dhe librat e shkollës dhe ambientohesha me mësimet e klasës së parë që do të vazhdoja. Librat shkollorë zakonisht i huaja nga Aqifi dhe nga Selamiu, që ishin një klasë më lart nga unë.

Kur do të niseshim në vjeshtë për në Korçë i thashë anesë të më bënte një ëmbëlsirë për shokët e mi të dhomës, si Rasimin e të tjerë, që s'kishin familje. Aneja më kënaqi, duke rënë bërë një tepsi plot me llokume të shkrifëta. Xhaxhai, si merakçi që ishte, më bëri një teneqe tek usta Maloja, e solli, i vuri aneja me radhë brenda dhe xhaxhai përsëri i e mori teneqenë plot me llokume dhe e mbylli te Malo teneqexhiu me kallaj. Rasimi, Kel Gashi e të tjerë, u gëzuan shumë kur ua dhashë.

- Si lum ti që ke një nënë kaq të mirë që mendon dhe për ne pa nënë, - më tha Rasimi. - Kur t'i shkruash e falëndero nga ne dhe i thuaj se e përqafojmë, si djemtë e saj.

Nuk mungova t'i shkruaja anesë të falat e shokëve të mi! Kur isha nisur për pushime në Gjirokastër, i kisha thënë Rasimit: «Hajde me mua në Gjirokastër t'i kalojmë së toku pushimet në shtëpinë time». Ai më falënderoi, por nuk deshi, ndoshta që të mos na bëhej bar rë dhe se ishte «i rrjepur» i shkreti. Rrobat i kishte të vjetra, një këmishU kishte dhe, kur lante atë, vishte xhaketën mbi trup. Në dimër kishte një pallto të vjetër, që e ngrinte jakën kurdoherë për të ruajtur grykën nga të ftohtit. Kasketa e Rasimit ishte poemë: Tabani i saj ndriste nga djersa dhe nga dhigla e leshrave. Internati u jepte këtyre shokëve pa familje vetëm nga një këmishë dhe nga një pelerinë për dimër, të hollë, të zezë dhe deri mbi gju.

Filluam vitin e dytë të shkollës në Korçë, tash në bakalor eat, klasa e parë (première partie). Bakaloreati i përngjet maturës së sotme, por matura e sotme jepet një herë dhe mbaron brenda një viti, kurse në Liceun Francez të Korçës bakaloreati jepej në dy vjet, dy matura si me thënë (première partie et deuxième partie), të dyja të rënda, të dyja vendimtare. Po fi fitoje të dyja, atëherë quheshe se kishë mbaruar liceun dhe kishë të drejtë të hyje në çdo universitet të Francës dhe të të gjitha vendeve të tjera të Evropës. Kjo ekuivalencë e liceut tonë me licetë e tjerë të Francës u fitua pas shumë përpjekjesh nga ana e profesorëve francezë, sidomos nga drejtori i asaj kohe Baji Komti. Ky ishte një sukses i madh për Liceun e Korçës.

Gëzimi im ishte i madh që u poqa përsëri me shokët

e internatit dhe të klasës. I tregonim shoqi-shoqit përshtypjet e pushimeve, i thoshim njëri-tjetrit çfarë romane kishim lexuar dhe cilat pr e j type na kishin pëlqyer. Me shokët e klasës kam shkuar kur doherë mirë. Ishim një klasë pak a shumë e bashkuar, por nga mësimet qemë n 1e disnivele të ndryshme. Kishte shumë të mirë, si Hamit Kokalari, Selman Riza, kishte edhe nga ata që mezi kaluan ose ngelën. Në klasë kishim edhe një vajzë, e vetmja dh e e para vajzë në lice. Më vonë, pasi mbarova unë, erdhën dhe të tjera. Korça, megjithëse njihej si qytet përpar, imtar, për sa i përket ar simimit të vajzave ishte më prapa se Gjirokastra. Në Liceun e Gjirokastrës kishte edhe vajza. Bile edhe e vetmja nxënëse e Liceut të Korçës, ishte nga Gjirokastra, nga Libohova, çupa e një doktori. Një vëlla e kishte në klasën e filozofisë. Ishte e lezetshme, e zgjuar, po nuk shkëlqente në mësim, s'linte dy gurë një mbi një, vervele e bënte klasën, ua nxirrte trutë një shokut tonë nga Gjirokastra dhe një beu elegant. Në fakt ajo me të gjithë këta tallej. Fillimisht ua zgjaste e i sillte vërdallë, paataj s'ua vinte më veshin as këtyre, se ia filloi dashuriçkës me profesorin tonë të fizikës dhe të kimisë, Sen Zhënenë, për të cilin do të kem rastin të flas më poshtë. Beu elegant dhe Aleko Turtulli ishin arhondë, prandaj s'na hahej muhabeti me ta. I pari e fliste lirshëm frëngjishten (babai i tij ishte ministër i Jashtëm në ato kohë), kurse i dyti ishte nga më të dobëtit e klasës. Kristo Fundoja e disa korçarë të tjerë, si shokë ishin të ftohtë, por në mësim venin mirë, sidomos Fundoja ishte nga të parët në matematikë.

Përveç profesorëve të mëparshëm, për klasën tonë erdhi edhe një i letërsisë frënge, që quhej Maraval. Ai ishte i zoti, por një fodull i madh, kurdoherë e mbante kokën lart dhe hundën përpjetë. Dimër-behar ai hynte me shall në qafë, në dimër të leshtë, në behar të mëndafshhtë dhe njërin nga cepat e shallit e hidhte pas krahëve. Maravali rrallë e tek qeshte, ose më mirë buzëqeshte, si duket e kishte adoptuar si pozë për ne, nxënësit, në shenjë autoriteti. Ne e këshillonim shoqen e klasës të bënte ndonjë shaka me të, sa t'i merrnim erën, por ai nuk lëvizte nga e tij.

- S'kam ç'bëj më, - na thoshte shoqja, - veçse të vishem si klloun.

Maravali, kur na bënte komentet e teksteve, mbante kurdoherë përpara çantën e tij të fryrë, nxirrte një libër «misterioz» dhe fliste si bilbil. Analizat e tij ishin të thella, ne përfitonim, por donim të dinim çfarë ishte ai libër. Atëherë vumë shoqen të bënte zbulimin. Më kot. Më në fund u ça rrethimi. Shoqja zuri miqësi me të zonjën e shtëpisë ku jetonte profesori dhe hyri në dhomën e Maravalit, mori titullin e librit, adresën e librarisë, por edhe të disa librave të tjerë, që kishin modele të trajtuara të temave të ndr yshme letr are.

Një shoku ynë i klasës i porositi këta libra te babai i tij në Francë dhe ne i shtimë ata në dorë. Një ditë Maravali e ngriti atë të komentonte një tekst dhe ai, ngaqë e kishte mësuar përmendsh komentarin, ia filloi siç ishte në njërin nga ata libra. Maravali e dëgjonte me sy të shqyer, skuqej, i binin djersë dhe e shikonte me vërejtje shokun tonë. Kur ky mbaroi dhe

e tha mësimin në mënyrë të shkëlqyeshme, Maravali i vur i notën 9. Notat në lice numëroheshin me 20, domethënë 20-a e asaj kohe ishte barazi me 10-ën e tashme. Shoku ynë mori kështu një notë të pakalueshme. Me fjalë të tjera, Maravali e kuptoi që libri i tij «misterioz» u dogj dhe e zhduku nga çanta e tij, nuk e sillte më në klasë. Mir ëpo ne sollëm edhe të tjerë nga ata libra, pse ishin shumë të mirë, na ndihmuan, prandaj më në fund, deshi s'deshi, ai na i rekomandoi vetë ata dhe të tjerë.

Për të mësuar letërsinë franceze ne përdornim tre autorë, Emil Fagetin, Lansonin dhe Brynëtierin. Mua më pëlqente më shumë Lansonin dhe një autor tjetër, i cili ishte më konciz në definicione, kishte citate të veprave, ishte edhe i ilustruar mirë.

E vërteta është se Maravali na ndihmoi shumë të pasuronim njohuritë tona në letërsinë franceze dhe si domos në atë të shekullit të 19-të dhe të fillimit të shekullit të 20-të.

Unë vazhdova të lexoja me etje Balzakun, i cili më pëlqente shumë, pse në romanet e tij, në atë kohë, kur i këndoja, shihja të përshkruheshin aq bukur tipa njerëzish që kishin shumë gjëra të ngjashme me njerëzit që njihnim në jetën tonë të përditshme, sidomos të fajdexhinjve, të gënjeshtarëve, të pasanikëve dhe të njerëzve të thjeshtë e të varfër. Te Balzaku më pëlqen te gjuha e tij e pasur dhe tema në përgjithësi e ndërtuar me mjeshtëri. Më vonë unë do ta kuptoja si duhet rëndësinë e madhe të «Komedisë njerëzore», kritikën e saj therëse ndaj borgjezisë dhe se si Balzaku,

duke u nisur nga pikëpamjet e tij monarkiste, arriti të bënte një demaskim kolosal dhe real të borgjezisë franceze.

Shatobrianin, po ashtu, e kam kënduar me kujdes, gjithashtu, Alfred de Vinjinë dhe Lamartinin. Shumë vjersha të Lamartinin i mësonim përmendsh, sidomos «Liqenin». Simbolistët, si Mallarmé, nuk më pëlqenin dhe nuk i kuptoja. Kurse Verlënin dhe Rembonë i këndoja me qejf. «Les fleurs du Mal»* *(«Lulet e së keqes», përmhledhje poetike.) të Bodlerit i këndonim me kuriozitet, pse ishin ca të çuditshme për ne në atë kohë. Shumë gjëra nuk i kuptonim dhe as nuk mund t'i kuptonim dot ndjenjat e Bodlerit, por, kur lexonim biografinë e tij, arrinim të realizonim se ato ishin ëndërrimet e një poeti të sëmurë. Ne ishim kuriozë, pse disa nga vjershat kishin një shënim: «të ndaluara». Kjo na çudiste edhe për ar syen se ne arrinim të këndonim libra si «La garçonne»* *(«Çapkenia», roman i botuar më 1922.) të Viktor Margër itit që ishin më skandalozë për studentët e liceut. Romane të tilla i lexonim fshehurazi, ato na i huanin shokët e jashtëm.

Përshtypje të madhe më bënin edhe «Poemat antike dhe barbare» të Lëkont de Lilës, më pëlqenin shumë sonetet e Heredias, shumë nga të cilat i kam pasë mësuar përmendsh që në atë kohë e disa prej tyre i kujtoj edhe tani.

«Zjarri» i Barbysit ishte një nga romanet që më kishte pëlqyer shumë, pse atje gjeja një përshtypje shumë real të luftës, të mjerimeve dhe të vuajtjeve të ushtarëve dhe të njerëzve, një kritikë të ashpër kundër luftës dhe kapitalistëve që e shkaktonin. Por, nuk arrija të kuptoja si duhet që një shkr imtar kaq serioz si Barbysi të shkruante edhe romane si «Skëterr a». Më von do t'i kuptoja më mirë këto probleme.

Edhe libri i gjermanit Remark «Asgjë të re nga fronti i Perëndimit» më pati bërë përshtypje.

Është e zorshme të më kujtohen të gjithë librat që kam kënduar në atë kohë, por është edhe e panevojshme të zgjatem, vetëm dua të them se të gjitha këto lexime më zgjeruan horizontin e kulturën jo vetëm mbi jetën dhe mendimet e popullit fr ancez, por më ndihmuan të mësoja më mirë gjuhën franceze dhe të kuptoja dhe të reflektoja më thellë mbi gjendjen e popullit tonë. Me mendjen time të asaj kohe bëja shumë paralelizma e konkluzione.

Në frëngjisht këndoja me ëndje jo vetëm libra të autorëve francezë, por edhe rusë, si «Lufta dhe paqja», «Ringjallja» dhe «Ana Karenina» të Tolstojit, të cilat më kishin pëlqyer. Kisha kënduar edhe libra të Dostojevskit, si «Vëllezërit Karamazov», «Krim dhe ndëshkim», «Shtëpia e të vdekurve» etj. Këta libra më dukeshin të çuditshëm edhe për faktin se në literaturën fr anceze nuk kisha hasur në libra të tillë «të rëndë».

Nga literatura angleze kisha kënduar në frëngjisht Shekspirin, Dikensin, Defonë, Lord Bajronin dhe Kitsin.

Te «Verteri» i Gëtes, më kishte pëlqyer shumë historia e Lotës dhe e Verterit dhe më kishte trishtuar fundi i tyre. Nga Shileri kisha lexuar disa drama si «Valenshtajnin» dhe «Pikolominin».

Nga literatura spanjolle kisha lexuar Servantesin dhe «Kasollen» e Ibanjezit, kurse nga ajo italiane «Burgjet e mia» të Peikos. Me një fjalë, që në atë kohë kisha një ide, jo të gjerë natyrisht, të lëvizjes letrare dhe në vendet e tjera të Evropës.

Në matematikë nuk shkëlqoja. Profesor të kësaj lënde kishim një që quhej Dëlor. Ky ishte një burrë i shkurtër, me leshra të verdha, i heshtur, që e mbante më të shumtën e herës gojën mbyllur, për arsye se dhëmbët i kishte të dalë dhe të prishur. Edhe mua, si shumë të tjerëve, dhëmbët filluan të më prisheshin që kur shkuam në Korqë, zunë të na dhimbnin dhe, meqë për te dentisti nuk kishim as të holla, as kohë të venim dhe as kujdes sa duhet, ata morën të tatëpjetën. Thoshin se uji i Korqës i prishte dhëmbët ngaqë kishte shulnë gëlqere. Por për profesor Dëlorin nuk ishte uji i Korqës që ia kishte prishur dhëmbët. Dëlori ishte shumë i zoti në matematikë. Megjithëse e dëgjoja mësimin me kujdes, prapëseprapë, shumë gjëra nuk i kuptoja.

Në detyrat ose provimet në klasë, sidomos kur na jepte teorema për të par, ashtuar, këto i zhvilloja, por problemet i zgjidhja me zor të madh. Kështu që merrja notë të kalueshme, por duke mos lëvizur shumë nga kufiri i notës së kalueshme dhe të pakalueshme, domethënë 10-ës (mbi 20-ën kurdoherë). Kishte në klasën tonë shokë të zotë në matematikë, si Kristo Fundoja që e kam përmendur (e që bënte çdo ditë, dimër-behar, dush të ftohtë), Hamit Kokalari, Kiço Karajani, i cili

mburrej duke thënë se kur ishte në Gjirokastër, mamaja i jepte çdo mëngjes të hante nga 20 kokrra vezë. «Pse haje 20 vezë, e ngitnim ne Kiçon, prandaj të janë përveshur buzët», dhe e thërritnim «buzaç».

Kurse gjeometrinë nuk e kisha aq të rëndë si matematikën, ajo ma përmirësonte ca notën. Kur filluam të mësonim gjeometrinë deskriptive, atje e kisha më shumë zor sesa në gjeometrinë plane.

Në fizikë dhe në kimi kishim profesor Sen Zhënenë (Saint-Genez). «Shenjt» e kishte emrin, por ishte shejtan. Atij i vinte nga Franca edhe një gazetë me titull «La croix». Ishte veç njeri shumë i mirë, i zoti shumë, i qeshur dhe mjaft i hapët me ne. Ai na bënte shaka dhe ne kurdoherë e respektonim dhe e donim. Sen Zhëneja kishte një fytyrë të gjatë dhe të hollë, hundën si të shkabës, dhëmbët të bardhë dhe të mëdhenj, shalët të gjata. Ai ishte nga Gaskonja. Ne që kishim lexuar Edmond Rostandin, dhe «Siranonë»* («Le Cyrano de Bergerac».) e tij, kur Sen Zhëneja ishte në qejf i thoshim:

«...*CEil d'aigle, jambes de cigogne Moustache de chat, dents de loup Nous sommes les Cadets de Gascogne, De Carbonne, de Casteljaloux**. *(«...Me sy shqiponje e këmbë lejleku

Me mustaqe maçoku e dhëmbë ujku

Ne jemi kadetët e Gaskonjës,

Të Karbonës, të Kastelzhalusë.)

Ai qeshte në mënyrë shumë simpatike dhe na thoshte:

- Ju keni harruar një varg! - të cilin ne e linim apostafat:

Bretteurs et menteurs sans vergogne»*. *(Shpatarë e gënjeshtarë pa turp»)

Sen Zhëneja na bënte për të qeshur, pse, kur na ngrinte në dërrasën e zezë, herë rrinte ulur, herë në këmbë dhe, për të na korrigjuar gabimet që bënim, kur ishte ulur, merrte nga një copë shkumës dhe qëllonte në dërrasë nga vendi ku rrinte. Ne e merrnim vesh se kishim gabuar, e ngrinim copën e shkumës, ia vinim përsëri afër dhe shkonim në dërrasë e kështu vazhdimisht kur na korrigjonte. Kur ishte në këmbë, meqë i kishte shalët të gjata, ai ngrinte këmbën në vend të dorës dhe me majën e këpucës na tregonte në dërrasën e zezë ku ishte bërë gabimi.

Fizika më pëlqente dhe në këtë lëndë isha nxënës i mesëm, kurse kimia më dukej abstrakte. Formulatat dhe kombinimet e tyre nuk i kuptoja si duhej, prandaj edhe këtu çaloja si në matematikë. Por ashtu si gjeometria në matematikë, në kimi ishte fizika që ma ngrinte notën.

Qeshnim kur ngrihej shoku ynë i klasës Kel Gashi, në dërrasë të zezë. Keli ishte nga Mirdita, në qoftë se s'gabohem, sidoqoftë ishte nga malësitë e Veriut. Frëngjishten mezi e fliste dhe mësimet i kapte me zor. Ishte shok i qeshur e simpatik, tash nuk e di ç'është bërë. E ngrinte profesori dhe i thoshte:

- Thuamë ligjin e Arkimedit! - dhe Keli ia fillonte:

- *Un corps plongé dans l'eau, un corps...** *(Frëngjisht - një trup i zhytur në ujë, një trup...) dhe kështu vazhdonte pesë, shtatë herë me radhë. Nuk i kujtohej rasti i ligjit dhe përsëriste si gramafon vetëm fillimin. E kështu qesh ne dhe qesh Sen Zhëneja. Pastaj Keli, që ta ndreqte, kërcente në ligjet e Lavuaziesë dhe kështu bënte një mish-mash të madh. Sen Zhëneja më në fund i thoshte:

- Oh quel gâchis!

Ia fillonim përsëri të qeshurit, pse në frëngjisht emri dhe mbiemri i Kelit, të thëna së bashku, duan të thonë «ç'katranosje!», me një fjalë «çfarë rrëmuje!» dhe kjo për çudi i shkonte si gant Kelit, pse ai ishte i hallakatur dhe i parregullt jo vetëm në mësimet, por edhe në jetë.

Me laboratorë të fizikës, pa lëre të kimisë, ishim shumë-shumë të varfër, s'kishte ku vente më të varfër. I gjithë liceu kishte vetëm një dollap të vogël në sallën e madhe të katit të dytë, çelësin e të cilit e mbante vetë Sen Zhëneja në xhep, që të mos i hallakateshin edhe ato gjëra të pakta që kishim. Çdo gjë e mësonim nga figurat e librave. Mirë fizikën, po kiminë? E kishim zor.

Shkencat e natyrës më pëlqenin dhe, sido që s'ishin pasioni im, i përvetësoja mirë. Këto na i zhvillonte Brezhoi, derisa erdhi profesor Ligor Serafini. Brezhoi na bënte edhe historinë e

gjeografinë, lëndë ndër më të dashurat për mua e në të cilat dilja shumë mirë, isha nga të parët e klasës. Brezhoi gjeografinë na e zhvillonte me shumë detaje dhe unë, që e kisha profesor të vjetër që nga Liceu i Gjir okastrës e kisha marrëdhënie të mira me të, i thashë një ditë:

- Zoti Brezho, edhe kotecët e pulave të Francës po na mësoni në gjeografi! Atij i pëlqeu vërejtja ime dhe qeshi.

Gjuhën anglisht, si gjuhë të dytë, na e bënte «babi Loni», ose Loni Kr isto. Ky kishte qenë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që kthyer, nxirrte në Korçë një gazetë me emrin «Shqiptari i Amerikës», pastaj gazeta u mbyll dhe «babi Loni» u bë profesor i anglishtes në lice. Ishte i heshtur, disi i egër, asnjë fije pedagogjie dhe didaktike nuk njihte e nuk zbatonte. Vinte në klasë, hapte metodën, lexonte tekstin, e përkthente dhe me kaq mbaronte. Kur vinte mësimi tjetër, hapte metodën, pyeste ndonjë nga ne, që lexonim tekstin e shpjeguar prej tij., e përkthenim, vinte notën dhe... mbaroi! Ky ishte mësimi i anglishtes. Natyrisht, ne s'mësuam gjë pr ej tij dhe, kur ndonjëri nga mërzia bënte ndonjë çikë zhurmë, «babi Loni» i thoshte:

- Pusho, or ti atje në fund, se përndryshe të bëj aeroplan nga penxher ja.

Por më vonë, kur unë shkova si pr ofesor në Liceun e Korçës dhe me Lonin u bëmë kolegë, konstatova se nuk ishte burrë i keq, ishte njeri i mirë, i drejtë dhe muhabetçi, por pa kulturë dhe konservator në mendime. Ai më vonë nuk na mbështeti në Luftën Nacionalclirimtare, por nuk doli as kundër Lëvizjes dhe Luftës, sig dolën miqtë e tij, Fazlli Frashëri dhe Stavri Skëndi.

Kur afrohej provimi i bakalor eatit ishte një eveniment i rëndësishëm në liceun tonë. Për ne që do të hynim në këto provime, ky ishte një preokupim i madh dhe shqetësim serioz. Muaji i fundit sidomos, ishte më i ngarkuari, pse, përveç që profesorët duhej të mbaronin programet, mbasi nuk dihej çfarë pyetjesh mund të vinin nga Franca për provimet me shkrim për të dy bakaloretatë, nga ana tjetër ne vetë duhej të intensifikonim përpjekjet tona për të mësuar individualisht. E mbi të gjitha, në këto kohë në Korçë fillonte vapa. Ne, internatistët e klasës së parë, rreth 15-20 ditët e fundit që kishim leje para futjes në provime, nuk na pengonin të dilnim të mësonim në natyrë, mjaft që të ktheheshim në rregull në kohën e drekës dhe të mbrëmjes. Kështu që ne, të «prëmierit» dhe të filozofisë, do të na shikoje me libra nën sqetull që në mëngjes herët dulce u ngjitur nga kafja e Pandës, nga Shënthanasi, ose dulce qëndruar nën hijen e plepave të varrezave të myslimanëve.

Provimet e bakaloretatit ishin shumë të rënda. Duke gjykuar sot, unë mendoj se ato ishin shumë më të rënda se matura e shkollave të tjera të asaj kohe edhe se matura e shkollës së sotme. Në lice lëndët ishin shumë të zgjeruara dhe të ngarkuara, profesorët ishin shumë ekzigjentë dhe notat i kishin të shtrënguara, sidomos në provimet e fundit. Duke pasur parasysh se provimet jepeshin gati të gjitha në frëngjisht, ato bëheshin akoma më të rënda. Përveç kësaj, nxënësit në kohën tonë nuk kishin ato lehtësira të të mësuarit që kanë sot. Metoda e të mësuarit ishte diçka empirike, jo e orientuar nga profesorët. Ata asnjë ndihmë nuk u jepnin nxënësve jashtë 45 minutave të orës së mësimit, asnjë seminar nuk bëhej në kohën tonë në shkollë. Një gjë e tillë as që njihej.

Në klasën e parë për lëndët kryesore ne kishim dy lloj tekstesh: tekstin e plotë të lëndës, e cila zhvillohej gjithë vitin, dhe një përmbledhje, precis të vogël të tekstit. Precis-ja ishte diçka shumë e mirë, e bërë po ashtu nga autorë kompetentë të materialit. Këto *aide-mémoire**, *(Frëngjisht - ndihmëse kujtese.) siç i quanim, na ndihmonin shumë, sidomos ata që gjatë vitit mësonin sistematikisht. Kishte shokë që në fund mësonin vetëm mbi këto precis, bile i mësonin edhe përmendsh.

Pyetjet për provime, natyrisht, ishin të panjohura jo vetëm nga ne, studentët, gjë që është e natyrshme, por edhe nga profesorët. Gjatë vitit ne nuk orientoheshim sistematikisht me formulime pyetjesh që të ishin pak a shumë të parapërgatitura. Profesorët na pyetnin gjatë vitit, natyrisht, në mësim, por ato që na bënin ishin pyetje të zakonshme, të rastit, jo të plota, jo si duhet të sistemuara. Të gjitha këto dhe atmosfera solemne, kur fillonin provimet, i bënin ato shumë emocionante për ne.

Duhej të futeshim më parë në provimet me shkrim, pastaj në provimet me gojë. Në rast se kalonim me shkrim, kishim të drejtë të hynim në provimet me gojë. Në rast se ngeleshim me shkrim, duhej t'i jepnim provimet në vjeshtë. Por edhe në rast se mbeteshim vetëm me gojë, prapë duhej t'i jepnim

provimet me gojë në vjeshtë. Me shkrim jepnim gjuhën shqip, gjuhën frëngjisht, matematikë-gjeometrinë dhe fizikë-kiminë.

Ditëve të provimit na dridheshin këmbët, na dukej sikur të gjitha i kishim har ruar, ndienim një boshllëk të thellë në stomak. Provimet i jepnim në sallat e mëdha të katit të dytë të liceut. Në çdo bankë rrinim nga dy veta, por në bankën më pas nuk rrinte njeri, pra një bankë kishte nxënës, tjetra më pas jo, që të mos shikonim nga njëri-tjetri. Nuk e mbaj mend mirë nëse letrën e merrnim me vete apo na e jepnin, por kur hynim në sallë të gjitha letrat vuloseshin me vulën e drejtorisë. Asgjë nuk duhej të kishe në bankë të pavulosur. Asnjë libër nuk duhej të merrje. Ndalohesh kopja, përndryshe, po të të zinin, të nxirrnin nga provimi dhe mbaroje.

Kur niste provimi, hynim në sallë drejtori me profesorin dhe në mënyrë solemne hapej zarfi i pyetjeve. Zakonisht ishin dy pyetje, nga të cilat mund të zgjidhje kë të doje. Më kujtohet, ne rrinim si të ngrirë dhe në sallë nuk dëgjohej vetëm se çjerrja e zarfit nga ana e drejtorit. Kur ai niste të diktonte pyetjet, penat tona fillonin punonin. Pasi merrnim pyetjet, atëherë ngrinim kokat, shikonim rreth e rrotull njëri-tjetrin. Ca ishin të gëzuar, ca të menduar, ca të hutuar, ca me sy në bankë, ca me sy në tavan, ca shikonin nga penxherja për t'u frymëzuar; disa fërkonin duar t nga kënaqësia, disa të tjerë shikonin me zili ata që fërkonin duart. Më vonë i bëheshin shoku-shokut pyetje të heshtura me kokë: «Cilën zgjodhe, pyetjen e parë apo t^o dytë?», ose prapë me kokë «Si dukesh, të ecën apo jo?». Përgjigjet, po ashtu në heshtje, jepeshin sipas terezisë, po e kishe mirë punën, pra, po i dije, i jepje shenjën shokut për të mirë, në të kundërtën, varje kokën. Në pr ovimin e matematikës bënim orvatje të kujdesshme për t'u marrë vesh të paktën për rezultatin e afërt të problemit dhe këtë e bënim me anë të gishtërinjve, sidomos kur ishte fiala për numra. Kur dorëzonim letrat dhe dilnim, atëherë me njëri-tjetrin verifikonim zgjidhjet që u kishim bërë problemave dhe trajtimin e hartimeve. Shokët e vitit të dytë të bakaloreatit, pra ata të filozofisë, me të cilët ne shkonim e i verifikonim, na inkurajonin «e keni bërë mirë; sikur të vinit edhe këtë, do të ishte akoma më mirë»; «si e mendoj unë do të marrësh notë të mirë» etj. Këto ishin inkurajime dhe ngushëllime të më të rriturve, gjë që do ta bënim edhe ne në vitin tjetër, kur të shkonim në filozofi për shokët që vinin në të parin.

Pasi mbaronim pr ovimet, vinte pr itja në ankth, bëheshin supozime. Me zor në këto ditë zinin libra me dorë, vinim rrotull rrugës së liceut mos shihnim ndonjë profesor. Kur ai dilte, ne e përshëndetnilln dhe vinim re fytyrën e tij, në rast se ai na buzëqeshte, neve sikur na ngrohej zemra. Cipon e kishim si barometër «të kohës së mire, o të kohës së keqe».

Më në fund drejtori na komunikoi rezultatet. Unë kalova mirë në të gjitha, në matematikë që kisha frikë, kisha një note të kalueshme, në të tjerat shumë mirë dhe mirë. Kur them shumë mirë, duhet të kuptohet, se rr alle e tek merrej në lice nota 20, bile edhe 18 ose 17. «Nota 20, thuhej në lice, është e perëndisë, 17-ta është e profesorit, kurse nga nota 16 e poshtë fillon resti per nxënësit.»

Ç'gëzim i madh per ne që kaluam! Hidheshim përpjetë, sikur arritëm malin dhe qiellin me dorë. Ngalaseshim me shoqi-shoqin dhe, duke kënduar, shkuam në internat. Atje na pritnin shokët, na uronin, na puthnin, na përqaфонin. Guri, portieri, s'na ndalonte më të hynim e të dilnim lirisht. U bëmë të privilegjuarit në këtë drejtim. Zyrën e PTT-së e kishim afër, shkova i bëra një telegram xhaxhait, ku i thosha se kalova me shkrim, se na kanë mbetur provimet me gojë, por ato ishin më të lehta. Dhe në fakt ato i kalova po ashtu mirë dhe u bëra «*bachelier*». *(Frëngjisht - maturant.) M'u duk sikur fitova botën, sikur u lehtësova nga një barrë e rëndë, kreu një detyrë të rëndësishme ndaj atdheut dhe ndaj familjes.

Çështja e vuajtjeve të popullit dhe ajo e familjes më preokuponin shumë. Isha në atë moshë të pjekurisë që i kuptoja hallet që na kishin mbuluar. Regjimin e Zogut e ndienim në kurriz si një barre kolosale që na shtypte. Ne shihnim rrugëve popullin të varfër, të uritur, të rreckosur, shikonim, nga ana tjetër, nëpunësit, tregtarët, spekulatorët të fitonin në kurriz të popullit, i cili ishte pa punë. Kishte nga ata që përpiqeshin të gjenin një punë per të çarë gurë në rrugë per një lek ditën. Një lek kushtonte një kile bukë. Mund të mendohet lehtë ç'mjerim kishte në familjet e popullit. Ne me njëri-tjetrin këto kishim në gojë, edhe kur shkonim në Gjirokastër per pushime.

Në Gjirokastër ne kishim një shoqëri shumë të mire, pavarësisht se disa ishin mirë nga dynjallëku, si Selahudin Kokona, që ishte njeri shumë i mirë nga karakteri. Ne bisedonim për hallet e popullit, shanim Zogun dhe bashkëpunëtorët e tij, urrenim xhandarët dhe të gjithë spiunët e tyre, i demaskonim, i njihnim me gisht dhe u ruheshim. Asnjë fjalë nuk doli nga bisedimet tona. Shumë u përpoq një prefekt i poshtër i Zogut, Qazim Bodinaku, të na fuste në burg, bile kjo për pak u arrit në vitin 1932 kur po bëhej gjyqi i «komplotistëve të Vlorës»,* *(Është fjala për të ashtuquajturën Lëvizje e Vlorës, një lëvizje e fshehtë antizogiste me karakter të theksuar komplotist. E organizuar dhe e përgatitur keq nga brenda, me një përbërje heterogjene e të kufizuar në radhët e saj, e manipuluar dhe e subvencionuar nga reaksioni italian e jugosllav, pa shtrirje në popull, pa program të qartë, kjo lëvizje dështoi pa arritur të bënte asgjë. Xhandarmëria e Zogut arrestoi mbi 60 pjesëtarë të saj në gusht 1932.) të cilët u dënuan ashpër nga Zogu.

Isha kthyer nga Franca për pushimet e verës kur morëm vesh se ishte zbuluar e ishte arrestuar një grup i fshehtë që përgatitej të rrëzonte Ahmet Zogun. Në Gjirokastër ne shkruam në mure: «Në rast se ata pushkatohen, atëherë populli do të ngrejë krye, do të pëlçasë revolucionin». Me këtë rast mua, Enver Zazani, Selahudin Kokonën, Selami Xhaxhiun dhe disa shokë të tjerë, që njerëzit e regjimit na kishin në sy, na arrestuan dhe na mbyllën në burgun e prefekturës. Kur na morën në pyetje, ne i refuzuam akuzat, duke u thënë se këto janë shpifjet tuaja, na provuan shkrimet dhe, në mungesë provash, na liruan. Urrejtja jonë u bë edhe më e madhe kundër regjimit.

Viti i fundit për mua në Korçë si nxënës i liceut, ishte viti i klasës së filozofisë. Nxënësit që kishin fituar bakaloretin e parë mund të zgjidhnin lirisht kë të donin, sipas prirjeve të tyre, ose klasën e matematikës, ose klasën e filozofisë. Në klasën e matematikës venin, natyrisht, ata shokë që ishin të fortë në matematikë, kur se në atë të filozofisë ata që shquheshin në letërsi, në gjuhë, në shkencat historike etj. Kuptohet, unë zgjodha klasën e filozofisë, sepse shkencat sociale, politike e historike ishin pasioni im. Kishte edhe disa lëndë që bëheshin së toku nga të dyja klasat, në të njëjtën sasi, me të njëjtët profesorë.

Te ne lëndët kryesore ishin filozofia, logjika, psikologjia, morali etj., kurse për klasën e matematikës këto lëndë jepeshin shumë të përmbledhura, ose, në qoftë se nuk gabohem, atje bëhej vetëm logjika.

Këtë lëndë na e bënte profesor Maieri. Ishte një topolak, fytyrë rumbullakët, që pinte duhan me duman, siç pi unë sot*, *(Këto kujtime janë shkruar para vitit 1973. vit kur shoku Enver vendosi dhe e la përtundimisht duhanin, të cilin e kishte pirë shumë, për rreth 40 vjet me radhë.) pse, kur isha nxënës, nuk pija duhan. Këtë e fillova kur shkova në Francë. Maieri ishte nga Alzasa dhe frëngjishten nuk e fliste me aksentin e saj normal. Pikëpajnet e tij ishin konservatore, por pa pasione të theksuara. Ai u qëndronte besnik teksteve zyrtare të filozofisë që kishim në duar e në program dhe rrallë e tek më kujtohet që të kishim me të debate të acaruara. Maieri na shpjegonte njëherë pas tjetrës shkollat dhe doktrinat filozofike, por, kur vinte puna te doktrina e Marksit, ai ishte lakonik dhe po në mënyrë lakonike u përgjigjej pyetjeve tona. Siç duket, ka qenë urdhri rigoroz i Ministrisë së Arsimit që të mos zgjatej.

Nuk më kujtohet në bënim në të filozofisë diçka matematikë, por më duket se nuk bënim. Kurse lëndët e tjera si: letërsia franceze, letërsia shqiptare, letërsia e huaj, historia kontemporane, gjeografia, shkencat e natyrës e disa lëndë të tjera të dorës së dytë, bëheshin shumë gjerë në klasën e filozofisë. Letërsia shqiptare dhe ajo e huaj (ku nuk përfshihej ajo franceze, e cila natyrisht bëhej veç dhe shumë gjerë) na mësohej me kompetencë të madhe nga profesor Cipoja. Këtë vit unë mësova më thellë letërsinë gjermane, angleze, spanjolle, ruse, italiane dhe pak nga ajo arabe, sidomos të atyre vendeve që ishin koloni të Francës. Në këtë klasë nuk kisha asnjë vështirësi në mësim, këto lëndë më pëlqenin dhe mësoja mirë në të gjitha, sepse tashmë kishte dalë nga mesi matematika.

Ne, nxënësit e klasës së filozofisë dhe të matematikës. tani ishim pak më të lirë nga pikëpamja e regjimit ditor, të disiplinës, qoftë në internat, qoftë në shkollë. Ishim klasa e lartë e liceut. prandaj mbvlllej ca syri për ne, sido që kujdestarët e ndonjë pedant tjetër nuk mund të rrinin pa e manifestuar herë pas here qenien e tyre.

Ja ç'më ndodhi një ditë. Si çdo mëngjes shkuam në shkollë në radhë, bëmë një ore mësin-1 dhe tre orët e tjera nuk do të bënim, pse profesori ishte sëmurë. Zakonisht, kur ngjiste kështu, ne, internatistët, duhej të rrinim në shkollë të pritnim, derisa të mbaronin të gjithë, që në drekë të ktheheshim me radhë në internat. Mirëpo ne, që tani ishim në klasën më të lartë të liceut, kërkonim ca më shumë liri. Pikërisht në këtë ditë unë dola. I Jir ëpo te dera e madhe qëndronte kurdoherë «i famshmi» Nisi. që ruante daljen si cerber. S'më linte të dilja pa marrë leje nga drejtori. Më në fund u zumë, shty ai, shty unë, kuturisa, hapa portën dhe dola. Të nesërmen u thirra te Papakristoja. Ai, duke më shikuar vëngër, filloi të më thotë:

- Ç'që ajo që bëre, duke dalë n-ie forcë dhe përplase Nisin te muri?

Iu përgjigja se kërkoja të dilja me të mirë, por që Nisi që më shtyu, prandaj e shtyva edhe unë dhe dola. shkova në internat dhe jo rrugëve etj., etj. U mbyll kjo ngjarje me një qortim, me një «mos e bën herë tjetër, se do të marrim masa».

Ne, nxënësit e filozofisë dhe të matematikës kishim një shenjë dalluese në kasketat tona, e vetmja pjesë e veshjes që konsiderohej si uniformë. Mbi shiritin e kuq dhe mbi strehën e kapelës kishim një shirit të bardhë, të qëndisur si me mëndafsh të bardhë. Ishte shiriti që ne blinim nga më të parat gjëra kur fillonim këtë vit dhe doemos, mburreshim me të. E vërteta ishte se me atë shirit na dukej sikur ndillnim respekt dhe njëkohësisht zili te nxënësit e klasave të ulëta.

- Lum ju, shpëtti! - na thoshin ata të klasave poshtë nesh.

- Dale, si shpëtuam, - u përgjigjeshim. - s'kemi marrë akoma diplomën!

- Oh! Derisa vutë shiritin e bardhë. diplomën e keni në xhep. - ndërhy nin ata përsëri.

Mirëpo. për ta marrë diplomën, duhej mësuar. bile fort dhe kështu bëra. Profesor ët ishin të kënaqur nga unë.

Në lice atë vit erdhi për herë të parë si profesor i historisë dhe i gjeografisë Petraq Pepoja. Në klasën tonë të filozofisë ai, në qoftë se nuk gabohem, na bënte gjeografinë, se historinë vazhdonte të na e bënte Brezhoi. Pepoja ishte po ai, si Pepoja i sotëm, i sjellshëm por ca i rrëmbyer dhe, natyrisht, donte të imponohej në kolegët e tij fr ancezë dhe shqiptarë dhe te ne, nxënësit.

Dëshira e të tillë profesorëve të rinj shqiptarë për t'u imponuar ndaj kolegëve, sidomos ndaj atyre francezë, kishte në vetvete një synim të mirë, por io kushdo mund ta arrinte lehtë këtë gjë. Ca më keq vinte puna kur ndonjëri, në vend që të imponohej me kulturën, zellin e taktin e duhur, përpiquej të evidencohej me deklarata e veprime të bujshme, me mjete e forma artificiale. Erdhi në ato vite një profesor i tillë i ri dhe, ç'është e vërteta, aq shumë pretendonte e kërkonte të dukej sa shpesh çdo gjë kthehej në komedi. Profesori i ri thoshte se kishte mbaruar «Ecole Normale Supérieure», një nga shkollat më të mëdha e më të shquara të Francës. të cilën asnjë nga profesorët tanë francezë nuk e kishte mbaruar. Pra ai mburrej aq tepër dhe orë e çast, sa që të tjerët u mërzhitën dhe filluan ta vinin në lojë, bile të dyshonin nëse e kishte bërë me të vërtetë apo jo atë shkollë. Sidoqoftë, ata i thoshin profesorit se ai që pranuar atje «si i huaj» dhe jo për aftësi të veçanta në mësim. Në fakt, në atë kohë ai nuk kishte eksperiencë, por hiqej sikur çdo gjë e dinte. Zëri i tij, kur fliste, ishte i çuditshëm, bënte të fliste me zë të lartë, sa që bëhej qesharak dhe ne ua fillonim të qeshurale.

Frëngjishten e fliste më keq se ne. megjithëse kishte qenë në Francë. Mësimin ai duhej ta jepte në frëngjisht dhe këtu fillonte komedia. Donte të fliste shpejt për të treguar se frëngjishten e loste në majë të gishtërinjve si një «ancien élève de l'Ecole Normale Supérieure»*. *(Frëngjisht – ish-nxënës i Shkollës së Lartë Normale) Mirëpo bëhej qesharak. pse në mes të frazave frëngjisht, kur nuk gjente dot termin korrespondues. fuste fjalë ose shprehje shqip. Për shembull. kur i qëllonte të fuste për blegtorët në Francë. thoshte:

- *Ils dormaient sur le rrogoz et ils s'enveloppaient avec les bruc*?.**(Frëngjisht – ata flinin mbi rrogz dhe mbështilleshin me bruc.)

Ose kur ndonjëri nuk i përgjigjej mirë, i thoshte: «*Tu lui as donnë le fleuve*», «ia dhe lumit», shprehje popullore shqiptare që e përkthyer fjalë për fjalë nuk shkonte në frëngjisht. Ose në vend që të thoshte në frëngjisht «*écoutez!*» (dëgjoni), përkthente ad literam nga shqipja shprehjen «mbani vesh» me «*tenez l'oreille*». Ne kakariseshim nga gazi dhe të gjithë zinim majat e veshëve me duar. Ç'nuk i bënim atij të ziu, sidomos Enver Zazani, Avdulla Rami dhe shoqja e vetme e klasës.

Më kujtohet një ditë dimri kur kishte rënë dëborë. Disa shokë të jashtëm kishin sjellë me vete disa copë karbur dhe dy prej tyre, që rrinin në fund të klasës, vunë në qoshe të murit, mbi dysheme, copërat e karburit dhe në orën e profesorit të «Ecole Normale Supérieure» «i vaditën» ato me pështymë. Karburi filloi të ziente dhe të kundërmonte klasën. Profesori fol dhe çfrynte me hundë, të cilën e kthente sa andej-këndej si një zagat gjahu. Më në fund s'iu durua dhe bërtiti:

- *Ouvrez les dritare, ça sent le m. . . ici!** *(hapni dritaret, bie erë m... këtu !)

Ne ia dhamë gazit me sa forcë që kishim. Ikte era dhe ne i propozonim:

- Të mbyllim penxheret se do të plevitosemi !

Me të mbyllur penxheret, rifillonte në qetësi «vaditja» me pështymë e karburit dhe prapë fillonte era e qelbur. Profesori këtë herë thoshte:

- Rien à faire, vetëm kur të hyni në shkollë, kontrolloni këpucët, se mos keni shkelur ndonjë.. . *trésor*.* *(Përzierje fjalësh mes frëngjishtes e shqipes: S'ke ç'bën,... kontrolloni këpucët se mos kin.i shkelur ndonjë... thesar.)

Por incidenti më i rëndë në mes atij dhe profesorit francez Brezho ngjau pikërisht kur unë jepja provimin me gojë të historisë. Të dy ishin caktuar në komisionin e provimit dhe secili përpiquej t'i jepte më rëndësi vetes. Ishte fundi i studimeve në lice, kisha kaluar të gjitha provimet me shkrim të pjesës së dytë të bakaloratit dhe po jepja provimet me gojë. Natyrisht, rivaliteti në mes Brezhosë dhe profesorit të ri kishte arritur kulmin, pse të dy ishin historianë, të dy hiqeshin të zotë, por është e drejta të thuhet se më i zoti ishte Brezhoi, i cili kishte më tepër përvojë, mbante mend edhe më shumë. Por që të dy ishin ca «të krisur» nga trutë e kokës, siç thoshim ne. Për Br ezhonë unë isha nxënës i mirë jo vetëm pse më kishte nxënës që në Gjirokastër, por se në lëndën e historisë dhe të gjeografisë isha me të vërtetë mirë. Brezhoi dhe profesori, pra, ishin ata që do të vlerësonin dijet tona në histori. Rrinin të dy në tryezë afër e afër, pa e shikuar dhe pa i folur njëri-tjetrit. Nxënësit që do të pyeteshin, hynin, uleshin përpara tyre dhe tërhiqnin tezën, ku ishin shkruar pyetjet. Kështu bëra dhe unë. Mësimet i dija, nuk isha aspak i emocionuar, hoqa pyetjen dhe i ndera letrën Brezhoit. Pyetja vërtitej rreth Napoleonit të 3-të. Brezhoi e lexoi pyetjen me zë të lartë dhe pa e shikuar fare kolegun i hodhi letrën e pyetjes. Fillova fola gjerë e gjatë mbi grushtin e shtetit, mbi Perandorinë e dytë, mbi Luftën Franko-Gjermane, mbi politikën e brendshme e të jashtme të Napoleonit të 3-të dhe më në fund për kapitullimin në Sedan. Brezhoi, pasi mbarova, tha:

- Shumë mirë, Hoxha. - dhe e pashë që më vuri notën 18. Pastaj, duke m'u drejtual. tha «mbaruam me ty» dhe unë u çova. Mirëpo profesori tjetër, për të kundërshtuar Brezhonë, ndoshta, apo për të treguar epërsi ndaj tij, më tha:

- Mos u go, se dua të të bëj një pyetje!

Unë u ula përsëri. Më kujtohet që më pyeti:

- Cili ishte ministri i Jashtëm i Napoleonit të 3-të në kohën e Sedanit?

Solla ndër mend lloj-lloj ministrash, por ai i periudhës së Sedanit s'm'u kujtua dhe ngeca. Brezhoi, pa e kthyer kokën nga kolegu thotë:

- Ministër i parëndësishëm dhe pyetje e kotë!

Tjetri, që i mbante veshët ngritur nga Brezhoi, kundërshtoi

- Kjo është pyetje me vend dhe jo e kotë, - dhe meqë unë nuk përgjigjesha, e tha vetë emrin e ministrit (nuk më kujtohet as tani emri). Me të dëgjuar këtë emër, Brezhoi, duke qeshur në mënyrë tallëse, i drejtohet kolegut

- Kur vetë nuk e di kush ishte, s'ke të drejtë t'ua pyesësh nxënësve! - dhe përmendi një emër tjetër. Kolegu rival i Brezhoit mori inat, u skuq, iu mor goja dhe e kundërshtoi, duke i thënë se nuk ishte ai ministri që zuri në gojë. Edhe Brezhoi u skuq, u ngrit në këmbë dhe i tha:

- Ti je një injorant.

Atëherë u nxeh zënka, mend u rrahën. Hyra unë në mes që t'i pengoja të mos ziheshin me grushte. Nga një anë i ndaja, nga ana tjetër i thosha të riut:

- Zoti profesor, më vuri një herë notën time se mos harroni, pastaj vendosni për ministrin e Jashtëm!

Më në fund të egërsuar shkuan që të dy te drejtori. Brezhoi kishte të drejtë për sa i përket emrit të ministrit të Jashtëm të Napoleonit, që tok me këtë i vuri kazmën perandorisë, por mend më dëmtoi edhe mua në provimin e historisë!

Viti i filozofisë kaloi i lehtë dhe më i lezetshëm për mua. Të gjitha leximet që kisha bërë, më kishin ndihmuar shumë dhe më pëlqenin lëndët. Ishim më të lirë nga internati, bashkoheshim më shumë me shokët e jashtëm, organizonim studimet së toku në bibliotekën e qytetit ose jashtë në kodrat rreth e rrotull. Me ne vinte edhe djali i drejtorit Pere, Rozheja, i cili ishte shumë simpatik dhe i shoqërueshëm.

Ato vite kishte ardhur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe djali i madh i Ramiz Shehut, kujdestarit tim. Atë e quanin Telat, por ai na thoshte ta thërrisnim «Çarli», pse këta, kur shkonin në Shtetet e Bashkuara, ndërronin emrat.

- Do të të thërresim Telat e jo Carli, - i thoshim ne, - pse ti je qyngj Gjirokastrë dhe jo qyngj Bostoni!

Telati ishte disa vjet më i madh nga ne. Një ditë na mblodhi ne të gjithë, studentë nga Gjirokastra, dhe na dha një drekë të bukur në manat e Boboshticës, me mish të pjekur e bakllava. U kënaqëm gjithë atë ditë, hëngrëm, pimë, kënduam e kërcyem valle.

Një të diel tjetër «Çarli» na mblodhi prapë, këtë herë për të bërë një fotografi së toku, te fotografi më i mirë i Korçës, Sotiri, në «Sotir Studio». Këtë fotografi e kam edhe sot. Fotograf Sotiri ishte një mjeshër, artist i fotografisë, atë e kishte mik e shok profesori ynë i pikturës, Vangjush Mioja. Me Vangjushin unë e kisha shumë mirë, edhe kur isha nxënës, por edhe më vonë, kur u bëmë kolegë. Shumë herë, si nxënës, ai na merrte e dilnim në natyrë, ku, si zinte vend, pikturonte, kurse ne i rrinim nga pas, e soditnim tablonë e tij, i bënim pyetje, ose mësonim nën hijen e ndonjë peme.

Gëzimi im ishte i papërshkruar kur mbarova me sukses të gjitha provimet. Dola mirë, mbarova liceun. Këtë e kam konsideruar një fitore të madhe. Kur mora diplomën e liceut, kisha përshtypjen sikur fitova diçka të madhe. Jeta hapej përpara meje ndryshe. Por hallet dhe brengat do të vazhdonin edhe pas kësaj dite të gëzuar, të cilën ne e festuam me shokë. Na vinte keq për ata që nuk kaluan dhe i ngushëllonim. Ne që mbaruam, na thirri një pasdreke për çaj drejtori francez, Pere, i cili rrinte në një apartament në hotelin e ri «Pallas». Ai, gruaja e tij dhe Rozheja na dhanë pasta, çaj dhe fruta. Pereja na përgëzoi dhe na foli për dëshirat tona të mëtejshme, na foli për jetën në Francë dhe na rekomandoi universitetet dhe qytetet. në rast se do të shkonim të vazhdonim atje studimet e larta.

Ja, kështu përfunduan vitet e studimeve të mia në Korçë. Erdhi çasti të ndahesha nga ky qytet që ishte bërë i dashur për mua, sepse aty fitova më tepër dituri, njoha më mirë jetën, njoha më shumë njerëz dhe, më kryesorja, aty nisa t'u hyj më thellë gjërave, të shtroja shumë pyetje për ato ngjarje, fenomene, ndodhi e probleme që ngrinte

paeshtur jeta e përditshme në lice e jashtë liceut. Nuk mund të them se për tërë atë mori pyetjesh që na lindnin i dija përgjigjet e sakta e të plota. Jo, kjo do të realizohej

më vonë. Kryesorja është se atje nisa të shoh jetën, realitetin, njerëzit e ngjarjet më me seriozitet e vëmendje, të ndiej se shumë gjëra, në mos të gjitha, nuk shkonin e nuk ishin ashtu si duhej, se duheshin ndryshime të thella, se duhej përmbyesje, se duhej revolucion, siç do të konkludonim më vonë. Se si do të arrihej kjo, se ç'rrugë duhej ndje

kur, këto do t'i mësonim më pas. Por nuk do të harroj kurrë se ishte pikërisht Korça ajo që, bashkë me diplomën e liceut të përfunduar, më bëri të qartë se ishte një shkollë tjetër, shumë më e vështirë e komplekse se çdo lloj shkolle zyrtare, që duhej ta kryente djalëria e asaj kohe. Imazhin e parë të kësaj «shkolle», që i duhej se s'bën Shqipërisë, ma shfaqën të parët korçarët punëtorë e për parimtarë, e mbi të gjitha, Korça e «Punës», Korça e fukarenjve, Korça e punëtorëve dhe e zanatçinjve të vegjël.

Ashtu si liceun e mëhallët e bukura të qytetit, vend të preferuar në ato vite kisha pazarin e vjetër të Korçës,

rrugët e ngushta me dyqane të vogla, me taraba prej druri. Ecja pranë punëtorëve çirakë, të kërrusur me gjilpëra o me fëndyej në dorë, që qepnin, mballosnin dhe me

remetonin sendet e vjetruara e të grisura të atyre që i çonin. Ata punonin nën mbikëqyrjen e ustait, i cili herë ishte ters e vëzhgonjës, herë kishte pamjen e një babaxhani, por që s'i linte çirakët të merrnin frymë. Këta ngriheshin që me natë, hapnin e fshinin dyqanin dhe pastaj s'mungonte të vinte i zoti. Herë u thoshte «mirëmëngjesi», herë nuk u fliste fare, vetëm u jepte Lzrdhra, i qortonte, u tregonte si duhej ta qepnin e ta mballosnin sendin. Punëtorët, në ato dyqane pa dritë e me lagështirë, punonin që nga mëngjesi deri natën. Drekën e hanin në tezgë, ndonjë copë bukë, djathë, ose ndonjë llukanik të tharë. Por këtyre punëtorëve sytë u lëshonin xixa. Ata të shikonin me kujdes nga koka në këmbë. Mbaj mend mjaft punëtorë të tillë kur isha nxënës dhe veja mballosja këpucët, ndreqja kapelën ose prisja ndonjë palë pantallona. U njoha me ta, më hahej muhabeti dhe më vonë këta e shumë të tjerë do t'i njihja më mirë, do të bëhesha shoku i tyre i halleve, i mendimeve dhe i idealeve. Kisha respekt e admirim për ta, për punën e tyre, për faktin që, megjithëse nuk kishin shkollë, dukeshin të zgjuar, të hedhur, të paepur në mjerim. Në punishtet e dyqanekat e vogla u njoha e u miqësova me Koci Bakon, Sotir Gurrën, Gaqo Naston, Teni Konomin, Llambi Dishnicën, Petro Papin, Pilo Peristerin, Ilo Dardhën e shumë të tjerë. Ishin vërtet për t'u admiruar. Shkoje tek ata për një mballomë këpuce apo për të blerë një çikërrimë, dinin të të hapnin muhabet, të shtynin në biseda «të rastit», të blinin mendjen e pastaj, po ata punëtorë e çirakë mballomatarë, të tronditnin kur të vinin në duar edhe «Manifestin» e Marksit, të bënin pyetje të tilla që vështirë t'i dinin qoftë Brezhoja, qoftë ndonjë profesor tjetër! «Na thuaj ç'di për Komunën e Parisit»; «Student, ç'di ti për Rusinë Sovjetike» etj., etj.

Kam shkruar e do të shkruaj edhe në raste të tjera për ata punëtorë të pahar ruar që më futën ndër të parët në rrugën e ideve e të lëvizjes komuniste, kaq herë u kam shprehur mirënjohjen e këtë do ta bëj sa herë të bjerë fjala për ta. Në fillim etjen e tyre për të pyetur e për të mësuar «gjëra të rrezikshme», e merrja si një gjë të rastit, pasojë e ndonjë fjale ose lajmi që e dëgjonin rastësisht dhe, edhe për kaq, i admiroja. Më pas do të merrja vesh se asgjë nuk ishte e rastit në ato pyetje e biseda që ata mundoheshin t'i zgjatnin e t'i bënin më të shpeshta. Kishin filluar të organizoheshin, kishin filluar të përqafonin idetë e lëvizjen komuniste.

Kur isha student në lice, sapo ishte krijuar Grupi Komunist i punëtorëve të Korçës, ndikimi e shtrirja e tij ishin të pakta, në hapat e parë, por sidoqoftë «ujërat kishin nisur të lëviznin» e të ndiheshin. Kontaktet e mia me komunistët e asaj kohe ishin vetëm kontakte njohjeje, bile unë ende s'dija fare se disa nga ata që më thërritnin e më pyetnin, si Koci Bakoja, Llambi Dishnica e të tjerë ishin komunistë. Më pas, kur pas 6 vjetësh do të kthehesha përsëri në Korçë, lidhjet tona do të viheshin në baza të shëndosha dhe unë do të bëhesha pjesëtar i Grupit Komunist «Puna», krah për krah me punëtorët komunistë korçarë, gjë të cilën e kam pasur e do ta kem gjithmonë për nder. Por, siç thashë, kjo do të ndodhte më vonë. Le të kthehem te ditët kur me diplomën e liceut në xhep, mendoja se kisha arritur qiejt!

Shkova në Gjirokastër i gëzuar. Familja ishte po ashtu e gëzuar, xhaxhai me anenë ç'të më bënin! Djali u mbaroi shkollën. Ata thoshin:

- Do të bëjmë~ë, si të bëjmë edhe disa vjet, pastaj do të shpëtojmë nga vuajtjet, çështja është të të japin bursë për të ndjekur mësimet e larta.

Kuptohet, ëndrra ime ishte të shkoja në Francë, në universitet. Dëshira ime e madhe ishte të mësoja o për letërsi. o për histori-gjeografi. Në këto lëndë kisha prirje dhe isha i bindur se do të dilja me sukses dhe do të bëhesha profesor i shkollës së mesme. Mirëpo çdo gjë varej nga fakti nëse do të më jepnin bursë. se plaku ishte «kripë», s'mund të përballonte shpenzimet as për dy muaj jashtë, jo më për tre vjet. Pra, edhe i gëzuar isha që mbarova shkollën, por edhe i shqetësuar shumë, se si do të më shkonte halli më tej. Asnjë njeri nuk kisha në Tiranë që të thoshte ndonjë fjalë të mirë në Ministrinë e Arsimit. Për mua do të flitnin për mirë vetëm notat që mora dhe që ishin fiksuar në dëftesën e shkollës. Varej po ashtu sa bursa do të jepeshin për në Francë dhe për çfarë lëndësh.

Më në fund në gazetë doli lajmi, se gjithë ata që kishin mbaruar liceun e gjimnazet, duhej të bënin lutjet në Ministrinë e Arsimit dhe këtë ta shoqëronin me dëftesa të shkollës e me dokumente të tjera. Të gjitha i bëra gati dhe në lutje shënova se dëshiroja të ndiqja studimet për histori e gjeografi ose për letërsi. I dërgova dokumentet në Ministrinë e Arsimit brenda afatit të caktuar. Kuptohet

padurimi im ishte i madh. Disa shokë si Selahudin Kokona, Hamit Kokalari, Aqif Selfoja do të shkonin me të hollat e tyre. Ata nuk kërkuan bursë. Këta ne i kishim zili, pse nuk kishin kokëçarje, do të zgjidhnin degën që donin dhe qytetin ku do të studionin.

Më në fund e binda xhaxhain se duhej të shkoja edhe vetë në Tiranë që ta ndiqja nga afër qështjen e bursës. Në Tiranë shkova për herë të parë. Nuk më bëri veçse përshtypje të keqe. Në bisedat tona gjatë studimeve në Korçë, kryeqytetin në mënyrë figurative ne e quanim «çerdhja e hajdutëve të Zogut, çerdhe e korrupsionit», dhe, kur e pashë, kur e njoha nga afër, vetëm për një gjë e ngushëlloja veten: kishim plotësisht të drejtë që e quanim çerdhe hajdutësh! Unë nuk njihja njeri dhe zura jo një dhomë, por një krevat në një nga dhomat e një hoteli të vjetër, pis, që quhej «Hotel Durrësi». Dhoma ku flija unë kishte katër krevate, prandaj çdo natë v inin atje nga tre njerëz të panjohur. Në mëngjes vetëm sa i thoshim njëri-tjetrit nga një «mirëmëngjes» nëpër dhembë dhe nga një «nga je ti, për ç'punë ke ardhur në Tiranë?» etj.

Shkoja përditë në Ministrinë e Arsimit. Atje ishte si në pazar. Mbushur qenë shkallët dhe korridoret me njerëz të panjohur, me studentë si unë që kishin bërë lutje për bursa. Përpiqeshim të takonim ndonjë nga sekretarët e ministrisë. Por nuk na lejonin.

- Duhet të pritni, - na thoshin, - janë të zënë.

Për ditë me radhë të njëjtat njoftime: jo do të deklarohen sot, jo nesër listat e fituesve të bursave! Kështu vazhdoi me javë dhe herë ngrënë, herë pa ngrënë shkoja çdo ditë në Ministrinë e Arsimit, ku mbeta shkallëve dhe korridoreve. Më në fund dolën listat e fituesve. Gëzimi im ishte në kulm. Më jepej një bursë për histori e gjeografi për në qytetin Monpelje të Francës! U hodha përpjetë nga gëzimi. Atyre që u doli bursa, u doli emri në një listë që u botua edhe në gazetë.

Pas disa ditësh shkova në ministri që të bëja forma litetet e duhura, kur më ngriu në vend lajmi:

- Ty t'u hoq bursa dhe iu dha një tjetri!

Merret me mend ç'dëshpërim ishte kjo për mua. T'uirëpo nuk lëshova kollaj. Fillova të bërtisja se «po bëhen hatëre, se bursa ime iu dha të tjerëve që kishin hatër, se unë nuk largohem nga ministria pa u vënë në vend padrejtësia dhe vendimi i parë i deklaruar zyrtarisht në gazetë» etj. Me një fjalë bëra potere, pse njeri nuk kisha kush të më ndihmonte. Më në fund fitova. Më thirri sekretari i përgjithshëm i ministrisë dhe më tha:

- Mor djalë, u bë një gabim me ty, bursa jote për gjeografi iu dha një tjetri, por ty do të të japim një bursë për shkencat natyrore! Nuk e dimë në e pranon këtë degë, po unë të këshilloj ta pranosh, ndryshe mbete pa gjë!

Kam pasur e kam respekt e dashuri të madhe për shkencat e natyrës, jo më tani, por qysh atëherë. I njihja bukurinë, forcën dhe rëndësinë e tyre, e dija në përgji thësi se ç'progres kish in sjellë e sillnin ato për njerëzimin. Por, pavarësisht nga ky respekt për këto shkenca, pasioni im, dashur ia e prirja ime qëndronin te shkencat shoqërore, te historia, letërsia, jurisprudenca. Ua thashë këtë memurëve të ministrisë, por ata u bënë më memurë se ç'qenë.

- Në daç shko për shkenca natyrore, - më thanë. - në mos daç, kthehu në Gjirokastër.

E pashë se s'tundeshin dhe i pyeta:

- Më siguron se mos më ngjasë si më parë?

Më siguruan dhe më porositën:

- Shko në filan zyrë dhe bëj formalitetet e duhura! Shkova dhe kështu çdo gjë mbaroi, beteja u fitua, mora bursë për në Francë.

I gëzuar u ktheva në Gjirokastër të përgatitesha. Xhaxhai më bëri r roba të reja që m'i preu Aqif Gabeci, këpucë të reja, disa këmishë etj., dhe në vjeshtë u nisëm nga Durrësi tok me shokë të tjerë për në Francë, përmes Italisë. Ishte hera e parë që lija atdheun. Një faqe e re hapej në jetën time për të cilën do të përpiqem të hedh disa kujtime në ndonjë fletore tjetër.

II

DUKE KALUAR NË ITALI

Unisa për në Francë me gjithë shokët e tje që do të ndiqnim shkollat e ndryshme të lauta. Kryesisht, ata që mbar onin Liceun e Korçës. dërgoheshin në Francë dhe një pjese u akordoheshin edhe bursa. Kanë kaluar 45 vjet që në atë kohë dhe s'e mbaj mend ekzakt shifrën, por di mirë se ishte në shumë e vogël për atë kohë, prandaj do të rronin shumë shtrënguar, si studentë të varfër që ishim. Kryesoria ishte se e ndienim veten të lumtur që na u akordua bursa, pse etja jonë për të mësuar ishte e madhe.

Më lart tregova për peripecinë e akordimit të bursës sime, gjersa më në fund u detyrova ta pranoja degën e shkencave të natyrës. Që kur u nisa, pra, nuk isha aq i kënaqur për degën ku më caktuan, por «të shkojmë një herë, mendova, pastaj atje shohim e bëjmë».

Një pjesë nga ne, mes të cilëve edhe unë, u cañtuam t'i kryenim studimet e larta në qytetin Monpeije. qytet i vjetër dhe me famë universitare që në shekullin e 15-të, sidomos për Fakultetin e Mjekësisë, ku kishte qenë profesor në kohën e tij edhe Rabëleja. Isha i gëzuar që më caktuan në Monpelje, se në lice, ku rra flitej slzumë për Francën, për kulturën dhe për shkencën e saj me famë botërore, na flitej sidomos për qendrat e saj universitare dhe veçanërisht për Monpeljenë, kryeqendra e departamentit të Heroltit. Në lice kisha mësuar se Monpeljeja kishte klimë të butë, në dimër s'binte borë, as nuk bënte shumë ftohtë, frynte ca erë që e quanin «le mistral», kurse në verë ishte nxehtë si te ne, një nxehtësi e durueshme, mbasi atje ndihet ndikimi i Mesdheut.

Aneja me xhaxhain, me atë fukarallëkun e tyre, duke marrë edhe ca borxh, më bënë një pallto dimri, një palë rroba të reja, një palë këpucë. dy këmbishë, të brendslzmet dhe nja dy palë çorape. Kur më nisën, më bënë sipas zakonit edhe disa karkanaqe me sheqer për rrugë, më dhanë edhe një teneqe ndonja dykilshe me llokume të thata (jo me finjë, por me gjalpë e me sheqer) për motrën e madhe, Fahrijen, e cila me burrin, Bahriun, dhe djaln. Luanin, që në atë kohë ishte i vogël, banonin si emigrantë politikë në Bari të Italisë. Me këto bagazhe, me hidhërimin që lija anenë. xhaxhain dhe Sanon vetëm pa njeri. dhe që, sipas pikëpanijeve të tyre. shihnin tek unë në lbështetjen e vetme. u nisa për në Tiranë dhe që andej për në Durrës, ku do t'la hipja vaporit për të zbritur në Bari.

Largohesha për herë të parë nga atdheu im i dashur. E lija atë nën shtypjen e tmerrshine të mbretit satrap dhe të banditë ve që e rrethonin. Populli vuantc për bul;ën e gojës, shtypej nën taksa të i ënda dhe nën kërbacin e xhandarëve e të spiunëve. Ne, djemtë e popullit fukara. edhe kur me një mijë belara mbaronim ndonjë shkollë. nuk mund të gjenim lehtë punë në shtet. Të bëheshe një sekretar o memur i vogël, duhej të kishe miq, mbështetje, të cilat neve na mungonin. Shumë nga shokët tanë nuk arrinin të mbaronin as shkollën e mesme, por, për sa i takon punës, ata ishin më «të privilegjuarit», sepse futeshin çirakë te ndonjë këpucar o rrobaqepës dhe fitonin disa lekë për të jetuar dhe për të ndihmuar familjen. Unë nuk po i vija dot akoma në ndihmë familjes dhe kjo ishte një brengë e madhe për mua, sepse në vend që t'i bëhesha krah, përkundrazi familja vazhdonte të më ushqente. Por isha i gëzuar se do të mësoja më shumë e pastaj do t'ua shpërbleja.

Çështjen e diturisë, të mësimit, që në vegjëlinë time, e kisha kuptuar si një detyrë të madhe ndaj atdheut dhe popullit dhe një ushqim të nevojshëm si buka që haja. Këtë nevojë ma kishin futur në kokë dhe në zemër, që në bankat e para të shkollës fillore, mësuesit e mi të dashur e patriotë, Naimi dhe rilindësit e tjerë me vjershat e tyre që i mësonim me aq zell përmendsh. Më nxitnin në këtë rrugë të mësimit baba Ceni, që ishte njeri i mësuar, po edhe aneja me paditurinë e saj, por me atë dashuri të madhe të nënës. Me atë zgjuarsinë dhe me mprehtësinë e vet ajo e kishte kuptuar mirë se duhej të mësoja e të veja rregullisht në shkollë. Me kujdesin e madh të saj ajo ekonomizonte disa lekë dhe nuk më la kurrë pa kalem, pa katror (defter, siç i quanin atëherë), pa bishtapene e xina, pa blerë çdo libër që na rekomandohej nga mësuesit.

Ane e dashur, të kujtoj sot me dhembshurinë më të madhe. Ti rrojte dhe i pe fëmijët e mi të rriteshin, të venin në çerdhe e në kopshte, të ndiqnin shkollën fillore. Ti nuk rrojte të shihje Ilirin, Sokolin, Pranverën që mbaruan universitetin me të gjitha të mirat. Ti nuk arrite as fëmijët e tyre,

Valbonën dhe Ermalin, që po rriten si pëllumba. Por më kujtohet si sot, kur u thoshe kalamanëve të mi:

«Mësoni, se tanfi ju i keni të gjitha të mirat. Këto jua solli Partia, prandaj dojeni atë me gjithë shpirt. Popullin ta doni si beben e sirit. Babai juaj luftoi për Partinë dhe për popullin. Unë e di, fëmijë, ç'kam hequr! Haja atë farmak bukë në mbrëmje dhe mendoja: «Ku e kam djalin? A është gjallë? Mos e kanë vrarë?» Mirëpo ja, ai doli nga lufta dhe shihni ç'të mira i solli popullit lufta që bëri. Ju shkollat i keni në vend, kurse në kohën e vogëlisë e të djalërisë së Enverit, ç'kemi hequr me shkollat! S'e harroj kurrë atë ditë kur inë iku djali për në Francë. Edhe gëzoja që vinte të mësonte, por edhe isha e pikëlluar, pse më dukej sikur mbetëm në mes të rrugës pa të. Prandaj, mësoni fëmijë dhe bëhuni të mirë për popullin, për atdheun, për babanë tuaj dhe për vete!»

Zogu e kishte mbushur vendin me «këshilltarë» italiane, të cilët ishin nëpër zyra, në reparte të ushtrisë, ata kishin në dorë naftën dhe bakrin, kishin zaptuar Sukthin dhe sillnin atje kolonë të tjerë nga Italia. Vendi ishte i mbushur edhe me spiunë italiane, që kishin organizuar rrjetet e tyre dhe përgatitnin okupacionin e tërë vendit. Zogu dhe klika e tij ndanin kreditë që gjoja Musolini ia jepte Shqipërisë, por që në fakt me këto shitblerje, borxhe e kredi, Zogu e Musolini, të dy, i përgatitnin varrin Shqipërisë. Fajdexhinjtë vendës ishin bërë shushunja të vërteta që u pinin gjakun fukarenjve.

Borgjezia

tregtare po ngrihej, tregu italian ishte i hapët për të; nëpërmjet saj regjimi zogollian importonte edhe bukën e

paktë të gojës së popullit, deri te vezët, vaji e ullinjë dhe sillte nga Italia stofra luksi, këpucë, enë fajance, qelqurina e çdo gjë që i duhej borgjezisë, që i hapej vazhdimisht oreksi, asaj dhe nëpunësve të lartë, të cilët merrnin rroga mujore shumë të majme. Ndodhte kjo në kohën kur një punëtor, i cili çante tërë ditën gurë në diell për të shtruar rrugët që i duheshin Italisë për luftën që do të shpallte më vonë, merrte një sasi të papërfillshme, domethënë r rreth 20 herë më pak se pagat e nëpunësve të regjimit. E tiilë ishte diferenca e rrogave! Por kjo ishte vetëm një nga moria e pafund e formave dhe e mënyrave si shtypej e shfrytëzohej populli. Varfërinë e mjerimin i shihje në çdo hap. Me këtë brengë të madhe në zemër po ie lija atdheun tim.

la hipa një vaporit italian mallrash që shkonte nga Durrësi në Bari. I kur seva ato të pakta të holla xhepi që kisha, pse çdo gjë e kisha llogaritur derisa të veja në Monpelje. Shokët që kishin shkuar më pare në Fran

co, më kishin folur për gjithçka, që nga çmimi i biletës së trenit dhe derisa kushtonte një kuti shkrepse dhe më kishin instruktuar si duhej vepruar. Kështu që për udhëtimin me det mora një biletë për në «kuver të», jashtë, në «urë të vaporit». Bëra llogari të zija ndonjë qoshe nën ndonjë shkallë, të vija kokën në valixhe dhe të mbulohesha me pallto. Po të më zinte gjumi, mirë, në mos po do të shëtitja në kuvertë. Ishte hera e pare që bëja një udhëtim me vapor. I ri dhe i fortë isha, natyrisht edhe ca romantik; yjet, hëna, deti me valët e tij të lehta dhe shkuma e bardhë që linte vaporit, të tëra këto më zbavitnin. Pastaj, fundi një nate do të ishte kjo dhe kalohej si të kalohej ! Në mëngjes do të isha në molin e Barit, ku me siguri më pritnin Fahrija, Bahriu dhe ndonjë mik tjetër! Kështu e kalova atë nate, jashtë, në kuvertën e një vaporit mallrash, më tepër pa gjumë se me gjumë, duke vërtitur në mendje lloj-lloj gjërash, duke shtruar lloj-lloj pyetje, duke bërë lloj-lloj hamendjesh për atë ç'më priste në rrugën e gjatë të jetës që kisha përpara. Malli i atdheut dhe i njerëzve që lija pas, dhimbja e ndarjes, mjegulla e së ardhmes, kolovitjet e vaporit, yjet e hëna, ëndrrat e brengat, të gjitha u bënë lëmsh atë nate gjersa mbërritëm në portin e Barit. Menjëherë gjithçka nga tollovitjet e natës u fshi dhe e vetmja gjë që më interesonte tash ishte: ka dalë njeri të më prese apo jo! Në fakt më pritnin motra e dashur Fahrie, me bur rin e me djalin.

Zbrita, u puthëm e u përqaftuam me ta. E mora Luanin e vogël në duar që më ngalaste e më thërriste «dajko»! Gjeta një familje tjetër timen në një vend të huaj. Ua hipëm karrocave, në qoftë se s'gabohem ishin nja dy, dhe u nisëm për në shtëpinë ku rrinte áso kohe Fahrija. Kjo shtëpi ishte në një rrugë që quhej «Via Piccinni». Kaluam një lagje mjaft të ndyrë, me rrugë të vogla, plot popull në pragje të dyerve e në penxhere, që flitnin, gër thitnin, këndonin. U çudita dhe pyeta Bahriun :

- Ç'është? Ku jemi kështu?

- Ky është Bari i vjetër, siç i thonë, këtu rrinë njerëz të varfër!

Dolëm nga Bari i vjetër dhe kaluam në një rrugë të gjerë, nga e cila ndoqëm bregun e detit.

- Këtë e quajnë «Lungomare», më tregonte Bahriu.

Ishte e bukur, e gjerë, me parmacë, e asfaltuar dhe nga e djathta kishte skuare me gjelbërim dhe pallate. Ecëm, ecëm, po mua më tërhiqte vërejtjen diçka e çuditshme: në penxheret e shumë prej këtyre pallateve s'kishte as perde dhe as njerëz si në Barin e vjetër. Kishte vetëm nga një pankartë ku shkruhej diçka, për të cilën pyeta, se nuk e kuptoja. Më shpjeguan se shkruhej «Jepet me gira». Kuptova kështu se ato ishin bosh dhe pritnin qiraxhinj, të cilët nuk venin. Më vonë do të kuptoja dhe do të mësoja se këto pallate ishin investime kapitalistësh, siç kishin nisur të bënin edhe në Shqipëri tregtarët e agallarët tanë, ashtu siç blinin edhe toka, duke i quajtur këto investime të sigurta e të paluajtshme. Ashtu si tregtarët tanë shfrytëzonin bujkun në toka, ashtu edhe këta kapitalistë italianë, duke shfrytëzuar punëtorët e vendit të vet ngrinin këto pallate prej betoni, për t'i shtrydhur më mirë ata që do të banonin. Por klientë nuk gjenin ose gjenin rrallë, se qiratë ishin tepër të shtrenjta.

Më në fund u futëm në rrugën «tonë»; hymë në «pallat», në katin përdhes. Fahrija nxori çelësin nga çanta, hapi portën dhe u futëm në apartament. Ishim në shtëpinë tonë, në familjen tonë! Apartamenti kishte dy dhoma dhe një kuzhinë. Një dhomë ishte e gjumit dhe një dritare e saj binte mbi rrugë; tjetra ishte dhoma e pritjes, ku ditë e natë duhej të rrije me dritë. Edhe kuzhina që e vogël, me një dritare. Apartamenti ishte i errët dhe i ftohtë, pse nuk shikonte diell, që shtruar me pllaka çimentoje. Ku shtëpitë e bukura plot ajër e dritë të Gjirokastrës, me kopshtije të vogla përpara, me ndonjë lofatë me lule të kuqe o një man në mes të avllisë të shtruar me plloça ! Këtu, në Bari, ose të paktën në këtë pjesë të tij, shihje vetëm asfalt e çimento, kishte mungesë dielli dhe rrallë gjelbërim.

Rruga që të çonte në shtëpinë ku rrinte Fahrija ishte e gjatë dhe, prej saj e deri në rrugët kryesore të qytetit, duhej të ecje ndonjë orë më këmbë. Edhe kjo rrugë ishte e ftohtë, pa diell, pse pallatet ishin të larta e me shumicën e apartamenteve bosh. Megjithatë në këtë rrugë kishte plot kalamanë dhe gra të popullit.

Sidoqoftë isha i gëzuar. se ndodhesha në mes të të afërmëve të mi. Motra ishte shumë e mirë. Edhe Bahri Omari në atë kohë na donte, ishte i ngrohtë me ne, bënte çmos që të na kënaqte. Nuk është vendi këtu të flas gjatë për veprimtarinë dhe për pikëpamjet e Bahriut në emigracion derisa u kthye në Shqipëri më 1939 pas okupacionit. Për fazën kur ai ndodhej në emigracion në Itali e që, gjatë shkuarjes apo kthimit nga Franca pata rastin ta takoja disa herë, të rrija e të bisedoja me të dhe miqtë e tij, pra për këtë fazë, Bahriun ne e njihnim dhe e mbanim si antizogist, si përkrahës të «Opingës», të demokracisë e të zhvillimit. natyrisht borgjez, të vendit. Edhe shumë miq të tij që në vitet 30-të hiqeshin si antizogistë, pata rastin t'i njihja që në ditët e para kur shkela në Bari, por edhe më vonë në vajtje-ardhjet e mia nga Franca për në Shqipëri. Ata ishin një grup i tërë «të arratisurish politikë» dhe më pas pata me ta edhe biseda politike, edhe biseda shoqërore, pse, në përgjithësi, shkonin mirë me njëri-tjetrin, venin e vinin, rronin tok dhe nuk grindeshin, siç e kanë zakon emigrantët politikë në mërgim. Por për historitë e tyre, qoftë në emigracion në Itali ose në Francë, ashtu edhe kur ia behën në Shqipëri do të kem rast të shkruaj më gjerësisht një herë tjetëri. Këtu desha vetëm të përmend shkurtazi se më 1930,* *(Shih: Enver Hoxha, «Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re» - Kujtime e shënime historike, Tiranë 1984, f. 200-214.) kur shkova për herë të parë në Bari, ashtu edhe më pas, sa herë më binte rruga të ndalja aty, Bahri Omari si njeri i nuk dukej i keq, përkundrazi ishte i sjellshëm. Motra dhe ai bënin çmos të më kënaqnin jo vetëm në çështjen e ushqimeve, por edhe me ndonjë palë rroba, me ndonjë palë këpucë apo me ndonjë këmishë që më blinin. Kur m'u pre bursa në Francë dhe ndodhesha në Paris, i kërkova motrës dyqind franga franceze. Ajo dhe Bahriu m'i dërguan menjëherë. Bahriu ishte shahist i tërbuar. Ditën luante ngandonjëherë në «Stopani» me italianë, avocati, ragionieri, ingegneri. që e thërritnin «Onorevole Omari». Por loja bëhej sidomos natën, pse sa herë isha tek ata në kalim, sa hanim bukë në mbrëmje, dhe unë me Fahrijen e Luanin e vogël rrinim në shtëpi, Bahriu dilte.

- Ku vete? - e pyesja motrën.

- Vete në klub, - më thoshte ajo, - luan shah dhe, meqë e di mirë, edhe fiton.

Të tjerët nuk dija ç'bënin. Dija vetëm për Shehun (Karbunara) që nuk luante e për Muharrem Vllamasin që luante poker, pse e dëgjoja herë pas bere që pyetej nga shokët e tij

- Fitove gjë?

Muharrem Vllamasi hiqej i grupit të Bahriut, Shehut etj., dhe ishte «plot shakara e humor», gjë që mbulonte lojën e tij politike. Ai nuk tregohej fashist, por sharjet i bënte me shaka, hiqej edhe me nacionalistët e Bahri Omarit, të Ali Këlcyrës. Sejfi Vllamasit dhe Kol Tromarës, por edhe shok e mik i Qamil Celës dhe imi. Ishte një element liberal me të gjithë.

Kapiten Beqir Veloja, një ndër ata që njoha në atë kohë. ishte njeri i thi, është dhe i mirë. Rronte thjesht, e gjeje kurdoherë ne ecje, u shërbente të sëmurve që vinin nga Shqipëria për shërim, njihte doktorët, njihte magazinat dhe të zotët dhe në ta çonte e ndihmonte shqiptarët që blinin dhe ata i jepnin ndonjë lek. Bukën e nxirrte me djersë. Ishte ndër të vetmit që, kur u kthye nga mërgimi, u bashkua me Luf tën Nacionalçlirimtare dhe qëndroi si patriot.

Qamil Cela, «Kuqalashi», midis emigrantëve politikU që njoha në Itali ishte njeriu më i mirë, më i thjeshti. më i ndershmi dhe më i varfri nga të gjithë. Ai, me sa di unë, s'merrte rrogë nga kurrkush, ishte i lidhur me Halim Xhelon dhe me shqiptarët komunistë të Sent-Etienit, Gogo e Kozma Nushin, Ymer Dishnicën, më vonë edhe me mua. Qamili ishte komunist vetëm me dëshirë, por jo teorikisht dhe as militant i vërtetë. I donte Bashkimin Sovjetik e Stalinit, por, me sa di unë, dhe sidomos në Itali, veprimtaria e tij ishte e paqenë. Asnjë lidhje nuk kishte me njeri brenda vendit, mundet me ndonjë si Demir Godelli ose me Selim Shpuzën. Sidoqoftë ishte njeri i mirë. Ai lidhej me shqiptarët e Amerikës dhe, siç dihet. asnjë nga ata nuk ishte komunist, qoftë edhe sa per emër. Qamili, edhe pas pushtimit të vendit nuk u kthye si të tjerët nga mërgimi, mbeti në Francë dhe nuk tregoi asnjë lloj veprimtarie gjatë viteve të luf tës. U kthye. me sa di, pas Clirimit dhe ne e respektoam. U fut edhe në Parti «si komunist i vjetër», por Partinë ai as e njihte, as e kuptonte. Kujtonte se meqë quhej në mërgim «Kuqalash», tash që erdhi në Shqipëri duhej të ishte në krye ose të trajtohej si Ali Kelmendi. kurse ne, të tjerët, pa e shprehur hapur, por gjë që nënkuptohej, ishim «nxënësit» e tij. Më vonë filloi nga pakënaqësitë dhe nga grindjet me shokët e organizatës në Elbasan. Ne i këshilluam ata të ishin zemërgjerë me plakun patriot dhe ta trajtonin si një komunist të vjetër. pse sentimentalisht ashtu kishte qenë.

E tillë ishte në vija të përgjithshme shoqëria e nacionalistëve emigrantë antizogistë në Bari. Si gdhijeshin, ngryseshin, një jetë pa asnjë veprimtari antizogiste ose organizim tjetër. Këndonin titujt e «Gazzetta del Mezzogiorno» dhe përhapnin thashethemet e shqiptarëve që hynin e dilnin në Bari qysh para se të na okuponte Italia.

Bari thithte gjithë prodhimet e popullit shqiptar dhe na shiste lecka e vogëlsira të tjer a që Italia i shiste me tonë. Lloj-lloj njerëzish venin në Bari nga Shqipëria, spiunë të kalibrit të lartë zogist që, natyrisht. shkonin të hanin në grazhdet më të pasura të Romës. por edhe spiunë të vegjël që dërgonte regjimi për të parë në rrinin qetë kundërshtarët e vet. Të tillë spiunë, «kushëriri i kushëririt të filanit». pra i besuar në shkallën e 10-të, u sillnin emigrantëve «antizogistë» lajme «sensacionale» kundër Zogut.

Një vit, kur shkova nga Shqipëria në Bari, m'u vërsulën Shehu, Bahr iu dhe të tjerët, të eksituar, të gëzuar dhe më pyetën

- Ç'kemi ndonjë gjë nga Shqipëria?

- S'kemi gjë tjetër, veçse fukarallëk e mjerim. Spiunë, është mbushur plot Tirana dhe gjakpirësit rrojnë mirë! - u përgjigja unë.

Kërceu Shehu, duke më parë me ata sy si të një kuçi të tërbuar dhe, në mënyrë misterioze, më tha

- S'do të rrojnë shumë, vanë, s'e kanë jetën të gjatë.

- Pse? - pyeta, - ç'ka ngjarë?

- S'ke mar rë vesh gjë fare? - bëri ai çudinë. Pastaj vazhdoi. - Ju, studentët, nuk jeni per gjë, por kjo është e natyrshme, të rinjve s'u thonë gjë.

E pashë Shehun edhe i çuditur, edhe i zemëruar. Ai vazhdoi:

- Vajti Zogu!

- Ku vajti? - e pyeta.

- Në xhehenem, ka kancer! Dy-tre doktorë të famshëm kanë vajtur nga Vjena për ta shëruar, po kanceri nuk fal !

- Të vdesë, maloku i m...! - ia mori fjalën Bahriu.

- Kush jua dha këtë sihariq? - i pyeta.

- Ah, jo, - u përgjigj Shehu, - sekretet dhe njerëzit tanë ne nuk ua zbulojmë kuqalashëve!

- Atëherë, - u thashë, - më porositni një kasatë të mirë për sihariqin që më dhatë, por unë po ju them se Zogu është si macja me shtatë shpirtra. Ai do plumb që të ngordhë !

Në të vërtetë historisë së kancerit të Zogut në Shqipëri i kishte dalë boja. Zogu që kthyer nga Vjena shëndoshë e mirë, bile atje, jo më «kanceri» që s'i bëri gjë, por as shkrepjet e kobureve të dy aventurierëve shqiptarë, agjentë të të huajve, nuk e kishin zënë, kur u munduan ta goditnin tek dilte nga opera. Tamam pas kësaj ishte zbuluar e famshmja «lëvizje e Vlorës», që s'ishte tjetër veçse një komplot i fshehtë, i kurdisur nga të huajt, por i dështuar që në embrion sepse, qoftë «antizogistët» e emigracionit, qoftë agjenturat e huaja të lidhura me këtë farë «lëvizjeje antizogiste», nuk merrnin parasysh e nuk mbështeteshin tek urrejtja e popullit, por te llogaritë e tyre për fitime, për ndërrime kolltukësh e varësish të huaja. Gjërat pra vazhduan rrugën e tyre; Zogu përgatiti okupacionin, grabiti arin e popullit, shkoi në Egjipt te Faruku, bëri kontrabandë, pastaj vajti vdiq në Paris, kurse të famshmit «patriotë antizogistë» erdhën në Shqipëri, u bënë ballistë, bashkëpunëtorë të italianëve dhe të gjermanëve. Na luftuan me ar më, po ne i kapëm, i çuam në gjyq dhe i dënuam për tradhti të lartë ndaj atdheut dhe popullit. Kështu mbaroi historia e tyre. Por le të kthehemi në momentet kur u njoha për herë të parë me një pjesë prej tyre, pr a kur për herë të parë kalova nëpër Itali, gjatë rrugës për në Francë.

Italia, kur kalonim ose kur rrinim disa ditë në Bari, na dukej, ashtu siç ishte, një skëterrë, burg i popullit italian dhe armike e vendit tonë. Ajo e kishte lidhur fort pas qerres së saj xhelatin e popullit tonë, Ahmet Zogun, e mbante në fuqi dhe përmes borxheve, koncesioneve, huave e fijeve të shumëllojta, nga njëra anë. Përgatitej të rripte popullin shqiptar, nga ana tjetër, përgatiste okupacionin e ardhshëm të Shqipërisë. Populli italian ishte vetë i mjeruar, rrugët e Barit qenë mbushur plot me lypës. Po të lije në bankat e kafes «Stopani», qoftë edhe një cigare në tavllë, përnjëherë zhdukej, pse dikush të përgjonte, kalonte andej me seriozitet dhe e rrëmbente. Cigaret në dyqane bliheshin me copë dhe njerëzit i shihje nëpër rrugë tek mbanin nga një kokë lakër o ndonjë presh, pavarësisht se leshrat u ndritnin nga brilantina. Rrugës shihje, gjithashtu. shumë oficerë, të veshur bukur si kukulla, gjokset plot me shirita (nishane), që i kishin marrë pa bërë asnjë luftë, shihje kudo jerarkë fashistë me rroba të zeza me cohë dhe me çizme lustrina, barkalecë dhe faqekuq. Këta mbushnin trotuar et.

Kurdoherë që udhëtonim me tr en, mblidheshim gjithnjë dy ose tre shokë së toku, pse kishte rrezik të na vidhnin valixhet. Kur shkonim në stacion për të blerë biletat për në Ventimilja*, *(Qytet italian në kufirin italo-francez.) biletashitësit, që na pyeste ç'bileta donim, për ku dhe në ç'klasë, i përgjigjeshim me atë italishten tonë shatra-patra:

- *In mancanza di quattro classi, una terza**. *(Në mungesë të klasës së katërt, na jep një biletë për të tretën.)

Udhëtimi me tr en në klasën e tretë ishte tmerr. Uleshim në dër rasa sa këputeshim ditë e net me radhë, pastaj mezi gjenim vend. Veç kësaj, duhej të ruaje vazhdimisht valixhet, se t'i përllanin. Orë e çast duhej t'u jepje kontrollorëve dhe karabinierëve dokumentet. Vagonët e klasës së tretë le që ishin plot, po qelbeshin; dimër-behar në ta kishte pisllek të madh.

Krejt ndryshe ishte kur hyje në Francë. Na dukej sikur dilnim nga bur gu, pse, pas kufirit francez e der i në Monpelje, vërtet udhëtonim në klasë të tretë, por vagonët e trenave francezë ishin me meshin dhe me krin br enda, të butë dhe kurrë nuk mbeteshim pa vend. Kur se nëpër Itali ishim të detyruar të merrnim çfarëdo'loj treni, hipnim edhe në ata që qëndronin në fshatra pak a shumë të mëdha.

Ndër stacionet italiane qoftë ditën, qoftë natën, bëhej zhurmë e madhe dhe mbi të gjithë, dëgjoheshin ata që shitnin cuscini (jastëkë), cestini (një qeskë me një copë bukë, një copë mortadelë dhe një copë djathë) dhe portabagagli (hamejtë). Për sa na takon neve, hamej nuk merrnim kurrë, se kjo na kushtonte. Vetëm se djersnim e këputeshim me valixhe në duar, ngaqë na duhej të

ndërronim disa herë trenin dhe të kapërcenim binarë e tunele. Veç kësaj, trenat ishin të vjetër e shpesh pësonin defekte. Një herë udhëtonim në veri të Italisë. Ishte në të hyrë të dimrit, bënte ftohtë dhe binte borë, por në vagon ishte nxehtë, se veç kaloriferëve, kishte edhe shumë frymë. Në një moment u çanë tubat e kaloriferit dhe ne u mbytëm në avull; brenda bënte një nxehtësi e tmerrshme, në një kohë që jashtë ishte acar. Të hapje penxheret keq, të mos i hapje prapë keq e kështu vazhduam nja dy ore, herë nxehtë e herë plevitosu.

Zakonisht nuk largoheshim nga stacionet, por një herë, kur udhëtoja me Enver Zazanin, që studioje në Lion, vendosëm të dilnim për të parë Romën. Pasi mbërritëm atje nga Bari, lamë valixhet në depo të stacionit dhe dolëm. Filluam shëtitjen, por ngaqë s'dinim ku të shkonim e lamë veten ku të na çonin këmbët. Dolëm në një rrugë të gjatë, në fund të së cilës dukej një monument i madh i bardhë që mbyllte bulevardin. Iu futëm asaj rruge dhe ec e ec e na dukej sikur s'kishte mbarim. Më në fund dolëm në një shesh, e kapërcyem edhe atë dhe iu avitëm monumentit. Kangjellat ishin mbyllur. Qëndruam dhe po shihnim këtë monument të madh dhe avdall, si i themi në Gjirokastër. Por, kur po soditnim monumentin, pamë se nja gjashtë a shtatë civilë, na kishin futur në mes. Njëri na pyeti:

- Ç'bëni këtu?

- Shohim monumentin, - iu përgjigjëm.

- Po ç'jeni ju? - thanë ata.

- Po ju që na pyetni, ç'jeni? - vazhduam ne.

- Jemi policia! - tha njëri i vrenjtur.

- Ah, - u thamë, - jemi studentë albanezë!

- 1 dokumenti! - thirri njëri prej tyre dhe ne u dhamë pasaportat, i panë sa mbarë mbrapsht dhe, duke na i kthyer, na thanë:

- E shikoni këtë rrugë?

- Po, - u përgjigjëm, - e shohim.

- Atëherë, - theksoi i pari i tyre, - nisuni drejt, Pa kthyer as kokën, në rast se nuk doni të flini në burg!

- Va bene! - ia kthyem dhe u larguam.

Me vete thoshim: Vallë ç'të ketë atje? Më vonë mësuam se ishte «Piazza Venezia», ku kishte zyrat Musolini. Pa e ditur, kishim hyrë në zonën e spiunërisë dhe soditnim monumentin e të vdekurve që kishin shtypur popujt!

Një vit tjetër ndalua për disa orë në Firenze, qytet i bukur, historik, vend i njerëzve të mëdhenj të Rilindjes italiane. Kaluam mbi lumin Arno tek ura e vjetër, vizituam «Piazza delle Signorie» dhe statujat e saj me famë, pastaj u ngjitëm e vizituam kopshtet e Bobolit. Vizitën këtu e bëmë pa telashe, nuk u ndalua riga policët e riga spiunët e fashizmit që kishim përshtypjen se të ndiqnin pas në çdo hap. Ndoshta kjo ishte një përshtypje që vinte edhe riga riami i keq që po i jepte Italisë regjimi fashist në fuqi, edhe historia e marrëdhënieve italo-shqiptare, e sidomos riga ajo politikë antipopullore e antikombëtare që ndiqte regjimi i Zogut në marrëdhëniet me Italinë e Musolinin. Për të gjitha këto, kudo ku kalonim nëpër Itali, e ndienim veten si të rrethuar me armiq. Natyrisht kjo ndjenjë armiqësie kishte të bënte me regjimin dhe njerëzit e tij. Sepse, në përgjithësi, populli italian është i mirë dhe punëtor. Këtë e kam vërejtur veç shumë rasteve të tjera një çikë më me kujdes në një qytet të vogël banjash të quajtur Salcomaxhiore. Kur isha mësues në Korçë dhe Italia ria kishte okupuar, mua m'u fry gjuri keq dhe doktorët më rekomantuan se duhej të bëja banja me një baltë speciale. Fahrija dhe Bahriu nuk ishin kthyer akoma në Shqipëri. Mora ca para hua dhe tok me Fahrijen shkuam 15 ditë në Salcomaxhiore. Duhet thënë banjat ishin të mira, po ashtu edhe shërbimi dhe pata një përmirësim të tillë sa sëmundja e gjurit nuk m'u përsërit më, bile as gjatë viteve të rënda të luftës. Pensioni ku rrinim që i thjeshtë, i lirë dhe të zotët qenë njerëz të mirë, të sjellshëm. Asnjëherë nuk ria folën për fashizmin. Vetëm nëpër rrugë shihja jerarkë me rroba të zeza dhe bersalierë me pendë gjeli në kapelë.

Kapitulli i udhëtimeve përmes Italisë, kur shkonim në Francë, mbyllet në Ventimilja, ku çdo herë i nënshtroheshim një kontrolli të dyfishtë, doganës dhe pasaportave. Kontrolli në doganë nuk ishte

për sa këmishë o këpucë kishe, por për librat që mund të kishe me vete. Çështja e librave ishte një histori më vete. Doganieri kishte një listë librash, shikonte titujt e librave tanë dhe pastaj i hidhte një sy listës së vet, shfletonte librin se mos kishte ndonjë dokument ilegal brenda dhe, pas kësaj, ta hidhte librin në valixhe. Kurse, kur veje në gishenë* *(Kabinë, zyrë e vogël në stacione trenash) e vizës së pasaportës, si në hvrje. edhe në dalje fjalën e kishte karabinier i. Ai kontrollonte mbarë e prapë pasaportën, merrte lupën, shikonte vulat dhe, pasi e kishte mbar uar këtë operacion të hollësishëm, nxirrte riga sirtari dy albume, për rastin tim. njëri me germën E dhe tjetri me germën H. Karabinieri shikonte nëse ndodhej në faqet e albumit në vendin përkatës sipas rendit alfabetik fotografia jote, vërente me kujdes herë albumin, herë pasaportën e, pastaj fvtvrën dhe. po të mos gjente asgjë të dyshimtë, merrte vulën. ia bënte dv herë bamb-bamb një në bojë dhe një në pasapor të dhe ti, matanë gishesë, ku r uante një karabinier në këmbë, ia bëje dy herë uf, uf !
Kjo ishte Italia fashiste e Musolinit, armike e betuar e vendit dhe e popullit tonë, armike e Bashkimit Sovjetik, e socializmit dhe e komunizmit.

III

NË FRANCË – MONPALJE

Vetërn disa minuta duhej të ccte treni nga Ventimilja, kur buçiste sirena që lajmëronte se po hynim në një vend tjetër. Kjo ishte Franca, vendi

° i galëve të lashtë, djepi i qytetërimit evropian, vend i lirisë, i punës, i kulturës dhe i revolucionit. Emocionet tona në këto momente ar rinin hulmin, shihnim me kureshtje e gëzim peizazhin rrotull, gjithçka na duk-ej ndryshe, si më e re, më e bukur, më e ndritshme dhe një kohësisht e afërt.

Nga Ventimilja e deri në IMonpelje udhëtimet kanë qenë kurdoherë të qeta, pa incidente. Kur udhëtimi qëllonte ditën, shikonim me kureshtje dhe me dashamirësi këtë vend të revolucionit demokratiko-borgjez, këtë vend që i kishte dhënë botës filozofë, shkencëtarë, doktorë, shkrimtarë, poetë, dramaturgë e komedianë me famë. Shumë prej tyre jetën, idetë, veprat ua kishim studiuar gjatë gjithë kohës që mësuam në liceun francez, qoftë në atë të Gjirokastrës, qoftë në atë të Korçës. Ne e kishim kokën plot me ngjarjet historike dhe shoqërore të Francës, dinim gjuhën e saj dhe tash që hynim për herë të parë në tokën e galëve na dukej sikur njihnim çdo stacion, çdn qytet o qytezë. Këndonim me gëzim reklamat në stacione, pyetnim në frëngjisht: «Ku është çezma? Ku është kiosku i gazetave? Sa kohë do të qëndrojë treni?» etj. dhe na dukej si çudi që dinim ta flitnim kaq mirë e kaq lirshëm frëngjishten. Francezët na kuptonin dhe as nuk shihnim ndonjë habi në fytyrat e tyre në lidhje me aksentin e të folurit.

Nga treni soditnim krahinën e madhe të Provansës dhe na dukej sikur bisedonim me më të njohurin shkrimtar të këtyre anëve, Alfons Dodenë, me shkrimtarin tjetër të preferuar të Provansës, Mistralin; shumë njerëz në stacione na dukeshin si heronjtë e librave që kishim lexuar, si Tartarini o Kostekalda; djemtë e vajzat e reja na dukeshin si Kadudali, si Mirela. Kur ecte treni na dukej sikur kalonim Kamargën e famshme, që shtrihej në të dyja anët e lumit Ron, me kuajt e demat e saj të njohur që vraponin në fushat e livadhet e begata; na dukej sikur shihnim në një kodër mullirin e Dodesë, ashtu si në tregimet e bukura të tij, me krahë të palëvizur dhe ku «priste» e vazhdonte «të priste» akoma millonai i vjetër që t'i sillnin grurë për të bluar. Por më kot, pse fabrikat moderne të bluarjes e kishin kthyer mullirin me erë në një «muze» të rrënuar.

Të gjitha këto e shumë të tjera i përshkonte imagjinata jonë e re që kalonte mbi urën e Avinjonit *Où on dansait tout en rond la farandole**.*(Frëngjisht - ku kërcëhej në rreth (arandola (lloj valleje popullore e krahinës së Provansës).)

Duke ecur treni dhe duke na nanuritur zhurma e tij monotone, na kujtohej historia e papëve të Avinjonit, udhëtimi i kardinalit Rishëlië që vinte i sëmurë nga rrethimi i hugënotëve* *(Kështu quheshin me përbuzje nga katolikët protestanët kalvinistë në shekujt e 16-të - 18-të.) në La Roshelë dhe në rr ugë

arrestonte Senk-Marin dhe Dë Tunë, favoritët e mbretit të tij, Luigjit të 13-të dhe u priste kokën në Lion.

Ose më kujtohej kryqëzata e albizhuave, sekt i katarëve heretikë të Romës, therja e tyre në masë nga inkuizicioni, i madhi i të cilit thoshte: «Vritni kë të mundni, se në parajsë zoti do të zgjedhë cilët janë armiq të dhe cilët janë tanët».

Me zhurmën e trenit, që na çonte në Monpelje, përziheshin barbarizmat e Simon të Monfortit dhe rezistenca e fundit e katarëve heretikë në kështjellën e shqiponjave Monsegryr.

Me frymë optimiste mendoja se do të veja në një qytet të lashtë, ku kishte dhënë mësim shekuj më parë Rabëleja, ku jepte mësim Batajoni e shumë profesorë të tjerë të shquar. Të gjitha këto, të cilat i kisha mësuar në lice, më ringjallehin tash në kujtesën time me tufa, me detaje dhe më jepnin përshtypjen e thellë sikur nuk isha në një vend të huaj, por në një vend mik që nuk i kishte bërë kurrë keq popullit tonë.

Në stacionin e Monpeljesë hymë natën. Stacion modest në krahasim me ato të Italisë, i qetë, me drita pak dhe intim. Në stacion kishte shumë pak njerëz dhe ishim ne udhëtarët, që zbritnim nga treni, që u jepnim stacionit dhe rrugëve pranë për 5-10 minuta gjallëri. Në stacion asnjëri s'të mërzieste, s'kishte hamej të të lëshoheshin drejt valixhes, nuk kishte shitës gazetash o ushqimesh, pa lëre jastëkësh, që s'qe nevoja, pse siç thashë, në Francë edhe vagonët e klasës së tretë ishin të butë, si shilte. Më çudiste kjo thjeshtësi dhe kjo qetësi, pse në lice kishim mësuar se vendësit e Provansës, Heroltit, Nimës etj., ishin egzuberantë. Ata ishin simpatikë, të qeshur dhe të gjendur, po t'ua kërkoje ndihmën. Shkelnim për herë të parë në këtë qytet, por në fillim s'pyetnim askënd për të na drejtuar se gëzoheshim dhe kënaqeshim ta gjenim vetë rrugën, sikur të kishim qenë këtu dhe herë tjetër.

Me të dalë nga stacioni, arritëm në një shesh, nga i cili dilnin disa rrugë të ndriçuara mirë. Në shesh të stacionit pamë një hotel «Terminus»*. *(Kështu quheshin në Francë hotelet e vogla në periferi të qyteteve, pranë stacioneve të trenit.) Unë u nisa drejt tij, shtyva derën dhe vajta te hotelxhiu që rrinte në këmbë dhe priste klientët. I kërkova një dhomë me një krevat.

- E do për një natë apo për shumë net? - më pyeti.

I thashë se jam vetëm dhe besoj të rri dy-tri ditë. Kur më kërkoi pasaportën, i tregova se jam student. I VIë caktoi dhomën, i ra ziles, erdhi një shërbëtor i natës dhe i tha:

- Merr e zotninë dhe çoje në kat të tretë, në këtë numër !

Ai mori valixhen dhe ngjitem shkallët, se atëherë s'kishte ashensorë në hotele të kësaj kategorie. U futa në një dhomë modeste. me çarçafë të bardhë, me një lavaman, kurse për WC-në më tregoi fundin e korric'orit të katit.

Ishte nata e parë që flija në Monpelje, ku do të qëndroja tre vjet, do të njihesha dhe do ta doja këtë qytet të lashtë, të bukur, me blerim dhe të qetë. Qytet province, thoshin parizianët për të, por për mua ai ishte plot gjallëri, pse atje kishte shuinë studentë dhe gati nga të gjitha anët e botës. E preferonin këtë qytet për famën e universitetit të tij. për klimën e butë, për njerëzit gazoë dhe plot temperament.

Në mëngjes u cova, dola në sheshin e stacionit, shikova me habi, me kuriozitet dhe me kënaqësi një park të vogël me pemë të larta, që ndante dy rrugë të gjera me trotuare dhe me shtëpi të larta, por jo uniforme. Në të djathtë të stacionit pashë tabelën e një kafeneje «De la gare». Në një reklamë shihje një grua që mbante një tepsi, mbi të cilën qenë pikturuar çafka me kafe au lait (me qumësht) dhe croissants të ngrohtë. Croissant unë e dija ç'do të thoshte, e kisha parë edhe nëpër libra të ilustruar, por nuk e meri ja dot me mend se ajo gjë e ngrohtë, që servirej me kafe rre qumësht do të ishte një lloj simiteje në formë gjysmëhëne, aq e shkrifët, e pjekur bukur dhe e butë si sfungjer. Hyra në kafene dhe porosita një kafe rre qumësht dhe dica kruasane. Ky ishte mëngjesi. Vajza që shërbente më solli kafënë dhe një shportë me kruasane. u piva, duke futur në kafe simiten të dredhur si kizë e të pjekur si (lori. E pagova vajzën dhe e pyeta:

- Ç'rrugë duhet të marr për të shkuar në universitet

- Në cilin fakultet? - më pyeti ajo.

- Në fakultetin e shkencave - i thashë.

- Atëherë më merr lar t r r ugën e madhe, do të dalësh në «Place de la Comédie» («Sheshi i Komedisë»), në «CEuf» («Veza»), - tha vajza me një të folur të shpejtë, sic e kanë zakon francezët dhe, ndërsa unë po mun, lohesha të kuptoja se ç'të që kjo «Vezë» ku duhej të dilje, ao vazhdonte të më tregonte restin e itinerarit: - Ec drejt pa ndaluar, ngjit filan rrugë, do të dalësh në postë, kaloje sheshin e postës dhe nga e djathta do të gj esli n ië shesh tjetër rne librari. Pastaj ndiq rrugën, z'Illrit enne do ta gjesh me siguri rrugën date fakultetin që kërkon, se atje do të shohësh plot të rinj si ti, do të shohësh një *nid d'oheille**. *(Koshere bletësh)

E falënderova vajzën, p or me vete thashë «shumë e kornplukuar». Sidoqof të, në Gjirokastër thonë se duke pyetur, gjen cdo gjë. Bhe u nisa rrugës përpjetë, quhej «Rue Maguelone», në qoftë se s'gabo hem. se 45 vjet kanë shkuar që nga ajo ditë.

Kur mbërrita te teatri municipal (teatri bashkiak), u gjenda përpara një sheshi të gjerë, të bukur, në mes të të cilit ishte një platformë ca më e ngritur nga rruga që e rrethonte. Kjo platformë ishte e famshmja «Vezë» historike e qytetit. Në atë kohë. këtë vend ne e konsideronim si qendrën e qytetit. Për ta parë më mirë «Sheshin e Komedisë», ka-oërceva irot.uarin dhe dola në «Vezë». Ato;e s'kishe frikë nga makinat. «Veza» kishte tamam formën e objektit, emrin e të cilit mbante, ishte e shtruar me plloca bo;ë hiri dhe në mes, mbi një pedestal të bukur pre,i guri të bardhë, gjendej një statujë ose rne mirë tri statuja në një ansambël plot bukuri dhe hijeshi, tri gra prej mermeri të bardhë. Ky ansambël ishte në mes të «Vezës» dhe quhej «Les trois grâces»*. *(Kështu quheshin në mitologjinë greke hyjneshat e bukurisë që shkonin pas Apolonit. Zakonisht citohen tri: Agllaija, Talia, Efrosina.) Ndenja ditën e parë dhe sodita me admirim të parën statujë që po hasja në Francë. Më vonë do të shikoja edhe të tjera, po ky ansambël m'u duk i bukur. Nga «Veza», shikova teatrin municipal. Edhe ky m'u duk i bukur, «madh,ështor», s'kisha parë kurrë një gjë të tillë. Por, më vonë, kur pashë edhe të tjerë, nuk më bëri më përshtypjen e parë, vetëm se në sheshin qendror të Monpeljesë ai kishte një pozitë të dukshme dhe dominonte pamjen e kësaj qendre, nga ku dilnin shumë rrugë, që më vonë jo vetëm ua mësova emrat, por edhe i soditja çdo ditë kur shkoja në fakultet, në shtëpi, në shëtitje. Rreth e rrotull sheshit shihje sidomos kafe me frona jashtë, kafe të mëdha, nën pallate të stilit të vjetër, barok etj. dhe nisa të këndoja tabelat: «Café du Commerce», «Café de France», përballë «Café Riche», më tej dy-tre bare, ca më tej një kafe tjetër njëlloj si «Café de France».

Nga e djathta e teatrit bashkiak, përtej «Vezës», ndodhej një park i madh, që më vonë mësova se quhej «Esplanade», për të cilin do të flas disa herë më vonë. Në shesh kishte edhe banka ku mund të uleshe; në një nga pjesët kryesore, ndanë tij, ngrihej «Galérie Laffayette», supermagazinë disakatëshe, ku shkonim për të blerë çdo gjë, që nga sapuni për t'u rruar e deri te brisku, por edhe për të shëtitur në të gjitha katet e mbushura me mallra nga më të ndryshmet. Atje, kryesisht, shkonim të shihnim vitrinat, mallrat e reja që hidheshin në treg, sepse as kishim mundësi të blinim ndonjë gjë të shtrenjtë, shkonim sidomos të shihnim sektorin e librave. Duhet të them se në Monpelje, në këtë qytet të famshëm universitar, fryma e popullsisë në atë kohë nuk ishte libertine, por anonte nga konservatorizmi. Dyqane e magazina të tjera nuk shihje në «Vezë», përveç një kiosku librash e gazetash në rrugën që të qonte te kinemaja. Por do të kem rast të flas edhe herë tjetër për këto vende.

Nga «Veza» kapërceva trotuarin e «Café Riche» dhe, duke ndjekur trotuarin e djathtë të një rruge që quhej «Rue de la Loge», u ngjita, u ngjita dhe, duke pyetur, arrita në një shesh të vogël të rrethuar me librari, ku shiteshin sidomos libra universitarë. Njëra nga këto, që e frekuentoja më shpesh, në qoftë se s'gabo hem, quhej libraria «Vidal». Prej andej dola në një sokak të ngushtë me kalldrëm, me dyqane të vogla, pa trotuare, ku rrallë e tek kalonin makina dhe u befasova: m'u duk se ndodhesha në rrugët e Gjirokastrës sime. Të ngushta e të pjerrëta, të mbathura me kalldrëm cep më cep, me radhën e shtëpive që ngriheshin e zgjateshin njëra pas tjetrës, me vitrinat e dyqaneve në të dyja anët, me gra e fëmijë nëpër dritare e para portave, të vinte të pyesje: mos jam në Varosh ose në Palorto?! Më hipi një gëzim dhe njëkohësisht një nostalgji, ecja lirisht, se isha bir i Gjirokastrës me gurë e me kalldrëlile, që s'kishte njohur ende asfalt. Zaten të gjitha rrugët nëplr të cilat kalova ditën e para ishin me kalldrëm.

Duke zbritur poshtë kësaj rruge, arrita në një ndërtesë të madhe, me një portë në formë harku (me një ngjashmëri të habitshme në formën e përgjithshme me portat e Gjirokastrës), përballë së cilës ishte një kafe plot me të rinj dhe të reja. Atëherë thashë: këtu do të jetë universiteti. Kalova portën e madhe dhe dola në një oborr në formë katrori shtruar me zhavorr dhe ku ishin mbjellë oleandra të kuqe. Oborri ishte i rrethuar me një korridor me kolonada. Hyra aty sikur të kisha qenë edhe herë tjetër dhe, duke kaluar, lexoja tabelat në portat që ishin në korridor: sekretariati, amfiteatri i drejtësisë, Fakulteti i Zoologjisë, biblioteka e universitetit, Fakulteti i Letërsisë, i Historisë, i Gjeografisë. Nga e djathta, kur hyje në katin e parë, ishte një balikon i hapur si terracë; atje (siç do të mësoja më pas), ndodheshin biblioteka dhe amfiteatrot e historisë dhe të gjeografisë. Drejtpërdrejt hyrjes kryesore, përmes një kalimi në katin përdhes. dilje në një oborr tjetër si i pari, me zhavorr, me oleandra, me amfiteatro.

Për mua kjo ishte një ditë e gëzuar, e paharruar, pse ndeshesha me gjëra të panjohura, të papritura, që më ngjallnin kureshtjen e ndërkohë duhej të informohesha si të veproja për sistemimin në universitet e në internat. Hyra në sekretariat. Atje rrinin njëri pas tjetrit studentë dhe studente që kishin zënë radhën për t'u regjistruar. U futa edhe unë në radhë si të tjerët. Para meje ishte një djalë i gjatë, flokëverdhe e shumë simpatik. Më përshëndeti, e përshëndeta edhe unë, i dhamë dorën shoqi-shoqit dhe iu prezantova:

- Hoxha.

- Ronkant, - tha aie më pyeti: - Ç'nacionalitet je?

- Shqiptar!

- Kani simpa ti për Shqipërinë, pse bëj histori, kam mësuar për SI-ënderbeun tuaj trirn. A do të më ndihmosh të di më tepër për të? - shtoi ai.

- Ale gjithë qejf, - i thashë, - dua të jem shok me ty!

- Me kënaqësi! - ma priti dhe vazhdoi: - P o në ç'iakultet je ti?

- Në atë të shkencave natyror e.

- Shumë mirë! - tha.

- Sapo kam ardhur nga vendi im dhe dua të informohem ç'duhet të bëj për t'u regjistruar.

- Shumë e thjeshtë, - tha Ronkanti. - Ç'ke mbaruar, lice?

- Po, Liceun frëng të Korçës.

- Klasën e matematikës apo të filozofisë?

- Klasën e filozofisë.

- Mirë, dil përpara meje!

- Jo, - kundërshtova unë, - ti ke ardhur më parë!

- Hajde, hajde se je bleu*, *(Student i ri) - më thotë, - unë janl më i vjetër se ti.

Iu afruam sekretarit, të cilit i kërkova shpjegime.

- Si i huaj, - më thotë ai, - nuk e flet keq

frëngjishten.

Ronkanti, që e njihte mirë sekretarin, i tha duke

ceshur:

- Pa hë, mund ta flasësh dot shqipen, siç e flet Hoxha frëngjishten?

Sekretari, një burrë simpatik, i hollë, nja 50 vjeç, ceshi dhe tha:

- *Salut Roncante, c'est notre protégé**. *(Përshëndetje Ronkant, këtë do ta llemi në patronazh.)

Ai iu për gjigj

- Po është stërnipi i Gjergj Kastriotit.

- Nuk e njoh këtë njeri, - vazhdoi sekretari.

a ka studiuar Kastrioti në universitetin tonë?

Në të dy qeshëm.

- Jo. - i thashë. - Skënder beu ka qenë bui rë i shquar. që ka jetuar në shekullin e 15-të, por për t'kanë shkruar Montenji, Ronsari e vjershëtarë të tjerë Plejadës, Volteri e të tjerë.

- Ç'të duhen shkencat atëherë, - e mori prapë fjalën sekretari me të qeshur, - regjistrohu në histori, letërsi!

Shakaja goditi tamam ku më dhimbte.

- Atje e kam pasur vërtet qejfin, po s'mundem se jani me bursë shteti dhe për shkenca më kanë caktuar. Mund të ma ndërroni ju?

- E pamundur! - ma ktheu sekretari tashmë

tepër serioz. - Këtu, sidomos për të huajt, zbatohen me rreptësi ato ç'kanë vendosur vendet që akordojnë bursat.

Sekretari m'i dha të gjitha informatat e duhura dhe më kërkoi t'i çoja të nesërmen dokumentet. Dola nga radha dhe prita Ronkantin.

- Shkojmë pimë një kafe në bar, - tha shoELu francez. - Merr dhe një kruasan!

- Jo, - i thashë, - kam ngrënë.

Kur futa dorën në xhep të paguaja, Ronkanti më ndaloi.

- Ajo gjë s'bëhet, ti je miku im i ri, - dhe më pagoi kafënë.

U lidha me të me shoqëri të mirë. Tash duhej të gjeja shokët shqiptarë, që nuk ua dija adresat, por më të vjetrit, si Eqrem Hadoja, Niko Stralla e Selim Damani më kishin thënë se pas bukës, në drekë, shkonin pinin kafe o në «Café Riche» ose në «Café de France».

Drekën e hëngra në një restorant të vogël afër universitetit, të cilin ma tregoi Ronkanti. Ishte plot me studentë dhe studente të qeshura, zallahi e madhe, *du चाहत*, siç thoshte e zonja e restorantit, një plakë e mirë. U ula në një tavolinë, ku ishin tre djem.

- *Bouffe du boudin, vieux**, *(Ha suxhuk.) - më tha një prej tyre, pa kuptuar se ç'do me thënë *bouffe*, po e mora me mend se donte të thoshte ha, ose merr, kurse *boudin* nuk e dija ç'gjellë ishte! I thashë garsones:

- *Va pour le boudin**. *(Po mirë, suxhuk.)

«*Mirë boudin*, - po i thosha vetes, - po përse ai më tha «*vieux*», unë nuk jam plak, po i ri». Më vonë mësova se kështu i thoshin shoku-shokut pa teklif. Hapëm pasta] bisedën, ata më pyetën se ç'fakultet ndiqja dhe u tregova ç'do të mësoja.

- Do të fillosh me PCN, - tha njëri, - ne do të mësojmë së toku, rrofshin bretkosat e Deruvilit dhe kopshti botanik! - Më kujtohet se këtë student, e quanin Rëne.

Më erdhi gjella. Ishte një suxhuk i trashë me gjak në pjatën të mbushur me pilaf jo të shkrifët, sic na e bënte aneja, po qull. E shikoja dhe Rëneja më shikonte:

- Bouffe, - më tha, - *c'est bath**. *(Ha, është i shijshëm!)

«Cfarë frëngjishte është kjo?» - pyesja veten disi i shqetësuar, sepse këto qenë fjalë që nuk i dija. Futa pirunin dhe thikën, e preva budinin copa-copa dhe po i përzieja tok me pilafin. Ishin jashtëzakonisht të shijshme. Shokët më pyetën:

- Të pëlqeu?

- *C'est bath*, - u përgjigja pa e ditur ç'donte të

thoshte. Kush mbaronte i pari, paguante, ngrihej, thoshte «*salut*» dhe ikte. Njerëz të mirë dhe të thjeshtë.

Me të mbaruar drekën shkova në «Café Riche», një

kafe e madhe, muret me pasqyra, me një vend për orkestër dhe nga të dy krahët me banketa me copë të kuqe. Hyra si i hutuar, pse nuk kisha parë kafe të tillë, kaq të madhe dhe me pasqyra.

Klientë nuk kishte shumë në atë orë. Shikova andej-këndeje për të gjetur shokët kur një zë më thirri nga një cep i kafenesë:

- Enver, eja këtu!

Ktheva kokën dhe kërceva nga gëzimi, u vërsula

drejt shokëve të mi të një klase në lice që kishin shkuar atje më parë se unë, po dhe shokëve të tjerë që kishin dy dhe tre vjet në Monpelje, por që shumicën i njihja që nga Korça, se kishim jetuar bashkë në internat. Këta ishin Eqrem Hadoja, Sotir Angjeli, Rexhep Neziri (nga gjimnazi i Shkodrës), Bahri Kopliku, Niko Stralla, Aleko Turtulli, një koloni e tërë shqiptarësh. Kishte dhe të tjerë, të cilët i takova më vonë. U përqaftova, u puthëm, më pyetën dhe i pyeta, u tregova për peripecitë e ditës së parë.

- Shumë mirë, - më tha Sotir Angjeli, - do

të jemi në një fakultet së toku. Nesër shkojmë bashkë, regjistrohu dhe vemi në amfiteatër të zoologjisë të dëgjojmë leksionin.

Eqrem Hadoja më pyeti në ç'hotel flija. I trego

va se isha vendosur përkohësisht në hotelin pranë stacionit.

- Pi kafënë, - më tha ai, - pasta] vemi në

shtëpinë time, rrimë ca atje dhe pasdreke shkojmë te mesiti (agjenti që merrej me shitje ose gjetje shtëpish me qira). Dhe kështu bëmë.

Eqrem Hadoja ishte nga Delvina, bir i një avokati. Ai kishte mbaruar mirë Liceun e Korçës dhe kishte ar dhur në Monpelje një vit më par ë. Aty ai ndiqte vitin e dytë të drejtësisë. Ishte i mirë nga sjelljet e në mësim, i dashur, nxehej shpejt, por nuk mbante kurrë mëri, ishte i qeshur, vetëm mburrej ca. Unë e doja, e ngisja, bëja shaka me të, por ai kurrë nuk zemërohej me mua. Sa ndenjëm bashkë, nuk patëm asnjë gr indje studentësh.

- Unë jam për një r epublikë, por autoritare - thoshte.

Unë, natyr isht, nuk pa jtoheshja me këto mendime të tij, isba kundër monarkisë dhe kundër Zogut. pse doja komunizmin. Më vonë, kur po diskutonim për këto gjëra, më tha në konfidencë:

- Ki mendjen, mos lol hapur me të gjithë, se kemi edhe të këqij në mes tonë, që bëjnë raporte në Tiranë! Ruhu nga Selim Damani e Foto Bala, pse janë nga ata që të buzëqeshin, por ta ngjeshin dhe të pritet bursa.

Foto Balën e njihja, e kam pasur në një klasë, ishte njeri pa karakter që në atë kohë, kurse Selim Damanin nuk e njihja nga afër. Në Monpelje i njoha që ishin njerëz me karakter të dobët dhe rrjedha e viteve, veçanërisht periudha e Luftës Nacionalçlirimtare nxori më qartë në pah karakterin dhe formimin e tyre të dobët. Këta u lidhën me reaksionin e përfunduan keq. Eqrem Hadoja nuk gabohej në vlerësimet e tij.

Shkuam te mesiti. I kërkuam një dhomë jo të shtrenjtë, me shërbesë, me sobë mundësisht dhe jo në periferi të qytetit. Ai na tha:

- Kam! Pikërisht dje më njoftuan për një dhomë këtu, afër «Vezës», në një rrugicë në katin e tretë. «Rue Bryjas».

- Sa kushton? - e pyetëm.

- 300 franga në muaj, - u për gjigj ai.

Ne shikuam njëri-tjetrin. Ishte shtrenjtë për mua dhe Eqremi ia tha dulce shtuar se vetë banonte në një dhomë me banjë dhe paguante 250 franga.

- Hajdeni, - tha mesiti, - ta shohim një herë. se edhe unë s'e kam par ë, atje bëjmë pazar në vend me të zonjën e shtëpisë. Por duhet të dini që më parë se kjo shtëpi nuk është entrée libre, domethënë nuk mund të conit kë të doni; ajo është familje serioze.

- Dakord! - aprovuam ne.

Shkuam në rrugën «Bryjas», një rrugë e ngushtë, me trotuare të ulëta dhe nga të dyja anët me shtëpi të vjetra 3-4-katëshe. Ishte shumë pranë «Vezës», as 40-50 metra larg nga sheshi qendror i qytetit. U ngjitëm në katin e 3-të, i ramë ziles. Na e hapi derën një plakë topolake nja 70 vjeçe, që fliste gjysmë frëngjisht gjysmë provansalçe. gjuha e Mistralit. Mezi hiqej, por ishte simpatike. Mesiti i thotë:

- Të solla një klient, është student i huaj ! Mund ta shohim dhomën?

- Hyni! - na tha plaka dhe na futi në një sallon të vogël. Ajo na pyeti, duke më shikuar mua nga koka në këmbë dhe jo një herë, por disa herë.

- Nga jeni?

- Nga Shqipëria, - i thashë.

- Albanie, Albanie... - përsëriti plaka me vete disa herë pastaj, për të mos e vrarë më mendjen, pyeti:

- Afër cilit vend bie Shqipëria, se nuk e di?!

- Afër Italisë, - i përgjigjem dhe shtova: - afër Greqisë, Jugosllavisë.

- Ah, në Ballkan! - thirri plaka. - Atje ka luftuar dhe është vrarë një nipi im, ishte me gjeneral Sarrain.

- Tr upat e Sarr ait kanë qenë edhe në vendin tim, - plotësova unë, - pikërisht atje ku kam mbar uar liceun.

- Më dukesh djalë i mirë, - më tha plaka. - hajde ta shohim dhomën.

Dhoma ishte shuinë e pastër , me dy ballkone. se binte në qoshen ku kalonin dy rrugë, krevati bus i bardhë, edredoni* *(Lloj jorgani.) mbuluar me dantellë, një kolltuk dhe një lavaman, me brokë me ujë.

Më pëlqeu dhe ia shfaqta plakës kënaqësinë.

- Pranoj kushtet që më tha zotnia, - i thashë, - vetëm s'paguaj dot më shumë se 200 franga!

- Nuk prishemi! - kërcëu plaka. - Për hatrin e nipit që mund të ketë qenë në vendin tënd po pranoj. Na çelësin.

E mora dhe i pagova plakës 2 muaj përnjëherë.

Ishte një plakë shumë e mirë.

- Mos m'i paguaj dy muaj përnjëherë, se student je dhe mund të kesh nevojë, - më tha.

- Jo, - iu përgjigja, - jam nga një vend i varfër, ku njerëzit janë ekonomë!

- Unë i pëlqej njerëz të tillë, - ma ktheu me kënaqësi ajo dhe shtoi: - Sidoqoftë, në rast se nuk i pjek dot dy majat e muajit, më kërkoi përsëri një pjesë, sa të marrësh të tjerat.

Në dhomën e kësaj plake të mire, të thjeshtë, të dashur dhe shumë-shumë të pastër ndenja tre vjet. As u qava kurrë nga ajo dhe as ajo nga une. Çdo gjë e gjeja në rregull, çdo gjë e lija hapur, i çoja herë pas here nga ndonjë pastë o banane, se s'kishte as dhëmbë. Ajo herë pas here më jepte nga një gotë pije.

- Pak, pak, mama, - i thosha, - se une nuk pi.

- Çfarë garçonnet je ti që të mos pish një gote konjak! - ma kthente ajo dhe më linte gotën në dorë.

Kur kthehesha nga Shqipëria i sillja nga një peshqesh të vogël artizanati. Ajo kënaqej. Plaka nuk kishte asnjëri të saj. Herë pas here i bënte vizitë një njeri, edhe më plak se ajo, që ecte me shkop. E kisha takuar disa herë në sallonin e vogël të shtëpisë. Edhe ai fliste më shumë gjuhën provansale.

- S'e harrojmë dot këtë gjuhë, - mor zoti student, - më thoshte, - na duket gjuhë e bukur, na kujtohen këngët e gjinkallave në fshatra të Kamargës, na kujtohen kuajt e bardhë hergjele, vallet e bukura dhe zakonet e fshatarëve e të familjeve tona.

- Flisni si poet me nostalgji, - i thosha, - shumë mirë bëni që i ruani dialektin dhe zakonet e mira të të parëve. Edhe une i ruaj të popullit tim.

- Më tr egoni diçka nga vendi juaj, zoti Hoxha, - më thoshte ai dhe une, duke e njohur shpirtin e tij poetik, mes të tjerash i thosha se gëzimet dhe hidhërimet populli ynë i këndon jo vetëm dulce bërë vjersha, por edhe duke i kënduar me zë. Një ditë plaku nxori nga xhepi një hartë të vjetër të Ballkanit, vuri syzet dhe më pyeti

- Ja Shqipëria, po ju ku keni lindur?

I vura dorën në sup plakut dhe i thashë:

- Ja, e lexoni dot? Argirokastro!

- Po, - tha, - e shoh. Po trupat franceze të gjeneral Sarrait deri ku erdhën?

I tregova Korçën në hartë dhe i fola për të ashtuqajturën Republikë e Korçës që u formua në atë kohë. I thashë se në Korçë ndodhen të sistemuara më vete edhe varret e francezëve, të rrethuara me kangjellá, të ndërhuara me gurë mermeri dhe njerëzit vene e u vënë lule çdo vit.

Plaka e shtëpisë u gjallërua, e mallëngjyer më hodhi dorën në qafë dhe më tha:

- Zoti Hoxha, biri im, interesohu se mos ndodhet atje edhe varri i nipit tim!

- Patjetër, - i premtova, - do të vete t'i vizitoj dhe, kur të kthehem, do të të tregoj.

Plaka u lidh më shumë me mua dhe më thoshte:

- Kërkomë ujë të ngrohtë për t'u larë, për t'u rruar, mos më kurse, se të kam si djalë.

Plakë shumë e mirë që e kujtoj me mirënjohje.

Rruga ku banoja ishte shumë e qetë, kishte disa ore diell në mëngjes. Më vonë bleva një aparat të vogël radioje me «galene» që kapte vetëm emisionet e Radio Monpeljesë. Më kujtohet se ky ishte një gëzim i madh për mua. e para radio që bleva në jetën time! Kushtonte 25 franga (25 lekë). Gjë e madhe për xhepin tim.

Të nesërmen shkova e mora les inscriptions, siç i thoshin frëngjisht, regjistrimit dhe, sipas një zakoni të heshtur që më treguan shokët, në momentin që pagova kuotën ligjore, i lashë sekretarit edhe 25 franga bakshish. Ai më falënderoi, gjë që e bënte me të gjithë. Kështu, tash isha student i rregullt i Universitetit të Monpeljesë.

U regjistrova në shkencat natyrore, në PCN, siç e quanim shkurt, duke u nisur nga tri inicialet e para të fjalëve fizikë, kimi dhe shkenca të natyrës. Pas kësaj u interesova për auditoret, laboratorët etj. Këtu puna ishte pahëz më e vështirë. Për të ndjekur leksionet duhej të shkonim në tri ndërtesa: zoologjia lokalet dhe laboratorin i kishte në qendrën e universitetit, «Rue de l'Univer sité» ku ishin edhe fakultetet e drejtësisë, të letërsisë, të historisë dhe rektorati. Në ato vite, në qoftë se s'gabohem, rektori quhej Morin dhe ishte jurist i madh. Fakti që rektorati ishte në të njëjtën ndërtesë ku zhvilloheshin zoologjia e punët e laboratorit nuk më interesonte shumë. Ndryshonte puna me faktin tjetër: qenien në të njëjtën ndërtesë të fa kulteteve të drejtësisë, të historisë etj. ! Shumë herë «harroja» ose «ngatërrohesha» e, në vend që të hyja në auditoret e zoologjisë, hyja në ato të historisë e sidomos të drejtësisë. Dëgjoja ligjëratat me etje të madhe dhe më shtohesh më tepër zilia e pasioni për këto fakultete. Kaq herë i thosha vetes se «është hera e fundit» që shkel në jurisprudencë, se «duhet të mbledh mendjen e të mos lë mënjanë zoologjinë e kiminë», por pas katër-pesë ditësh prapë «harroja». Në të vërtetë s'ishte çështje harrese, por çështje dëshire, pasioni. Po e paguaja, natyrisht në dëmin t'n. atë padrejtësi që më kishin bërë në Shqipëri, kur më urdhëruan të vazhdoja shkencat e natyrës në vend të atyre politike e sociale. Aq dendur e bëja këtë sa kishte shumë nga studentët e drejtësisë ose të historisë që mendonin se vazhdoja fakultetin e tyre, në një kohë kur formulat e kimisë e të fizikës hera-herës «ngriheshin në protestë». Bile-bile do të vinte dita që këto të fundit do të hakmerreshin për -har resën» që u bëja, por për këtë do të shkruaj më poshtë. Fakulteti i Fizikë-Kimisë ishte jashtë ndërtesës së zoologji-drejtësi-rektoratit. Për të arritur nga Fakulteti i Zoologjisë në atë të kimisë, duhej të ngjitje disa sokakë të ngushtë e të lezetshëm sa të dukej sikur ndodheshe në Manalat ose në Dunavatit e sipërm. Por këtu në Monpelje, në këto lagje karakteristike, ngandonjëherë mund të ndodhte të mer r je edhe ndonjë kovë me ujë jo të pastër në kokë nga ndonjë penxhere. Ti mund të bërtisje, të fusje edhe nga ndonjë të sharë studentësh, por s'të përgjigjej njeri. Të mbetej të ngjitje rr ugën i qullur sikur kishte rënë shi.

Kurse kursin e botanikës do ta bënim në një nga vendet më të bukura të qytetit, brenda në Kopshtin botanik (një vepër e krijuar që në shekujt e kaluar e që ishte pasuruar vazhdimisht). Ky kopsht nuk ishte dhe aq i madh, por ishte i rrethuar me mure. r r ugë dhe bulevar de nga të katër anët. Fillonte me pjerrësi dhe mbaronte në një vend të shtr uar. Porta e madhe binte poshtë «Promenade du Peyrou», për të cilën do të flas më vonë. Në të hyr ë, nga e djathta, ishte një bulevard tjetër ; përballë Kopshtit botanik ndodhej një kullë e vjetër shekullore, mbuluar me kurpul dhe me sarmaçe*. *(Biroë hacavarëse.) Atje fillonte fakulteti i famshër në ndër më të vjetër it e më me emër në Evropë, ai i medicinës, ku kishin mësuar e dhënë mësim nxënës dhe doktorë të mëdhenj të Francës, që nga Rabëleja, Klod Bernari. Delmasi e shumë të tjerë. Matanë hyrjes kryesore të Fakultetit të Medicinës, me statuja dijetarësh te porta, pak më poshtë, ngrihej një nga kishat më të vjetra të Monpeljesë.

Rreth e rrotull Fakultetit të Medicinës kishte shtëpi të modës së v jetër, të ulëta, asnjë moderne, shumë pak të lyera me gëlqere o me bojë, me rrugë të ngushta. me parmakë hekuri, jo shumë të pastra dhe që e shihnin pak diellin. Atje dhomat ishin të lira. por i zinin studentët e Fakultetit të Medicinës. Në fund të bulevardit që kalonte në mes të Kopshtit botanik dhe «Ecole de Médecine». ndodhej s pitali i madh, té paktën kështu na dukej ne. Atje venin bënin stazhin *carabins-ët** *(Kështu thirreshin ne zhargonin popullui studentët në mjekësi.) e ardhshëm.

Nga ana e spitalit, Kopshti botanik kishte edhe një hyl je tjetër të madhe. Ai ishte i hapur çdo ditë për publikun né orë të caktuara dhe ne rrugë e né ulicat e tij do të takoje studentë. nxënës. vajza me dashnorët e tyre. mëlna me karroca me kalalnanë. Të gjithë këta vizitorë kishin kufijtë clerit ku mund të kalonin. Atje kishte lule të bl.lkura, pemë të mëdha egzotike, pemë me hije, pemë të rralla, fidanishte. Çdo pemë, çdo fidanishte. çdo grup lulesh, kishte tabelën me emrin latinisht dhe frëngjisht. Ishte e ndaluar të pr ekje me dorë pemën ose lulen dhe né fakt asnjë nuk i

prekte. Kishe të drejtë vetëm ta studioje lulen, t'i merrje emrin, ta vizatoje dhe kaq. Kurse ne, studentët e këtij fakulteti, që kishim leje të posagme, futeshim edhe në vende të ndaluara për të tjerët. Në këtë vend, që ishte i sheshtë, i bukur, kishte pemë të llojllojshme, të gjelbëra dimër e verë, bimë të tjera që zverdheshin e hidhnin gjethet në vjeshtë, kishte bimë e lule në serra të ngrohta në dimër, lule që kultivoheshin direkt në parcela ose në fidanishte. Ne atje jo vetëm shëtisnim lirisht, por bënim edhe orë studimi me profesorin, i cili na shpjegonte bimësinë, barin, lulet, drurët pyjorë, dekorativë, shkurret, pemët, insektet, efektin e ngricave, llojet, familjet, klasifikimet sipas Lineut, sipas Byfonit ose shkencëtarëve dhe teoricienëve të tjerë të shquar botanistë, francezë dhe të huaj.

Mes kaq e kaq gjërash të mira e interesante që shihje te ky Kopsht botanik ishte edhe nderimi që u bëhej atje botanistëve e dijetarëve të tjerë të shquar të bimësisë. Herë pranë ndonjë grupi pemësh, herë në mes parcelave me lule. diku ndanë një rrugice të rrethuar me gjelbërim. diku pranë serrës ose hyrjes së fakultetit. kishin vendosur buste të botanistëve të shquar. që nga ata të shekujve të 16-17-të e gjer te botanistët e mëdhenj të kohës sonë. Përveç bustit në pedestal, mbi një pllakë mermeri. guri ose Inetalike. ishte gdhendur emri i secilit si dhe viti i lindjes e i vdekjes. Duke admiruar bimësinë. pemët e lulet vetvetiu admiroje edhe ala që i kishin kushtuar jetën kësaj fushe të jetës e të shkencës. Jo më ne që ishim studentë të kësaj dege. por edhe vizitorët e thjeshtë që vinin aty, për shëtitje e çlodhje, edhe të dashuruarit. dashur pa dashur. duke parë lulet e pemët, ndaleshin edhe para statujave. bëheshin kuriozë, lexonin në heshtje ose me zë emrat e botanistëve që kishin dhjetëra ose qindra vjet që kishin vdekur dhe, pikërisht kjo gjë, qoftë edhe ky lexim i emrave të tyre, ishte nderim i madh për ta, ishte një nga format e shfaqjes së pavdekësisë. Këtë zakon të mirë e pashë pastaj thuajse në të gjitha fakultetet e tjera të Universitetit të Monpeljesë, ashtu siç e pashë edhe në universitete e shkolla të tjera me emër të Parisit. Kudo evidencoheshin nëpër oborre, para portave, në sallone, ose edhe nëpër mure, një pjesë me statuja (më të shquarit), të tjerë me pllaka përkujtimore, figurat dhe emrat e dijetarëve të mëdhenj që kishin kryer studimet ose kishin qenë profesorë në këtë ose atë fakultet apo shkollë.

Në Kopshtin botanik unë pasurova dijenitë e mia me emrat e farërave, me llojet e tyre, natyrën e shtimit, të kotiledoneve, të monokotiledoneve, me teoritë e Mendelit që hibridizoi varietete të *petits-pois-ve**. *(Bizele.) Atje unë shtova njohuritë e mia mbi lulet dhe emrat e tyre, shumë prej të cilave edhe sot e kësaj dite i di në frëngjisht dhe jo në shqip. Atje mësova të njoh shumë lloj drurësh që rriten në krahina të ndryshme të Francës dhe të vendeve të tjera, veçanërisht nga ato që rriteshin në ish-kolonitë e Francës. që nga Algjeria e deri në Senegal. Sahara e Hoggar. Edhe unë i tregoja profesorit çfarë pemësh, drurësh ose lulësh rriteshin në vendin tonë. Ai i mbante shënim në përgjithësi, por donte deta je der i te madhësia e bishtit dhe e fletës së manushaqes. gjë që nuk isha në gjendje t'la thosha. për arsye se isha djalë qyteti dhe jo fshati. mandej. kuptohet, s'kisha pasur ndonjëherë dëshirë të bëhesha botanist, ndaj ato që s'dija do t'i mësoja për herë të parë tanfi.

Në mes të kësaj zone ishin ndërtesat e Fakultetit të Botanikës, anfiteatri me dritare që binin në kopsht, me sallat e studimit, me sallën e bibliotekës plot me libra, me herbariume lulësh, gjethësh, por edhe me salla plot trungje drunjsh të ndryshëm të prerë si libra. Një vend të veçantë kishin laboratorët me mikr oskope për cilinda nera ne studentët. Ky ishte vendi më i këndshëm, më i lezetshëm dhe më i pasuri me materiale se të gjitha fakultetet e tjera.

Një nera profesorët e këtij fakulteti quhej Batajon, një njeri i qetë, i dashur, i kaluar nera mosha. Ishte një profesor botanike me famë në Francë dhe herë pas here në auditor, kur ai mbante leksione, shihnim njerëz të panjohur, jo vetëm studentë të moshës sonë, por edhe të kaluar nera mosha. Ne mendonim se ishin studentë të mbetur në klasë, që gjenin kohë dhe vinin me vonesë për të dhënë provime. Por s'qenkej kështu. Ata ishin botanistë me diplomë, ishin profesorë liceu ose universiteti që vinin nera vende të ndryshme të Francës për të dëgjuar filan leksion të profesor Batajonit. Këta i shihnim edhe pa u leksionit që mbylleshin disa orë në zyrën e tij. pastaj nuk i shihje më. Iknin në punët e tyre.

Interesante ishin seksionet që u bënë bimëve, bishtit, fletës, lules, farës, pistilit, overit, seksione të imëta, të imëta. Pasi u hidhnim me pipetka të vogla nera një solucion kimik të veçantë, që duhej ta përgatitnim vetë, i vinim këto me delikatesën më të madhe në mikroskop. Dhe atëherë fillonte

studimi i celulave. Evidencoheshin ndarjet e tyre që në mënyrë aq artistike i kishte sajuar natyra, brendia e celulave, kromozomet, protozoaret dhe një botë e bukur, e zmadhuar, e ngjyrosur na dilte përpara syve tanë. Afër mikroskopit kishim kurdoherë një fletë vizatimi, ku qysh më parë kishim vizatuar bimën, lulen o pjesën e saj. së cilës do t'i studionim celulat në mikr oskop. Këto duhej t'i bënim bukur e pastër dhe të shkruanim emrin e çdo pjese përbërëse. Pastaj do të hidhnim në po këtë letër përbërjen dhe konturet ekzakte të celulave që studionim në mikroskop dhe të shkruanim bukur me shkronja të vogla, por të lexueshme mirë, jo vetëm përbërjen e celulës me emrat e çdo pjese, numrin e elementeve që shikoje, format e filamenteve o të kokrrizave që vetëm në mikroskop i dalloje, por edhe funksionet e gjithsecilës, përbërjen e paruave* *(Pareteve) të celulave, si bëhej «osmoza». si përtërihej jeta, ç'transformime bënte poleni që ngjiste në pistil. si kalonte në over dhe metamorfozat që pësonte ajo kokrrizë. derisa arrinte në kotiledonet etj., etj. Ishte një botë e mrekullueshme. që fillova ta dashuroj më shumë se degët e tjera, për të cilat studioja. Degët e tjera më dukeshin më *rëbarbatif**, *(Frëngjisht - të mërziqshme.) prandaj në to nuk pata sukses, sidomos në kiwi.

Amfiteatri i kimisë dhe i fizikës, siq e thashë, ndodhej rubi një «kodër» shtëpish të vogla dhe të vjet,ra, ku shkoheJ përmes rrugicash si të Manalatit. Në amfiteatër dë jonim leksionin e profesor fit të kimisë dhe shikonim të shkruante në dërrasën e madhe të zezë formula që rreshtoheshin herë si vargje poezish, por të pakuptueshme dhe herë merrnin forma të ndryshme gjeometrike, sipas kombinimeve dhe rezultateve të këtyre kombinimeve. Çdo for mulë ose çdo shkronjë e madhe rrallë ndodhte që të nos kishte ndonjë numër në një qoshe të kokës, të cilat më ngjisnin si qeleshja e Riza Bështikës që ma vinte inbi sy dhe kontrollonte gjoja akaciet e xhadesë në Gjirokastër. Por xha Rizai i beledies së qytetit asgjë nuk kuptonte nera akaciet. Edhe unë, të them të dr ejtën, asgjë nuk kuptoja nera këto formula latine, me shifra arabe mbi kokë. Keq ishte. por sidomos kjo lëndë s'më tërhiqte. E kisha të qartë rëndësinë e kimisë, e dija që ishte shumë interesante dhe drejtpërdrejt ose tërthorazi kishte lidhje edhe me lëndët e tjera të shkencave natyrore. por në vend që të merresha me përbërjen ose shpërbërjen kimike të trupave, me ligjësinë e këtvre proceseve kaq interesante, më tërhiqnisi me magnet të tjera probleme, të tjera ligjësi.

Kur vinte puna në laboratorin e kimisë, ishte më ndryshe, ishte, si me thënë, teoria e vënë në praktikë.

Këtu, në praktikë, diçka kuptoja më mirë, por teoria e saj për mua ishte me mjegull. Laboratori i Fakultetit të Kimisë ishte shumë i varfër, lëre pastaj salla e madhe e ftohtë, vetëm me disa banka me lavamanë dhe me një çezmë të ndryshkur nga koha me ujë të ftohtë. Por edhe lavamanët qenë të çarë, të nxirë nga acidet dhe dukeshin sikur kishin që në kohën e Lavuaziesë ose të Gej-Lysakut.

Në këtë laborator një asistent që rrinte afër bankës me epruvetat përpara, të jepte dy-tri prej tyre, sipas praktikës së ditës, të hidhte në cilëndo prej tyre disa lloj acidesh, të jepte një copë letër *tourneol** *(Frëngjisht - lakmus.) dhe vrit veten. Ti zije një *lavabo**, *(Frëngjisht - lavaman.) shihje problemin me formula në dërrasë te zezë dhepërzieje formulat e acidit në epruvetë, provoje ngjyrat që dilnin dhe konkludoje se çfarë lënde ishte. Të them të drejtën qëndronte më thjesht puna kur aneja ngjyroste leshrat për çor apet që na bënte në dimër, ose kur na skuqte vezët me lëng qepe. Ju siguroj për këtë, por nuk është nevoja t'ju siguroj që kjo punë ishte e vështirë për mua.

Bëja përpjekje, por jo edhe shumë, prandaj në këtë lëndë dola shumë dobët.

Më ndryshe ishin zoologjia, leksionet teorike dhe *diseksionet** *(Nga frëngjishtja - ndarje në pjesë përbërëse. Këtu në kuptimin: ndarje dhe analizë metodike e pjesëve të ndryshme të një organizmi.) në laboratorë. Profesorët zoologë na i shoqëronin leksionet edhe me fotografi me ngjyra të kafshëve, të gjymtyrëve, të organeve të tyre. Ata na bënin krahasime me organet e njer ëzve, tregonin ndryshimet e transformimet milenere* *(Nga frëngjishtja - mijëvjeçare.) që kishin ndodhur në kafshët e në organet e ndryshme të trupit, funksionet e tyre etj. Kjo lëndë ishte pasionante.

Laboratori i zoologjisë ishte po ashtu interesant, gjithmonë aty gjeje kafshë të gjalla dhe të ngordhura, të konservuara në fenol. Më kujtohet se në atë kohë profesori ishte një plak me eksperiencë, i çalë, me shkop, që e tubante kurdoherë pranë. Mbante afër edhe një kusi me bretkosa të vogla e të mëdha. Nën mbikëqyrjen e profesor Deruvilit futje dorën dhe peshkoje një bretkosë, të

cilën do t'a sillje më vonë të operuar me mjeshtëri, jo si kasapët e urës së lumit në Gjirokastrë, që thernin deshtë për refene; duhej t'ia paraqitje në një tepsi prej teneqeje me letërën shpjeguese hapur. Ai e këqyrte diseksionin, shihte figurat, të bënte disa pyetje dhe, po të përgjigjeshe mirë, ngrinte shkopin dhe të fuste një të goditur me të në këmbët po të ishte i gjatë, ose në vithe, po të ishte i shkurtër, duke të thënë *c'est bon!**. *(Mirë!) Po qe keq, s'të godiste me shkop. Goditja, pra, ishte mirë, mosgoditja qe shenjë e keqe. Kështu ishte natyra e plakut. Copat e bretkosës i hidhnim në një teneqe të madhe që qelbej fenol. Pyeta një shok:

- Ç'i bëjnë këto?

- I hamë ne, në formë karrote ose *choufleur**, *(Lulelakër.) pse i bëjnë pleh, vieux, - më thotë. - Ti s'ke haber nga bujqësia, kurse babai im është *vigneron**. *(Vreshtar.)

Kur bënim diseksionin e ndonjë qeni o maceje të ngordhur, shoqet studente iknin e na linin terrenin të lirë.

- *C'est le combat sans in firmière**, *(Kjo është betejë pa infermiere.) - thoshte profesori. - *Elles ont déserté le champ de bataille**. *(Ato e kanë lënë fushën e betejës.)

Por se mos neve djemve na vinte qejf përpara një maceje të ngordhur, që i mblidhnin nëpër rrugë rojat e bashkive. Ngandonjëherë laboratorit edhe «*shomonte*»* *(Nga frëngjishtja - mbetej pa punë.), pse si duket *la gent animale** *(Frëngjisht - me ironi: kafsha.) bëhej prurë përpara bisturive të studentëve.

I ndiqja pra diku me zell, diku pa qejf, këto drejtime të shkencave natyror e, për të cilat më ishte dhënë bursa, por dëshira ime nuk ndryshonte nga letërsia, historia dhe gjeografia. Për këtë, herë pas here ndiqja vullnetarisht leksionet në këto degë e sidomos vazhdoja të lexoja me synimin që të zgjeroja kulturën sa më shumë që të ishte e mundur. Natyrisht, një gjë e tillë edhe kohë më hante, edhe nuk më lejonte të përqendrohesh në degën që më ishte caktuar, kështu që vihej në rrezik marrja e të tëra pr ovimeve. Kapërcimi i tyre u bë i çalë, pse, rastiste që kur fitoja me shkrim, rrëzohesh me gojë. Në disa lëndë si në botanikë isha mirë, në zoologji disi, kurse në kimi e fizikë dobët.

Në Francë, leksionet në auditoret e fakulteteve mund të ndiqeshin nga cilido student që dëshironte, edhe sikur të mos ishte regjistruar në to. Bile për qëllime e interesa të ndryshëm, në auditore mund të asistonin dhe njerëz nga jashtë, pa qenë studentë. Kishte mes këtyre edhe nga ata që vinin sa për të kaluar kohën e për të bërë *chahut**. *(Frëngjisht - zhurmë, rrëmujë.) Kjo ngjiste sidomos në Fakultetin e Drejtësisë dhe në atë të Letërsisë. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës nuk vinin thjesht për qejf elementë të jashtëm, sepse mërzhiteshin. Sa për laboratorët e tyre, atje nuk pranonin veçse studentët e degës dhe, para se të hyje në ta, duhej të tregojë librezën.

Unë herë pas here shkoja sidomos në auditorin e drejtësisë dhe dëgjoja leksione të profesorëve mbi të drejtën romake, mbi të drejtën civile, mbi problemet e pronës dhe për një sërë problemesh që m'i rekomandonin shokët shqiptarë që ndiqnin studimet për drejtësi. Në këto amfiteatr-bëheshin edhe «numra». Atje s'kishte as regjistra, as pyeste njeri kush je e nga vjen. Hyje, zije vend, hynte profesori, ca ngriheshin në këmbë, ca jo, ca duartr okitnin. ca fërshellenin, ca i binin bankës. Profesori nuk e prishte gakun, fillonte fliste dhe nuk ndalej sikur nami të bëhej. Në auditor nganjëherë dëgjohej koliitje e sakaduar. po profesor i as që donte t'ia dinte, vazhdonte leksionin. Ndokush, që mërzhitej, dilte, vetëm ose me shokë apo me shoqe, në mes të leksionit. Edhe në raste të tilla profesori s'donte t'ia dinte, ai vazhdonte, ua bënte me dorë adieu atyre që iknin dhe e vetmja gjë që mund t'u thoshte ishte «mos e përpiqni d'rën», dhe kështu vazhdohej derisa mbaronte ora. Dëgjohej sinjali i mbarimit të leksionit dhe atëherë profesori vinte në kokë kapelën speciale me fruda që shkonte me togën e tij dhe dilte. E duartrokiste a s'e duartrokiste njeri, atij aq i bënte. Pyetje, përgjigje, domethënë seminare, si i themi ne tash, atje s'kishte, pra mbetej ç'të mësoje vetë nga librat e profesorëve të lëndës ose të të tjerëve që gjendeshin në bibliotekë.

Në Fakultetin e Letërsisë dhe të Histori-Gjeografisë ishte ndryshe. Atje mund të asistonin edhe studentët të fakulteteve të tjera, por kërkohej librezë. Zakonisht nuk shkonin shumë të jashtëm në këto leksione, sidomos në ato të gjeografisë. Një fjalë popullore franceze thotë se «në ka njeri që nuk e njeh gjeografinë është francezi».

Unë ndiqja me qejf e me kujdes leksione dhe konferenca mbi letërsinë, filozofinë dhe mbi historinë. Sido që nuk mësoja për t'i dhënë provim, i dëgjoja me vëmendje leksionet në këto degë, i kuptoja dhe mund të them me bindje, pa qenë nevoja të fitoja diplomë, mora njohuri kulturore të gjera dhe të vlefshme mbi zhvillimin e kulturës botërore dhe veçanërisht të asaj franceze dhe mbi epokat e ndryshme të historisë së Francës dhe të botës. Këto dijeni, që i ndiqja me vullnetin tim, por që më hanin kohën e nevojshme për shkencat e natyrës, ku më kishte caktuar Ministria e Arsimit, më ndihmuan shumë si atëherë, por sidomos në jetën time revolucionare.

Analizat që u bëheshin epokave të ndryshme, ngjarjeve, autorëve, kryengritjeve, ideve, programeve e në tërësi filozofisë së tyre, qoftë në Fakultetin e Letërsisë, qoftë në atë të Historisë, kishin karakterin borgjez, por shumë herë këto analiza ishin progresiste. Flitej realisht dhe nuk shtrembërohej karakteri i letërsisë klasike, i epokës iluministe dhe revolucionare, as i epokës romantike, parnasiane ose i korrenteve të ndryshme, si ato të Rembosë, Malarmesë, Fransit, Zhidit etj.

Në filozofi, qoftë në atë francezen, qoftë në anglezen apo gjermanen, dominonin pikëpamjet metafizike, idealiste. Marksi dhe marksizmi ose injoroheshin përpara Fihthes, Klopshtokut, Dyrkajmit, Hegelit, Niçes, Bergsonit e të tjerë, ose analizoheshin fare pak dhe në mënyrë për Vi luftuar. Por në grupe studentësh çështja e marksizmit shtrohej ndryshe. Në diskutime, në konferenca, në mitingje dhe në kafene e klube punëtorësh, shkonim e dëgjonim të flitnin oratorë, komunistë dhe punëtorë në debate me njerëz që e kundërshtonin marksizmin. Të tilla mbledhje debatesh e polemikash ishin nga më interesantet, pse atje të gjithë mund të pyetnin, të diskutonin, të duartrokitnin, të fërshëllenin, të pinin birra ose verë në tymin e cigareve si mjegull e dendur. Ngandonjëherë kam asistuar kur ndërhynte dhe policia, pse lëvonin grushtet. Policia kërkonte pasaportat, i fuste në automobila ata që ziheshin dhe i çonte drejt e në postë, prandaj ne sa herë shkonim në aktivitete të tilla jashtë universitetit i mbanim kurdoherë në xhep pasaportën dhe librezën e studentit.

Policia ndërhynte në lokale të ndryshme, por në universitete jo, se ishte e ndaluar me ligj. Vetëm kur ngjiste ndonjë krim i rëndë, dhe me lejen e rektorit, mund të hynin autoritetet e drejtësisë për hetime, kurse për manifestime, rrahje, konferenca që zhvilloheshin brenda universitetit policia s'mund të ndërhynte. Ndodhnin edhe raste të tilla: kur në rrugë zhvillohej ndonjë ndeshje në mes policisë dhe studentëve, pasi rriheshin mirë e mirë, studentët mbylleshin në oborret e universitetit, kurse policia e gjakosur i bënte studentët sehir nga jashtë. Nuk kishte ç'u bënte, se brenda s'hynte dot.

Tekstet shkollore detyroheshim t'i blinin me të hollat tona, gjë që na e vështirësonte buxhetin tonë të varfër. Unë frekuentoja dy biblioteka dhe nuk mbaj mend të kishte të tjera gjithë ai qytet universitar. Njëra ishte biblioteka e universitetit, brenda në ndërtesën e tij. Tjetra ishte biblioteka municipale, e cila binte në një bulevard që lidhte «Vezën» me lagjen e poshtme të qytetit. Ky bulevard i gjatë formonte edhe njëfarë unaze, pse dilte pranë spitalit, ngjiste avenynë në mes Kopshtit botanik dhe «Ecole de Médecine», dilte në «Promenade du Peyrou», kalonte «Harkun e Triumfit», ngritur për nder të Luigjit të 14-të, zbriste avenynë «Foch», «Rue de la Loge» dhe dilte në «Vezë».

Pra, në këtë unazë përballë «Esplanadës» ndodhej biblioteka municipale, një ndërtesë e stilit të shekullit të 19-të, me portë të madhe hekuri, me një shkallë të gjerë, të madhe, me parmakë me hekura të farkëtuar bukur nga artizanë vendës. Nga porta e madhe hyje në një paradhomë me mure plot me libra të mbyllur në dollapë xhami, prej andej futeshe në sallën e leximit që ishte plot me tryeza me njerëz dhe ku vazhdimisht kishte qetësi. Në mes të saj ishte një sher* *(Nga frëngjishtja - katedër.) si në fakultetet, ku rrinte një erudit dhe lexonte. Në fund të sallës ndodheshin bibliotekarët. Ai që kërkonte një libër, shkruante titullin e tij që e gjente më parë në skedarë të veçantë dhe ia jepte njerit prej bibliotekarëve. Kërkesa firmosej dhe lihej te bibliotekari bashkë me librezën e studentit. Pasi gjendej libri studenti e merrte, zinte vend me qetësi në sallë dhe fillonte leximin. Në qoftë se ndonjëri donte ndonjë shpjegim, atëherë ngrihej dhe pyeste eruditin. Në qoftë se ai kishte mundësi të ta shpjegonte pyetjen, e bënte këtë aty për aty, në të kundërtën të shkruante emrin e një

profesori dhe të tregonte një derë në krah të sallës dhe të thoshte drejtohu te ky profesor! Hyje në një sallon, ku gjeje profesorin, i cili të jepte shpjegimet që kërkoje. Këtë bibliotekë do ta mbaj mend si më të rregulltën, më të qetën, me profesorë xhentilë, të ditur e që të ndihmonin.

Atje shkonim shumë shpesh me Sotir Angjelin, një shoku im shumë i mirë, i qetë, i ndershëm dhe studioz. Shkencat natyrore i kishte shumë qejf, po për të tjera gjëra nuk interesohej. Edhe lajmet e gazetave ia tregoja ose ia komentoja unë. Tamam «njeri i shkencave ekzakte», siç mendonim atëherë, sepse në fakt nëse njeriut të shkencave shoqërore i duhet një kulturë sado e përgjithshme për shkencat e natyrës, ca më tepër njeriu i shkencave ekzakte duhet të ketë një kulturë të mjaftueshme edhe në shkencat shoqërore, politike etj. Sotiri dhe unë kishim qenë në një klasë në lice, tok e mbaruam, tok shkuam në Monpelje, ku shoqëria jonë u shtua. U kthyem në kohë të ndryshme në atdhe dhe, pak a shumë, me drejtime të ndryshme në jetë. Ai u bë profesor nga më të mirët në gjimnazin e Tiranës. unë fillimisht u bëra mësues në Tiranë e në Korçë. Filloi lufta, unë u hodha në luftë. Sotiri s'doli, megjithatë qëndroi me popullin, i ndershëm, i thjeshtë, antifashist. Pas Çlirimit u bë pedagog nga më të mirët e Universitetit të Tiranës. Ishte aq i thjeshtë e i druajtur, sa asnjëherë s'kërkoi jo ndonjë gjë nga unë, por as të piqej. Dy-tri herë e kërkova vetë, erdhi, u puthëm, u përqaftuam. E pyeta, i kërkova mendime për zhvillimin e mëtejshëm të universitetit, u interesova shumë kur u prek nga një sëmundje e rëndë dhe u pikëllova kur më lajmëruan vdekjen e tij të parakohshme. Por fjalën e kishim në vitet kur së bashku ishim studentë në 11 Monpelje. Atëherë ai banonte në një dhomë afër bibliotekës municipale. Unë shkoja më parë në dhomën e tij, pastaj shkonim së toku në bibliotekë.

Rrinim shpesh bashkë, i huanim njëri-tjetrit edhe lekun e fundit, mësonim së toku, së toku morëm edhe nja pesë a gjashtë herë mësimë dansi! Ishte i shkurtër nga trupi dhe qeshnim kur i takonte të mësonte me ndonjë vajzë të gjatë.

Një herë na ndodhi një histori, histori për të qeshur në fillim, por e hidhur në mbarim. Është e thjeshtë si ngjarje, por edhe në thjeshtësinë e saj tregon arrogancën dhe egërsinë e policisë franceze dhe arbitraritetin e gjyqeve borgjeze.

Vendosëm me Sotirin të shkonim në teatrin municipal për të parë pjesën «Les cloches de Corneville»*. *(«Këmbanat e Kornëvilit», operetë me tri akte e R. Planketit.) Ishte e para herë në jetën tonë që shkonim në opera. Hymë në ndërtesë dhe po shihnim me kureshtje shkallët në for më potkoi. mur et me pasqyra, dyshtemenë të shtruar me qilima të kuq. kolltukët me kadife të kuqe etj., sipas tipit të teatrove të shekullit të 19-të. Mbaroi akti i parë dhe dolëm në pushim në një sallon të madh, në fuaje*. *(Vend pushimi në teatër ku zakonisht pihet duhan e pije.) Ndezëm të dy nga një cigare dhe vinim rrotull duke parë tablotë dhe ornamentet e mureve. Na tërhoqi vëmendjen fakti që plot njerëz shikonin nga ne.

- Ç'kanë që na shikojnë, ti je dhe shkurtabiq! - i thashë Sotirit gjysmë me të qeshur, gjysmë i shqetësuar nga tërë ajo vëmendje që po na kushtohej.

- Ç'ke me ta, - m'u për gjigj Sotiri. - kanë qejf të na shohin, le të shikojnë!

Por, pa mbaruar ai fjalën, na doli një polic përpara dhe na tha:

- Shuani cigaret, nuk e dini që në fuaje nuk pihet duhan?

Unë e hodha cigar en dhe e shova, Sotiri u vonua dhe i tha policit:

- Ça va, ça va! - domethënë gati me indiferencë «mirë, mirë».

Polici e mori si ofezë dhe i tha Sotir it:

- Më jep pak pasaportën!

Nxori bllokun dhe i mori emrin, rrugën dhe profesionin. Kundërvajtje. Ndërhyra unë dhe i thashë:

- Zoti polic, na e falni, është hera e parë që vijmë në këtë teatër dhe nuk i dimë rregullat!

- Nuk ofendohet policia franceze, si bëri ky individ, - m'u për gjigj ai duke më shikuar egër.

Kërceu Sotiri e i tha policit:

- Nuk është e vërtetë që ju ofendova!

- Ta tregoj unë nëse më ofendove apo jo, - ia ktheu polici. Dhe iku.

- *Mort aux vaches!** *(Këtu në kuptimin: poshtë policët!) - i thashë Sotirit, për t'i dhënë zemër, se m'u kujtua sharja që i bëri policit Krekëbili në novelën e famshme të Anatol Fransit.

Ne e harruam fare këtë incident, por pas 10 ditësh Sotirit i erdhi një njoftim që të paraqitej në gjyq se kishte ofenduar një polic. Të poshtrit! Iu vumë punës të dy dhe përgatitëm mbrojtjen, nja tri fletë të daktilografuara. Ditën e caktuar, Sotiri me mbrojtjen në xhep dhe unë si dëshmitar, po të më pranonin, shkua në sallën e gjyqit. Salloni para sallës së gjyqit ishte plot, sigurisht të paditur si Sotiri. Në sallën e gjyqit thërritnin me emër. Erdhi radha, thirrën emrin e Sotirit dhe ne u ngritëm të dy që të hynim. Njëri prej gjyqtarëve pyeti:

- Kush është Sotir Angjeli?

- Unë! - iu përgjigj Sotiri.

- Po ti?! - m'u kthye mua. - Prit radhën!

- Jam dëshmitar i tij! - u përpoqa ta sqaroja.

- *Fous le camps!* *(Përfjashta, shporru!) Çfarë dëshmitari! - tha ai dulce më vështruar vëngër e më tregoi me gisht derën.

Pas pesë minutash doli Sotiri. Gjyq ekspeditiv. E pyeta:

- Si u bë?

- Më pyeti gjykatësi për identitetin, - nisi të më tregojë Sotiri. - Më tha se ke ofenduar filan polic. Unë nxora nga xhepi fletët dhe, sa fillova të lexoja fjalën e parë, gjykatësi më pyeti:

«Ç'e ke atë?»

«-'Vbrojtjen time», - iu përgjigja.

«Fute në xhepin nga e nxore, pse nuk kemi kohë të dëgjojmë përrallat e tua. Pesë franga gjobë! - dhe bërtiti: *au suivant!*». *(Të vijë tjetri.) Ja, ky qe gjyqi! - e mbylli tregimin Sotiri e pastaj, si duket i prekur që s'i kishin dëgjuar mbrojtjen, u bë trim:

- Pesë franga gjobë! Sa na munduan deri këtu! Do të vete prapë në teatër, do të nderz prapë cigare dhe do t'ia punoj prapë po atij polici!

Mirëpo dardha e kishte bishtin prapa. Pas disa ditësh një polic i trokiti në derë Sotirit dhe i nderi faturën e gjyqit 100 franga! Vërtet gjoba ishte 5 franga, por 95 të tjera qenë shpenzime gjyqi e detyrime të tjera, dhe në rast se s'i paguante, do të shkonte në burg! I ziu Sotir u detyrua të paguante qindëshen, e përse? Pse i tha një polici: «Mirë, mirë, do ta shuaj!».

Ne ishim pajtuar dhe hanim bukë, drekë e darkë, në një restorant në rrugën që të çonte në stacion, «Rue Maguelone», në qoftë se s'gabohem. Ishte një restorant i vogël, i gjatë, i thjeshtë dhe me nja 8 tryeza për 4 veta në secilën, me një rrugicë të vogël në mes. Vetëm një garson na vinte rrotull të gjithëve. Pronari ishte një burrë shumë i mirë, i urtë dhe i ndershëm. Përpiqej të na kënaqte dhe ne e paguanim në rregull, me të marrë bursën. Bëheshim rreth katër a pesë shqiptarë, Eqrem Hadoja, Sotiri, Abaz Xhomoja, unë dhe ndonjë tjetër që hanim bukë në atë restorant. Veç nesh, shqiptarëve, atje kishte klientë edhe studentë sirianë, irakianë, nga Arabia Saudite. Emrat e disave i mbaj mend, Nesim, Kamel, Ahmed, Teufik, Fuad, Namik e të tjerë. Kishte edhe nga Libani e Palestina. Ishim si në familje në këtë restorant, shokë të ngushtë me njëri-tjetrin në universitet dhe jashtë. Përveç nesh, studentëve, atje rrallë e tek vinte ndonjë udhëtar që donte të hante lehtë dhe lirë. Me studentët e huaj shpesh shkonim tok në kafe, bënim nga një *belotte** *(Një lloj loje me letra.) dhe, kur s'kishim pare, na i paguanin ata të hollat e kafesë, kur s'kishin ata, por kjo ngjiste rrallë (se ata merrnin pare shumë, gati dy herë më shumë nga ne), i paguanim ne. Ata ishin njerëz të dashur, të drejtë e të thjeshtë, pavarësisht se mund të ishin bij tregtarësh ose pronarë tokash. Atyre u vinin nga Libani, nga Siria, nga Arabia Saudite arka të tëra me portokalle, fiq çepellë dhe hurma arabie në palco. Kurrë nuk na linin pa na dhënë gjithsecilit nga një pako hurma, nga një pako fiq çepellë ose nga ato portokallet e mëdha të Palestinës e të Libanit. Ne njiheshim edhe me studentë egjiptianë, algjerianë e të tjera kombësi arabe, por me ta nuk na hahej dhe aq muhabeti dhe nuk shoqëroheshim aq shumë. S'dihet ç'u bënë ata njerëz, ç'rrugë morën, ç'ideologji përfaquan!

Francezët zakonisht nuk pinë ujë, pinë verë, *du pinard*, si i thonë, kurse ne, shqipot, pinim ujë dhe jo verë. Vetëm kur na vinte bursa pinim nga një shishe verë, qerasnim edhe padronin, edhe garsonin. Francezët hanë pak ose aspak bukë, por hanë gjellë mirë dhe pinë verë e birra, kështu që

kaloritë i ngjitnin deri edhe në 4 000. Kurse ne, shqipot, hanim shumë bukë dhe s'bëheshim shumë merak për gjellë. Ustai i restorantit na i kishte njohur zakonet dhe i rregullonte proporcionet.

Kurdoherë në drekë ne qeshnim me garsonin që e kishim bërë si shokun tonë. Ai, para se të venim për drekë, i shtronte trapezat, në mes tyre vinte një pjatë plot me thela buke të bardhë (buka ishte llogaritur në pagën mujore, por mund të haje sa të doje), à discrétion*, *(Pa karar) si thoshin francezët. Me t'u ulur, na vinte Fransuai, garsoni, dhe na pyeste ç'gjellë donim dhe, sa vente ai në kuzhinë të merrte gjellët, buka ishte zhdukur nga pjata. Kur na vinte gjellët përpara, ne e nduknim nga xhaketa e bardhë dhe i thoshim:

- Fransua, ti je dhe i ri, pse të ka lënë kujtesa, ke harruar të na vësh bukë !!

Ai, duke qeshur, thoshte:

- Po këtu te kjo pjata e mesit ç'kishte, gështenja?
- dhe shkonte na sillte përsëri një piring me bukë.

Tërë kohën që qëndrova në Monpelje hëngra te ky restorant i vogël; nuk më ikej dhe nuk kishte arsye, sepse nuk hanim keq, padroni edhe na kreditonte, se ngandonjëherë bursat na vinin me dy ose tre muaj vonesë. Ishte koha kur në Shqipëri rrogat e nëpunësve merreshin pas pesë ose edhe tetë muajsh. Ne i thyenim o i shkëmbenim çeqet te një bankë e vogël që na mbante 10-15 franga në 000 franga.

Në teatër vetëm dy-tri herë shkova, por edhe shumë shokë të tjerë si unë nuk shkonin më dendur se bileta kushtonte, kurse në kinema shkonim kurdoherë që kishte film të ri. Vetëm tri kinema kishte gjithë ai qytet, të paktën kaq dija unë dhe ato ishin të gjitha në qendër. Njëra ishte më e madhja dhe bileta në të ishte ca më shtrenjtë. Ne këtu, natyrisht, blinim bileta në radhët e para, kurse dy të tjerat, të ndodhura po në një rrugë, ishin më të lira, më popullore. Për këto të dyja nganjëherë shokët na gjenin edhe nga një kartë speciale, që i jepnin magazinat, me të cilat të bëhej një zbritje 50 për qind, por vetëm në ditën e dytë o të pestë të filmit dhe në orët e para të pasdrekes, kur nuk kishte shumë njerëz. Kinematë në Monpelje ishin kur doherë plot, por preferoheshin seancat e orës 8 të mbrëmjes. Kur dilnim nga kinemaja, ata që kishin të holla shkonin në restorante që bënin gjellë speciale dhe hanin darkë, kurse ne, studentët e varfër, bënim një xhiro në këmbë dhe ktheheshim në shtëpi.

Futbollin herë e ndiqja, herë jo. Edhe kur shkoja, biletën ma jepte një futbollist hungarez që luante në ekipin e Monpeljesë si qendërsulmues. Ishte nga lojtarët më të mirë të këtij ekipi dhe e quanin Pishta. Ai rrinte po në atë ndërtesë që rrija dhe unë. U njohëm, u miqësua dhe, kur kishte ndeshje futbollit, nuk mungonte të më mbyllte një biletë në një zarf, të cilën ia jepte klubi dhe ai e hidhte në kutinë time të postës në fund të shkallës. Kurrë nuk e harronte këtë Pishta. Tifoz nuk isha, por doja të fitonte Monpeljeja dhe kur golat i shënonte Pishta, dhe ai shënonte shpesh, kënaqësia ime ishte e madhe.

Kur ngrohej koha, domethënë në qer shor, para se të ktheheshim për pushime në Shqipëri, të dielat kur ishte kohë e mirë, shkonim me shokë në plazhin e Palavasit. Plazhi nuk ishte shumë larg Monpeljesë, ndonja treçerek ore larg. Ky plazh i vogël lidhej me qytetin me një tren të vogël, të vjetër, që nuk ecte veçse ndonja 20-25 km në orë. Si breshkë kalonte ai qytetin, dilte ca në fushë, në disa fshatra të vogla, pastaj arrihe në Palavas, stacioni i të cilit i ngjiste një hauri me teneqe mbuluar, sa për të futur kokën kur binte shi. Rëra atje nuk ishte e keqe, po sa larg rërës së artë të plazheve tona që deri atëherë nuk i kisha parë kurrë me sy. Në Vlorë dhe në qytetin e Durrësit kisha shkuar kur isha nxënës, po në plazh jo. Rreth plazhit të Palavasit kishte disa vila të vogla, po aq të vogla sa dhe ato që kishin ndërtuar në plazhin e Durrësit tregtarët tiranas. Vetëm se në Palavas kishte një kazino, dhe poshtë ndërtesës së saj ishte një pistë dansi, ku shkonim pasi laheshim, pinim një arançatë dhe kërcenim derisa vinte ora e trenit, pse nuk kishe ku të flije. Edhe po të kishe të holla, s'kishte hotel. Palavasi ndahej në dy rrugë. Në mes të të dyja këtyre ishte një kanal ndonjë metër e gjysmë i gjerë, që mbushej me ujë nga deti dhe ku futeshin varkat e peshkimit dhe ndonjë varkë e bojatisur. Atje u futa për herë të parë në ujë, natyrisht pllajq-plluq me shokët, si patat, se nuk dinim not, prandaj dhe nuk largoheshim nga bregu. Ne futeshim në ujë derisa na zinte këmba tokë dhe shpejt ktheheshim, se kishim frikë mos mbyteshim. Vitin e dytë mësuam sa të qëndronim ca mbi

újë. Por per bela, mbaj mend që një ditë, kur kishte dallgë, dola një çikë nga kufiri dhe megjithëse u përpoqa të dilja, uji më tërhiqte drejt thellësisë. Ia bëra me dorë një shoku francez që ndodhej në breg dhe ai erdhi më dha dorën.

Stacioni i Palavasit në Monpelje ishte një ndërtesë e vogël, po e lezetshme, në të hyrë të «Esplanadës», një shëtitore ose park i bukur që e kam përmendur. Atje kishte një *allée** *(Rrugë me gjelbërim.) me pemë, me frona. Në të dy krahët e saj kishte rrugë sekondare. Atje studentë, popull, dashnorë, gra me karroca me kalamanë bënin shëtitje, dimër-verë e vjeshtë. «Esplanade» dhe «Promenade du Peyrou», ishin të vetmet parqe të bukura të qytetit, por parqe pa lule shumë, me bushe të vogla dhe me pemë të larta. Sidoqoftë të dyja këto ishin vendet e preferuara të qytetarëve. Studentët, pasi bënin dy-tri xhiro mbi «Vezë», kalonin në «Esplanade» që ishte jo shumë larg. Këtu, në pranverë o në të hyrë të verës, bëhej nga një panair. Në njërin anë të *allée*-së së gjerë ngriheshin baraka prej dërrase, që zbukuroheshin me reklama me drita dhe ku shiteshin ëmbëlsira, lodra, prodhime të vogla artizanati. Kishte edhe nga ndonjë stendë ku mund të qëlloje për të fituar ndonjë top, ndonjë shishe pije etj. Ne qëllonim dhe shquheshim, nuk dilnim bosh, pa ndonjë shishe verë ose pako me biskota apo me karamelle. Çdo stendë kishte muzikën e vet, radion ose disqet e veta të gramafonit, të cilat buçitnin në të njëjtën kohë secila për hesap të vet. Kjo na dukej në atë kohë një gjë e bukur, por sidoqoftë krijohesh një kakofoni e zallamahi që ç'ke me të! Megjithatë shëtitnim me qejf në mes të dritave, në mes njerëzve, shikonim stendat e zbukuruara, dëgjonim këngët e filmave të ripërsëritura në disqe, qeshnim e bënim edhe ndonjë shaka. Kjo, në qoftë se nuk gabohem, vazhdonte nga dy javë dhe si për qytetin ashtu edhe për ne, studentët, ishte një eveniment.

Në krye të «Esplanadës», ishte një mur që e kufizonte, prej nga zbrisje po të doje, nëpër një shkallë të gjatë të gurtë dhe dilje në një tjetër rrugë buzë një përroi që quhej «Verdanson». E kam fiksuar këtë, sepse prej këtej kalonim në një ulicë ku, në dhomën e një shtëpie banonte në atë kohë një nga shokët e mi të vjetër të liceut, Shefqet Shkupi nga Kosova. Ky ishte një shok i mirë, i urtë, i ndershëm, më i madh nga unë në moshë. Më hahej muhabeti shumë me të. Ai bënte ç'bënte dhe me mijëra herë në ditë ngrinte syzet që i vareshin.

- Ngriji syzet Shefqet, - i thosha, - se të ranë dhe s'ke më me se t'i blesh!

Çdo gjë në atë kohë, sidomos për ne studentët ishte e shtrenjtë, por, për fat të mirë, ishim të rinj dhe as e pamë dhe as na pa ndonjë doktor me pare. Edhe kur na dhimbte koka vinin na shikonin shokë francezë si Rukoti, ose greku Thanos që studionin për mjekësi. Shefqeti studionte për drejtësi dhe, kur u kthye në Shqipëri, u emërua gjykatës. Nuk mori pjesë në luftë, por qëndroi me popullin dhe derisa doli në pension, punoi në gjykatën e Vlorës. Më uron ngahera me telegrame për ditëlindje.

Nga shkalla e gurtë e «Esplanadës» shkonim, gjithashtu, në këmbë nëpër fushë për të arritur buzë një lumi o gjoli të vogël. Buzë ujit ndodhej një shtëpi-kafe me një gramafon, atje kishte dhe varka me lopata. Ne, dy-tre shokë, merrnim me qira një varkë dhe bënim disa xhiro duke vozitur.

Këto ishin «dëfrimet dhe zbavitjet» tona në Monpelje. Me rëndësi ishte dhe «la Promenade du Peyrou», ndërtuar në shekullin e 17-të nga Daviler. Kjo shëtitore ishte me të vërtetë e bukur, plot hijeshi dhe gusto, me mure të bardha të ndërtuara me një gur të bukur, me portë të madhe me kangjella të hekurta të qëndisura bukur nga artizanët. Allée-ja e mesit ishte kryesorja, në mes saj ishte statuja e Luigjit të 14-të mbi një pedestal të madh. Skulptori që e kishte bërë këtë vepër, sipas thënieve të studentëve, pati vrarë veten pas inaugurimit, sepse kishte harruar t'i vinte yzengjitë kalit dhe mbretit i vareshin këmbët si Sanço Pançës.

Në krye të «Pejrusë» ngrihej si karakoll një monument shumë i bukur plot graciozitet, ku ngjiteshe nëpër shkallë me gurë të bardhë dhe monumentalë. Ishte një *château d'eau*, depo uji në ato kohë. Uji aty vinte nëpërmjet një ujësjellësi të bukur, të gjatë, rreth 800-900 metra, me gurë të bardhë, me dy kate arkadash, i ndërtuar disa shekuj më parë nga njerëz që dukej se ishin mjeshtër për ndërtime të tilla, të cilat, ashtu si në Monpelje i gjen edhe në të tjera vende të Langëdokut, si në Setë, Nimë etj. Le *château d'eau* dhe ujësjellësi formonin një ansambël të bukur në këtë shëtitore të mbushur me rrape të mëdha shekullore. Rrape të tilla kishte si në shëtitorën e madhe, ashtu edhe në të dyja anët e rrugës që zbriste poshtë.

Në «Pejru» jo vetëm shëtitnim, por shkonim edhe për të studiuar nën hijen e pemëve dhe buzë lulishteve të rrethuara me kangjella të ulëta artistike.

Nga Fakulteti i Medicinës, duke kaluar përmes «Tour des Pins», portës së madhe të «Pejrusë» e rrugëve që të nxirrnin te «Harku i Triumfit», çdo vit, kur nisnin mësimet në fakultete, fillonte i famshmi «monomi»* *(Varg studentësh të mbajtur njëri pas tjetrit nga supet dhe që shëtitin nëpër rrugë.) i studentëve. Ishte një manifestini gazmor, i çuditshëm, plot këngë, kërcime, orkestra, fërshëllima, këngë të vjetra tradicionale, këngë të revolucionit borgjez, si «Ça ira, ça ira, les aristos à la lanterne»*, *(«Kështu do të bëhet, kështu do të bëhet; Aristokratët do t'i varim».) këngë grivoises* *(Këngë bujtinash, mejhanesh.) të studentëve plot humor e kripë, plot sharje drejtuar policëve dhe autoriteteve. Kakofonia gazmore që mbushte avenynë «Foch», zbriste në «Rue de la Loge» dhe korteu atje ndalej në shtëpinë e Rolidélesë ku kishte qëndruar Rabëleja, figurë dhe emër i madh për shkollën e medicinës së qytetit. Nga «Rue de la Loge» monomi shpërthente në «Sheshin e Kornedisë» dhe atje fillonin kërcimet, farandolat, akrobacitë. Lustikët* *(Nga frëngjishtja - shakatar, njeri që bën farsa.) ngjiteshin te monumenti «Les trois grâces» dhe kush i përqafoje, kush i puthte e të tjera biçimllëqe. Kjo vazhdonte deri vonë. Policia asgjekundi nuk ndërhynte. Ky manifestini ishte si një traditë shekullore e shenjtë e studentëve. Studentët e viteve të lama thoshin se monomin e organizonin për *les bleus*, domethënë për studentët e vitit të parë, për t'i njohur me traditën dhe për t'i inkurajuar.

Në këtë qytet të vjetër universitar kishin lindur e kishin mësuar filozofi Ogyste Kont, themelues i pozitivizmit, Kambaseresi, legjislator i Napoleonit, një nga redaktorët kryesorë të Kodit civil të Francës, poeti Valeri që kishte lindur në Setë, ku dhe ishte takuar për herë të parë me Andre Zhidin e të tjerë shkrimtarë të shquar.

Më pëlqente shumë piktura, prandaj shumë herë vizitoja muzeun «Fabrë», që e kishte marrë emrin në nderim të piktorit monpelerian të shekullit të kaluar Fransua Ksavier Fabrë. Kishte në këtë muze tablo të ndritura. Isha i dashuruar pas Kamil Korosë, për koloritin e tij aq të shkëlqyeshëm, për stilin e tij të thjeshtë, të pastër e plot ndjenjë si në peizazhet edhe në portretet. Më pëlqenin tablotë aq të ngrohta të Gystav Kurbesë, për fushat me mullarë sane të thatë e me hije, që të dukej sikur merrje erën e barit të fushave, me gra punëtore fshati. Më pëlqente shumë tabloja realiste e Kurbesë, ku mecenin i heq kapelën piktorit, duke i thënë «*bonjour, Monsieur Courbet*». I admiroja veprat e këtij piktori realist edhe se ato ishin vërtet shumë të bukura, por edhe për faktin se Kurbeja ishte një revolucionar që u ndoq e u internua nga qeveria reaksionare e Tierit si luftëtar pjesëmarrës me Komunën e Parisit. I këqyrja me qejf tablotë e tij të ndritura «*Les baigneuses*» dhe «*Baudelaire*».

Në këtë muze kishte shumë skulptura dhe tablo me famë si «*Les femmes d'Alger*» e Delakruasë. Atje kishte tablo të piktorëve holandezë dhe të shkollës flamande, kishte buste të Hudonit, autorit të famshëm të bustit të njohur të Volterit.

Kudo dhe kurdoherë që hapeshin në Monpelje ekspozita pikturash dhe skulpturash une shkoja dhe mësoja prej tyre, më hapej horizonti, ato më zhvillonin ndjenjat dhe më ndihmonin të kuptoja dhe të shijoja më mire jetën shoqërore dhe kulturore të një populli me aq kulturë të gjerë e të shumanshme. Një herë vizitova vestizhet* *(Nga frëngjishtja - rrënojat.) e Magëlonit shkatërruar nga frankët e Charl Martelit. Qëndroja mbi rrënojat buzë detit, në jug të Monpeljesë, qytet i rëndësishëm i mesjetës, i ngritur mbi rrënojat e një katedraleje të lashtë dhe me këtë rast përpiquesha të përfytyroja e të kuptoja luftërat e Charl Martelit, të Pepën lë Brefit, ndalesën e sarasinëve e me radhë të tjera histori të mesj, tës franceze. Po ashtu vizitova dhe Eg-Mort, qytezë-port e mesjetës së hershme rrethuar me mure nga të gjitha anët. Prej këndeje, në qoftë se nuk gabohem, u nis mbreti i Francës Sen-Lui për në Egjipt e Tuniz dhe u zu rob nga arabët në një nga ekspeditat e tij.

Vizitova në një ditë e një nate Nimën, vendlindje e Alfons Dodesë, «Shtëpinë katrore» dhe «Arenat», të dyja vepra të romakëve, okupatorë të Galisë. Këto janë dy monumente të mbajtura shumë mirë. Në «Arenat» pashë një shfaqje toreadorësh me *mise à mort** *(Therje, vrasje.). Ishte hera e parë që shikoja me sy një ndeshje të tillë dhe për këtë më nxiti leximi i një romani të ri, «*Arènes sanglantes*»*. *(«Arenat e përgjakshme», vepër e shkrimtarit spanjoll Blasko Ibanjez).

Mua më interesonte shumë letërsia dhe shpenzoja për të një pjesë të bursës. Përpiqesha të lexoja romane që kritika i quante progresiste, kurse klasikët e mëdhenj të letërsisë i këndoja dhe i rikëndoja në bibliotekën e universitetit. Atje gjeje dhe literaturën e re. Blija çdo dite gazetën e Partisë Komuniste Franceze «L'Humanité» dhe çdo javë «Le Canard enchaîné». Gazetat e tjera i lexoja në kafe dhe këto ishin «La dépêche de Toulouse», «Le Temps» etj. Në organet e tjera të shtypit, që Franca i kishte me shumicë, të të gjitha llojeve, rrymave, krahinave, degëve të ekonomisë etj., u hidhja nga një sy lajmeve të shkurtra të politikës së jashtme ose ndonjë ngjarjeje sensacionale të brendshme. Blija ngandonjëherë dhe «Les nouvelles littéraires» që ditte një herë në javë, por ishte gazetë më e shtrenjtë.

Kishte në Monpelje dhe një librari që jepte me qira libra për të lexuar me çmime shumë të lira, me kusht që librin ta mbaje mire. Kujdesin për mirëmbajtjen e librave une e kisha dhe vazhdoj ta kem kurdoherë të theksuar. Kam në bibliotekën time libra të vjetër e të rinj, që i kam shkuar dhe i shkoj shumë herë në duar, e megjithatë ata janë të mirëmbajtur, si të papërdorur, vetëm se koha disave prej tyre u ka zbehur ngjyrën.

Në këtë drejtim, nga leximet, përfitova shumë. Gjykoja më me pjekuri për moshën time evenilnentet e rëndësishme ndërkombëtare, kuptoja egërsinë dhe shtypjen që borgjezia kapitaliste u bënte proletariatit e popujve. U ndodha në Francë kur Hitleri mori fuqinë në Gjermani. Ishin momente të rënda edhe për ne, studentët në Francë. Ndiqnim shtypin dhe gjykonim se fashizmi italian dhe nazizmi gjerman po armatoseshin, po përgatitnin luftën, pa provokonin. Ligat fashiste franceze po ngrinin krye, qeveritë e asaj kohe i financonin, i ndihmonin, i nxitnin kundër Partisë Komuniste Franceze dhe elemen tëve progresistë. Në shtyp dukeshin hiletë dhe qëllimet e pseudoqeverive demokrate franceze, të Anglisë dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ishin daulle pa të kremte atë që deklaronte kryeministri i atëhershëm i Francës, Albert Saro, se «ne nuk do të lejojmë që Str asbur gu të ndodhet nën kërcënimin e forcave gjermane», kur Hitleri okupoi pa çak, pa bamb Renaninë dhe çori kështu Traktatin e Versajës.

«Demokracitë» perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës financuan Gjermaninë revanshiste, mëkëmbën Kr upët, ndihmuan vendosjen e diktaturës fashiste të Hitlerit, për ta hedhur këtë në luftë kundër Bashkimit Sovjetik.

Në Francë, dhe konkr etisht për mua në Monpelje, kishte një fushë të gjerë dhe të lirë për të mësuar marksizëm-leninizmin, për t'u njohur më mirë me luftën dhe me jetën në Bashkimin Sovjetik të Leninit dhe të Stalinit. Seksioni i Partisë Komuniste Franceze për Monpeljenë kishte një kiosk të veçantë ku shiste libra dhe broshura mbi Marks, Engels, Lenin, fjalime të Stalinit etj. Atje shiteshin të shtypura në brosl-lura komente që i bënte vetë partia shumë të kuptueshme, pse i përgatiste për punëtorët e për komunistët e thjeshtë dhe, doemos, ato ishin aq të nevojshme dhe të domosdoshme edhe për mua, studentin e ri me zemër komuniste.

Materiale të tilla zakonisht i blija, pse partia i shiste lira, ndërkohë, kur arrita të njihem me klubet e punëtorëve që drejtonte Partia Komuniste Franceze, shumë materiale të tjera të shkurtra më jepeshin pa pare dhe i studioja me zell. Kur kishte probleme që nuk i kuptoja, shkoja dhe kërkjoja shpjegime te kiosku. Ai që shiste, s'kishte kohë për sqarime, po më jepte adresën e një kafeneje të humbur në periferi dhe më thoshte:

- Shko atje, gjej shokun Marsel dhe kërkoi atij të t'i shpjegojë, pse ai është propagandist i partisë!

Kështu arrita të bëhem frekuentues i rregullt i librarive, i klubeve punëtores, i diskutimeve që zhvilloheshin atje dhe, nga të gjitha këto. çdo ditë e më mirë mësoja atë shkencë që për mua u bë një qëllim i jetës dhe e vija mbi shkencat e tjera të universitetit. Fillova të marr kështu në dorë armën e mprehtë të luftës revolucionare. Mora kontakt si lexues me shumë njerëz të Partisë Komuniste Franceze. Një ditë Marseli më tha:

- Nesër do të shitet libri i Politzerit, filozofit të shquar të partisë sonë, ai është profesor në universitetin e natës të marksizëm-leninizmit në Paris, që ka hapur Partia.

- Po ju, - e pyeta, - nuk keni një degë këtu?

- Jo, - m'u përgjigj.

Mbase ai nuk më njihte sa duhej dhe ashtu ishte, por më rekomandoi të merrja «Principes élémentaires de philosophie»* *(«Parime themelore të filozofisë».) të Politzerit dhe «tu m'en diras des nouvelles», që me fjalë të tjera donte të thoshte: «do të shikosh sa i mirë, sa i thjeshtë dhe i kuptueshëm është.»

Më dha edhe një këshillë:

- Në fund të çdo kapitulli Politzeri bën pyetje; atyre duhet t'u përgjigjesh vetë. Po të kërkohen me shkrim, ca më mirë është t'i përgatitësh përgjigjet po me shkrim.

Të nesërmen shkova e bleva «Politzerin» në kioskun e Partisë Komuniste. Nisa ta lexoj e të rilexoj kapitull më kapitull. Ç'mrekulli! Kisha fituar jo pak njo huri në filozofinë marksiste, por, nga paraqitja sistematike, e qartë dhe e kuptueshme që Politzeri u bënte ligjeve dhe krejt teorisë marksiste, mund të them se po më hapeshin sytë më mirë, po kuptoja më thellë luftën që Marksii u bënte Ovenëve, teorive të Rikar dos dhe gjithë filozofëve e ekonomistëve të tjerë idealistë, për të cilët dëgjoja të flitej ndryshe në konferencat e amfiteatrove të universitetit. Kuptova më qartë rrenat, shtrembërimet, falsifikimet që bënin borgjezia e njerëzit e saj për të gënjyer klasën punëtore dhe për të mbrojtur rendin shtypës e shfrytëzues.

Studiova në mënyrë më serioze e të thelluar «Manifestin» dhe «Luftën civile në Francë» të Marksit. Mësova më shumë për barbarizmat e borgjezisë, për tmerret e Tierit dhe të mareshalit Galifet, vrasësit e komunarëve, kuptova më thellë ç'ishin Komuna e Parisit dhe komunarët që «sulmonin qiejt». Të gjitha ato që mësoja, i lidhja me atdheun tim, me popullin tim të mjeruar, por kurrë të përkulur. Mua, që më pëlqente shumë historia, interpretimin dhe studimin më serioz të saj ma bënin shumë më të qartë e mësimdhënës leximet mbi Marksii, Engelsii, Leninii, fjalimet e Stalinit dhe broshurat e Partisë Komuniste Franceze. Tash jo vetëm kisha shumë më të qartë armiqësinë dhe luftën e pamëshirshme që duhej t'u bënim monarkisë dhe Zogut, por sikur largoheshin nga sytë e nga mendja ime disa copa që më pengonin të shihja se ç'do të bënim, si duhej të luftonim dhe si të vepronim kur të fitonim.

Veçanërisht në vitet 1932 e 1933 pasioni im për shkencat shoqërore u kthye në një nevojë e detyrë të përhershme. Në këtë fazë edhe vetë veprimtaria publike e PK Franceze po gjallërohej më tepër dhe unë. krahas ndjekjes së kësaj veprimtarie, pasur oja pareshtur bagazhin tim për njohjen dhe përvetësimin e teorisë marksiste.

Studime të tilla ma hoqën akoma më tepër vëmendjen e duhur nga ato studime për të cilat kisha marrë bursën. Me këtë nuk dua të them se i nënvleftësoja, prapë përpiqesha dhe disa provime i dhashë, po në disa nuk fitova. Në fund të fundit i kisha dhënë karar vetes: do të thellohem e të mësoj atje ku janë edhe më të ndjeshme prirjet e mia. Edhe kështu do t'i shërbej atdheut tim, bilebile, mendoja, mbase kështu do t'i shërbej më mirë. Shqipëria e asaj kohe kishte nevojë për dritë, përparim e perspektivë në të gjitha fushat, në të gjitha degët e shkencave e të veprimtarisë. Por mbi të gjitha, mendoja, ajo kishte nevojë urgjente e të domosdoshme për të gjetur rrugën e drejtë në çështjet thelbësore të zhvillimit politile e shoqëror. Nuk mund të them se qysh në ato momente përcaktova prerë si rrugë të jetës sime atë të njeriut të politikës dhe as e kisha të qartë se si e çfarë do të bëja në të ardhmen. Kisha më se të qartë faktin që atdheu vuante nën një regjim të urryer e se ai regjim duhej të përmbysesh. Dija mirë se kazani në Shqipëri kishte nisur të ziente, se po përgatiteshin e organizoheshin forcat e reja të përparimit e të zhvillimit shoqëror, punëtorët e komunistët revolucionarë. Me dijet e mia, gjykoja, do të di të rreshtohem përkrah tyre, të militoj me ta e t'i ndihmoj aq sa të mundem e të kem forca. Në këtë përfundim arrita sidomos kur në fillimin e vitit 1934 m'u pre përfundimisht bursa. Kjo ishte një goditje e rëndë, sepse mbetesha pa asnjë mjet jetese, por edhe pas kësaj do të përpiqesha akoma me shpresën se mund të gjeja ndonjë mënyrë për t'i përfunduar studimet e larta. Por për një gjë isha më se i vendosur: diplomën, nëse do të arrija ta merrja, nuk do ta kërkoja më në shkencat natyrore, ku më kishin dërguar me detyrim.

Sidoqoftë, edhe gjatë tre vjetëve të studimeve në Monpelje, mësova shumë gjëra në universitet dhe jashtë tij dhe këto i konsideroja si diploma të miat. Fshehurazi nga shokët, veç jo nga Sotiri, shkoja dy-tri herë në javë në barin e Marselit, ku u bëra si klient i rregullt.

Vinin atje punëtorë ndërtimi ose të degëve të tjera të industrisë dhe lëvonte muhabeti pa druajtje kundër patronatit. Marseli komentonte kryeartikullin e «L'Humanité»-së, i bëheshin pyetje dhe ai na përgjigjej. Atje mësoja kur dhe ku kishte debate kontradiktore me të deleguar të Partisë Komuniste Franceze dhe të partive të tjera. I ndiqja këto debate që bëheshin zakonisht nëpër klube punëtorësh. Këto mbusheshin plot me dëgjues nga të dyja palët dhe me tym cigareje që s'njihte ideologji. Ishin konferenca e debate shumë interesante. Atje une mësoja si shtröheshin problemet, si zhvillohej lufta me gojë e oratorëve dhe si shoqëroheshin ata, sipas mbrojtësve e simpatizantëve të gjithsecilit, me duartrokitje, me fërshëllima, me goditje të bankave, me grushte etj. Një chahut dhe një tintamarre e çuditshme. Ngandonjëherë, sic kam thënë edhe më lart, degjeronnte mbledhja edhe në përleshje me grushte. Asistova në disa prej tyre. Por edhe mësoja, edhe habitesha nga oratoria e atyre e diskutantëve pa letër, që flitnin «bilbil». Njëri fliste, tjetri i priste fjalën, dikush i bënte pyetjen dhe ai hazër xhevap jepte përgjigjen dhe as që turbullohej dhe përsëri e gjente fillin e diskutit, atje ku ia këputnin.

- Sa të zotët! - thosha me vete, dhe i admiroja për tërë ato që dinin e thoshin, por nganjëherë edhe pyesja veten: Mos flasim si shumë?! Valle e tërë kjo punë, çështje diskutuesh e debatesh duhet të jetë?

- Ça viendra, - më tha një ditë një murator, që kisha pranë në një nga këto debate; - *l'essentiel est de connaître le marxisme, sa dialectique, et le problème, ça ira comme sur des roulettes**. *()

Dy a tri herë një grup studentësh bullgarë morën iniciativën të bënin disa mbledhje me të gjithë ne, studentët ballkanikë. Unë i pyeta disa shokë:

- Do të vemi?

- Je në vete! Do të na akuzojnë si komunistë në Ministrinë e Arsimit - m'u përgjigjen.

- Mirë, - u them, - atëherë nuk shkojmë.

Por une vajta. Mbledhjet shkuan mire, diskutuam të gjithë për problemet e vendeve tona, diskutova edhe une. Diskutimet ishin progresiste, por ngjyrë komuniste nuk kishin. Megjithatë këto mbledhje u lane, se duhej t° merrej leje nga policia dhe këtë gjë ne s'e pranuan.

Atje u njoha me dy studente grekë, që studionin për medicinë. Njëri prej tyre, i quajtur Thanos (ose Thanas), kryente vitin e peste dhe ishte *interne des hôpitaux** *(Frëngjisht - asistent.) në pavionin e psikiatrisë. Unë u lidha me të, ishte i dashur, i sinqertë, i shkurtër e flokëverdhtë. E doja dhe më donte.

- Thanos, - i thosha, - po të mos ishe flokëverdhtë, por flokëzi dhe po të ishe ca i gjatë, do të të thosha se je shqiptar nga të Sulit e të Foto Xhavelës, të Kollokotronit dhe Bubulinës që morën pjesë heroikisht në r evolucionin tuaj në kohën e Ipsilantit.

Thanoja qeshte dhe më përgjigjej me vargjet:

«Arvanites palikarja

Me spathja qe me hanxharja

Arvanites penemeni

Pu ine o Ali Pashas kajmeni

Mesa apo to Tepeleni...»* *(«O ju trima shqiptarë

Ali Pashë shpata e me hanaxharë

Të lënduar ju shqiptarë ku e keni, o të mjerë Ali Pashë Tepelenë...».)

Ai më kishte marrë nja dy herë për darkë në spitalin e psikiatrisë. Kur vinte në kafe Thanoja merrte me veto edhe një të marrë «të shëruar», por që nuk duhej të pinte as një gotë vere, se i hipte në kokë. Pasi pui kafënë, një dite ai i tha Thanos:

- Të dal të marr pak ere, ja atje, te kiosku i gazetave?! Thanoja e la, mirëpo atje afër ishte një bar dhe miku sa shkoi pui dy birra dhe i hipi në kokë. Dëgjojmë një zallamahi të madhe:

- Morisi! - tha Thanoja. - Ngrihu, Enver, se diçka po bën, ka pirë! Vamë me të shpejtë, po ai kishte thyer kupat dhe qe goditur me kafexhiun. I ndamë, e qetësuam barmanin, i paguam kupat, i kërkua të falur dhe i shpjeguam se Morisi ishte i sëmurë.

Në mes nesh, studentëve shqiptarë, nuk kishte as zënka, as mëri, po sidoqoftë edhe grupoheshim. Rrinim tok dhe na hahej muhabeti, Eqrem Hadoja, dy shokë shkodranë dhe unë. Ishte pastaj klani korçar, aristokratët dhe pasanikët si Aleko Turtulli, Thimaq Ballauri e të tjerë që na rrinin rëndë dhe luanin poker. Niko Gliozheni ishte më i thjeshtë dhe më demokrat, rrinte herë me korçarët, herë me ne. Thimaq Ballaurin e thërritnim «*Monsieur le baron*»* *(Zoti baron.) dhe atij i vinte mirë, se e dëgjonin dhe francezët e fr ancezet që kthenin kokën e shikonin, pse ishte një stap i gjatë me një kokë si kalë dhe me një hundë si çomange. Vishej mirë dhe «*faisait le beau*»* *(Këtu në kuptimin: krekosej.). Kur na vinte Foto Bala pushonim, nuk flitnim për çështje politike.

Vitin e tretë në Monpelje, në qoftë se s'gabohem më 1333, na erdhi nga maji a qershori një inspektor i Ministrisë së Arsimit me emrin Kromiqi (jo i vëllai i tij, profesor Kurrizoja). Na tha se kishte shkuar në universitet, kishte pyetur për studentët shqiptarë dhe kishte mbetur gjoja i kënaqur. Kishte nja tre muaj që nuk na kishin ardhur bursat dhe hanim e pinim veresie. Ishim mbushur kështu me borxhe. Ky inspektor i arsimit, me gjithë madamën e tij, na ftoi ne, studentët shqiptarë, që të mblidheshim një pasdreke në «Café Riche», se donte të na njihnte dhe të bisedonte. U gëzuam shumë për këtë, pse ishim të bindur se ai kishte sjellë me vete edhe çeqet e bursave tona. I dhamë dorën, e përshëndetëm dhe u ulëm rreth e rrotull të dëgjonim ç'do të na fliste. Ai na tha ato pak fjalë që përmenda më lart, se gjoja kishte biseduar me rektorin, i cili i kishte thënë se «studentët shqiptarë në përgjithësi mësojnë». Pasi mbaroi këtë, filloi të na bënte propagandë për Zogun: «T'i qëndrojmë besnikë, pse ai është kështu, është ashtu, se duhet të urre ni komunizmin, përndryshe jo vetëm do t'ju presim bursën, po do të mbaroni edhe në burg» etj., etj. Inspektori i Zogut na kërcënonte me burg, po fjalët e tij neve nga një vesh na hynë, nga veshi tjetër na dolën. Pak pasi ishim ulur erdhi garsoni i kafesë dhe na pyeti se çfarë do të merrnim. Shikuam inspektorin dhe madamën që kishin mar rë akullore dhe ne hezitua pak, sep se kushtonin, por, duke menduar se do t'i paguante ai që na ftoi, porositëm të gjithë akullore.

Pasi mbaroi diskutimin inspektori, u ngri t Eqrem Hadoja dhe i tha:

- Zoti Kromiqi, po bëhen tre muaj që neve s'po na i dërgojnë bursat dhe s'kemi ku të hamë, mund të na nxjerrin edhe nga shtëpitë, prandaj besojmë se ju që erdhët deri këtu nga Ministria e Arsimit, na keni sjellë dhe bursat.

«I famshmi» inspektor, pa u skuqur fare, u përgjigj:

- Unë nuk jua kam sjellë bursat sepse s'është kjo detyrë ime. Detyra ime është të shkoj në Paris, në Tuluzë, Lion e gjetkë ku ka studentë shqiptarë dhe të inspektoj.

Na hipi mustarda në hundë, siç thotë francezi, prandaj e mora unë fjalën dhe i thashë:

- Zoti inspektor, gjendja e jetës sonë ekonomi ke në një vend të huaj nuk hyn në inspektimin shëtitës të zotërisë suaj ? Kujt t'i drejtohem ne më mirë përveçse inspektorit të Ministrisë së Arsimit?

- Më mirë nga të gjithë, ju vetë duhet t'i drejtoheni Ministrisë së Arsimit. Unë kam për detyrë vetëm të raportoj për këtë gjendje, u përgjigj inspektori pa pikë turpi.

Kërceu një shok tjetër, nuk e mbaj mend kush, por që ishte mire me mësim dhe atë vit mbaronte, pra s kishin ç'î bënin dhe i tha:

- Zotërinjtë ministra dhe deputetë e marrin rreullisht rrogën e majme, kurse ne na lënë pa bukë.

Inspektori, të cilit ia pimë lëngun dhe e shikonim .ne inat, u përgjigj:

- Djalë, mati fjalët kur flet për ministrat dhe për deputetët, se mund të të pritët bursa !

- S'e ke prerë që tani! - ia preu ai. - Zaten është njësoj sikur na i keni prerë, meqenëse s'na i dërgoni.

Filluan grindjet dhe inspektori, për të dalë nga kjo situatë, na kërcënoi me fjalët:

- Do të raportoj në Tiranë për këtë frymë indisciplinimi që po tregoni.

- Pse, indisciplinim e quani ju kërkesën e së drejtës sonë? - ndërhyra une.

- Garson! thirri inspektori, sa bëjnë dy akullore?! (domethënë e tij dhe e madamës) dhe i dha garsonit 100 franga.

Kërceu Eqrem Hadoja dhe i tha garsonit:

- Jo dy akullore, por të gjitha i paguan zotnia.

I poshtri, duke na ditur se ishim pa asnjë lek, vinte nga Shqipëria dhe jo vetëm s'na sillte bursat, por na ftonte në kafe dhe s'na paguante as akulloren. Ne e njihnim mirë garsonin dhe ai nga të 100 frangat i ktheu vetëm pesë. Kromiqi hapi sytë dhe e pyeti:

- Pse, dy akullore 95 franga bëjnë?

- Të gjitha ç'janë konsumuar në tavolinë bëjnë aq, - iu përgjigj garsoni.

- Unë paguaj vetëm dy, akullorën time dhe të gruas.

- Po të tjerat kush i paguan? - iu drejtua garsoni.

- Ata që i konsumuan! - u përgjigj përfaqësuesi i mbretit mufliz.

- Unë, - u përgjigj garsoni, - i njoh këta studente, janë njerëz të mirë, por janë pa para, prandaj gjejeni vetë në mes jush hesapin, - dhe u largua.

Inspektori u bë si bishë, u skuq, dhe i tha gruas:

- Çohu të largohemi !

As dorën na dha, na e ber i me kokë, doli jashtë kafes dhe s'ia pamë më surratin. Ne vëmë i shtrënguar dorën garsonit, i cili na tha:

- *J'ai compris tout de suite que c'était un salaud, le mec**. *(E kuptova menjëherë se ishte një maskara ai tip.)

Mirëpo mandata na erdhin më vonë. Mua më pr' enë bur sën, pse kisha disa provime të pashlyera në shkencat e natyrës dhe se në kundërshtim me urdhrin e ministr isë, atë vit kisha ndjekur Fakultetin e Drejtësisë dhe jo atë që më ishte caktuar. Bursat na erdhën deri nga fundi i vitit 1933 dhe, gasi mora lajmin e prerjes së bursës, fillova të mendohesha për të bërë ekonomi. Haja më pak, në kafe s'veja, në kinema shumë rrallë, gazetat m'i huanin shokët. Ndërkohë mendoja dhe kërkoja të gjeja ndonjë punë për të vazhduar studimet dhe për këtë më rane këmbët, po asnjë sukses nuk pata në këtë drejtim. Atëherë me ato kursime të vogla që do të mblidhja dhe, pasi të merrja edhe bur sën e muajit të fundit, vendosa të nisesha për në Paris. Atje kishte shokë shqiptarë dhe mendoja se do të më ndihmonin të gjeja një punë sa për të jetuar që të mundja të vazhdoja studimet në Sorbonë.

Mora dëftesat e disa provimeve në të cilat kisha marrë nota kaluese, disa dëftesa që kisha ndjekur në rregull vitin e parë të drejtësisë dhe kështu u nisva nga Monpeljeja për në Paris me 1 500 franga në xhep. Shkoja në Paris me shpresën se medoemos do të gjeja ndonjë punë çfarëdoqoftë dhe do të mësoja e do të zgjeroja horizontin më shumë. U largova, pra, nga Monpeljeja, që e kam dashur shumë dhe e kujtoj me dashuri edhe sot: u largova i hidhëruar, i br' engosur e i shqetësuar se si do të vente halli im, por edhe me ndonjë shpresë të vogël për punë e mësim. Të kthehesha në Shqipëri pa marrë ndonjëfarë diplome, asnjë punë nuk të jepnin, do të vuaja për bukë. Vuajtje për vuajtje, prandaj vendosa të bëja përpjekjen e fundit.

IV

NË FRANCË – PARIS

Në Paris kisha qenë edhe në vitin e parë të vajtjessime në Francë. Më kishin ftuar shokët që studioin atje, të cilët më mbajtën disa ditë. Vizitova me këtë rast tok me ta Ekspozitën koloniale dhe disa qendra të njohura si Versajën, Luvrin, Invalidët e Panteonin, disa bulevard kryesore si «Champs-Elysées» e «Boul-Mich» (bulevardin «Sen-Mishel»), «Place de la Concorde», të famshmin «Quartier Latin» dhe Monparnasin. Ato ditë fjeta te studenti Abaz Omari, djali i çupës së xhaxhait tim, të cilit më vonë, kur filloi Lufta Nacionalçlirimtare, i bëmë thirrje të bashkohej me ne dhe të luftonte kundër okupatorëve, po ai u bashkua me Ballin, luftoi kundër popullit dhe më së fundi forcat tona e kapën dhe iu dha dënimi që meritonte.

Por këtë herë në Paris shkoja ndryshe: nuk isha më një student që ftohesha atje për vizitë nga shokët e mi, por një i ri shqiptar që rrethanat e detyronin të shkonte në kryeqytetin francez në kërkim të rrugëve e mundësive për të jetuar e për të mësuar. Tash isha më i pjekur, me horizont më të gjerë,

por me xhepin bosh! Shpresën e kisha të më ndihmonin shokët që të gjeja ndonjë punë në ndonjë fabrikë o ku të ishte dhe të mundja të ndiqja studimet për drejtësi ose ndonjë kurs tjetër të shkencave historiko-shoqërore në Sorbonë. Zbrita herët në «Gare de Lion». Iashë valixhen në konsinjë* *(Nga frëngjishtja - Vend për ruajtje plaçkash në stacione trenash.) dhe mora metronë që të nxirrte në bulevardin «Sen-Mishel». Atje do të gjeja shokët që njihja, sidomos Qemal Karagjozin, Remzi Ficon e të tjerë. Kisha adresën e Qemalit, ai banonte në «Hôtel Monsieur le Prince».

Meqë ishte shpejt, mëngjes, u ula në kafenenë «Dupon t» në bulevardin «Sen-Mishel», ku piva një *café au lait* dhe hëngra tri kruasane, duke i thënë vetes:

- Një çikë më javash në të ngrënë, se do të mbetesh pa një lek. Por më kishte marrë uria. Që nga Monpelje e deri në Paris kisha ngrënë një çerek kile bukë dhe një copë djathë «Camember», që i bleva në stacionin e Monpeljesë.

Bulevar di zuri të lëvizë, studentët kishin filluar të dilnin nga shtëpitë, prandaj u çova dhe drejt në hotelin «Monsieur le Prince». I bukur hotel! Emrin e kishte të madh nga rruga ku ishte, por nga pamja dhe brenda qe mizerabël.

Hyra te dhoma ku rrinte e zonja e hotelit, një plakë trashaluge, me fytyrë të frvrë dhe me leshra gri.

- Kë do? - më pyeti.

- Një student që rri këtu, quhet Qemal Karagozi.

Ajo hodhi sytë te vendi i çelësave dhe m'u përgjigj

- Ngjitu në katin e katërt, filan numër të dhomës, duhet të jetë brenda.

Ngjita shkallët katër e katër me gëzim. Trokita te dera e Qemalit dhe menjëherë dëgjova zërin e tij që e njihja. Ai bërtiti në frëngjisht:

- Ç'do, kush je?

I fola në shqip:

- Hape, Qemal, jam unë, Enveri.

Dëgjova zërin e tij nga brenda:

- U. ç'të solli. - pastaj hapi derën dhe iu hodhëm në qafë shoqi-shoqit.

U ula në krevatin e tij dhe i tregova historinë.

- Mos u mërzit, - më tha ai, - do të bëjmë si të bëj më.

Qemali ishte djali i Halim Karagjozit, ai dhe vëllezërit e tij qenë pronarë të pasur bagëtish. Ishte më i vogël nga unë. por kemi qenë shokë të mirë si në Liceun e Gjirokastrës, edhe në atë të Korçës. Qemali jo vetëm që ishte shok i mirë, nga karakteri i thjeshtë, por ishte edhe me ide përparimtare, bile dhe komuniste.

- Ke ngrënë mëngjes? - më pyeti.

- Kam ngrënë, - i thashë, - po vishu të bisedojmë se si do të rregullohem, se 1500 franga kam në xhep. Po i mbarova këto, vdiqa për bukë!

- O, mor i varfër! - ia filloi Qemali. - Tani mirë që kemi ata 1 500 frangat e tua, se unë kam mbetur betur dhe m'u ça hunda për një cigare! Tani jemi të basur. Nga java e ardhshme, më vijnë mua të hollat o?he tok do t'i kemi.

- Do të humbasësh. - i thashë, - se unë s'kam tjetër burim veçse të gjej ndonjë punë. Po vishu tani të vemi të blejmë nga një «zhon» (këto ishin cigaret më të lira. «kromië», sic thoshin në Gjirokastër) dhe të pimë ndonjë kafe-krem me kruasane, se, siç po e shoh, paske mbetur trokë.

- Më ke gjetur në «thatësirë», - ma preu ai dhe kur unë i dhashë 100 franga thirri i çelur: - Tani më duket sikur e mbusha koburen me 100 plumba, *c'est quelque chose vieux** - *(Diçka ia vlen, miku im.) përfundoi ai.

- Më parë se çdo gjë duhet të rregullojmë ku do të fle dhe ku do të ha - i thashë. - E more vesh buxhetin tim?

- T'y mbylltë dera, - foli Qemali, - u bëre i kur syer si xha Halili !

- S'dua të turpërohem! - u mbrojta.

- Ne do të flemë së toku, derisa plaka e hotelit të më thotë: «Pse dy veta do të flini në një dhomë?» - nisi të më shpjegonte Qemali dhe vazhdoi të imitonte plakën. «Unë atë e kam dhënë për një, prandaj miku apo kushëri yt duhet të paguajë». Por, meqë e di se plaka është e mirë, nuk do ta zërë në gojë

këtë çështje veçse pas 20 ditësh. Atëherë ne do t'i themi se do t'i paguajmë diçka më shumë, derisa të lirohet një dhomë, ja atje lart në papafingo, në majë fare, me një baxha dhe me përmasa dy metra me një metër e gjysmë. Atje do të kërrusesh, edhe kur të hysh, edhe kur të rrish në këmbë, edhe kur të lexosh. Vetëm një krevat do të kesh dhe baxhën nga e cila do të shohësh çatitë e shtëpive rreth e rrotull Parisit.

M'u kujtua «La vie de bohème»* *(Shkurtim i titullit të veprës «Les scènes de la vie de bohème». «Skena nga jeta bohemiane».) e Myrzhërit, por ajo që propozonte Qemali ishte zgjidhja më e mirë që mund t'i bëhej gjendjes sime në ato situata.

- «Hundo» (e thërritnim kështu sepse e kishte hundën të madhe, pllaçko e të shtrembër), - i thashë. - Specialist je bërë!

- Këtu në Paris do t'i mësosh të gjitha. Sa për të ngrënë, - tha Qemali. - do të shkojmë të hamë atje ku hamë edhe unë dhe shokët e tjerë, «Chez Llazare».

- Ç'është ky? - pyeta Qemalin, pse mendoja që mund të vinin edhe ditë të këqija.

- Është shqipo, nga Përmeti, frëngjishten e flet si bicots (algjerianët), po zemrën s'e ka të keqe. Po ia vonove paratë, s'të shtrëngon; po kalove muajin o një muaj e gjysmë, të jep vetëm një supë dhe një copë bukë, po ia vonove dy muaj, të thotë: «Pa futu në kuzhinë dhe laj pjatat, pastaj të hash bukën».

- S'e ka keq, - i thashë, - qenka njeri i mirë.

Shkuam në «Chez Llazare» që atë drekë, u poqëm me Remzi Ficon, Sinan Imamin e të tjerë. I dhamë dorën Llazos, i cili më pyeti:

- Qenke i ri në Paris. Nga je?

- Nga Gjirokastra, student! - iu përgjigja.

- Qenkemi nga një mëhallë! - tha përmetari. Plot kam këtu nga Gjirokastra!

Si më pa që u përqafuam fort me Remzi Ficon, babai i të cilit kishte qenë ministër fuqiplotë i Shqipërisë në Turqi dhe nëna e të cilit ishte nga një fis me fisin tonë, kredia ime te Llazari u ngjit.

- Llazo, - i thirri Remziu, - drekën e Enverit ma shkruaj mua.

- Si urdhëron! - pranoi Llazoja dhe kur do të dilnim, gjeti rastin e më pyeti veçanërisht:

- Ç'e ke doktor Remziun?

- Nip nga nëna e tij, - iu përgjigja.

- Bukur, eja ha këtu, abonohu, mos shko tek ai rrufjani i Mulletit!

- Jo or, - ia ktheva unë, - ç'më duhet të lë vëllain gjirokastrit dhe të vete gjetkë! (As e dija kush ishte ky farë rrufjan Mulleti, më vonë do të mësoja që ishte Qazim Mulleti, po restorantin e kishte vëllai i tij). - Por, Llazo. - vazhdova duke i dhënë një paradhënie prej nja 400 frangash, - mund të më qëllojë që edhe të t'i vonoj ca paratë, ngandonjëherë do të më bësh edhe ndonjë çikë kredi.

- S'je as i pari, as i fundit, - ma ktheu Llazari dhe dulce qeshur shtoi në frëngjisht: *Le vieux Llazar avec les étudiants en a vu de toutes les couleurs**. *(Plaku Llazar ka parë lloj-lloj studentësh.) U rregullua edhe kjo punë.

U ambientova snjejt me Kartienë dhe qysh ato ditë asistova në disa - konferenca në auditoret e Sorbonës. Një pjesë të mirë të kohës shkoja në Kopshtin e Luksembur gut, zija një vend në ndonjë bankë në diell dhe lexoja «L'Ht-lmanité»-në apo ndonjë gazetë tjetër me anonsa për ndonjë vend pune. Anonsat i lexoja një për një çdo drekë, se prej tyre varej e ardhmja ime. Por më kot pr isja, se zakonisht kërkoheshin vende me diplomë, të cilën unë nuk e kisha. ose viheshin të tjera kushte që unë nuk i plotësoja. Pasi lexoja gazetën, e fusja në xhep dhe shkoja laja duart në basenin e «Fontaine de Médicis». Përpara ishte «Palais du Luxembourg», ndër tesa e madhe e senatit francez. Gjithçka në ndër tesë e rreth saj ishte madhështore, e bukur, imponante dhe, në gjendjen time të papunë e me shpresa të vakëta, të gjitha këto m'i shtonin më tepër mërzinë dhe shqetësimin. E ku mund të më shkonte mua atëherë në mendje e që një ditë, r r eth 10-11 vjet më vonë, pas fitores mbi fashizmin, do të vija po në këtë vend, tash Kryeministër i Shqipërisë së re demokratike popullore. do të ngjitesha në tribunë të «Palais du Luxembourg» dhe do të flisja për luftën heroike të popullit tonë të lavdishëm!

Nuk do t'i harroj ato ditë të gushtit e të shtatorit 1946 të ngjeshura me punë, me biseda. k onferenca shtypi e debate. Qarqet reaksionare e shoviniste, veçanërisht reaksioni anglo-amen ikan bënë ç'është

e i:undur që Shqipëria e re, e dalë fitimtare nga një luftë e përgjakshme, të mos zinte vendin që meritonte në gjirin e kombeve e në mes vendeve që kishin dhënë kontribut të madh në luftën kundër nazi-fashizmit, u përpoqën e ç'nuk bënë që ta copëtonin më tepër se ç'e kishin copëtuar në fillim të shekullit Shqipërinë. Por tash populli ishte në fuqi, kishte krijuar në luftë pushtetin e vet popullor, kishte Qeverinë e vet Demokratike të dalë nga lufta dhe populli e Partia më ngarkuan mua me detyrën të shkoja në Paris, në Konferencën e Paqes dhe të mbroja e të afirmoja të drejtat legjitime të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Që kur hyra në sallën e madhe e të ndritshme, e cila kishte javë të tëra që ziente nga fjalime, debate, grindje, pretendime, thirrje, deklarata e kundërdeklarata të delegacioneve të vendeve të ndryshme, e ndjeva edhe më qartë se tashmë Shqipëria, donte apo s'donte reaksioni ndërkombëtar, ishte bërë një faktor i fuqishëm që s'mund të mos merrej në konsideratë. Këtë të vërtetë e kisha dëgjuar edhe nga Hysni e shokët e tjerë të delegacionit, të cilët prej ditësh ndodheshin në konferencë; se ç'thuhej e diskutohej për Shqipërinë kisha lexuar në shtypin francez e në materiale të tjera; për çështjen slzqiptare më folën Vishinski e Moshë Pijade, Moris Torezi e të tjerë. Por më qartë u binda për këtë gjatë ditëve që mora pjesë në punimet e konferencës. Unë atje fola në emër të një çështjeje të drejtë, në emër të vendit e të popullit tonë trim e luftëtar, zëri im ishte zëri i Shqipërisë së re që i kishte fituar të drejtat që i takonin me gjak e sakrificë, i kishte ato de facto në duart e veta e tanfi kërkonte jo vetëm të mos ia cenonte kush, por dhe t'i njiheshin e t'i afirmoheshin në arenën ndërkombëtare.

Gjatë këtyre ditëve që qëndrova në Paris, më 1946, në ndonjë moment të lirë gjeja rastin të shihja edhe ato ambiente, ato sheshe e rrugë ku isha endur 10-12 vjet më parë. Përpara syve i kam ata punëtorë emigrantë shqiptarë, të cilët na rrethuan me dashuri e përkujdesje të veçantë sapo shkelëm në tokën e Francës. Ishin dhe ata të gëzuar e krenarë që tash nga vendi i tyre vinin përfaqësuesit e popullit e dinin të mbronin me forcë e dinjitet të drejtat legjitime të Shqipërisë.

Por të gjitha këto do të ndodhnin shumë vonë. Le të kthehem në ato ditë të viteve 1934 e 1935, kur endesha nëpër Paris në kërkim të punës e të mjeteve minimale të jetesës, në ditët e vështira kur qëndroja me orë të tëra nëpër bankat e Kopshtit të Luksemburgut. Ashtu student i varfër sic isha, që haja vetëm drekën, e cila më kushtonte pesë franga dhe që lexoja çdo ditë anonsat për të gjetur ndonjë punë, më kujtoheshin shkrimet e Anatol Fransit, i cili në biografinë e tij shkruante: «...I vogël, me beretën në kokë. me duart në xhepa të xhakëtës dhe me çantën me libra në krahë, çaja erën e ftohtë të Kopshtit të Luksemburgut dhe shikoja fletët e verdha të pemëve që binin njëra pas tjetrës mbi supet e bardha të statujave...». Mundet nuk e citoj ekzaktësisht shkrimin e Fransit, por në esencën e tij, bile dhe në frazë nuk gaboj shumë. Anatol Fransi ishte një nga autorët e mi më të preferuar, kisha lexuar shumë nga romanet e fuqishme e të bukura të tij shoqërore dhe politike. Kisha një admirim të madh për të edhe për faktin se ai shkrimtar aq i madh dhe me famë botërore, kërkoi dhe u bë anëtar i Partisë Komuniste Franceze dhe i tillë vdiq.

Muajt kalonin, mbeta shumë shtrënguar ekonomikisht, ecja me orë të tëra në këmbë dhe, kur uleshë në ndonjë kafe i raskapitur dhe lexoja gazetën, pse ishin pa parë, garsoni kalonte tri-katër herë dhe me pecetën bënte sikur fshinte tryezën. Kjo donte të thoshte «o konsumo edhe ndonjë gjë të dytë, o liro vendin», kështu që detyrohesh të ngrihesh. Qemali më ndihmonte, Remziu më jepte ndonjë frangë hua, më paguanin ngandonjëherë edhe biletën e kinemasë. Sidoqoftë u lodha për ndonjë punë, vajta edhe në disa shtypshkronja të kërkoja, më pyetnin q'shkollë kisha e u përgjigjesha si e kisha punën.

- Je i sindikuar, e ke taserën? - vazhdonin pyetjet.

- Jo, jam student.

Pyetjet e përgjigjet vazhdonin, nganjëherë thjesht për mirësjellje ose korrektësi, sepse thuajse kudo në fund merrja këtë përgjigje:

- Këtu s'ka punë për francezët dhe jo më për te huajt.

Një herë në anonsën e një gazete pashë se kërkonin një njeri për të kopjuar adresën në zarf. U paraqita, ishte një dyqan që përfaqësonte shtëpi të verërave. Ai që më priti më dha një letër për të më provuar shkrimin mbi zarf. Si duket i pëlqeu shkrimi dhe më tha:

- 20 000 adresa 30 franga. *Ç'a vous va?** *(Si ihua?)

- Sigurisht që pranoj ! - i thashë, pa marrë par asysh ç'donte të thoshte kushti që më vuri. Më vonë e provova lodhjen, pse duheshin dy-tri ditë që të shkruaja adresat në 20 000 zarfe dhe t'i shkruaje bukur, pa gabime. Por ç'të bëja, ishin 30 franga!

U fola shokëve për punën që kisha gjetur, por ata s'ma miratuan.

- S'është gjë ajo! - tha Remziu. - Mbaje hëpërhë, por të këshilloj të shkosh në legatën tonë dhe me siguri do të të presë Noçka. Unë e njoh atë, kërko, insisto, që të vazhdojnë të të japin përsëri bursën.

- Mirë, do të vete, por s'do të dalë gjë, - iu përgjigja.

Vajta dhe në legatë, atje më priti njëfarë Noçka, që ishte sekretar i parë i legatës sonë në Paris. Ishte mesoburrë dhe nuk më priti keq, më uli, më zgjati edhe një cigare. Ia tregova hallin, i vura në dukje që kisha shkuar apostafat në Paris të kërkoja një të drejtën time etj., etj. Edhe unë i flisja me njerëzillëk.

- Po kush të ndihmon këtu? - më pyeti ai.

Iu përgjigja se shkruaja zarfe dhe se më ndihmonte disi Remzi Ficoja.

- Pse, ç'e ke Remziun? - pyeti Noçka.

Aty doja edhe unë që të më dilte, prandaj i them që e kam nip etj.

- Mirë, - premtoi Noçka, - do të raportoj në Tiranë dhe, kur të kem lajm, do të të thërres. Po ku rri ti?

I dhashë adresën dhe i kërkoja që të më lajmëronte me anën e Remziut.

Prit e prit dhe më në fund doktori më lajmëroi se Tirana qe përgjigjur që nuk më vazhdonte më bursa.

- Unë, - vazhdoi Remziu, - i fola shumë mirë për ty, prandaj më tha: «Pa ma dërgo edhe një herë në legatë se mund të gjejmë diçka hiëpërhë».

Vajta edhe në legatë, ku Noçka më njoftoi përgjigjen e Tiranës, duke shtuar se në këtë përgjigje thuhet se je edhe kunati i Bahri Omarit. Ç't'i thosha? Sidoqoftë e pashë se priste një përgjigje e i thashë:

- S'më lidh gjë me të, veçse motra. Por ministria e dinte klëtë që kur më dha bursën.

- Hiqe shpresën nga bursa, - theksoi Noçka, - se s'del gjë andej. Por kam një propozim tjetër: do të hapim një konsullatë nderi në Bruksel të Belgjikës. Konsull nderi atje do të jetë një i quajtur Maroth, kont dhe I pasur. Ai do të paguajë ndërtesën e konsullatës, rrogën e sekretarit të konsullatës dhe ne do të dërgojmë vulat, pullat konsullore etj. Unë mund të rekomandoj që të shkosh ti si sekretar (kancelar) i kësaj konsullate.

Pa e zgatur e falënderova Noçkën duke i vënë në dukje se po më bënte një nder të madh.

Më tha të mos shpejtohesha.

- Më parë se të hapet ajo konsullatë, - më sqaroi, - atasheu i shtypit dhe konsulli duan të mësojnë një çikë gjuhën shqipe. Për këtë ata duan të bëjnë dy orë mësim në javë dhe paguajnë 20 franga në orë ose në një orë e gjysmë.

- Dakord, - miratova, - jam gati që nesër!

U largova i gëzuar pse 60 franga që do të merrja në javë nga zarfet dhe 40 nga mësimi i shqipes, do të më bëheshin kështu 100 franga në javë. Ky për mua ishte një thesar, pavarësisht se në fakt ishte një mizerje. Rregullova oraret në zyrën e zarfeve dhe u nisa për në shtëpinë e konsullit që ndodhej në një rrugë të Parisit, që kush ia mban mend emrin!

Konsulli i nderit ishte njeri i sjellshëm, dukej se ishte i pasur dhe, siç mësova më pas, merrej me disa veprimtari tregtare e industriale. Kishte influencë e lidhje edhe në Belgjikë e Holandë, por, siç thonë, pasuria e hedh ujin përpjetë. Zoti Maroth, industrialist e afarist ishte keq për një çikë titull diplomatik! Donte të paraqitej jo vetëm në banka e në bursa, por edhe në qarqet e diplomacisë, të thirrej në pritje e të organizonte pritje kur të kishte rastin. E donte këtë thjesht për modë ose snobizëm, apo, përmes diplomacisë synonte të krijonte kushte e mundësi të reja për të zgjeruar veprimtarinë afariste, këtë nuk e mora vesh asnjëherë, sepse as desha ta dija, as rasti s'm'u dha ta mësoja. E vetmja gjë që e mësova qartë ishte dëshira e tij për t'u futur de jure edhe në qarqet diplomatike dhe, në ato kohë, realizimi i një dëshire të tillë, sidomos për ata që ishin të zënë e të shkathët, nuk ishte një gjë e vështirë. U qepeshin shteteve të vogla ose qeverive pa shpatulla, siç

ishte në ato vite edhe regjimi zogist, dhe u kërkonin lejen që të celnin konsullata e të akreditoreshin si konsuj nderi në ato vende ku shteti në fjalë s'kishte mundësi të çelte e të mbante vetë një konsullatë. Kështu bëri Marothi me regjimin zogist. Kërkoi leje të çelte një konsullatë shqiptare në Bruksel dhe të akreditohej atje konsull nderi.

Të gjitha shpenzimet e nevojshme, që nga ndërtesa, personeli, veprimtaria e konsullatës etj. përballtoheshin nga konsulli i nderit. Zogu, sig mësova, e dha miratimin, më pas lëshoi për këtë edhe një dekret të vegantë dhe Maroth Marothi, nënshtetas francez, me origjinë hungareze, u akreditua konsull i Shqipërisë në Bruksel të Belgjikës! Një lëmsh i vërtetë shtetesh e titujsh që kurrë s'mora vesh se ç'përfitoi në fakt njëra apo tjetra palë. Por nga e gjitha kjo, unë, studenti i varfër e i papunë, pata një përfitim jo të vogël: gjeta një punë, që, sig do të flas më poshtë, vërtet ishte zero në pikëpamje të diplomacisë, por më ndihmoi në aspekte të tjera.

Fillimisht detyrën e nisa me orë, duke u dhënë mësim konsullit dhe përgjegjësit të shtypit (edhe ky francez), mbi bazën e një libri që mora në legatë. Ditët e para e mora seriozisht dhe bëja përpjekje që t'ua shpjegoja mirë mësimet, por ata e kishin këtë marrje mësimi sa për t'i thënë qeverisë sonë se po mësonin shqipen! Shpejt u binda që ata jo më shqipen s'kishin për ta mësuar, por as për Shqipërinë, për historinë, jetën e problemet e saj s'kishin për të mësuar ndonjë gjë. Më pyetën se cilat ishin festat tona kombëtare, në ç'datë binin, i shkruan ato në blloqe që të mos lodheshin për t'i mbajtur mend dhe me kaq vazhdonin punën e vet. Por anën formale të mësimi të shqipes nuk e ndërprejnë, sepse, si duket, pritin dekreten e akreditimit zyrtar.

Kaluan kështu disa muaj që veja e vija për të dhënë mësim, më binin këmbët, por nga e gjitha kjo, përveç 40 frangave në javë, kisha edhe përfitime të tjera. Njihesha me rrugët, me sheshet e monumentet e Parisit, shikoja çdo gjë me vërejtje, më kujtoheshin emra, vende, statuja për t cilat kisha mësuar në sliqollë ose kisha lexuar në libra *Fragmente të historisë dhe të romaneve* që kisha kënduar i shihja tani të gjalla, por një pjesë edhe të ndryshuara. Këndoja emrat e rrugëve dhe më kujtoheshin njerëzit e shquar të historisë e të letërsisë franceze, luftërat që ishin udhëhequr nga gjeneralë e mareshalë emrat e të cilëve o shkruheshin në histori, o në ndonjë pllakë muri, ose ishin zhdukur pa nishan. Kaloja shumë herë në quais* *(Rrugët buzë Senës.) të lumit Senë, vizitoja bukinistët se më pëlqenin librat, dhe herë pas bere blija nga ata që ishin të përdorur dhe shumë të lirë. Vetëm atje mund të blija unë. Duke lexuar «*La guerre civile en France*», përpiquesha të gjeja rrugët e bulevardet ku u zhvilluan luftimet dhe u ngritën barrikatat; ca i gjeja, ca ishin ndryshuar. Shkova në «*Père Lachaise*», ku pashë murin e komunarëve heroikë. Një herë tjetër vizitova «*Notre-Dame de Paris*». Tërë kohën që shikoja statujat, vitrotë, shimeret, përfytyroja më qartë romanin e Hygoit, historitë me Kuazimodon, me Esmeraldën dhe dhinë e saj, me «*pasionet*», revoltën dhe zhibenë e Monfokonit*. *(*Le gibet de Montfaucon*: trekëmbëshi i Monfokonit, ndërtuar në lokalitetin e Monfokonit në shekullin e 13-të për ekzekutimin e të dënuarve me varje.)

Mes vendeve ku shkoja shpesh e me admirim të veçantë ishte rruga para hotelit «*Kontinental*», në mes të Parisit, atje ku 15 vjet më parë djali trim i Shqipërisë, patrioti e demokrati i shquar Avni Rustemi, shtriu përtokë tradhtarin me damkë, Esat pashë Toptanin. Përpiquesha të përfytyroja sa më qartë rrugën që kishte ndjekur Avniu për të gjetur pozicionin e saktë nga do të qëllonte mbi gjeneralin tradhtar e kopuk, momentin kur Esat pasha doli nga hoteli, gjullurdinë e rrëmujën që u shkaktua ndër kalimtarët kur dëgjuan të shtënat dhe panë si u shtri gjerë e gjatë anadollaku e njeriu i njëqind flamurëve, befasimin e të gjithëve, kur atentatori, një djalë i ri, shtatshkurtër, i zbehtë por me një shikim të qetë e të vendosur, pa asnjë hezitim, me revolverin që e kishte grykën ende të nxehtë, u dorëzua vetë tek autoritetet franceze. Të shtënat e Avni Rustemit në Paris nuk qëruan nga faqja e dheut vetëm një tradhtar. Ato buçitën atje duke ngritur lart në opinionin publik francez e të vendeve të tjera emrin e Shqipërisë së vogël e trime, vendosmërinë e bijve të saj për të mbrojtur të drejtat e interesat e atdheut pa pyetur për jetën e tyre.

Në Paris, pavarësisht se vështirë të gjesh rrugë e shesh kutë mos ketë pliaka, buste ose monumente në kujtim e nderin: të figurave të ndryshme ose të ngjarjeve të ndryshme të historisë, kuptohet, nuk kishte as pllakë as ndonjë shenjë tjetër në përkujtim të aktit të lartë të Avni Rustemit. Por për çdo shqiptar që shkel në Paris vendi ku kreu aktin e lartë Avni Rustemi është e do të jetë një vene, i

shenjtë, vend ku secili shkon e përkul kokën me nderim para veprës së Avniut, vend ku edukohen atdhedashuria e guximi revolucionar për të mos u përkulur para asgjëje, për të mos vënë asgjë mbi interesat e lartë të atdheut. Me të tilla ndjenja e emocione shkoja dhe unë atje, në ditët e vështira të jetës sime prej studenti.

Në Paris u njoha edhe me emigrantë politikë, si Kol Tromarën, Qazim Koculin, Ali Këlcyrën, Beqir Valterin e të tjerë. Të gjithë luanin kumar, poker, dhe merrnin pjesë në bastet për garat e kuajve, me përjashtim të Sejfi Vllamasit dhe të Rexhep Mitrovicës. Me këta më njohën Remziu, Qemali a ndonjë tjetër. Më prezantonin me ta si kunati i Bahri Omarit dhe për këtë arsye ata më jepnin nganjëherë dorën dhe më përshëndetnin. Ata as që merreshin fare me politikë, për Shqipërinë as çanin kokën fare, pse ishin larg dhe lajme e njerëz nuk shkonin në Paris, si në Bari. Këta farë politikanë nuk kishin as unitet të paktën shoqëror me njëri-tjetrin, ata vetëm të luanin kumar dinin, dhe përpiqeshin kush të rripte shoqi-shoqin. Para merrnin mirë, kushedi nga ç'grazhd, pse jo vetëm jetonin në apartamente që kushtonin, po të gjithë frekuentonin kafenetë e mëdha, si «La Coupole» në Monparnas. Rrallë i shihje në kafenetë popullore, si «Dupont» që kishte në çdo rrugë.

Të gjithë këta myteberë, gjoja antizogistë, i ktheu Italia kur okupoj Shqipërinë, i organizoi në luftë kundër popullit dhe Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Bëmë gjithë përpjekjet që në mos me popullin e lëvizjen, të paktën të mos ngriheshin kundër, por ata e kishin vendosur rrugën e tradhtisë, u bëne krerë të Ballit Kombëtar, na goditën hapur me armë, prandaj ne krerëve u dhamë atë që meritonin, si kriminelë lufte, disa të tjere i dënuam me burg, kurse një pjesë u arratisen me varka angleze dhe ngordhën përsëri si tradhtarë të urryer në arrati, si agjentë dhe spiunë të armiqve imperialistë kundër Shqipërisë.

Partia Komuniste Franceze në lagjet e punëtorëve kishte disa qendra leximi, ku unë shkoja për të lexuar shtypin e partisë, për të lexuar «Anti-Dytingun» e Engelsit, pjesë dhe komente të «Kapitalit», dëgjoja leksione për Leninin dhe për Stalinin. Këto më ndihmuan shumë në formimin e botëkuptimit tim marksist-leninist. Idetë e komunizmit shkencor më rrënjoseshin thellë në zemër, kujtoja vendin tim të mjerë, shokët e Liceut të Korçës, punëtorët, shikoja mjerimin e proletarietit francez, shikoja edhe mjerimin tim personal dhe, megjithatë, më dukej se bëhesha më i fortë. Asistojta në mitingjet e hapëta që organizonte në sheshe e në stadione Partia Komuniste Franceze dhe atje shihja forcën e proletarëve, forcën e ideve të pavdekshme të Marksit.

Do të fitojmë, thosha me vete, por do të fitojmë duke luftuar.

Jeta më mësoi, vuajtjet më kalitën, pse, sa ndenja në Paris rreth 10 muaj, s'e ngopa kurrë barkun me bukë, pale me gjellë. Në mbrëmje shumë herë haja nga një «briosh», në drekë pak tru të zier me ca patate si kontorno dhe një copë bukë. Ngandonjëherë rrija edhe 24 orë pa ngrënë, para se të merrja ato pak franga nga puna që bëja.

Këpucët më ishin grisur, prandaj i kërkova Fahrijes të më dërgonte 200 franga dhe ajo m'i dërgoi. Me to bleva një palë këpucë, një palë çorape dhe një këmishë blu, se e bardha duhej larë çdo dite dhe më grisej. Një këmishë të bardhë që kisha, e ruaja kur veja i jepja Marohtit mësimin e shqipes.

Më në fund një ditë ky më tha:

- Çdo gjë është gati për konsullatën në Bruksel! Nga fundi i javës të vini të merrni dy rroga avancë dhe paratë e rrugës me tren të klasës së dytë. Kemi lajmëruar ambasadën e Belgjikës në Paris që të shkosh të marrësh vizën e hyrjes. Rroga jote do të jetë 600 franga belge dhe do të flesh në konsullatë, kështu që qira s'do të paguash. U gëzova shumë dhe renda te Qemah e Remziu për t'u dhënë s'hariqin.

Pastaj shkova në qendrën e leximit të Partisë Komuniste Franceze dhe i kërkova përgjegjësit nëse mund të më organizonte një takim me shokun Pol Vajan Kuturie, se kisha diçka për t'i thënë. Ai më tha të shkoja të nesërmen të merrja përgjigje. Kur shkova në mëngjes më porositi të shkoja në zyrat e «Huma»-së* *(Shkurtimi i titullit të gazetës «L'Humanité».) se do të më priste Vajani, ose ndonjë shok tjetër. Shkova dhe për fatin tim më pritivetë Vajani. Ishte një mesoburrë nga shtati, me një fytyrë të qeshur, me sy të ëmbël, që egërsoheshin përnjëherë kur fliste për fashizmin dhe për borgjezinë. Vajani më dha do rën dhe më uli. I tregova shkurtimisht historinë time.

- Tash së fundi, - e njoftova, - m'u paraqit rastite punoj në Bruksel si sekretar privat në konsullatën shqiptare që do të çelet, me konsull një të huaj. Atje do të merrem edhe me shtypin. Do t'ju lutem për një gjë, vazhdova. - Unë jam komunist me gjithë shpirt, partia, shtypi juaj dhe mjerimet e popullit tim më kanë bërë komunist. Ngandonjëherë, nga lajmet që mund të marr nga Shqipëria, a mund të dërgoj në «L'Humanité» nga ndonjë artikull të vogël për të demaskuar regjimin feudal të zogut?

Vajani më shikoi me ata sytë e ëmbël dhe më tha:

- Posi, të dërgoni, shok, do t'ju botojmë me gjithë qejf.

Unë u gëzova, sikur kapa qiejt, dhe u ngrita. Vajani më propozoi të rrija dhe ca dhe më pyeti:

- A mund të na flisni ca për Shqipërinë, për gjendjen shoqërore, për klasën punëtore, për fshatarësinë, pse ne dimë, por duhet të pohoj, nuk dimë shumë gjëra.

- Me gjithë qejf, - pranova unë dhe ia filiova, dulce bërë kujdes të mos zgjatesha shumë, se i haja kohën dhe dulce dashur që t'ia bëja sa më të qartë ç'më kërkonte. Qëndrova një orë e gjysmë. M'u duk se i ngjalla interes, pse mbante shënime dhe, kur më dha dorën, ma shtrëngoi dhe më tha:

- Frëngjishten e flet mirë, duhet edhe ta shkruash. Për çdo artikull që do të na dërgosh, vur pseudonim. Shkrimet që do të na vijnë nga Brukseli e që do të flasin për Shqipërinë do të kuptojmë se vijnë nga ju, shoku Hoxha.

Kur u ndamë, Vajani më theksoi:

- Ta duash dhe të luftosh për komunizmin.

- Deri në vdekje do të luftoj ! - i thashë.

Kaq ishte me sa më kujtohet pjekja ime me këtë komunist të madh, me të cilin unë, një student i ri, pata fatin e madh të bisedoja dhe ai të më dëgjonte për një orë e gjysmë tek i flisja për mjerimet, luftën dhe shpresat e popullit tim.

Në ditën e caktuar nga konsulli, mora me vete ato pak bagazhe që kisha, kryesisht pak tesha e shumica libra, i hipa trenit për në Bruksel dhe u nisa. U mbyll kështu një faqe e jetës sime në Francë, ku qëndrova në Monpelje e Paris, rreth katër vjet. Ruaj kujtime e përshtypje të mira për këtë vend e popullin e tij, të cilët m'i kishin bërë të njohur e të dashur jo vetëm shkolla e librat që lexoja, por edhe njohja e kontaktet direkte gjatë katër vjetëve. Ky vend kishte një të kaluar të pasur me luftëtarë të mëdhenj të penës e të mendjes, me luftërat e pareshtura për liri e përparim e sidomos me Revolucionin Borgjez Francez që ndikoi aq shumë në Evropë e në botë. Por unë, si mijëra e mijëra të tjerë që kanë pasur rastin ta njohin nga afër atë vend, nuk e admirova Francën e popullin francez vetëm për ato çka i takonin historisë. I admiroja e i respektoja njerëzit e saj të letërsisë, të kulturës e të shkencës për krenarinë që kishin për paraardhësit e tyre, për skrupulozitetin dhe vullnetin që shfaqnin në punë, për ndjeshmërinë që kishin ndaj f'ateve të vendit të tyre. Në atyrisht kishte në Francën e asaj kohe edhe shumë gjëra që s'shkonin. Kishte atje një borgjezi të pasur, të konsoliduar, tepër ambicioze e tepër shtypëse ndaj masave, kishte një aparat të fuqishëm shtetëror që ishte i gatshëm të shtypte, në emër të mbrojtjes së rregullit e të ligjit, çdo gjë që mund të cenonte rendin e rregullin zyrtar; kishte sidomos në ato vite të rënda e plot tronditje politike e sociale, të tillë politikanë të cilët, për një mijë e një arsye e shkaqe, pas disa vjetësh do ta çonin Francën në disfatë e kapitullim të turpshëm. Por, unë në ato vite s'kisha të bëja e as më duhej të kisha të bëja me këto «anë» të Francës. Kisha shkuar atje të mzoja dhe Franca ka pasur e ka shumë ç'të mësosh. Edhe në këtë sferë, në sferën e Francës së letërsisë, të kulturës e të shkencës, kishte, krahas mrekullive të mendjes e të shpirtit krijues të njerëzve, edhe shumë eksese, yje fallco që ndizeshin e shuheshin, por të gjitha këto, në një vend si Franca, ishin të paevitueshme. E rëndësishme ishte të qëndroje larg tyre, e rëndësishme ishte të mësoje te Franca atë çka kishte të mirë e mësimdhënëse ajo.

Largohesha andej me mendimet e përshtypjet më të mira për popullin francez, për njerëzit e thjeshtë punëtorë e sqimatarë, me të cilët s'mbaj mend të kem pasur konflikte apo grindjen më të vogël. Largohesha në vitet kur atje po rriteshin si kurrë ndonjëherë hapësira dhe dimensionet e luftës klasore, në vitet kur proletariati francez po ngrihej në demonstrata e mitingje të fuqishme në mbrojtje të të drejtave të tij, në mbrojtje të atdheut e të botës nga rreziku kërcënues i mortajës fashiste. Pata rastin kaq e kaq herë të rreshtohesha edhe unë, studenti proletar, me proletarët e

uzinave e të minierave në mitingjet që organizonin sindikatat ose Partia Komuniste Franceze. Ikja kështu nga ky vend më i pjekur, më i mësuar, më i regjur, Davarësisht se në shkollë nuk mora ndonjë diplomë. Veten e ndieja më të fortë, pse çka kisha lexuar, çka kisha dëgjuar, çka kisha parë dhe çka kisha vuajtur shpirtërisht edhe ekonomikisht, ishin për mua diploma që do të më shërbenin, siç më shërbyen, më shumë se një letër e shkruar me *en tëte** *(Frëngjisht - këtu në kuptimin: me titullin, emërtimin.) të një fakulteti. Puna e diplomës ishte çështje «e fitoje ose jo provimin». Unë e ndieja se kisha mësuar edhe në fakultete, por më shumë në jetë dhe si autodidakt.

V

NË BELGJKË – BRUKSEL

Udhëtimi me tren nga Parisi në Bruksel ishte shumë më i shkurtër se nga Monpeljeja në Paris u dhe, veç kësaj, gjendja ime shpirtërore ishte disfi më e ngritur. Tanfi isba i siguruar, të paktën përkohësisht, me mjetet e jetesës; kisha një punë, të cilën vërtet s'e përfytyroja dot si do të qe e si do ta kryeja, por thellë në ndërgjegje nuk shqetësohesha shumë. Në fund të fundit s'kisha për t'u bërë diplomat, edhe sikur gjithçka të më shkonte mbarë në konsullatë. Në Bruksel kishte një universitet të mirë e të konsoliduar dhe kisha marrë premtimin e konsullit se do të më ndihmonte për t'u regjistruar në Fakultetin e Drejtësisë.

Dukej pra se punët po më ecnin për mbarë dhe kjo, pa dyshim, i bëri më të këndshme ato orë që zgjarbi udhëtimi Paris-Bruksel. Shihja nga vagoni peizazhin që shpalosej, fusha e livadhe pa mbarim, tokë e begatë, e kultivuar dhe e mbajtur me kujdes, tufa lopësh e kuajsh nëpër kullota, buzë xhadesë e kanaleve, fshatra e qyteza të bukura e të sistemuara, me çati karakteristike të kuqe ose bojë hiri. Peizazhi ishte thuajse i njëjlojtë si në pjesën franceze ashtu edhe kur kaluam kufirin e hymë në Belgjikë.

Dhe ja më në fund Brukseli. Ishte një qytet i madh, por kurrsesi me madhësinë e bukurinë e Parisit. Zbrita nga treni, dola nga stacioni dhe mora një taksì. I dhashë adresën: «Rue de la Loi», nr. 155. Kapërcyem lisa rrugë që ngjiteshin, kapërcyem një katedrale dhe dolëm në një rrugë të gjatë, të gjatë që nuk kishte të mbaruar. Gjëja e parë që më ra në sy ishin tramvajet. Në këtë qytet kishte shumë tramvaje që u binin lagjeve kryq e tërthor. Nuk shihje as shumë automobila dhe as shumë autobusë si në Paris. E gjithë kjo rrugë e gjatë ishte «Rue de la Loi».

U futëm në një portë me kangjella he'kuri, pjesë e një rrethimi të madh të të gjithë vendit me kangjella të tilla. Brenda në këtë territor ishin 5-6 a 7 paliate ose *grantte-ciel* me 10 a 11 kate. Në adresën që më kishin dhënë, më kishin shënuar numrin e pallatit dhe të katit, më duket i pesti.

Mora valixhen, i pagova paret shoferit të taksisë dhe u nisa drejt ashensorit. Para se të futesha më ndaloj konsierzhi* *(Nga frëngjishtja - portieri.) i pallatit dhe më pyeti:

- Kush fieni dhe ku shkoni?

I dhashë pasaportën dhe i tregova se isba sekretari i konsullatës shqiptare.

Ai pa pasaporttën time dhe më tha:

- Jam lajmëruar për ardhjen tuaj, merrni ashensorin, shtypeni në këtë numër dhe do të gjendeni në apartamentin e konsullatës, fiera përballë.

U ngjita dhe i rashë ziles. Pas pale m'u hap fiera dhe një grua me flokë të thinjura më shikoi, më pa valixhen dhe më pyeti:

- Ju fieni zoti Hoxha?

- Po, iu përgjigja.

- Urdhëroni, - më tha dhe desh të më merrte valixhen.

- Jo, - i kundërshtova unë, - e mbaj vetë.

- Atëherë, ndiqmëni mua, - tha ajo, - do t'ju çoj në apartamentin tuaj.

«Paskam dhe një apartament më vete», - thashë me mendjen time, duke parë korridoret dhe dhomat e hapura plot me kanape, me kolltukë e me llamba të mëdha. Apartamenti ishte një dhomë me krevat, me një kolltuk, një tavolinë e një fron dhe një derë që të çonte në një banjë të vogël.

- Këtu do të banoni, - më tha gruaja, emri i së

cilës s'më kujtohet. - Çlodhuni dhe në orën 6 pasdreke ju pret atasheu i shtypit në zyrën që është më tutje (jashtë kthinës ku do të flija unë).

Më vonë mora vesh se kjo zonjë ishte femme de chambre e gruas së atasheut të shtypit, një plakë hungareze, ndërsa i shoqi ishte më i ri. Ky mund të ishte nja 55-60, ajo qe nja 70 vjeç.

Siç e kam theksuar, edhe konsulli, edhe atasheu i shtypit, ishin të pasur dhe funksionet diplomatike i kërkonin e i merrnin si tituj nderi për t'u përzier në trupin diplomatik dhe për të marrë dekorata. Bile edhe Zogu, do të mësoja më vonë u kishte varur të dyve nga një nishan.

Në fakt, konsullin, sa ndenja në Belgjikë, e pashë a s'e pashë nja tri-katër herë, po kështu edhe atasheun e shtypit, i cili kishte apartament të veçantë, po në ndërtesën e konsullatës. Ata vinin në Belgjikë fio për punë të konsullatës, për të cilën as që çanin kokë fare, por për të marrë pjesë në ceremoni e bankete që jepeshin për trupin diplomatik në ditët e shënuara, në festat nacionale të Belgjikës ose të mbretit, të mbretëreshës, o të Vitit të Ri. Të tillë ishin këta përfaqësues të huaj e kozmopolitë, që përfaqësonin mbretërinë e poshtër të vendit tonë. Ata, siç kam shkruar edhe më lart, Shqipërinë nuk e njihnin gati fare, dinin diçka nga biografia e Zogut dhe e disa personaliteteve të regjimit dhe kaq ishte për ta Shqipëria. Unë i vura ca në korent, por e shikoja se çka u thosha për historinë e vendit, nga një vesh u hynte nga tjetri u dilte. Po kështu ndodhi edhe me ato nocione të para të gjuhës sonë që u mësova, të cilat shpejt ua kishte marrë era.

Në orën e caktuar erdhi në apartamentin tim zonja në fjalë, e cila bënte, siç po dukej, edhe të zonjën e shtëpisë; jashtë apartamentit të plakës, të cilën e pashë vetëm tri-katër herë. Ajo më njoftoi se po më pritnin në zyrë.

Isha i veshur dhe u paraqita. I dhashë dorën konsullit dhe shefit të shtypit dhe u ula pranë tavolinës së punës. Ata rrinin në kolltukë. Siç dukej, kjo ishte zyra ime, me dritare të mëdha, plot diell, andej shihje Brukselin dhe parqet rreth e rr otull. Vetëm një gjë s'më pëlqeu: mbi kokën e tyre, përballë meje ishte varur në mur portreti i Zogut. Isha i detyruar që, kur ngrija kokën, të shihja xhelatin. Zyra e tyre e përbashkët ose më mirë salloni me kolltukë, me qilim, me llambadarë e abazhurë të mëdhenj, ishte përballë. Sii kuptova, ata as që kishin ndër mend të bënin ndonjë punë në konsullatë; atë punë që do të duhej, do ta bëja unë, kurse ata vinin në Bruksel sa bënin një *atte de présence** *(Frëngjisht - paraqitje.) dhe iknin pas disa ditësh. Kjo gjë ishte në interesin tim.

Foli konsulli i pari dhe më vuri detyrat

- Duhet të paraqitesh në Ministrinë e Jashtme dhe të kërkojsh regjistrimin tënd si kancelar i konsullatës. Unë do të të jap letrën me firmën time që të paraqitesh dhe emri juaj të shënohet në Anuarin diplomatik konsullor. Duhet të sillesh mirë, se do të përfaqësosh vendin tënd etj., etj., - vazhdoi ky i huaj hungarezo-franko-belg e më bëri nja pesë minuta mësim për detyrat e mia ndaj atdheut (Gri, thosha me veten time, ti po më jep mësim për atdheun tim!). Pasta] vazhdoi të më thotë:

- Ti do të japësh viza për ata që do të kërkojnë të venë në Shqipëri, me përjashtim të komunistëve, të cilët i tremi armiq! (Fol, i thosha me vete, ti armikun e tre brenda dhe të qëndron përpara.) - Ata që kërkojnë vizë, duhet të mbushin një formular, përveç atyre që rekomandohen nga Ministria e Jashtme Belge. Tregtarëve, afaristëve që kërkojnë të shkojnë në Shqipëri, jepu vizë. Atyre do t'u japësh shpjegimet që kërkojnë pr të blerë ose për të shitur dhe për këto gjëra drejtoju legatën në Paris, e cila të jep shpjegime dhe ti duhet t'u përgjigjesh.

Pas këtyre mësimëve «diplomatike» u ngrit në këmbë, hapi dy sirtarët e tavolinës sime dhe vazhdoi:

- Këtu ke vulat, ke pullat, ke formularët, ke dhe regjistrat. T'i mbash në rregull e pastër. Ato që do të harxhosh për pullat si dhe taksat që do të marrësh, do t'i regjistrosësh kështu dhe ashtu. I ke të qarta? - më pyeti.

- Shumë qartë, zoti konsull!

- Për këto do të më japësh llogari mua!

- Si urdhëron, zoti konsull!
- Kaq kisha unë, - tha më në fund, - tash je përgjegjës.
- Dakord, - iu përgjigja.

E mori pasta] fjalën atasheu i shtypit i legatës sonë në Paris, i cili më tha afërsisht:

- Për çështjen e shtypit juve këtu, në konsullatë, do t'ju vijë nga një agjenci e shtypit kupyra nga çdo gazetë që do të shkruajë qoftë edhe ndonjë lajm të vogël mbi Shqipërinë. Ne do të abonohemi në këtë agjenci. Ju do të treni një fond të veçantë për këtë. Me të marrë kupy rat, do të blini pesë numra të asaj gazete që tra shkruar për Shqipërinë dhe do t'u presësh artikullin ose lajmin. Këto pasta] do t'i ngjitësh në një letër të bardhë.

Në krye do të ngjitësh titullin e gazetës dhe datën e numrin e saj. Këto, kuptohet, duhet të bëhen pastër; 2 kopje prej tyre do t'i dërgosh në Ministrinë e Jashtme në Tiranë, ose në legatë në Paris dhe një do ta mbash në zyrë. Në qoftë se artikulli është në ndonjë revistë të ilustruar, të tërë revistën dër goje në adresat që të thashë në aq kopje si dhe gazetat. E treni të qartë? - më tha.

- Shumë të qartë, - iu përgjigja edhe këtij. (Se mos ishte ndonjë filozofi e madhe!)

- Atëherë ne mbaruam! - më thanë. - Fillo nga

puna në mëngjes dhe vazhdo deri në ora 13^{oo}, kur zyra duhet të jetë hapur, pasta] fieni i lirë.

I falënderova, por akoma pa dalë, më kërkuan që të gjeja administratorin e pailatit, që i kishte zyrat ca andej oborrit, dhe t'i lutesha që të më jepte adresën e ndonjë punishteje ose piktori gravurash për të na bërë një tabelë prej bronzi për konsullatën. E mora dhe këtë detyrë e u largova.

Ata qëndruan edhe nja tri-katër ditë, më takuan o s'më takuan edhe nja dhjetë minuta të tjera dhe u bënë gati të niseshin për në Paris, ku kishin qendrën. Gjeta rastin dhe i kujtova konsullit premtimin që më kishte dhënë për të më rekomanduar që të regjistrohesha për drejtësi në Universitetin e Brukselit.

- Ah, po, - tha. - Do ta bëjmë. Formulo një letër në formë kërkese nga ana ime, shkruaj ç'quani ju të arsyeshme se duhet shkruar, shtypeni dhe silleni ta firmos e pasta] ta vulosim.

- Faleminderit, - i thashë, - do t'ju jem...

Por ai më ndërpreu:

- Mos e vononi letrën për universitetin se na duhet të nisemi shpejt për në Paris.

Kalova matanë, e përpilova letrën, ia çova konsullit dhe brenda dy-tri sekondash Konsullata Shqiptare në Bruksel vulosi aktin e parë të veprimtarisë së saj : një letër rekomandimi drejtuar rektoratit të «Universitetit të lirë të Brukselit».

Pas kësaj konsulli dhe atasheu i shtypit u larguan, kështu që unë ngela vetëm. Apartamentin e tyre e mbyllën, sfida që me valixhe erdhën dhe me valixhe ikën. Më mbetën çelësat e konsullatës sonë, që përbëhej nga zyra ime, dhoma e pritjes, dhoma ime e gjumit dhe një kuzhinë e vogël.

Vura zyrën e sirtarët në rregull dhe pasta] iu drejtova fotografisë së Zogut në mur: «Qen bir geni, zbrit andej nga muri, se s'të shoh dot, përpara!» dhe e mora e vura prapa një dollapi në kuzhinë. Në qoftë se do të vinte ndokush për vizitë, natyrisht do ta futja në sallon dhe, po të vinin konsulli e të tjerë, do ta vija prapë portretin ku qe, dulce gjetur një arsye. Por ata edhe ato herë që erdhën, lajmëronin dy-tri ditë më parë, kështu që më pas e fjeta mendjen. M'u duk se do të më njoftonin gjithmonë përpara, por, siç do të shkruaj më poshtë, pikërisht nga kjo bindje do ta pësoja.

Të nesërmen a të pasnesërmen takova administratorin e pallateve, një burrë nja 50 vjeç me syze, i cili më hriti me njerëzi, më pyeti si isba rregulluar lart, më dha numrin e telefonit të tij, me qëllim që, po të kisha nevojë për ndonjë gjë, Vi telefonoja. Pastaj më tha:

- Ne kemi edhe shër byes në dispozicion të aparta mentit për të fshirë zyrat dhe për të rregulluar dl:omat. Çdo gjë është inkluduar në qiranë e tërë katit të konsullatës.

E falënderova dhe i kërkova të më bënte tabelën e konsullatës, i dhashë modelin me stemën e mbr etërisë në mes etj.

- Patjetër, do ta rregullojmë ne çdo gjë! - më tha.

Kështu që nuk kishte pse të çaja kokën për tabelën.

Me fjetjen isba rregulluar si asnjëherë tjetër në jetën time. Tani më mbetej të shihja jashtë si ishte jeta, shtrenjtësia, sidomos ushqimi, pse në fillim 600 franga belge në muaj die m'u dukën. Sidoqoftë

më duhej të shihja një herë, se isba djegur në Francë e sidomos në Paris, kur kisha ngelur e fjetur edhe pa bukë. «Prandaj më kujdes, - i thashë vetes në fillim, - ruaj Enver frangat, rregullo jetën që të mos vuash.» Ndërkohë rrobat më ishin palosur, duhej të ekonomizoja për të blerë ndonjë kostum të zi që të dukesh si zyrtar; duhej po ashtu të regjistrohesha në «Université libre de Bruxelles».

Vendosa pra të vizitoja e të njihja qytetin dulce filluar nga qendra. Duhej të zbrisja «Rue de la Loi» gjatë sa s'behej. Rrugën e parë e bëra në këmbë, herë dulce ecur drejt, e berë e dulce zbritur, se i tillë ishte terreni.

U mbyta në djersë, por isba kurioz të shihja shtëpitë e dyqanet nga të dyja anët e saj. Shtëpitë në këtë rrugë nuk ishin me shumë kate, ishte një *quartier résidentiel style* 1900. Dyqane kishte tek-tuk, kryesisht me artikuj ushqimorë, por edhe ndonjë me lloj-lloj mallrash e artikujsh. Në këtë rrugë ndodheshin rezidenca e Ministrisë së Jashtme, qendra administrative, në qoftë se nuk gabohem «Théâtre de la Monnaie» etj. Pas këtij udhëtimi njohës, vendosa një rregull të përgjithshëm: kur të zbrisja në «Rue de la Loi», të ecja në këmbë, kur të ngjitesha, të merrja tramvajin, se ngjitja ishte shumë e lodhshme.

Puna që kisha në konsullatë ishte një *sinécure**, *(Frëngjisht - punë e rehatshme.) asgjë e lodhshme, asgjë e komplikuar sepse shtypi belgjian nuk shkruante shpesh për Shqipërinë, gati e injoronte. Artikuj të gjatë në gazetë shumë rrallë m'u sinjalizuan nga agjencia ku ishim abonuar dhe në raste të ulla unë veproja në mënyrën që tregova më lart. Lajme të shkurtra për ndonjë eveniment që ndodhte në Shqipëri, kishte më dendur, ato i jepnin agjencitë e Romës, «Rojteri» o ndonjë tjetër, i përsër ishin edhe ajo e Belgjikës dhe i botonin gazetën. Ç'ishin këto lajme? Rrëthë vajtjes dhe ardhjes nga Shqipëria të ndonjë ministri italian o të ndonjë qeveritari shqiptar në Romë, ndonjë lajm për Zogun, që priti filanin, për ndonjë kredi oso borxh që Italia i jepte Shqipërisë etj. Lajme të këtij lloji botoheshin në ndonjë qoshe të gazetës dhe zinin gjithë-gjithë tri oso katër radhë.

Në një moment, aty nga gjysma e dytë e gushtit 1935 erdhën lajme nga agjencitë që flitnin për «kryengritje në Shqipëri kundër Zogut». Përnjëherë i gëzuar u çova, u veshja, shkova në kuzhinë dhe iu drejtova fotografisë së Zogut, që e kisha futur në një qoshe: «Ah, tradhtar, ah, i poshtër, të erdhi fundi, do ta gjeshe vdekjen dhe do t'i paguash krimet që i ke bërë popullit». Por, flashet e para nuk thoshin asgjë se ku kishte plasur «kryengritja» dhe kush e udhëhiqte këtë.

Zbrita, bleva vandakun me gazeta, u hodha një sy aty për aty dhe pashë se të gjitha e jepnin njësoj lajmin. Disa zgjatëshin për jetën e Zogut, për lidhjet me Italinë etj. Ndonjëra botonte edhe ndonjë foto të Zogut e të princësive, ku këta vërtet kishin dalë të krekosur e të fryrë kushedi në ç'rast vizite oso cerimonie, por titujt e lajmet mbi «kryengritjen» sipër fotove e bënin më qesharak fodullëkun e tyre. I prova kupytrat si zakonisht, i ngjita në Tetra dhe po i vija në stivë. Të nesërmen, që në mëngjes dota përsëri dhe në kioskun afër bleva «Le Soir», «l'Indépendance Bolge» e nja dy a tri gazeta të tjera. I këndova me kuriozitet të madh, që të mësoja ç'behej në atdhe. Ditën e dytë gazetën shkruanin se «kryengritja» ka plasur në jug të Shqipërisë, në Fier dhe se po shtrihej edhe në zona të tjera. Ditët më pas u shtuan lajmet se «kryengritja është organizuar nga forca opozitare», se «kundër Zogut janë ushtria e xhandarmëria» etj., por pikërisht këto njoftime që lexuesit perëndimor i bënin përshtypje, mua më dekurajuan. E dija se në «forcat opozitare» të afishuara, futeshin shokët e miqtë e Ali bej Këlcyrës e ndonjë Vrionas, që mund të kishin njëqind pakënaqësi e grindje me Zogun, por në thelb ishin e mbeteshin njerëz të regjimit e të vetë mbretit, që s'kishin asgjë parimore e konsekuente në veprimet e tyre «antizogiste». Për më tepër e dija se, po qe se «kryengritja» për të cilën flitnin gazetën ishte vetëm vepër e tyre, lajmet oso ishin të gënjeshtërtë, oso, edhe sikur vërtet të kishte shpërthyer ndonjë gjë, do të shtypej shpejt. Populli nuk do të ngrihej me Ali bejtë e Vrionasit në kryengritje, le që vetë këta afendikonj, nuk do të mbështeteshin e s'mund të mbështeteshin te populli, edhe sikur të donin të bënin ndonjë gjë.

Më ranë ca shpresat nga lajmet e ditës së dytë, por fakti që gjithë shtypi i kushtonte vëmendje dhe vend asaj ç'ndodhte në Shqipëri, më bënin të mendoja se ndoshta e vërteta onde s'dihej mirë dhe uroja që lëvizja të ishte sa më e gjerë dhe e mbështetur në popull. Sillja ndër mend ata elementë patriotë oso demokratë që mund të kishin dorë në organizimin e një lëvizjeje të tillë, por Bado që e vrisja mendjen, s'gjeja dot një emër ku të përqendrohesha. Patriotët e demokratët e vër tetë, të

sprovuar në vitet 20-ë, veçanërisht në atë lëvizje që çoi në Revolucionin e Qershorit 1924, oso ishin vrrarë, e këtu kisha parasysh figura si Bajram Curri, Luigj Gurakuqi e të tjerë, oso ishin hedhur në mërgim e ishin shpërndarë në vende të ndryshme. Dija diçka mbi historinë e tyre në mërgim, dija se ishin përçarë, për të mos thënë në shumë, të paktën në dy grupe të mëdha. Njëri ishte grupi i KONARE-së, i cili qëndronte në pozita më të shëndosha dhe në njërën oso në tjetrën masë hislite lidhje edhe me Korninternin, tjetri ishte grupi i «Bashkimit kombëtar», ku përfshiheshin gjithë tipat që njoha në Bari e në Paris, si Ali Këlcvra e Sejfi Vllamas, Bahriu. sheh Karbunara e të tjerë. AL të kishin vallë gisht këto grupe në organizimin e «kryengritjes» për të cilën shkruanin gazetat? Si zor, megjithëse zemra ma dome që në këtë çështje të ishte dora e KONARE-së. Ndonjë gazetë; bile shkruante, pa dhënë burim, se për ngjarjet në Shqipëri kishin dorë «komunistR». «bolshevikët», gjë që, natyrisht, në ngazëllente. Kisha 5 vjet që isha larg atdheut dhe më dukej çudi që brenda këtyre viteve lëvizja komuniste atje të kishte bërë një hap kaq të madh përpara sa të shpërthente një kryengritje e armatosur kundër regjimit në fuqi. Vështirë, tepër vështirë, mendoja. Do të vijë dita që komunistët do ta bëjnë atë që duhet bërë thosha me vete, por tanfi për tanfi është e pamundur të presësh prej tyre një gjë të tillë. Megjithatë, i jepja gajret vetes, ndodhin edhe gjëra që s't'i pret mendja. Vazhdoja prerjen e lajmeve dhe i vija në stivë çdo ditë. Më pas gazetat shkruanin që forcat ushtarake mbretërore komandoheshin nga një kolonel, për të cilin në Shqipëri kisha dëgjuar lloj-lloj qyfyresh. Oh, thashë, ç'oficer ka vënë Zogun në krye të forcave, një karagjoz, një sahanlëpirës, që s'ka pasë kur të haber nga lufta; vetëm se Zogu e thërriste në pallat dhe e vinte t'i bënte shakara dhe ta zbaviste.

Por lajmet për «kryengritjen e Fierit» pas tri-katër ditësh morën tjetër drejtim. Gazetat shkruanin se Fieri vërtet ishte marrë në dorë nga «kryengritësit», se atje ishte vrrarë dhe një gjeneral i Ahmet Zogut, por kjo kishte zgjatur shumë pale. vetëm një ose dy ditë. Ushtria zogiste i kishte vënë forcat e kufizuara «kryengritëse» në dorë, i kishte goditur rëndë, disa grupe të vogla luftëtarësh ishin tërhequr në male. ku ndiqeshin këmba-këmbës nga forcat e ushtrisë e të xhandarmërisë zogiste, dhe se më në fund në Shqipëri ishte vendosur qetësia e «kryengritja dështoi». Më dëshpëruan këto lajme, megjithatë edhe ato i preva, i ngjita në letën dhe, kur u mbyll kjo historia, e dërgova vandakun e madh të gazetave në destinacionet e caktuara.

Sa ndenja në Bruksel kjo ishte e vetmja herë që dërgoja në Paris dhe në Tiranë një vandle të tillë me kupyra gazetash.

Gjatë ditëve që ishte në zhvillim kjo ngjarje më thirrën dy herë në Ministrinë e Jashtme të Belgjikës dhe me pyetën për hollësi. Unë hiqesha sikur dija më tepër se ç'thoshin gazetat e tyre, ua zgjatja; dulce u folur për popullin tonë që s'e duron gjatë shtypjen, për Fierin, për Skraparin etj. Më erdhi ato ditë edhe një korrespondent i gazetës «Le Soir» dhe më kërkoi disa detaje për këtë ndodhi. Edhe atij i përsërita po ato që thashë edhe në Ministrinë e Jashtme të Belgjikës.

Në muajt që pasuan vazhdoi në këtë drejtim rutina e përhershme, domethënë botoheshin fare pale artikuj për Shqipërinë, të cilat une i prisja e i dërgoja si ngaherë në destinacion.

Në çështjet konsullore po ashtu s'kishte punë shumë.

Gjatë gjithë qëndrimit tim atje dhashë a s'dhashë gjithsej ndonja 20-25 viza. Këta ishin disa tregtarë dhe ndonjë turist. Shqipëria me Belgjikën në fakt as që kishin marrëdhënie tregtare. Tregtarë belgë vinin dhe interesoheshin ç'mund të blinin dhe ç'mund të shitnin në Shqipëri. Unë e dija në ç'mjerim ishte vendi ynë në atë kohë; çdo gjë ia merrte Italia fashiste dhe çdo gjë e blinin nga Italia! Por unë i nxitja të shkonin, u thosha se te ne ka minerale, naftë, bitum, krom. Atyre këto u interesonin dhe unë, dulce u kapur pas kësaj, i nxitja me synimin që, po të kishte mundësi, të shkëputeshin diçka lidhjet tregtare të Shqipërisë me Italinë.

- Sa për nevojën - u thosha, - vendit tonë i duhet çdo gjë, devi edhe gjilpëra.

Më kërkonin adresa tregtarësh dhe unë u jepja të atyre që njihja ose që ua kisha dëgjuar emrin. si Selfot, Ali Hashot. Xilelo Dibrat. Turkeshët e të tjerë. Ç'rezultate kishin: ata me këto adresa. asgjë nuk dëna. Sepse, siç thashë, konsulli as donto të dinte se ç'lehej; legata jonë në Paris e shilte konsullatën e Belgjikës jashtë juridiksionit të saj, për Ministrinë e Jashtme dhe në përgjithësi për zyrtarët e lartë në Tiranë tregtia e jashtme e vendit konceptohej vetëm në suazën e Italisë dhe

asnjëherë e askush nuk më kërkoi asgjë, as për mirë, as për keq. Vetëm dy herë më erdhën dy nga tregtarët belgë dhe më falënderuan për adresat që u kisha dhënë, sepse kishin arritur të shitnin bojëra për ngjyrosje, tekstile, këpucë etj.

Unë bëja *l'important** *(Frëngjisht - i rëndësishëm; këtu në kuptimin: luaja rolin e personit të rëndësishëm.) dhe u thosha: - Shumë mirë. Do t'ju ndihmoj për t'i zgjeruar më tepër kontaktet.

Po çfarë ndihme! Siç thashë, asnjë lidhje nuk kisha me Tiranën, veçse dërgoja kupyrat, por edhe për këto asnjëherë nuk më lajmëruan nëse i merrnin apo jo, nëse i shihte njeri apo jo. Unë për Tiranën nuk ekzistoj, isha kancelar i një konsullate nderi, shpenzimet e së cilës i bënin konsulli dhe atasheu i shtypit.

Të mos ua ha hakun, këta më dërgonin edhe rrogën në rregull, edhe shpenzimet e gazetave, që në fillim të muajit. Për qiranë e konsullatës as që çaja kokën fare, ajo paguhej në administratën e pallateve nga ata vetë drejtpërdrejt.

Afro një vit pasi ishte hapur konsullata në Bruksel, marr një lajm nga legata e Parisit, e cila më njoftonte se në Anversë të Belgjikës do të hapej një tjetër konsullatë nderi e Shqipërisë, se konsull do të ishte holandezi Godfrid Parser dhe më kërkonin që edhe atij t'i shërbeja si sekretar. Më kishin dërguar dhe adresën e tij e më thoshin që ta ndihmoja.

Shkova në Anversë me tren, ishte ndonjë orë larg Brukselit. U paraqita te konsulli i ri, i cili, ashtu si Maroth Marothi, bile ca më tepër, ishte njeri i shumë shtetësive dhe i shumë aferave: holandez nga Amsterdami, me shtetësi belge e holandeze, afarist e industrialist i njohur, me aksione e kapitale në hotele e banka, anëtar nderi i klubeve të jahteve e automobilave, mbajtës i shumë dekoratave honori nga shumë shtete e që i duhej, pas tërë këtyre, edhe titulli i konsullit të nderit! Ahmet Zogu e akreditoi konsull në Anversë dhe, ca më vonë, pasi unë isha kthyer në Shqipëri, e gradoi kryekonsull, i vari, natyrisht, edhe një nishan me dekret mbretëror.

Por se ç'bënte Zogu me këta «konsuj» të Shqipërisë,

që s'kishin idenë jo më ç'ishite, por as se ku binte Shqipëria, për mua s'kishte asnjë interes. Dua vetëm të them se kur u takova me të më priti mirë dhe më tha se do të kishte nevojë për ndihmën time.

- Do të punosh në Anversë, - tha, - jo më shumë

se dy ditë në javë. Do të ndjekësh çështjen e vizave për në Shqipëri, po të paraqiten kërkesa, do të më përkthesh të dhëna tregtare nga shqipja në frëngjisht. Po të lind~° nevoja, - vazhdoi, - do të dërgosh ndonjë letër në firma tregtare në Tiranë, pse mua, - përfundoi ky konsull nderi, - më kanë ngarkuar edhe Danimarkën.

- Jam dakord të vij t'ju ndihmoj dy ditë në javë,

- i thashë. - Më tepër s'mundem se veç punëve në konsullatën e Brukselit vazhdoj edhe studimet në «L'Université libre».

- Ç'pagë kërkoni për këtë punë? - më pyeti.

C'ti thosha? Ia futa kuturu si ai fukarai:

- 300 franga në muaj, përveç udhëtimit vajtje e ardhje me tren!

- Dakord! - aprovoi ai dhe më pagoi dy muaj avancë, si edhe shpenzimet për udhëtimet me tren, klasë e dytë, që unë, për ekonomi, i bëja me të tretën.

Kështu shkoja dy herë në javë edhe në këtë konsullatë nderi, ku punoja nga gjysmë dite, nganjëherë një orë e gjysmë apo dy dhe pasta] dilja shëtitje, vizitoja qytetin, muzetë e famshme të Anversës, portin kolosal.

Një ditë në këtë konsullatë u paraqit një djalë më i madh në moshë nga unë, hyri në dhomë dhe, për habinë time, më foli shqip.

- Kush je ti dhe ç'bën në Anversë? - e pyeta.

Më tregoi emrin dhe më tha se ishte student në buj qësi a në tregti (nuk më kujtohet), se ishte nga Kolonja, nga fshati Vllamas.

- A!!, - i thashë, - ç'i ke Sejfinë dhe Muharremin?

Ai u gel dhe më pyeti:

- Pse, i njeh ti ata?

- Po, - pohova unë, - i njoh mirë.

- Jam kushëri me ta. (Nuk e mbaj mend kushëri i çfarë shkalle ishte).

U përqaftuam atëherë dhe biseduam, dolëm jashtë, shëtitem, hëngrëm bukë në një restorant, shpenzimet i pagova unë, sfida që isha më i këputur mundet se ai. Biseduam për Shqipërinë, pse ai ishte krejt i izoluar, më kërkoi shpjegime për të famshmen «kryengritje të Fierit» etj. Edhe unë, edhe ai u gëzuam, pse ishte hera e parë që takoja një shqiptar në Belgjikë. M'u duk sikur gjeta një vëlla në vend të huaj dhe, kur nga biseda e parë e pashë se ishte antizogist, flitnim hapur. I tregova ditët dhe oraret kur do të isha në konsullatë që të mund të vinte e të takoheshim. Bëmë edhe një fotografi me të në rrugë, dulce ecur, nga fotografët që bredhin trotuareve dhe të fotografojnë pa pyetur e papandehur e pasta] të japin adresën e dyqanit.

Kur mora dy rrogat nga konsulli i Anversës, shkova drejt e në një magazinë të madhe për të blerë një palë r roba të gatshme. Ai që shiste më pa trupin, më pyeti për ngjyrën dhe unë i thashë:

- I dua të zeza dhe ca të trasha.

Fap, dhe nxori dy kostume të zeza, njërin «kazmir» të qeruar, 800 franga, kurse tjetrin lesh, po të trashë, 500 franga. I thashë se këtë 500 frangëshen dua. E veshja dhe u çudita që më rrinte si jo me mirë, asnjë dorë s'mbetej të vinte ustai. Të them të drejtën, u habita, se kur isha më i ri dhe më qepte ndonjë kostum Aqif Gabeci në Gjirokastër, ose ndonjë rrobaqepës i hotel «Pallasit» në Korçë, io vetëm që do të prisja ndonjë javë, por vazhdonte puna shqep andej e pre këndeje, sa të ikte fare nga qejfi kostumi. Kurse ky që bleva në Anversë brenda dhjetë minutave ishte gati. U shikova andej-këndeje në pasqyrë, pagova paratë, e mbajta veshur, pronari më mbështolli të vjetrin dhe e mora në dorë. Dola i gëzuar se plotësova një nevojë, sidomos për t'ju përshtatur sërës diplomatike.

Në rrugën «La Loi», në apartamentin e madh nde njëm ndonjë vit, deri nga fillimi i vitit 1936, pasta] ndërruam selinë, se, si duket, qiraja e selisë së parë kushtonte shtrenjtë dhe në fakt shtrenjtë kushtonte për punën që bëhej. Konsullit, kur vinte në Bruksel për çështje protokollare, i kushtonte më lirë të flinte në hotel, kështu që konsullata mbetej sa për formë. Gjetëm një apartament të vogël me një sallon pritjeje, i cili shërbente si zyra kryesore e konsullatës, një dhomë gjumi për mua me një «cabinet de toilette». I zoti i shtëpisë me të zonzjën rrinin në katin e sipërm dhe konsullata kishte katin e parë më vete. Shtëpia ishte në një rrugë të zakonshme para se të veje në sheshin dhe në parkun e madh që quhej «Le cinquantenaire», sigurisht ngritur për festën e 50-vjetorit të formimit të Belgjikës si shtet më vete.

Gjatë kohës që qëndrova në Belgjikë u ktheva një

herë për pushime në Shqipëri, u poqa me njerëzit e familjes, u gëzova me ta, por pashë se vuajtjet e tyre e të popullit ishin të mëdha. Në mënyrë diskrete shikova një herë andej-këndeje se mos gjeja ndonjë punë në vend, se edhe familja vuante, por më kot. Atëherë, në kohën kur më mbaroi leja, u nisa prapë për në Bruksel.

Regjistrimet në «Universitetin e lirë të Brukselit» vërtet nisën me rekomandim zyrtar e me zell të madh nga ana ime, por qenkeshin punë goxha e ngatërruar. U zhvillua një korrespondencë e tërë me sekretarinë e universitetit: ku ke studiuar më parë, sa provime ke shlyer; ç'provime plotësuese duhet të jepja; plotëso këtë lutje, mbush këtë formular, kaluan muai të tërë. Më në fund u ra dakord që të regjistrohesh në vitro e dytë të fakultetit të drejtësisë, u regjistrova e nisa të ndiqja leksionet e konferencat.

Punova me zell e pasion disa muai, kushtet duhet të them se tashmë i kisha të mira, por, si duket, s'qe e thënë të jepja qoftë edhe një provim. Në valën e përgatitjeve për provimin e parë, krejt papritur, ia behu atasheu i shtypit nga Parisi. Hyri drejt e në sallonin e pritjes dhe më gjeti të zhytur në mes librash, gazetash e revistash. Ngaqë ato ditë përgatitesha për provimet, s'kisha treguar kujdes për t'i mbajtur të paktën në dhomën e gjumit gazetat e Partisë Komuniste Franceze e të Belgjikës, librat e Marksit, Engelsit e Leninit, që i kisha me shumicë.

E pashë që u skuq e u nxi menjëherë.

- Ç'janë këto? - më pyeti ai.

Nuk po gjeja ende një arsye për të hedhur lumin, por ai vazhdoi:

- Pse komunist qenke ti, zoti Hoxha? Ne këtë s'e dinim...

Mendova fillimisht t'i thosha se ishin gazeta e libra që shiteshin sheshit, por një argument i tillë, për një antikomunist si ai, nuk pinte ujë. Atëherë dulce mbledhur veten i thashë

- Nuk janë të miat, mund të jenë të djalit të shtëpisë, i citi do t'i ketë harruar këtu se vjen ngandonjëherë!

Por ai nuk e hëngri këtë

- Nuk është një gazetë o një libër i lënë rastësisht nga dikush i jashtëm, - tha me nënqeshje. - Këtu është mbushur tërë kabineti me literaturë komuniste.

Nuk këmbëngula më tej për t'i mbushur mendjen me «fajtorin» tjetër, sepse, veç të tjerash, dy të zotët e shtëpisë në Bruksel s'kishin fare djalë! Konsulli i Anversës po, ai kishte një djalë, më duket e quanin Donald, afërsisht i një moshe me mua ose disfi më i ri, që më takonte nganjëherë; bënim ndonjë shëtitje të shkurtër e bisedonim kundër fashizmit. Por nga ç'kisha parë, edhe Donaldi as kishte të bënte fare me komunizmin e komunistët.

Heshta, pra, i zënë me presh në duar dhe takirni me kaq mbaroi. Mbaroi për mua edhe periudha e Brukselit. Një a dy muaj pas largimit të atasheut të shtypit në Paris, më erdhi pushimi. Kjo i dha fund qëndrimit tim jashtë.

U dëshpërova nga kjo kthesë që morën ngjarjet jo për gjë tjetër, por sidomos për humbjen e mundësive që të vazhdoja e të përfundoja studimet e lama, task në një degë që e preferoja e që nuk e kisha të vështirë ta kryeja me sukses. Por edhe nga ai një vit, një vit e gjysmë që qëndrova në Belgjikë pashë, mësova e fitova diçka rënë tepër për jetën e të ardhmen time. Kushtet shumë të përshtatshme të banimit, genia thujse vetëm në konsullatë pa më shqetësuar e trazuar njeri, më dhanë mundësinë që të lexoja e të studioja më me zell se kudo një varg të tërë veprash të Marksit, Engelsit, Leninit etj., pa folur për shtypin komunist që e mirrja të tërin. Nuk isha abonuar në organet komuniste me qëllim që të mos tërhiqja vëmendjen e ndjekjen e policisë ose të organizatave fashiste që në Bruksel i gjeje kudo, por çdo ditë dilja i blija në kioske të ndryshme, dulce i maskuar në togun e gazetave të tjera të vendit. Por, ndërsa këtë gjë e bëja mirë, e nënvleftësova mundësinë e një ardhjeje të papritur të eprorëve në konsullatë dhe, nga gjithë e keqja që ndodhi, e mora një mësim të mirë: armiku më i rrezikshëm është ai që harrohet ose nënvleftësohet.

Ndërkohë, veç studimit të literaturës komuniste, tash do të largohesha nga Belgjika me gjithë atë bagazh që në njërin ose në tjetrën masë fiton njeriu gjatë qëndrimit në një vend të huaj. Po largohesha, pra, me një tog përshtypjesh, dijesh e kujtimesh për Belgjikën, për qytetin e Brukselit, të Anversës e për vendet që vizitova sa qëndrova atje.

Belgjika, siç e kishim mësuar në histori, ishte një vend i vogël me një popullsi shumë të dendur. Kishte shumë fabrika dhe punëtorë, përveç një kolonie të madhe, siç ishte Kongoja. Belgjika ishte mbretëri dhe e gjithë «Kongoja belge», pronë personale e mbretit që nga shekulli i kaluar, vazhdonte të ishte burim i pashtershëm fitimesh të majme për metropolin. Edhe në Belgjikë punëtorët, si kudo, shtypeshin, prandaj zhvilloheshin greva shumë herë të ashpra. Kam asistuar edhe vetë në to dhe në njërin prej tyre pashë se policia me kuaj e me kërbac ndërhyri me violencë mbi turmat e punëtorëve që marshonin dhe bërtitnin nga «Piace de Brouckère» deri në «Bourse».

Partia Komuniste e Belgjikës në ato vite ishte e vogël, por luftarake; Partia socialiste, që kishte në krye liderin socialdemokrat të Internacionales së Dytë, Vanderveldin, ishte më e fuqishme, ajo kishte edhe pozita në parlament.

Punëtorët në kryeqytet, në Bruksel, jetonin në shtëpi mizerabël në periferi të qytetit, por, siç lexoja në gazeta dhe në revista komuniste e socialiste, në zonat ku n,xirrej qymyri jetohej akoma më keq, si në romanet e Emil Zolasë. Kur këndoja këto mjerime të punëtorëve të Belgjikës, të Shqipërisë, të Kongos, të Nju-Jorkut, më vinin në mend poezitë e poetit belg Veraren, i cili u shkëput nga idealizmi simbolik dhe u bë një poet realist. Ky poet lidhi poezinë me realitetin. Unë kisha lexuar «La multiple splendeur»* *(Shkëlqimi i shumëfishtë.) dhe «Les villes tentaculaires»* *(Qytetet-oktapodë.) të tij. Nga ky libër i fundit mbaj mend vargjet e mëposhtme:

«Se regardant dans les yeux cassés de leurs fenêtres

*Et se mirant dans l'eau de poix et de salpêtre
 D'un Canal droit marquant sa barre à l'infini
 Face à face le long des quais d'ombres et de nuits
 Par à travers les faubourgs lourds
 Et la misère en pleurs de ces faubourgs
 Ronflent terriblement usines et fabriques»** *(«Duke u parë në sy kuadratësh tërë bira,
 Duke u pasqyruar në ujin plot ndyrësira
 Të një kanali që zgjatet në pafundësi,
 Përgjatë rrugësh kredhur në terr të zi,
 Përmes lagjesh punëtore kaba, të rënda, Dhe vajit e mjerimit që ato ndryjnë brenda,
 Uturijnë tmerrshëm uzina e fabrika».)

Në kohën kur isha unë, Belgjika vazhdonte të ishte një mbretëri dhe mbret ishte Leopoldi i 3-të, djali i Albertit të 1-rë që luftoi në krah të Antantës në Luftën e Parë Botërore kundër Gjermanisë së Kaizerit. Në këtë luftë emri i Belgjikës dhe i mbret Albertit dolën të nderuar, kurse më pas, në Luftën e Dytë Botërore djali i Albertit, Leopoldi, u dorëzua pa çak pa bamb serioz te Hitleri, i cili e dërgoi në *exil doré**. *(Frëngjisht - mërgim të artë.)

Brukseli ishte qytet i bukur, po më shumë i vjetër sesa moder n. Në atë kohë shihje fare pak paliatë moderne, nuk kishte mbirë akoma betoni. Gjithandej kishte mjaft kuriozitet; kishte rrugë të gjata, të gjera, bulevarde, parqe, dyqane e magazina me vitrina të mëdha e të pasura me mallra, por kishte edhe shumë rrugica të vogla me shtëpi të ulëta, që herë ngjiteshin, herë dridheshin si iabirinte. Kishte në Bruksel zona të vjetra shumë të bukura dhe të ruajtura për mrekulli, si për shembull «La Grand-Place», sheshi katror i «Hôtel de Ville» dhe të tëra ndërtesat rreth e rrotull katrorit ishin të gjitha të shekujve të kaluar, penxhere, dyer e mure, tours donjons et beffrois*, *(Frëngjisht - kulla të tipit donzhon dhe befua.)

të qëndisura si dantella me gurë. Një ansambël të tillë, ku guri, druri e hekuri ishin punuar me kaq mjeshtëri dhe kishin formuar ato ndërtesa madhështore që rrethonin nga të gjitha anët sheshin, nuk më kishte rënë rasti të shihja as në Francë, as në Itali. Ndërtesat ishin shumë të larta për atë shesh relativisht të vogël që rrethonin, por kaq e bukur dhe e hijshme ishte arkitektura, me kaq elegancë derdheshin e zbukuroheshin me gdhendje muret, kolonat e kolonadat, qoshet ose pjesët e sipërme të dritareve, sa, kur qëndroje në mes të sheshit, nuk e ndieje fare ngushtësinë. Përkundrazi, kishe dëshirë të rrije atje sa më gjatë e të admiroje gjeninë e njeriut të punës, shpirtin e dorën prej artisti të atyre që kishin ngritur këtë ansambël. Dhe ç'është e vërteta gjithmonë, në dimër ose verë, ditën e gjer natën vonë, në atë shesh shihje grumbuj njerëzish, të huaj ose belgë, që rrinin atje më gjatë se kudo gjetkë. Vetë belgët ishin krenarë për atë ansambël monumental dhe, kur merrnin vesh se ishe i huaj, të pyetnin patjetër se si të ishte dukur ansambli rrotull «Hôtel de Ville». E, nëse merrnin vesh se enfie s'kishe qenë, të tregonin menjëherë drejtimin ose të shoqëronin vetë gjer në mes të sheshit. Në këtë shesh hapej çdo ditë tregu i luleve, ku shitnin lule që nga firma të specializuara e gjer individë, burra, gra ose vajza të reja. Zemra e Brukselit ishte pra «La Grand-Place», ku historia thotë se përpara «Hôtel de Ville» abdikoi në mesin e shekullit të 16-të Charl Kuinti. Në katet e poshtme të ndërtesave që rrethonin sheshin, si dhe në gjithë rrugët e rrugicat që zgjatëshin prej andej si tunele drejt anëve më të ndryshme të qytetit, ndodheshin dyqane, reparte artizanati, sidomos për artikuj ari, argjendi e fildishi. Shtëpitë e korporatave të vjetra të peshkut të kripur, të bukëpjekësve etj., dukej që në atë kohë luanin një rol të rëndësishëm. Në sheshin katror shihje të varura tabelat e vjetra që mbanin shtëpitë në ato kohë. «Dëshiroj t'i pikturoj të gjitha këto shtëpi të vjetra», shkruan Viktor Hygoi. Ai shkante shpesh në Belgjikë, kishte jetuar edhe në një nga këto shtëpi të «La Grand-Place». Ja si shkruante:

*«J'habitais au milieu des hauts pignons flamands Tout ce qui peut temer un coeur ambitieux Etait là devant moi l'austère et gigantesque piace. Et les quatre pannes de l'Echafaud d'Egmond!»**. *(«Banoja në mes të shtëpive të lama flamande, Çdo gjë që e ndez një zemër ambicioze Ndodhej para meje, sheshi gjigant e i trishtuar Dhe katër dërrasat e gijotinës së Egmondit!».)

U ngjita edhe unë në shkallët e godinës ku kishte jetuar Hygoi. Përballë ishte kafeneja e vogël, ku poeti Rembo u qëllua me një plumb nga miku i tij Verleni. Bodleri kishte jetuar po aty afër. Në këtë shesh kishin shëtitur Volteri, Bajroni, Meterniku dhe gjithë turistët e botës që vizitonin Brukselin, si në kohët e kaluara, edhe në kohët e reja.

Belgjika edhe para Luftës së Parë Botërore ishte një vend disfi më i lirë dhe shumë politikanë, poetë, shkrimtarë, që dëboheshin ose ndiqeshin nga policia e reaksioni francez, gjenin strehim në Bruksel, si Hygoi, Dymasi (i ati) e shumë të tjerë. Atje ata vinin në skenë pjesë të ndaluara, botonin po ashtu libra që në Francë e gjetkë nuk i lejonte censura. Por duhet të them se edhe ajo «liri» e Belgjikës kishte caqet e kufijte e vet të lejuar nga borgjezia vendëse ose nga reaksioni ndërkombëtar. I ndjekur e i persekutuar nga reaksioni prusian, nga mesi i shekullit të kaluar kishte vajtur në Bruksel për të jetuar e punuar edhe Karl Marksi. Por në rastin e tij, si edhe të të tjerëve. Belgjiha tregoi se, kur ishte fjala për njerëz që me mendimin e idetë e tyre kërkonin transformimin e shoqërisë në favor të proletarëve e të popullit, e ashtuquajtura liri e saj, tregonte thelbin dhe vlerën e vet konservatore e reaksionare. Të madhin Marks policia beige jo vetëm s'e lejoi të qëndronte në Bruksel, por i hodhi prangat dhe e dëboi. I kisha lexuar këto gjatë studimit të literaturës marksiste dhe, i nisur nga fakti që atje gjeje afişe edhe për Valerinë e Rembonë, mendova për një çast, se duhej të gjeja edhe vendin ku kishte qëndruar Marksi. Por më kot kërkova nëpër Bruksel të gjeja qoftë edhe shenjën më të vogël për korifeun e teorisë e të praktikës revolucionar e të pr oletariatit. Belgjika zyrtare që e kishte dëbuar Marksine kur qe gjallë, nuk mund të vepronte ndryshe edhe pas vdekjes së tij.

Edhe jeta në Belgjikë ishte më e lirë se në Francë, Itali e gjetkë. Kjo ndoshta vinte ngaqë popullsia ishte më e vogël, industria e madhe dhe kolonia shumë e pasur. Brukseli konsiderohej si vendi borgjez par excellence, pse atje hahej mirë, pihej mirë, visheshe mirë, natyrisht për ata borgjezë që kishin pasuri, por jo për punëtorët.

Brukseli kishte një muze artesh shumë të pasur, me tablo të pikturëve më të mëdhenj holandezë. e flamandë, tablo të Rembrandit, Van Dikut e shumë të tjerëve më të rinj. Kisha shkuar atje dy-tri herë. Po ashtu kisha vizituar kishën e vjetër Sainte-Gudule, «Pallatin e Drejtësisë», një ndërtesë e madhe e trashë dhe «budallaqë» sikur ishte mbushur me birrë «Stout», një birrë e trashë holandeze dhe gati e zezë si katra.

Belgët flitnin dy gjuhë, flamanden dhe valonen. E folmja valone është gjuha franceze me njëfarë aksenti, ndërsa e folmja flamandë i përngjet gjuhës holandeze. Në Bruksel flitej kryesisht frëngjisht, kurse në Anversë më tepër dëgjohej e folmja flamandë.

Sidoqoftë, kudo në Belgjikë, në rrugë, në shesh, në kafe ose në universitetin i dëgjoje të dyja gjuhët: frëngjishten dhe flamanden, dhe, me ç'shijja, çështja e gjuhës, cita duhej të kishte superioritet ndaj tjetrës etj., ishte atje një problem i mprehtë për të cilin diskutoheshin jo vetëm mes njerëzve të letrave e në universitete, por edhe në qarqet politike e qeveritare. Rreth këtij problemi që paraqitej si kombëtar, kishte lloj-lloj diskutimesh, mendimesh, rrymash e shkollash, të cilat grindeshin me njëra-tjetrën jo vetëm për gjuhën, por edhe për përkatësinë e literaturës që shkruhej në njërin ose në tjetrën gjuhë.

Kishte në ato kohë korrente që literaturën beige të shkruar në gjuhën frënge e konfondonin me literaturën franceze, dhe kërkonin që gjithë literatura e Belgjikës «në gjuhë frënge» të konsiderohej si literaturë franceze. Në fakt vërtet ishte e njëjta gjuhë, por literatura që lexoja unë, kishte diçka karakteristike beige, si më dukej mua, duke vënë re edhe mënyrën e jetesës, edhe aksentin, edhe jetën sociale. Kundër rrymës pro franceze, reagonte gjuha neerlandeze (holandeze), sidomos në «Basse Belgique», ku qendra kryesore ishte Anversa, të cilën flamandët e quanin Antwerpen. Gjuha flamandë flitej, po ajo neerlandeze e sidomos e reja, nga ç'lexoja në gazetën letrare që botoheshin në gjuhën frënge, po humbiste terren. Frëngjishtja në ato vite po zhvillohej, sigurisht në ndikimin e madh të literaturës franceze dhe të kontakteve, të marrëdhënieve tregtare dhe të aleancave politike (sidomos aleanca franko-beige gjatë Luftës së Parë kundër Gjermanisë) etj. Nga gjuha flamandë nuk kuptoja asnjë fjalë dhe nuk bëra asnjë përpjekje të mësoja diçka. Më dukej një gjuhë e rëndë, ca

si «e ashpër», si gjermanishtja. Edhe në muzikë, edhe në qëndrime të ndryshme të njerëzve, e shihje diferencimin në mes dy popujve që përbënin Belgjikën.

Por, ndërsa në gjuhë frëngjishtja fitonte terren, në Muzeun mbretëror të Brukselit, një nga më të pasurit e Evropës, predominonin gjërat më të bukura të shkollës flamande dhe holandeze; atje kishte xhevahire të arteve figurative, sidomos të pikturës.

Në Bruksel art popullor dhe këngë popullore s'më ra rasti të dëgjoja. As njerëz të veshur me kostume kombëtare nuk pashë në qytet. Por në këtë aspekt atje pashë diçka që më ka bërë shumë përshtypje: kostumet e ndryshme kombëtare ia vishnin dhe ia ndërronin çdo ditë njerët prej monumenteve më të bukur, më të njohurit e më të vizituarit në Bruksel. Ky monument ndodhej në një rrugë karakteristike jo shumë larg sheshit katror, futur në një kamare dhe përfaqësonte një djalë të vogël minjon* *(Nga frëngjishtja - vogëlush simpatik.) nja tre a katër vjeç që bënte ditë e natë «pipi» pa pikë turpi. Ky monument popullor quhej «Manëken-pis». Ishte një nga kuriozitetet e qytetit. Nga të gjitha vendet e botës i kishin dërguar «Manëken-pis»-it nga një kostum kombëtar, të cilin, siç më thanë, ia ndërronin atij çdo ditë.

Por kështu ndodhte vetëm në Bruksel, sepse, me sa kisha parë në gazeta e në revista, në të tria pjesët e Belgjikës (*la basse, la moyenne dhe le nord*)*, *(Frëngjisht - e ulëta, e mesmja, veriu.) sidomos në fshatra, visheshin akoma kostume kombëtare, me lloj-lloj ngjyrash, me shami të bardha dhe me sabots (haliqe) prej druri. Në këto zona ruheshin, gjithashtu, traditat e folklorit në këngë dhe kjo si në fshatra të Flandrës, edhe në të Valonisë.

Belgët më kishin bërë përshtypje jo të keqe, por të paktën ata që njoha unë, sikur nuk e kishin atë *élan*, atë *esprit éveillé*, atë humor aq të njohur te francezët. Belgu pinte beter, mbushur ishin rrugët me pijetore plot me njerëz që pinin birra lloj-lloj. Edhe në Francë pihej, por jo birra dhe jo si në Belgjihë.

Ata belgë me të cilët pata rastin të njihem më dhanë përshtypjen se ishin njerëz «të ftohtë», jo të shoqërueshëm, ca fodullë, por kjo round të ketë qenë thjesht një; përshtypje e rastit, ngaqë me asnjë prej tyre nuk arrita të bëja muhabet të hapët dhe të shoqërohesha. Po në tërësi ishin njerëz të qetë, nuk të ngacmonin e as donin të shqetësoje.

Jetesa e përditshme në Bruksel ishte shumë e lirë jo vetëm në krahasim me Parisin, por edhe me Monpeljenë. Uslzqimet ishin shumë më të lira. Në një restorant të zakonshëm, natyrisht j'o ne rrugët kryesore, round të ngopje mui'ë barkun me 10 franga beige. Kinematë ku unë shkoja shpesh ishin shumë më të lira se në Francë, po ashtu edhe sendet industriale. bile më kishin thënë se francezët vinin në Belgjikë e furnizoheshin. Cigaret. gjithashtu. ishin tmë të lira se në Francë dhe karakteristike ishte se; kur blije një paketë rigare, shkrepse shitësi ta jepte gratis.

Një ditë tek po shëtisja në rrugën kryesore e të dyqaneve dhe të kinemave, «La rue Neuve» (rrugë për çudi e ngushtë, e shtmtq tetë-nëntë mete a e gjerë), dhe pa vështroja viti inat. në një dyqan të vogël qumësht, në mes të tjerash pashë një bankë dhe kërkova një «*Jaourt albanais*»*. *(Frëngjisht - kos shqitar.) I zoti ma solli çafkën dhe unë e pyeta:

- Pse e guani këtë kos «albanais»?

- E kam trashëgim nga gjyshi. që ishte shqiptar, - m'u përgjigj.

- Po ti e di ku është Shqipëria? - v azhdova ta pyesja.

- Po, - m'u përgjigj ai, - në Ballkan!

- Po nga ka qenë gjyshi yt ekzaktësisht?

- S'mund të të gënjej, nuk e di, - më tha e pasta] m'u drejtua: - Po pse më pyet?

- Se jam shqiptar! - e sqarova dhe i hodh dorën në qafë. Ai kaloi në pjesën e mbrapme të dyqanit, i foli gruas së tij dhe i tha:

- Eja se kemi një bashka~l,,dhetar të gjyshit tiro!

U foli për Shqipërinë dhe u kënaqën. Nxora të ho

llat të paguaja.

- Në asnjë mënyrë! - më tha, - jo vetëm sot, por, kur të kesh kohë dhe të të marrë malli për kos shqiptar, të vish këtu, se ndryshe do të më mbetet qejfi!

Shkova disa herë në dyqankën e tyre, edhe ai me gruan erdhën më bënë një vizitë në konsullatë.

U mësova ta shëtitja Brukselin me këmbë, shpejt u orientova me tërë rrugët e tij, shkoja në librari, ku round të lexoja edhe në këmbë, edhe pa blerë kur doherë libra. Disa gazeta kryesore i blija, të tjerat i lexoja në librari ose në biblioteka, jo vetëm se ma dome zanati dhe më tërhiqte politika, por kisha interes të ndiqja edhe zhvillimin e kulturës dhe pr oblemet ekonomike.

Sa herë më binte casti asistojta në mitingjet e Partisë Komuniste të Belgjikës, por ato nuk e kishin atë gjerësi shikimi të problemeve siç ndodhte me Partinë Komuniste Franceze.

Në atë kohë në Belgjikë doli në skenë edhe «Reksizim», lëvizje fashiste e hapët, nën udhëheqjen e Leon Degrelit. Partizanët e tij ishin banditë të hurit e të litarë si skuadristët e Musolinit. Ata dilnin në masë, thyenin goditnin hapur kundërshtarët e tyre politikë, kurse policia i bënte sehir. Më vonë u bashkuan me nazistët gjermanë.

Shumë herë dilja me tramvaj në lagjet e largëta të periferisë së Bruksel: elit, në mëhallët e qytezat e punëtorëve.

Pamja atje ishte tjetër, më i plakur dukej qyteti, njerëzit të lëvizur nga puna, atmosfera më e zymtë. Më kujtoheshin

vargjet e poetit Verlen:

*«Le ciel est de cuivre Sans leur aucune On croirait voir vivre Et mourir la lune»**. *(«Qielli është si i bakërt dhe fare pa ndriçim duket sikur hëna vdes fili porca lind».)

Kisha vizituar kështu grumbullimet e qyteteve të vogla rreth Brukselit, si Ikselën, Sen-Zhilin etj. Pasi kisha ecur me orë të tëra në këmbë për të parë nga afër jetën e njerëzve, hyja në ndonjë kafe ose uleshë në ndonjë tavolinë jashtë me një gotë birrë përpara (nuk mund t'i shpëtoje dot tentacionit*), *(Nga frëngjishtja - dëshi) të cilën e pasoja me një kafe të zezë, që zakonisht ta sillnin tok me një krem *fouettée** *(Frëngjisht - të rrahur.) të bardhë që, po të doje, ia hidhje brenda kafesë, po të doje e haje me lugë. Fshat e zanat. Në Francë kafënë ta jepnin me gota uji, kurse këtu në Filxhanë ca më të mëdhenj se tanët. Kalonte kështu ndonjë orë, pasta] kthehesha në Bruksel.

Një vend historik që shkova e vizitova me interes të veçantë ishte VATERLOJA, fusha historike ku u zhvillua beteja e famshme në mes Napoleonit, anglezëve dhe prusianëve. Shkova atje me autobus dhe më kujtohen emocionet e mëdha që ndjeva. Gjithë rrugës shikoja fushat, pemët, lexoja tabelat me emrat e rrugëve, «Chaussée de Waterloo», «Chaussée d'Ixelles», gjersa mbërrita në VATERLO, e cila lëshët jo larg, rreth gjysmë o treçerek ore në jug të Brukselit.

I njihja mirë historinë e «Perandorisë së parë», inkursionet e shumta dhe betejat e Napoleonit, të cilat në lice i patëm mësuar edhe me harta. Kështu që mua tashmë më ringjalleshin më me forcë kujtimet e shkollës, romanet dhe vjershat e famshme të Hygoit, librat historikë specialë që kisha lexuar mbi betejat e Vagramit në Austri, të Eilosë, Austerlicit në Sllovakia, «Fushatën e Rusisë», «Betejën e Francës» e më në fund të VATERLOSË. Shumë kisha lexuar, por më kishin mbetur në mendje «Les adieux de Fontainebleau» dhe «Mémorial de Sainte Hélène» të Las Kases. Në kështjellën e Fontenblosë, afër Parisit kisha qënë një herë para se të veja në Belgjikë dhe, më vonë, kur shkova në kryeqytetin francez për Konferencën e Paqes më 1946, e vizitova përsëri Fontenblonë bashkë me Hysniun e Kahreman Yllin, vizitua kështjellën e ambientet rrotull, bëmë edhe fotografi.

Literatura dhe shkolla franceze e ekzaltonin Napoleonin dhe epokën e tij si revolucionare, si vazhdim të revolucionit. Por, kur u hyje thellë këtyre leximeve, shikoje se strategu i madh e politikani i padiskutueshëm, ishte edhe tiran e kundërrevolucionar sepse ai ia derdhi gjakun Francës pa llogari. Ai ishte një diktator, një potentat borgjez, që dome të dominonte jo vetëm Francën, por edhe Evropën, me një fjalë të vendoste kudo hegjemoninë e familjes së tij, të vetën dhe të borgjezisë franceze.

Duke ecur me autobus në «Chaussée d'Ixelles», më rishfaqej e konkretizohej historia: Në Bruksel po bënte mbrëmje vallzimi Velingtoni dhe shtabi i tij madhor. Jepet alarmi se «*l'Ogre de Corse*»*(Frëngjisht - përbindëshi i Korsikës.) po marshonte drejt Brukselit me ushtri. Pikërisht nga kjo rrugë u nis Velingtoni me shpejtësi për të zënë pozitat e luftës në VATERLO, në «Mont Saint Jean». Po nga kjo

rrugë kaloi edhe Napoleoni me ushtrinë e tij për të dalë në luginën e Vaterlosë, ku do të zhvillohej beteja vendimtare në të cilën ai u mund definitivisht pas 100 ditësh sundimi tubasi që arratisur nga ishulli i Elbës. Vaterloja i vuri pikën e fundit perandorisë së Napoleonit.

Kur autobusi mbërriti në qafë, biletashitësi tha:

- Ja Vaterloja, do të zbresim te këmba e luanit të Vaterlosë, i cili u ngrit në vendin ku u plagos princi i Oranzhës. U ndal autobusi, zbritëm dhe përpar a pamë një parg të madh të lartë (në formën e një piramide vigane). Pamja ishte tepër imponante dhe të emociononte. Pargu piramidial ishte ndërtuar me dhe e gurë dhe dominon te krejt fushat e kodrat rrotull. Nisën pyetjet, por ciceroni na tha se do të ngjiteshim, nëpërmjet një numri të madh shkallësh (mbi dyqind shkallë në qoftë se s'gabohem), devë në majën e piramidës, te platforma ku është vendosur shatorja e një luani të madh që shikon drejt «Mont Saint Jean», ku qëndronte ushtria angleze dhe shtabi i Velingtonit.

- Bazamenti i luanit, domethënë platforma e pranllidës përfaqëson vendin ku qëndronte Napoleoni dhe drejtonte luftën, kurse luani, - na tha ciceroni, - është simboli i Napoleonit të madh dhe jo i princit të Oranzhit etj.

Pa qenë shumë të interesuar se kë pikërisht simbolizonte luani, Napoleonin apo princin e Oranzhit, ne mezi pritnim të ngjiteshim në majën e pir gut.

Ngjitja në atë mori shkallësh ishte disfi e lodhshme, por përballë emocioneve e kënaqësisë askush nuli u ndal. U ngjitëm pra në majë, në platformë, nën këmbët e luanit të madh, dhe andej shikoje si në pëllëmbë gjithë luginën e Vaterlosë. Në kujtesën time u ngritën të gjalla vargjet e pavdekshme të Hygoit kushtuar Vaterlosë. Të gjithë poemën në lice e kishim mësuar përmendsh. Jo atëherë aë e kisha të freskët, por edhe tash pas kaq e kaq vjetësh, m'aaj rënd vargje të tëra, disa nga të cilat po i shënoj. Ndërsa ciceroni na shpjegonte zhvillimin e betejës, unë lidhja shpjegimet e tij me poemën e Hygoit, të cilën edhe ciceroni e citonte shpesh. E tillë është forca e penës, forca e «verbit» dhe e ideve të Hygoit të madh.

*«Waterloo! Waterloo! Waterloo! morne Maine
Corame une onde qui boot dans une urne trop pleine.
Dans ton cirque de bois, de coteaux, de vallons
La pâle mori mêlait les sombres bataillons .*

.....
*O Waterloo je pleure et je m'arrête hélas!»**

*(Vaterlo Vaterlo Vaterlo! Fushë-varr
Porsi uji që vlon në një enë mbi zjarr
Në cirkun fëua prej pyjesh, tuginash e bregoresh
vækja e zbhtë trazonte atë gjëmë taboresh

.....
O Vaterlo! Po ndalem me sytë mbushur lot!».)

Pasi pamë «të gjallë» topografinë e vendit dhe na shpjeguan zhvillimin e betejës, duke na treguar drejtimet ku qëndronte e nga mësynte njëra ose tjetra ushtri, ku ishin vendosur shtabet e secilës etj., etj., ciceroni tha:

- Tash do të zbresim poshtë që të shikojmë panoramën e luftës së famshme të Vaterlosë!

Zbritëm dhe u futëm në një ndërtesë të rumbullakët, të ndriçuar anekënd, në të cilën me mjete figurative e ilustruese, të realizuara me art të madh e v ertetësi, paraqiteshin skena kryesore nga beteja e Vaterlosë, pozicionet e ushtrive e të shtabeve të tyr e, drejtimet e mësymjeve që i kishim parë në natyrë nga piramida e luanit. Në «grande nature» me ngjyra paraqiteshin, siç ishin veshur në atë kohë, ushtritë franceze, angleze, prusiane, gjithë forcat pjesëmarë në betejë. Shihej qartë napoleoni dhe shtabi i tij me mareshalin Nei, «le brave des braves»*, *(Frëngjisht - «Trimi i trimave».) siç quhej dhe Barda e tij në përleshje, lië fund ishte Velingtoni dhe ushtria e tij dhe në horizont, në mes të pluhurit, ushtria e prusianit Blüher tek hynte në fushën e betejës. I shihja me emocion të gjitha këto dhe vargjet e Hygoit më vinin të gjalla e të ftuqishme:

*«Le soir tonabait, la lutte était ardente et noire
Il avait l'offensive et presque la victoire
Il tenait Wellington acculé sur un bois
Sa lunette à la main il observait parfois
Le centre du combat, point obscur où tréaille
La mêlée effroyable et vivante broussaille
Et parfois l'horizon sombre Gomme la mer
Soudain joyeux il dit: «Grouchy» c'était Blücher.»**

* («Po ngrysej: luft' e ashpër, e zjarrtë ziente e valonte
Ai kishte ofensivën dhe shpresën të fitonte
E tubante Velingtonin mbërthyer në një kënd
Me dylbitë në dorë, vëzhgonte në atë vend
Ku ishte qendra e luftimit, pikë e errët ku dridhet
Përleshja, drizë e gjallë që mplikset e përdridhet
Pasta] nga horizonti vërente si skifteri
Befas thirri me gaz: «Grushi» - Ishte Bluhëri!...»)

Romantiku i madh Hygo, më duket mua, e kishte përshkruar betejën e fundit të perandorit me forcë e me një realizëm të jashtëzakonshëm. Piktorët që kishin bërë panoramën mendoj se ishin frymëzuar jo vetëm nga realiteti i vetë luftës, por edhe nga vargjet e Hygoit të madh.

Vizitua me autobus të gjitha pikat historike të fushës së betejës: «La Haie Sainte», «La belle Alliance», «Le Mont Saint Jean». Vizitua pusin historik të fermës «de Hougenmont», ku, siç na thanë, ishin hedhur 300 kufoma. Shkua edhe në vend për të parë nga afër pozicionin nga ku mareshali i famshëm Nei sulmonte me dëshpërim anglezët e Velingtonit. Të gjitha shtetet ndërluftuese në këtë betejë kanë ngritur përmendore dhe monumente në ato pika strategjike ku kanë sulmuar ose kanë pasur pozicionet kryesore forcat e tyre. Si monument ka mbetur dhe «Hoteli i kolonave» në «Mont Saint Jean», ku qëndroi Hygoi dhe shkroi poemën e famshme mbi Vaterlonë.

Afër «Panoramës» ishte edhe një mute, të cilin e vizitua, një dyqan që shiste relike artizanale me motive nga beteja, nga veshjet e ushtarëve, buste në miniaturë të Bonapartit, të personazheve të romanit «Të mjerët» të Hygoit, gjer edhe buste të Kambronit që gërthiste fjalën e tij... të famshme në historinë e kësaj beteje, kur iu përgjigjej anglezëve' etj. Më tej, në një restorant ku hëngrëm drekë, çdo gjë, që nga tabelat e deri te pjatat, mbanin emra që u përkitnin betejës, gjeneralëve, mareshalëve e mbi të gjitha perandorit Napoleon.

Me këtë pasazh po i mbyll këto kujtime të përmbledhura për Belgjikën, ku, me një ndërprerje të shkurtër të një pushimi në Shqipëri, qëndrova rreth një vit e gjysmë.

Përshtypjet e mia për këtë vend dhe për këtë popull kanë qenë e mbeten të mira, ashtu siç mbeten të mira e të paharruara edhe kujtimet për Monpeljenë, Parisin e popullin francez në tërësi. Në mesin e qershorit 1936, i pushuar përfundimisht nga puna, mblodha ç'kisha për të mbledhur dhe u nisa për në atdhe. As tentova dhe as doja t'u hyja përsëri përpjekjeve për të gjetur ndonjë punë ose mundësi studimi në Francë a Belgjikë. E ardhmja ime do të përcaktohej në Shqipëri, në mes popullit tim e bashkë me të do t'i kaloja të mirat e të këqijat. Kisha rreth gjashtë vjet që isha larguar dhe në këto vite, në vendet ku jetova, studiova e punova, mësova shumë, siç thotë Montenji në librin e tij të famshëm «Les Essais». Kontaktet, vizitat, studimi i jetës shoqërore të njerëzve, i gjendjes sociale e politike, i jetës artistike dhe kulturore të vendeve të ndryshme e të qendrave punëtore që njoha, më zgjeruan dijenitë e kulturën time. Ato më mprehën politikisht, më forcuan e më brumosën ideologjikisht në pikëpamjet e mia progresiste e komuniste; pse kudo shihja tablo tipike të shoqërive me klasa antagonistë : zhvillimin e borgjezisë gjakpirëse nga njëra anë dhe mjerimin e punëtorëve nga ana tjetër; shihja si shtypeshin proletarët në Breva e demonstrata dhe, në të kundërt, si shtoheshin pasuritë e turpshme të borgjezisë kolonialiste. Më ka mbetur në mendje varrimi «grandioz» i gruas së Leopoldit të 3-të, mbretëreshës Astri të Belgjikës, që u vra në një aksident. Në kortezh shihje fytirat e egra të njerëzve të regjimit mbretëror, gjokset mbushur me dekorata dhe,

nga ana tjetër, punëtorët e metalurgjisë e të qymyreve që gërmonin qindra e qindra kilometra mademe e për viete nLa'; kishin një pëllëmbë tokë ku të varroseshin.

Më forcohej urrejtja për klasat shtypëse e shfrytëzuese dhe kjo kthehej për mua në një forcë që do ta vi-ta në shërbim të atdheut dhe të popullit tim që vuante nën regjimin tiranik të feudalit satrap Ahmet Zogut e më pas të Italisë fashiste e të Gjermanisë naziste. Por këtë r'adhë luftën kundër tyre do ta zhvilloja dulce qenë i brumosur me ideologjinë komuniste, e më pas si ushtar besnik i Partisë Komuniste të Shqipërisë. Për këto ide e ndjenja që i kisha përqafuar dhe i mbroja me zjarr më pushuan nga pupa, por nuk u bëra pishman e nuk u mërzita aspak. Do të shkoja në atdhe, do të bashkohesha me shokët e ani të halleve e të ideve, me popullin tonë trim për të gjetur e çelur rrugët e sigurta drejt së ardhmes. Ndaj pushim;-n nga puna në Bruksel, në këtë pikëpamje e quaja një lfitore për mua, ashtu siç do të ishte përsëri një fitore edhe pushimi që më bënë më vonë si mësues në Liceun e Korçës.

VI

KTHIMI PËRGJITHMONË NË SHQIPËRI

Aty nga fundi i qershorit ose fillimi i korrikut 1936 u ktheva definitivisht nga jashtë, në vendin A tim, në mes të popullit dhe të njerëzve të mi. Për bukë nuk do të vdisja, një rrugëdalje do ta gjeja, se jashtë isha si jabanxhi, pa mbështetje dhe përherë në rrezik, siç dhe më ngjau me bursën që ma prenë ose me pushimin nga puna në konsullatë. Çdo gjë jashtë ishte efemere, pse edhe qëndrimet e mia politike ishin antizogiste, edhe ideologjia që më frymëzonte ishte marksizëm-leninizmi. Gjatë gjithë kohës që qëndrova jashtë isha përpjekur të mos bija në sy te njerëz të dyshimtë për dashurinë që kisha për komunizmin, për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin, për shtypin e Partisë Komuniste Franceze, broshurat e gazetat e tyre komuniste që lexoja etj. Por kjo veprimtari nuk mbetej e fshehtë. Në Bari emigrantët më quanin «Kuqalash»; këtë gjë bënë edhe Ali Këlcyra me Sejfi Vllamasin në Francë. Edhe Qemal Karagjozi i njihte mirë bindjet e mia, se me të shoqëroheshja dhe ai më ndihmonte kur nuk kisha të haja ose të pija ndonjë kafe-krem. Ishte nga një familje e pasur, por më fliste me admirim për komunizmin, bile edhe e ngrinte zërin, sepse s'kishte frikë se i pritej bursa ngaqë studioje me paret e babës.

Kishte ardhur apo jo informacioni në Tiranë mbi arsyet e pushimit tim nga puna, këtë nuk e di, por mendoja se në njëfarë mënyre edhe këtë çështje do ta përballoja, duke bërë kujdes që të mos bija në sy për qëndrimet e mendimet e mia.

Për mua tanfi rëndësi kishte të fitoja bukën duke gjetur një punë të përshtatshme, t'u dërgoja ndonjë lek xhaxhait dhe anesë që ishin hollë ekonomikisht, të njihja situatën ekonomike e politike të vendit dhe të krijoja lidhjet me elementët komunistë e patriotë. Në këtë aspekt të fundit mendoja të veproja me shumë kujdes e vigjilencë, gjersa të shuhej ndonjë përshtypje ose mendim i keq që mund të qe dërguar nga legata jonë në Paris.

Shkova fillimisht në Gjirokastër të çmалlesha me prindërit e të afërmit. Ditët e para e bëra mirë rolin e «djalit të urtë» për sa u përket qëndrimeve e pikëpamjeve politike. Por kjo nuk zgjati shumë. Tamam ato ditë atje ishte sjellë i internuar revolucionari ynë i madh Ali Kelmendi. Mbaj mend se sapo më tha Skënder Topulli se ç'ishte «Maloku» dhe pse e kishin sjellë në Gjirokastër, vendimit për të qëndruar pak kohë -«né hije» i vura kryq. Do të ishte e palejueshme dhe e pafalshme për mua, jo vetëm si djalë gjirokastre, por sidomos për bindjet e mia politike, për idetë komuniste që më ishin rrënjësuar, të mos i afrohesha, të mos e takoja, të mos e dëgjoja atë burrë, për të cilin Skënderin, siç më thoshte ky, e kishin njoftuar nga Korça se ishte ndër figurat kryesor e, në mos mé krvesori, në lëvizjen e atëhershme komuniste në Shqipëri. U v vumë, pr a. në kërkim të «Malokut», dhe, siç kam

tresuar hollësisht një herë tjetër, e gjetëm, ndenjëm gjatë me të. mësuam prej tij dhe bëmë ç'është e mundur gjersa u rregullua puna që ai të dilte jashtë atdheut.

Pikërisht në një nga ato ditë më thërret mësuesi im i viteve të vegjëlisë, patrioti e demokriti Thoma Papapano dhe më foli për përgatitjet që po bënin një grup patriotësh gjirakastritë për një akt të shënuar : do të merreshin eshtrat e Bajo Topullit në Sarandë e do të silleshin në Gjirokastrë, që Bajoja «të prehet ku i ka rënuar koka», siç më tha ai, duke perifrazuar poetin e shquar Andon Zako Çajupi.

- Kam mendimin dhe ua ~am thënë edhe të tjerëve, - vazhdoi Papapanoja, - që fjalimin kryesor në ceremoninë e ardhjes së eshtrave; të Bajos në Gjirokastrë ta mbash ti. . .

U preka e u emocionova pa masë për nderin e madh që më bënin, por í thashë se mbase kjo i takQijte ndonjë tjetri, më të njohur, më të moshuar, unë jam akoma i ri etj.

- Tamam se je i ri, ndaj duhet të flasësh ti, këmbënguli i paharruari Thoma Papapano. - Ne ç'patëm për të bërë e bëmë, Mani radhën e keni ju, djelmuria.

Më nguli sytë e përlotur, pastaj, si heshti pak, zgjati gishtin e më tha duke qeshur:

- Për përmbajtjen nuk ta kam frikën se në mendje i kam hartimet e tua të vegjëlisë. Por kujdes me ortografinë! Mos shkelësh rregullat e gjuhës!

Ia njihja mirë merakun këtij mësuesi të nderuar për saktësinë e të folurit e të shkruarit të gjuhës shqipe, por për ta ngacmuar me të qeshur, i thashë:

- Rregullat ortografike do të mundohem t'i respektoj, por ndonjë «rregull» tjetër mund ta shkel këtë radhë.

Më kuptoi ku e kisha fjalën dhe m'u përgjigj gjysmë me shaka gjysmë me të vërtetë:

- Po shkele gjë nga gjuha, përgjigjem unë, po shkele gjë nga të tjerat, do të kesh të bësh me Xhevat Kallajxhiun, drejtorin e «remokracisë».

Gjithë ato ditë jetova me emocionet e kësaj ngjar jeje. Përgatitja e fjalës që do të mbaja më preokuponte sidon10S për faktin se gjer në ç'masë duhej të shprehja lirisht e hapur ato që më zienin mua në kokë, si gjithë djalërisë përparimtare të kohës. Ceremonia do të ishte publike, do të merrte pjesë populli, por, donin s'donin, do të vinin edhe autoritetet e vendit, që nga prefekti e kryetari i bashkisë e gjer te xhandarmëria.

Duhej gjetur, pra, një gjuhë e një mënyrë e tillë e të thënit të gjërave që fjala për patriotin e shquar të tingëllonte edhe si nderim e mirënjohje e thellë për të e për gjithë patriotët e tjerë që shkrinë jetën për atdheun, por edhe si betim i djalërisë e i popullit për ta çuar përpara e për .ta realizuar çështjen e shenjtë të Shqipërisë, të përparimit e të transformimit të saj. Kështu edhe veprova. Ceremonia e sjelljes dhe e varrimit të eshtrave të Bajo Topullit ishte madhështore, shumë prekëse dhe emocionuese. Dulce nderuar e përkujtuar një patriot të së kaluarës, që regjimi zogist e kishte lënë në harresë, populli i Gjirokastrës, me pjesëtharrjen e gjerë në ceremoni, me fjalët e bisedat publike ose kokë më kokë, gjente rastin të shprehte mllefin ndaj rendit të urryer ekzistues, evokonte të kaluarën për ta vënë në shërbim të përlëshjeve e betejave që e pritnin në të ardhmen. Edhe fjala që mbajta unë u prit mirë. Njerëzve të regjimit disa pjesë u dogjën, por gjuha e përdorur ishte zgjedhur me kujdes, gjithçka justifikohet me faktin se ceremonia zhvillohej për të nderuar një patriot që kishte dhënë jetën për Shqipërinë, e jo për t'i thurur hosana mbretit.

S'shkuan as disa ditë e, nën përshtypjen e madhe që la ceremonia për Bajon, u vendos të krijonim një grup me patriotë e elementë të tjerë përparimtarë për të shkuar në Shkodër, të gjenim vendin ku ishin varrosur, diku në Shtoj, patriotët Çerçiz Topulli e Muço Qulli dhe eshtrat e tyre t'i sillnim të preheshin në Gjirokastrë, në po atë kodër, në hyrje të qytetit, ku tashmë preheshin eshtrat e Bajos. Në grupin iniciator isha dhe unë. U përgatitëm, shkua në Shkodër dhe nuk mund të harroj atë pritje aq të ngrohtë e atë frymë të ndezur patriotike që gjetëm te populli trim e patriot shkodran. Pata nderin e madh që edhe atje të flas unë në emër të delegacionit gjirakastrit e të të gjithë popullit të Gjirokastrës, në ceremoninë që organizoi populli i Shkodrës për të përcjellë eshtrat e Çerçizit e të Muço Qullit.

Të gjitha këto veprimtari që koincidonin në momentet kur sa isha kthyer nga jashtë, i pushuar nga puna me një motivacion tepër të rrezikshëm për ato kohë, vërtet rënë jepnin kënaqësi e më shtonin

vendosmër inë për të vazhduar më tej, por rrezikun e shtonin më tepër; afishohesha hapur në sytë e regjimit për prirjet e pikëpamjet e mia. Megjithatë, dulce u treguar i kujdesshëm që në publik të mos dilja jashtë kuadrit të demokratit përparimtar, që hapur të merrja pjesë ose të shpreheshja për ato ngjarje e çështje, të cilat regjimi zogist, dome s'donte, ishte i detyruar t'i lejonte e t'i pr anonte, pra, dulce vepruar kështu, mendoja se s'do të lija rast ku të kapeshin njerëzit e regjimit. Ndërkohë, nëpërmjet kësaj veprimtarie legale, brenda kuadrit të mundësive që lejonte ajo kohë, jo vetëm do të njihesha më mirë me ngjarjet, hallet e me njerëzit, por do të më krijoheshin raste e mundësi për t'u lidhur edhe me elementë e me grupet komuniste që vepronin në Shqipëri. Takimet e bisedat me Ali Kelmendin më kishin dhënë, në këtë aspekt, një vizion më të qartë për gjendjen.

Por, në radhë të parë e më urgjente dilte çështja e gjetjes së një pune. Aty nga fillimi i vjeshtës shkova në Tiranë, mora kontakt me miq e me shokë, më huan ca lekë Syrja Selfua e ndonjë shok tjetër dhe herë haja te njëri, herë tek tjetri. Në Tiranë kishte plot gjirokastritë, por shumica ishin tregtarë dhe me këta as kisha, as doja të kisha lidhje. Ngandongjëherë shkoja për drekë edhe te Hivzi Kokalari, me familjen e të cilit kishim një lidhje krushqie, nga ana e motrës sime, Fahrijes. Hivziu ishte një «kërriç», si dhe babai i tij, Samiu, i cili kishte vdekur atëherë në qoftë se nuk gabohem, por ai punonte në bankë dhe vëllai i tij Isai, një «kërriç» tjetër, u bë oficer. Të dy hiqeshin kapadainj të mëdhenj, dukej se u rëndej prezenca ime dhe në fakt i rrallova vajtjet tek ata. Nuk dinin të bënin bisedë tjetër veçse të mburrnin paranë dhe Zogun. Në kohën e luftës u treguan proitalianë, u bënë ballistë dhe kur u çlirua Shqipëria dhamë llogari sipas fajeve që kishin bërë.

Në ato kohë mjerimi e pa punë në Tiranë më shumë më janë gjendur Syrja Selfoja dhe Nexhat Peshkëpia.

Syrjai më ndihmonte herë pas bere dulce më dhënë nga 30-50 franga shqiptare, më merrte edhe për drekë, veçse jo në shtëpi, po në restorant. Në shtëpi as unë s'doja dhe as ai nuk dome të shkoja, pse vëllezërit e tij, me përjashtim të Halitit, ishin reaksionarë, antikomunistë, fodullë dhe arrogantë.

Nexhati më mente shpesh për drekë e për darkë në shtëpinë e tij. Ai ishte profesor dhe vëllai i tij, Malilsh1, ishte nëpunës banke. Gruaja e Nexhatit ishte mbesë në Hoxhatët dhe kjo lidhje bënte që unë të shkoja pa teklif në shtëpinë e tyre. Edhe Manushi në atë kohë ishte përparimtar, shok e mik me Shevqet Musaranë.

Nexhati, nuk e di në e kam shënuar diku, ishte anti ' zogist dhe antiitalian me plot gojën, të cilën s'e qepte kurrë. Por, kur erdhi Italia dhe filloi lufta, si Nexhati ashtu edhe Manushi u bashkuan me Ballin Kombëtar, me tradhtarët e popullit e kuislingët, luftuan Partinë tonë, Frontin Nacionalçlirimtar dhe mua personalisht. Manushi më pas mori dënimin e merituar, kurse Nexhati u arratis me anglezët në prag të Çlirimit, kaloi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku vazhdoi të na luftonte me organizime diversantësh dhe me propagandë. Para disa vjetësh ngordhi edhe ai në Nju-Jork si tradhtar e armik i Shqipërisë socialiste dhe i komunizmit.

Çështja e punës po kthehej në një odise të vërtetë. I uk dija asnjë zanat që të më pranonin si çirak në ndonjë punishte, kurse punë në ndonjë tregtar nuk gjeje, as te Selfoja, që e kisha gjirokastrit, pa le në të tjerë. U drejtova në Ministrinë e Arsimit për të më emëruar diku mësues të gjuhës shqipe ose të gjuhës frënge, por ishotte e pamundur. U thashë se mund të jepja edhe biologji (botanikë ose zoologji) sepse, pavarësisht që s'kisha diplomë, kisha studiuar për to, por edhe për këto veshi i ministrisë ishte i shurdhër. Iu drejtova ndërkohë edhe Ministrisë së Drejtësisë, duke pasur parasysh se me dijet që kisha fituar në kurset që ndiqja në Francë e Belgjikë, do të më dëgjonin. Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë ishte një Emin Toro nga Gjirokastra, e njihja, dhe ia par ashtu ova çështjen. Ndonjëfarë sekretar gjyqi, i këi kova, dulce i vënë në dukje se në gjithë atë kategori plu nonjësish që kishin zënë vende, shumë nuk kishin asnjë farë diplome, bile kishte edhe me shkollë filllore.

- S'kanë diplomë e shkollë, por kanë të drejtë të bëjnë drejtësinë! - më thoshte në ndonjë mon:er konfidencial Emini.

- Po unë, i për jashtuar jam nga kjo «e drejtë»? e shpoja. - Apo të drejtën e mbron ai që e shkel o---: që s'di fare se çështë drejtësia?!

Emiri pas kësaj bëhej i zymtë e më përgjigjej thatr

- S'kemi punë!

U rropa duke shkuar nëpër ministri, po reireni «s'kemi punë» e dëgjoje kudo.

- Insisto në Ministrinë e Arsimit! - më thoshn Nexhati, Aleko Tashkoja, Lele (Vangjel) Gjikondi. profesorë të gjimnazit të Tiranës, dhe unë atë palnë bëja. pc asgjë s'dilte në dritë. Shpesh si sebeb më nxirrnin mulgesën e diplomës, por kishte të rinj në Shqipëri që kishi diploma e punë s'gjenin. Regjimi u trembej njerëzve o mësuar, injoranca e analfabetizmi ishin sheshit. Kurse Fejzi Alizoti. ministër dhe deputet i Zogut. shërbëtor italianëve; thërriste: «Ç'na duhen gjithë këta njerëz me diploma».

Kur isba në kulmin e dëshpërimit nga një gjendje tillë me balle e pa per spektivë, më vijnë Nexhati me Svrjain dhe më thanë:

- Morëm vesti që Kryqi i Kuq Shqiptar jep bursa për jashtë. Tientoje edhe një herë fatin!

- Është e kotë, - u përgjigja, - nuk dua të da më jashtë! Mësova dhe pashë sa munda, tanfi dua punoj brenda dhe të fitoj një krodhë bukë për vete clipër pleqtë !

- Nuk e sheh që s'po të jep njeri punë?! - këmbër ngulte Syrjai. - Bëje një herë një lutje se nuk humbet gjë, po doli, doli.

- Mirë, - pranova, - po e bëj që të mos ju prish qejfin.

Shkrova një lutje, e nisëm por asgjë s'doli; siç duket e hodhën në shportë. Isba më se i sigurt që kështu do të ndodhte prandaj u kërkova Nexhatit dhe Syrjait që të vazhdonin të vinin në iëvizje miqtë e tyre që ishin pezzo grosso, për në Ministrinë e Arsimit !

Më së fundi, pas shumë përpjekjesh, mundimesh e vuajtjesh ministria pranoi të jepja mësim me orë, kur mungonte njëri ose tjetri mësues, në gjimnazin e Tiranës. U gëzova shumë, se tash e tutje do të punoja edhe me rininë, do t'u mësoja hapur e me gjithë shpirt çfarë dija në lëndën mësimore që do të jepja dhe, tërthorazi, do t'u ngjallja urrejtjen për regjimin. E nisa punën si mësues «proletar»: s'kisha të drejtë të sëmuresha, as të merrja pushime si gjithë të tjerët, pse isba me orë, domethënë aq sa orë punoja, aq lekë paguhesha! Kjo gjendje vazhdoi për gjithë ata 4-5 muaj sa punova në gjimnazin e Tiranës.

Fillimi i punës në gjimnaz, pavarësisht se merrja pak si rrogë, ishte për mua një lloj legalizimi zyrtar. Tash e kisha një mbulesë dhe nga ana ekonomike e nuk do t'u bija në qafë të tjerëve. Ishte një barrë e rëndë për mua, por duhet të kesh njohur urinë që ta kuptosh drejt edhe kërkesën e ndihmës nga të tjerët, pavarësisht se ata në atë kohë ishin miq e shokë të mi. Më dukej sikur lypja prej tyre, e konsideroja këtë një humbje të personalitetit. Por në varfëri dhe në mjerim, kurrë nuk e ula kokën as edhe përpara miqve e shokëve. Është e vërtetë se njerëz si Syrjai e Nexhati më ndihmuan e u sollën shumë mirë me mua, por, edhe në momentet më të rënda, do t'ua kisha refuzuar çdo lloj ndihme, nëse s'do të puqeshim, të paktën si shqiptar ë patriotë, në mendime e pikëpamje. E vërteta është se me të dy këta flisja hapur për çështje politike kundër regjimit të Zogut, pse që të dy në atë kohë ishin antizogistë.

Tani që më caktuan në gjimnaz, më duhej të rifilloja punën dhe luftën ilegale, të lidhesha së pari me shokë e elementë komunistë. Por në Tiranë kjo për mua në ato momente nuk ishte një gjë e thjeshtë, sidomos për faktin se në kryeqytet nuk kisha qëndruar asnjëheri gjatë, kisha pak të njohur ndër elementët demokratë (revolucionarë dhe asnjë lloj lidhjeje ose informate ti sigurt se me kë mund të takohesha për të hyrë në «struk~ turat» e lëvizjes së atëhershme komuniste. U përpoq shumë por s'po e kapja dot fillin, nëse ekzistonte vërte ndonjë fill i tillë i lëvizjes së organizuar komuniste ni Tiranë. Ai që më fliste herë pas here për «komunistë»

lëvizje komuniste ishte Tahir Kadareja, i cili në ato viti kishte mbaruar shkollën e plotësimit të oficerëve në Ti ranë, por fjalëve e historive të Tahirit vështirë t'u besoj seriozisht. E njihja në Gjirokastër që nga fëmijëria dh kur mbërrita në Tiranë disa herë flija në haurin ki ishte vendosur Tahiri. Me të bisedoje lirisht përse të doje kundër Zogut, kundër Italisë fashiste, për komunizmin et; dhe vura re se ai nuk i bënte këto thjesht për pozë ap për t'u hequr si përparimtar. Pavarësisht nga mendimE e pikëpamjet e avancuara që shfaqte, njëherë e pyet nëse këto pikëpamje ishin thjesht të tijat, ose të dy-tr të tjerëve, apo kishin ndonjë gjë më të organizuar, m serioze në këtë aspekt.

- Kishim alamet grupi! - më tha. - Po shkonir drejt krijimit të partisë, por na goditi Zogu kur deshër ta qëronim !

- Si? Në ç'mënyrë? - e pyeta.

- S'ke dëgjuar ç'u bë vjet këtu në verë? - më th i habitur. - Gati-gati morëm fuqinë. E kishim përga titur çdo gjë me hollësi, për dy-tri ditë do të bëhej nam por tamam kur ne do të shpërthenim kryengritjen, d kush tradhtoi e na zunë të gjithëve.

- Ç'thua! - ia ktheva me një lloj keqardhjeje

qesëndie bashkë. - U paska ikur zogu nga dora ! Mos kei gisht në ngjarjet e Fierit?

- Tamam ato! - thirri. - E paske dëgjuar Repartet kryesore të ushtrisë në Tiranë i kishim në dua Edhe xhandarmërinë e kishim me vete. Gjer edhe top; që do të qëllonin pallatin e mbretit i kishim caktuar. Por na zunë. . .

Më foli hollësisht, ca të vërteta e ca gënjeshtër për t'i bërë gjërat sa më tragjike e tronditëse, por nga gjithë ç'më tregoi, akoma më tepër u binda se «Lëvizja e Fierit» jo vetëm s'ishte e organizuar mirë dhe nga një qendër e vetme solide, por edhe se në përgatitjen e «shpërthimit» e saj, siç do të mësoja më vonë, elementët e grupet komuniste nuk ishin në krye të situatës. Tahiri më foli mbarë e mbrapsht, s'më ruajti gjë, por, nga gjithë ato biseda, m'u

krijua përshtypja se ai dinte shumë pak mbi gjendjen e vërtetë, organizimin dhe shtrirjen e lëvizjes së atëhershme komuniste në Tir anë use në të kundërtën, Tirana kishte mbetur prapa në këtë drejtim. Për sa u takon «oficerëve komunistë», për të cilët Tahiri fuste me ziarr. ata sidomos pas «Lëvizjes së Fierit», ishin bërë kashtë e koqe. Ishin shpër ndarë nëpër Shqipëri, disa ishin dënuar , disc ishin nxjerrë në lirico, të tjerë s'ndiheshin fare. Por ky «gr up komunist i oficerëve» cështirë se round të cilësohej si i tillë edhe para se të shpërndahej, sepse ishte tepër konspirativ dhe i mbyllur br enda një numi i të kufizuar oficerësh të rinj, nuk kishte ndonjë platformv politike të qartë, as ndonjë formë organizimi të përcaktuar, use ndonjë veprimtari që në një rën apo tjetrën masë të ndihej në popull. E pyeta Tahirin nëse dinte gjë se ç'bëhej në prefektura e krahina në drejtim të lëvizjes komuniste; më foli diçka të mjegullt për Korçën, por e pashë se nuk dinte gjë për të qenë. Me disa elementë në Tiranë që më sugjeroi, s'rashë dakord të takohesha, sepse, siç më tha vetë, ata s'dinin më tepër se ç'u thoshte Tahiri. I tubante «në lidhje» më shumë për muhabet e për ndonjë dorë bixhoz sesa për veprimtari ilegale. Kaluan kështu disa muaj dhe s'po gjeja asnjë rr ugë e mundësi për t'u lidhur me elementë të vërtetë komunistë.

Dulce u nisur edhe nga fakti që mënyra si isba sistemuar me punë në Tir anë ishte krejt gjysmake, nisa përpjekjet për të kërkuar punë si mësues në Korçë. mundësisht në lice. Atje i njihja mirë qy tetto e njerëzit e tij, njihja liceun, shokë e miq kisha më tepër. Kryesorja është se e dija, sidomos nga Ali Kelmendi, se lëvizja komuniste atje ishte më e organizuar e më e ndjeshme. Punëtorët korçarë, komunistët e atjeshëm, mendoja, do të më gjejnë vetë, pavarësisht nga përpjekjet që s'do të më mungonin. U ankova disa herë në drejtorinë e gjimnazit të Tiranës e në ministri për statusin tiro gjysmë me punë, gjysmë pa punë, bër a presion dhe. ndër kohë, vura në lëvizje kolegët e gjimnazit që të më ndihmonin të gjeja një punë për të qenë në arsim, qoftë edhe jashtë Tiranës!

1~Ië në fund, aty nga marsi i vitit 1937, më njoftuan se isba emëruar me punë në Liceun e Korçës ! Kjo ishte një fitore e madhe për mua, një ngjarje që do të ndikonte shumë në të ardhmen time. Iuk prua gjatë, mblodha ato pak gjëra që kisha. u nisa në një nga ditët e para të pr iilit dhe mbër r ita në Korçë. Këtu çdo gjë ishte e nj ohur dhe e dashur për mua : r r ugët e r rugicat, shtëpi të e oborret me kangjella; gratë punëtore e pastërtore korçare, të kulturuara, të zgjuara e që s'dinë të përkulen në jetë; bur r at e djemtë korçarë punëtor ë e seriozë, tr ima e për par i mdashës. 'aIë dukej sikur më për shëndetnin e më uronin mirëseardhjen të njohur e të panjohur dhe kjo ndjesi vinte pa dS-shim nga kujtimet e shumta që kisha për këtë qytet e këta njerëz.

Formalitetet në lice nuk zgjatën shumë. më thanë se do të jepja gjuhë frënge e mural dhe, pas kësaj. si për të mos u gëzuar shumë, më njoftuan se norma e punës siine përsëri do të ishte e cunguar ; do të paguhesha sipas orëve të mësimit që do të jepja!

- Pse kështu` - i pyeta. - Ië ministri më thanë se jam emëruar definitivisht.

- Nuk treni ngar kesë të plotë. - më thanë. Në na u krijofte ngarkesë. do të ta japim.

luk e zgjata shumë. Pranova, kërkova një ditë leje sa të gjeja një dhomë banimi e të sistemohesha. I lisi kështu faza e dvtë e jetës siine në Korçë. task si mësues në lice. Punova këtu tre vjet me radhë si mësues dhe gjithmonë ato vite i tram kujtuar dhe i kujtoj me përshtypjet më të mira. Procesi mësimor për mua nuk ishte i zorshëm, jo vetëm se tash kisha njëfarë përvoje nga 3-4 muajt e punës në gjimnazin e Tiranës, por kryesorja ngaqë të dyja lëndët që jepja, gjuhë frënge e moral. përpiques - që mësimet t'i zhvilloja sa më lirshëm, largr regullave të pedagogjisë pedante, dulce u përpjekur ta ktheja orën e mësimin në një lloj bashkëbisedimi me nxënësit. Kjo gjë më dukej më e përshtatshme edhe për përvetësimin më të mirë të mësimin nga nxënësit, por edhe për mundësitë e shumta që krijon bashkëbisedimi për të kaluar nga subjekti në subjekt, nga tema në temë, nga problemi në problem. Me kohë këto bashkëbisedime didaktike u thelluan. Vetë nxënësit u mësuan që, qoftë si shembuj gjatë konversationit në frëngjisht, qoftë për sqarim «paqartësish» në orën e moralit, të shfaqnin mendime e pikëpamje dhe të ngrinin probleme që ishin tepër të avancuara për kohën, pale për programin zyrtar të shkollës. Natyrisht, përpiquesha të ruhej masa, sepse kurrsesi s'doja e s'lejova që për një «kënaqësi» ose «guxim» të rastit, të ngjalleshin dyshime e të zbulohesh ajo çka zhvillohej jashtë orës së mësimin. Sepse, fakt është, në ato tre vjet të punës sime në Korçë, qenia profesor në lice dhe dhënia e mësimin me kohë u kthyen në një sfond, në një mbulesë të veprimtarisë që nisa të zhvilloj dhe unë në radhët e Grupit Komunist «Puna» të Korçës.

Për t'u rilidhur me komunistët korçarë nuk e pata të vështirë. Disa ditë pas mbërritjes sime atje, shkova në bazën time të vjetër, në ëmbëltoaren e Koci Bakos, për t'u takuar me mikun e vjetër e për të nxjerrë mallin e «ëmbëlsirave» të kohës kur kisha qenë student. Koci m'u hodh në qafë sa hyra te dera dhe u habita kur mësova se ai e dinte që isha emëruar në lice.

- Kur më thanë që ke ardhur profesor në lice edhe u gëzova, - nisi të më thotë, - por edhe mendova se s'kishe për të ardhur më në karakatinën time.

- Ç'thua! - ia ktheva. - Përse të mendoje ashtu?

- Epo helbete! Kur ishe student i varfër, ëmbëlsirat e Kocit ishin luks i madh! Tanfi që u bëre profesor, mendova se do bësh si të tjerët, do t'i mbash këmbët te «Kristali»: . .

- Kot që m'i ke dhënë ato ëmbëlsirat atëherë, e shpova dulce i shkelur syrin. - Pse kjo është konsiderata jote për mua, kështu më ke njohur?!

- Jo bre, Enver, po ndryshojnë gjërat, ndryshojnë njerëzit! «Ka qenë në Evropë, në Paris, ku i hyjnë më në sy ëmbëlsirat e mia!» mendova. Por kam menduar ligisht. Rrofsh që erdhe! Ç'do, të të kënaqë Koci?

- Nga ato ëmbëlsirat e atëherëshme, nga ato që pëlqejja më shumë! - i thashë dulce vërejtur rrotull dy-tre khentë që qenë ulur në një bankë e na shihnin disfi të cuditur.

- Bre, bre, profesori! - thoshte Koci, e shihte me një nënqeshje kuptimplote. U ul dhe ai një copë herë, biseduam lirshëm, e pyeta e më pyeti për familjen e punët, kujtuam shokë e të njohur të viteve të shkuara. Asgjë «të dyshimtë» nuk shqiptuam as unë as ai, por njëri-tjetrin e kuptonim.

S'shkuan shumë ditë pas kësaj, kur një mbrëmje, te shtëpia ku isha vendosur, më ndodhi një ngjarje disfi e veçantë. Menjëherë pas mbërritjes në Korçë isha sistemuar në një-shtëpi në të cilën ndenja disa muaj, para se të vendosesha te shtëpia e Andresë së Thullës, ku qëndrova gjer në fundin e vitit 1939. Kjo shtëpi e dytë, që tanfi quhet edhe «shtëpia e Poliksenit», sipas emrit të zonjës së shtëpisë, një grua e zgjuar, punëtoare dhe nikoqire korçare, fjalëmbël dhe bujare, njihet e mbahet si shtëpia ku unë banova në ato vite në Korçë. E vërteta kështu është, shtëpia e Andresë së Thullës dhe e Poliksenit u bë si shtëpia e prindërve të mi, atje më trajtonin e më donin si djalin e tyre, por duhet të them se edhe për shtëpinë e parë, ku vërtet qëndrova pak, vetëm disa muaj, ruaj përshtypjet e kujtimet më të mira.

Ndodhesha pra në këtë shtëpi të parë, kur disa ditë pas vizitës tek ëmbëltorja e Kocit, një mbasdite, ndërsa po përgatitesha për mësimin e së nesërme, hyn i zoti i shtëpisë e më thotë:

- More Enver, po pse s'na ke thënë nere që s'të. heq mirë oxhaku?! Shkonim ne gjenim usta, more djalë, pse vihe në siklet vetë?!

Nuk po mer rja vesh fare se përse ishte f fiala dhe, - sa do t'i thosha që s'kisha idenë e kësaj gjëje, zgjatkokcn te deva një i panjohur për mua e thotë:

- Zoti profesor, më dërgoi .ostai t'ju pastroj oxhakun sipas porosisë suaj ! . . .

E mbloodha shpejt veten duke rënduar se diçka fsi-rihej pas këtij «shër bimi» të papritur dhe u detyrova të justifikohem tek i zoti i shtëpisë se gjoja vërtet kisha biseduar me ca shokë për tymin e sobës.

«Pastruesi i oxhakut» hvri br enfia, lëshoi mbi dysHEME një çantë me ca litarë, çekicë e lecka e nisi t'u vertitej tubave të sobës. E pashë se sia thoshte atij zanati, bile aq shumë i godiste me çekiq, sa rrezik t'i shtrembëronte e t'i rrëzonte fare.

- Me cilin usta punon? - nisi të pyesce i zoti i shtëpisë.

- Me më të mirin e Korçës! - ia kxhente «pstruesi».

- Po ç'emër ka ai, bre djalë?!

- Të orbar oj punë pasta] ta theni! - i bënte bislit «oxhakpastruesi» e bumbumb mbi qyngjet e sobës e në rrëzë të murit, ku tubi futej në oxhak. - Di c'ke zotroie? - ia ktheu pasta] të zotit të shtëpisë. - Shko i thuaj sat shoqeje të na bëjë fiati kafenë e rakinë. Do të vimë me profesor in ta pimë poshtë, te sobalka.

Ai zbriti dhe, ndërsa unë po mundohesha të zhbiroja se ç'ishte tërë kjo histori, «pastruesi i oxhakut», nisi të më tregonte

- Erdhi Koci Bakoja tek Lzstai e po të lëvdonte e të ngrinte né, qiell. «Profesor liceo, biri i botës, po dashurli3e ka me proletarët», kështu i thoshte.

«Mos të do për të ëmblat. o Koci» i tha usta Pilua, por Kocit ia ke rrëmbyer zemrën. «Jo bre, - i thoshte, - ja ta njohësh e do ta shohësh se edhe kudhrën tënde do ta dojë, edhe mballomatarinë e Mihës do ta pëlqe jë» .

Se që thua, ti profesor, ne punëtorë e të këputur jemi, punojmë kush në një dyqankë e kush në një punishte, rior merremi vesh mirë dhe e duam njëri-tjetrin. Po edhe për të lexuar lexojmë ndonjë gjë, edhe njerëzit e mençur i duam. Njerëz të mësuar, që thua zotrote, ka plot Korça, pa ka të mësuar e të mësuar . Dome~thënë Kocit ia ke bërë shumë qejfin, i ke hyrë në zemër. Më tha vetë Piloja «t.~a shko o Raqkë, se Raqi Themeli më quajnë, e shihe p,ofesorin si i shkon tymi». «Ç'tym a t'u mbylltë! - ia Wheva. - Unë jam teneqexhi, s'marr vesh nga oxhakët». «Po shko bre, e hiq hundët te dhoma e profesorit! tna ktheu Piloja. Shih si i vete tymi, ç'ka ndonjë hall se, helbete, i porsaardhur është r_ë Korçë!». Ja, për këtë erd~îa, o zoti profesor, të bëra ca pis e rrëmujë po një qar e kam: do ia pi një raki e një kafe zonjës së shtëpisë.

Qeshja gjatë tregimit të tij, e kuptova mirë mesazhin dhe në fund, për ta ngacmuar i thashë:

- Faleminderit për të gjitha, po më thuaj: si t'u dak se ecën tymi im?!

- Birinxhi, bre profesor, brPinxhi më duket mua! Tnem për kutin e hundës sime, bre. se ndry she e kam unë, ndryshe Koci, ndryshe Piloja!

Të nesërmen a të pasnesërmeri shkova te farkëtaria e Pilo Peristerit, e njohëm shpejt nj ri tjetrin dhe që nga ato momente nisi veprimtaria ime, hrnë e organizuar, nië radhët e Grupit Komunist «Puna» të' Korçës. Më vinte, mirë dhe e kisha për nder që në ato vite militova aq sa munda dhe pa kursver asgjë në radhët e këtij grupi komunist, krah për krah me proletarët komunistë Miha Lakon e Pilo Peristerin, Koci Bakon e Sotir Gurrën, Petro Papin, Mesti Titanin, Petraq Titanin, Raqi Themelin, Foni Thanon, Llambi Dishnicën, Stefo Grabockën e dhjetëra të tjerë.

Gjithmonë i kam çmuar e i karn nderuar ata për faktin se në ato kohë të rënda ditën të ngrihen ndër të parët mbi mjerimin dhe zvetnimin, ditën të shhin përpara, organizoheshin a të hidhnin bazat a lëvizjes komuniste e punëtoare në Shqipëri. Kishte në veprimtarinë e në format organizative të lëvizjes komuniste në atë fazë edhe gabime e të meta, kishte dobësi e kufizime, të vogla ose të mëdha, të ndërgjegjshme ose të pandërgjegjshme, por kryesorja ishte që idetë komuniste dhe lëvizja komuniste në Shqipëri ette përpara, shtrihej e hidhte rrënjë në Korçë e në Shkodër, në Tiranë e në Elbasan, në Vlorë e në Gjirokastrë, dulce përgatitur gradualisht, përmes luftës e përpjekjeve, terrenin mbi të cilin më pas do të themelohej Partia e lavdishme Komuniste e Shqipërisë. Në tërë atë proces të mëpasshëm revolucionar ku do të na çonte Pania, vendi dhe roli i punëtorëve komunistë të Korçës është nga më të rëndësishmit e më kryesorët. Dhe është kënaqësi e krenari për mua që pata fatin të përgatitem si ushtar besnik i Partisë, pikërisht në radhët e «Punës» së Korçës. Një biseda

e takime të lira ose të organizuara në fshehtësi, punëtorët e Korçës kishin dëshirë e etje të pyetnin pareshtur, të mësonin t'u zbërtheje njërën ose tjetrën temë apo problem. Por duhet të them se ata vetë, edhe pse në shumicën dërrmuese s'kishin ndonjë arsim të veçantë, karakterizoheshin nga një sens politik e ideologjik i zhvilluar, qenë të pjekur e seriozë dhe nga të gjitha këto mësova shumë.

Si «sektor» mua më caktuan të punoja për përhapjen e ideve komuniste e për të çuar detyrat e grupit në lice, në radhët e intelektualëve përparimtarë e të rinisë jashtëshkollore korçare. Për këtë të fundit, me rekomandim të udhëheqjes së grupit, u bëra edhe anëtar i shoqërisë «Rima jashtëshkollore korçare» dhe merrja pjesë rregullisht në tërë veprimtaritë e shoqatës, që, ç'është e vërteta, në ato vite ishin të shumta dhe shpesh me karakter të ndjeshëm politik.

Kur unë nisa veprimtarinë në grupin «Puna», kishin ardhur direktivat e reja të Kominternit për lëvizjen komuniste në Shqipëri, të përpunuara në një mbledhje në Moskë në dhjetor 1935 - janar 1936 në frymën e direktivave të Kongresit VII të Kominternit. Siç dihet, Grupi i Korçës, që në verën e 1936-s u njoh me ato direktiva dhe ishte ndër të vetmit që i pranoi ato, dulce filluar nga kër «intelektuali revolucionar»! Kështu ma prezantuan edhe mua fillimisht dhe, sfida që fodullëku e kapadailëku i tij shfaqeshin sheshit. e dëgjoja dhe e respektoja. Shihja se më ndryshe, më realisht e çmonin atë komunistët punëtorë si Miha, Piloja e të tjerë. Me kohë, kur bashkëpunimi im me Koçon u shtuan, gjithnjë e më tepër u jepja të drejtë shokëve punëtorë për vler at e konsider atat ndaj këtij personi.

Tamam në këtë kohë; në radhë të parë për vetë vlerat e cilësitë e saj të vyera, por edhe si rezultat i punës së Koços, u afrua e u inkuadrua në veprimtaritë legale që drejtonte Grupi i Korçës, një nga intelektualët më të mira e më në zë të Shqipërisë, artistja e talentuar e virtuoze Tefta Tashko Koço. Edhe me Teftën më lidhi një shoqëri e miqësi e madhe, e cila u theliua e u sprovua në vitet e vështira të luftës, sidomos në kohën e ilegalitetit të thellë në Tiranë. Tefta Tashkoja nuk ishte as anëtar e e Grupit të Korçës, as më vonë anëtare e Partisë sonë Komuniste, por gjatë gjithë kohës ajo ishte e mbeti për ne shoqe e vërtetë e punës dhe e idealit. Zërin e saj të mrekullueshëm e vuri në shërbim të çështjes së popullit dhe, pas Çlirimit, talentin e jetën e saj i shkriu për popullin, për çështjen e Partisë.

Mes intelektualëve të tjerë me të cilët bashkëpunoja në ato vite, me orientim të grupit komunist. ishin edhe Ptaqi Qirinxhi e Manol Konomi, të cilët ishin anëtarë të 5rupit komunist. Mbanim në lidhje edhe të tjerë si miqtë e mi Vangjush Mion e Kristo Konon; të cilët vërtet s'u bënë komunistë, por përkr ahën pa kur sim vijën e direktivat tona, pa folur këtu për të tjerë, me të cilët punuam. u përpoqëm, u doiëm borxhit, por kur erdhi pura. ata iu kundërvunë Luftës Nacionalçlirimtare. Partisë e popullit.

Por këta ishin të paktë e i kam fshirë nga kujtesa, në krahasim me atë gardë të shëndoshë e revalucionare që përbënin bijtë e bijat më të mirë të Korçës, emrat e vetitë e të cilëve i ruaj të pashlyera në mendjen e në zmrën time.

Këto ishin kujtimet më kryesore të periudhës para dhe pasi u ktheva në atdhe në verën e vitit 1936. Natyrisht, jeta është plot evenimente, të vogla e të mëdha dhe të gjitha, as mbahen, as ia vlen të mbahen mend. Kam bërë shumë përpjekje të jem sa më ekzakt në ato që kam shkruar, por në ndonjë gjë mund të mos kem qenë krejt i përpiktë, sepse për gjithë periudhën derisa u lidha me shokët e Grupit të Korçës, por edhe në kohët e para pas kësaj, nuk kam mbajtur asnjë shënim. Edhe gjatë kohës së luftës nuk kam mbajtur ditarë të rregullt për arsye konspiracioni dhe të goditjeve të pareshtura me armiqtë okupatorë dhe veglat e tyre, kurse materialet tepër të rëndësishme dhe dokumentet zyrtare të kohës së luftës, i kam ruajtur si sytë e ballit dhe sot Partia dhe populli i kanë në duar. Prandaj këto shënime për vitet e rinisë sime jam përpjekur t'i hedh në letër duke u mbështetur kryesisht te kujtesa. Këto janë kujtime për Nexhmijen, për fëmijët e mi, por mbi të gjitha, ashtu siç janë dhe për aq vlerë sa kanë, janë pronë e Partisë sime të dashur. Përmes këtyre kujtimeve dëshiroj që Partia ime e madhe, e cila më rriti, më edukoi e më mësoi, ta njohë jetën time gjer në detaje, me të mirat dhe me dobësitë e saj. Se sa do të vlejnjë këto kujtime për këtë qëllim është tjetër punë, por unë, tash që po më mbulojnë thinjat, një gjë e them me krenari e bindje të

plotë: është një jetë që e kam vënë derisa të vdes në shërbim të Partisë së dashur, të popullit të dashur, të komunizmit dhe të revolucionit profetar!

VII

KUR VIJ NË KORÇË

(Marrë nga Ditari i shokut Enver Hoxha; shënim i hedhur prej tij më 18-20 gusht 1975.)

Gusht 1975

Më 18 gusht u nisëm me Nexhmijen për në Korçë. Kënaqësi e madhe rrugës. Gjelbëronte fusha e bukur e Star ovës, gjelbëronin misri e panxhari, ngrihej lar t lupola. Më tej Zervaska me shtëpi të bukura, me pyllin e gështenjave mbi kokë dhe krahas plantacionet e gjera me pemë frutore, mollë, dardhë, kumbulla etj. Bujqësi e kulturuar! Kapërcyem Pllo-çën në Çërravë e përsëri kudo gjelbërim, pyllëzim, shtëpi e fshatra të bukura dhe të veshura alga të gjitha anët me pemë. I kam vizituar e i njoh që na vitet e luftës këto fshatra, të cilat për vit bëhen më të Ëukur a. I them Nexhmijes:

- Ah sikur të bëheshim prapë të rinj, në zjë nga këto fshatra do të vinim të jetonim e të punonim. Shiko ç'anrekulli !

E tillë është pamja cleri në Korçë.

Kur vij në Korçë, ndiej një kënaqësi të veçantë, pse, veç të tjerash, këtu kam kujtimet e rinisë, të luftës për komunizmin në radhët e Grupit të Korçës. Të gjalla e të pashlyeshme më kanë mbetur kujtimet kur erdha këtu si mësues në lice, miqësia, shoqëria e ngushtë me nxënësit e mi të dashur, që u ngritën në demonstrata, që u hodhën në luftë kundër okupatorit dhe luftuan trimërisht. Kur vij në Korçë takohem me shokë të vjetër dhe të rinj, me punëtorë e me komunistë. Kjo më shton jetën, ndiej një gëzim të madh, gjallërohem. Më kujtohen bisedat me Miha Lakon, në dyqanin e tifi të vogël, ku dulce rrahur shollën e këpucës që të mas na dëgjohej biseda, flitnim dhe organizonim demaskimin e trockistëve, arqiomarksistëve, si: Niko Xoxi, Aristidh Qendro, Zef Mala. Më kujtohet farka e Pilos përballë kafënesë «Afrika», ku mblidheshin dhe edukoheshim për veprim.~Kam kujtimet e Koci Bákos, dyqanin e tifi të vogël ku shkonim e hanim nga një pastë dhe dëgjonim «Internacionalen» nga Moska e Stalinit. Kam kujtimet e mikut dhe shokut tim Sotir Gurrës, mbledhjet që bënim në shtëpinë e Korit, në kafenë e vogël pas «Mercur fit» o te dyqani i qymyrit të Hamit Bacës, ku dikur vinte Ali Kelmendi, kur ishte i internuar në Korçë. Në Korçë kam kujtimet e mësuesit dhe më vonë të kolegut tim, Vangjush Mios. Kur isha nxënës i liceut ai më thërriste «kòlopuç», pastaj, edhe kur u bëmë kolegë të dy, ai vazhdonte të më thërriste prapë «kòlopuç». Shkonim tok jashtë Korçës, në këmbë të Moravës, në Boboshticë, në Drenovë; ai ngr finte kavaletën dhe pikturonte, unë e vëreja dhe herë-herë lexoja.

- Kur ta mbaroj, më thuaj mendimin! - më porosiste.

- E ç'të të them, - i thosha, - s'ka piktor .si ti, s'ka peizazhist më besnik të natyrës se ti!

- Mos më lëvdo, - më thoshte.

- Jo, s'e kam zakon atë gjë! - i thosha Vangjushit dulce admiruar veprën e tifi.

Disa herë shkonim tok në studion e fotograf Sotirit, një ar tist i dalë nga populli dhe shumë i talentuar. Atje bisedonim. Shpeshherë u thosha të dyve:

- Këta qena që na sundojnë, na mbyten çdo gjë, edhe artin na e mbyten. Por populli shijon vepr at tuaja. Të dy fieni artistë të shquar.

- Zogu e larot e tifi, - thoshte Vangjushi, - janë qelbanikët më të mëdhenj !

- Ç'e do, - thoshte fotograf Sotiri, - s'ua hamë dot kokën.

- Do t'ua hamë! - u thosha unë.

- Po qysh? - pyeste Sotiri, - me fotografitë e mia e me peizazhet e Vangjos?
- Edhe me këto! - i thosha. - Edhe arti i vërtetë, si veprat tuaja, janë armë në luftën për zhvillim e drejtësi.

- E di ti, Sotir, - i thoshte Mioja, - «kolopuçi» është komunist.

- Qoftë shëndoshë, ne s'jemi!? Por po ta marrësh hollë-hollë, o Vangjush, i thoshte Sotiri, - se mos ne i duam Selim dhe Tefik Mborjen, Turtujt, Lakot e gjithë sorollopsëtë. Jo vetëm që i urrejmë, por mender këtu i kemi! - dhe Sobri ngrinte këmbën dhe me pëllëmbë u binte vitheve. Qeshnim.

- Këtyre kodos'hëve, - vazhdonte Sotir i, - duhet t'ua bësh si Karamanka që i shan në mes të rrugës. Të gjithë këto e të tjera më kujtohen kur vij në Korçë. Më shtohet jeta kur marr kontakt me punëtorët, me kooperativistët. Më merr një mall i madh për punëtoritë e tyre të dikurshme, të vogla, nga ku dilnin në demonstratë kundër okupatorëve, më merr një mall i papërshkrues për fshatrat e shtëpitë e tyre, për shokët partizanë të Vithkuqit, të Gjançit, të Voskopojës, të Panaritit, të Shpërkës, për barakat e Zvarishtit, për Progrin, Dusharin e shumë e shumë fshatra të tjera, ku kam luftuar si ushtar i Partisë sonë të madhe dhe i popullit tonë të mrekullueshëm.

Më merr malli për rrugët dhe shtëpitë e vjetra të Korçës.

- Ju lutem, i guani, - u them shokëve, - i restauroni, i urbani mirë, se janë veprat e popullit tonë gjenial!

Këtë herë u rashë anembanë me automobil rrugëve të Korçës. Tash u plaka, por, kur isha i ri, u bija tej e tëhu me këmbë. Dhe më vjen mirë që, si kur isha i ri dhe tanfi që u plaka, e shijoj dhe e ndiej me shpirt ar tisti kulturën materiale e shpirtërore të popullit. Shpirtin e kam artist, bile edhe më adhuroes e të pjekur se në rininë, për të shijuar veprat e bukura, xhevahiret e gjenisë së popullit tonë.

Shkova e pashë pazarin e vjetër të Korçës, qendra e dikurshme e punëtorëve. Kam dashur që ai të ruhet, të restaurohet, të mbetet siç ka qenë, si një monument i dyfishtë, monument kulture dhe monument politik, ideologjik, djepi i punëtorëve korçarë. Partia po ma plotëson dëshirën.

Vizitova ulicat, sokakët, e dredhur e të përdredhur dhe shtëpitë e vjetra që po i restaurojnë kaq bukur. Kudo rrugicat i gjeta plot me popull, me mall e me entuziazëm. E dinë zakanin tim që, kur vij në Korçë, brend rrugët e qytetit ku në rininë më griseshin tabanet e këpucëve, ndaj dalin të gjithë të më shohin e të më takojnë. Sa do të doja të ecja në këmbë në mes këtyre njerëzve, t'i puthja, t'i përqafoja, të futesha në sobalkat e tyre! Por këtë s'e bëj dot tash, se dua ta shoh tërë Korçën dhe koha s'ma lejon. Ecja ngadalë me automobil, i përshëndesja, por as ata, as unë nuk kënaqeshim me kaq.

Shkova në shtëpinë e push'unit të punëtorëve që është ndërtuar e re në lartësinë e Shëndëllisë. Gjë e bukur! Korçën që andej e ke si në pëllëmbë. Kishin ardhur për të pushuar të rinj e të moshuar nga gjithë Shqipëria, i hin të gëzuar si dhe unë. U takova me të njohur, me mësues, me punëtorë, me artistë, të cilët aty për aty improvizuan një koncert origjinal e të bukur. Në një peizazh madhështor me Korçën në sfond, dolën këngëtarët e vogla dhe me një zë të çiltër, të ëmbël dhe tingëllues si kristali kënduan këngë që të bëjnë ta ndiesh veten të ri, si zog në fluturim. Ishim ulur në disa banka dhe më kishin rrethuar miqtë e mi të vjetër, këngëtarët e «Korit të pleqve», Jorganxhiu (bassa), Tolia (tenor), Xherahu, mandolinisti Duro e të tjerë.

- A~jua më pëlqen t'ju thërres «Kori i pleqve», - u thashë miqve të mi, - por ju fieni të rinj, se këngët që këndonin, janë këngët e dashura të rinisë sonë, këngët patriotike, këngët që u këndonin e u këndonin bukurisë së natyrës, ndjenjave të pastra, dashurisë rinore dhe romantike. Arti juaj po përtërihet, po rinohet, ne rrojmë dhe forcohem me këngën e vjetër e me këngën e re të vogëlushëve që kemi përpara.

- Oh, s'noku Enver, - më thanë ata, - ç'mrekuhi 'përi kjo Partia jonë! Jemi kurdoherë të rinj; Partia, populli na duan, na respektojnë.

- S'e harroj dyqanin tënd, o Jorganxhiu, - i thashë, - atje te gruga e Mitropolisë. Shkoja dhe të shikoja nga xhami kur punoje dhe u thosha shokëve të mi studentë, dulce të treguar me gisht: «Ja, ai atje, këndon shumë bukur». Ju dëgjova përsëri këtë mbrëmje në shtëpinë e punëtorëve. Pas këngëtarëve të vegjël dolët ju, me udhëheqësin dhe dirizhorin tuaj të palodhur dhe të talentuar. Jt; ishit shumë këtë herë, kishit marrë edhe të rinj në kor shumë mirë keni bërë. Përtëritja, rinimi, janë

karakteristikë e jetës sonë. Mesko plaku vdiq, por 15 të tjerë E zëvendësuan. Ju kënduat për ~nderin tim këngë patriotikë të Rilindjes dhe të demonstratave kundër fashizmit. JI falënderoj dhe s'do t'jua harroj.

- Ç'këngë tjetër dëshironi të këndojmë shoku Enver' - më pyetën ata pastaj.

- Ju e dini ç'këngë dua unë dhe unë e di kë jua k: qejfi juve. - u thashë dhe bërtita: «Mullirin»!

Tingëlloi zër i basso i Jorganxhiut, ia priti tenori, To lia, dhe i gjithë kori ia filloi këngës së bukur, baladës s' «Munir fit» në ajrin e freskët të mbrëmjes.

Të dashur miq moshatarë të mi korçarë, më bëtë të kujtoja dhe të shikoja larg në vite bukuritë e vendit tim të më kujtoheshin mjerimet e popullit tonë heroik, q. luftonte e punonte, e, në mes luftës e fukarallëkul kurrë s'e ndau këngën nga goja! Tash ky popull ka fuqin në dorë. Pania ia bëri jetën të gëzuar dhe të lumtur. kënga është bërë bashkudhëtare e përhershme e tij, komponent i jetës.

U largova aq shumë i gëzuar nga ky takim dhe kur u ktheva në shtëpi, me udhëheqësit e Partisë dhe të pushtetit në rreth diskutuam maketet e qytetit. Më raportuan arkitektët. Konstatova se këta ishin të pasionuar për qytetin e tyre. Nexhmija dhe unë u kënaqëm me mendimet dhe guston e tyre. Pak sugjerime bëra, se ishin parashikuar mirë, bile dhe Nexhmija; që është shumë e pasionuar për arkitekturën nuk bëri shumë kritika dhe vërejtje. Mendimet e Nexhmijes ma forcuan bindjen se çdo gjë atje qe projektuar bukur.

Nuk munguam me Nexhmijen dhe me shokët të venim të shikonim në teatrin «Çajupi» komedinë e Ruzhdi Pulahës «Zonja nga qyteti». Pjesë e goditur, me përmbajtje politike e shoqërore shumë të mirë, komedi realiste dhe aktuale, komedi që nuk kishte formën e estradës, por që pasqyronte dhe luftonte në mënyrë edukative mbeturinat mikroborgjeze. Tema është shumë aktuale, vajtja me banim dhe për punë nga qyteti në fshat. Qesha, u kënaqa, pse pjesa përshkohet nga një humor i hollë dhe, po e njeh Korçën, atëherë e guston shumë pjesën. E gjithë trupa luante mirë, por veçanërisht luante bukur Dhor kë Or gocka, e cila tubante të mbërthyer 2 orë e 20 minuta skenën. Ç'talent i mrékullueshëm! Dallonte po ashtu artisti i shquar Pandi Raidhi. Në mbarim përgëzova artistët dhe. kur dota, ç'të shikoja në shesh? Populli i shtrenjtë priste. Më duhej ta nderoja me respektin më të madh. prandaj i rashë rreth e rrotull sheshit nën dr itat e neonit.

Kur u kthyem në shtëpi i fola Nexhmijes për përshtypjet. Ajo ishte dakord dhe dha një mendim të :nirë, më duket, që po kjo komedi të vihet në skenë. dhe ndoshta edhe me ndonjë përshtatje të vogël me karakteristikat e disc qyteteve të mëdha si Tirana; Shkoàra etj.. dhEe të luhet kudo. se është shumë edukuese.

Ishin një gëzim i madh për mua takimet dhe bisedat për punë me kuadrot, me punëtorët, koopeativistët e in teligjencien e rrethit. U gjallërova, mora forca të reja, të mëdha. S'ka gjë më insti uktive, -në shpëtimtare se kontaktet me bazën. Atje është jeta, lufta e madhe revolucionare, përpjekjet, mendimet krijuese. sugjerimet nga më të mirat. atje është eksperiencia e me të mirëve. Kush di të përfitojë nga gjithë kjo pasuri e klasës dhe e popullit, ai u shërben si duhet Partisë dhe socializmit.

Këtu qëndron forca e komunizmit, e ideologjisë sono, këtë zjarr duhet të ketë jeta e gjallë. këtë zjarr duhet të kenë kontaktet me bazën, referatet, leksionet, fjalimet.

Larg nesh formalizmi, stereotipizmi, cutina, puna angari, sa për të kaluar radhën! Vetëm klasa. populli, jeta e gjallë, puna dhe lufta revolucionare të mësojnë, të japin ide të reja, të hapin perspektiva. Kur i dëgjon, ata të flasin, dhe mendimet e tyre i përpunon dhe ua çon Partia si duhet. Klasa dhe masa i përpijnë ato, i bëjnë të tyre et, i zbatojnë në mënyrë revolucionare dhe e gjithë kjo bën të lindin mendime të reja, veprime të reja, thesare të reja. Teoria jonë është revolucionare, jo statike, jo e fjetur ; ajo është një forcë kolosale që krijon, që rrëmih cleri në fund të fundit materjen, andej ajo studion ligjet e zhvillimit dhe di t'i aplikojë në kushtet më të përshtatshme, duke kalitur çelikut dhe duke hedhur tej skoriet, duke zhdukur ndr vshkun e vjetërsisë idealiste dhe reaksionare.

V Sa entuziazëm të krijojnë punëtorët dhe kooperativistët! Kur shkon tek ata. disa herë thua: «Çfarë do t'u them?». se shumë gjëra ata i dinë. Mirëpo fino me pare t'i dëgjosh; krijo ambientin se je një shok i thjeshtë i tyre, se ke vajtur tek ata jo t'u shesësh mend. por në radhë të panë të marrësh mend

prej tyre dhe atëherë do të konstatolesh se do të të vijnë ide origjinale. forma thëniesh të reja, do të të vijnë një mori gjërash nga eksperiencia e madhe e Partisë, do t'i lidhësh këto pa ditur e pa kujtuar. do t'i ilustrosh me ndodhi. me shembuj të rinj. ose nga përvoja. Kështu do të bësh 'oidë të interesante dhe nëcosbarro se këtu-të situatë ta krijuan punëtorët, kooperativistët, shkrimtarët, artistët. me të cilët folën, degjove dhe të diëgjuan. Bëhet kështu një osmozë e çuditshme në mes mesicëve të bazës dhe përgjithësimeve të Partisë. Kjo është frytdhënëse, këtë metodë përpiqem ta zbatoj, por që çdo ditë duhet perfeksionuar. Këtë metodë në mënyrë modeste ua këshilloj edhe shokëve, njerëzve. Klasës, masës, folu kurdoherë hapur, kurdoherë drejt, asgjë mos u fshih. Do të ketë edhe lisa gjëra që interesi i përgjithshëm e do që të kihet durim në thënien e tyre, por gjej mënyrën, duke bërë aluzione larg e larg. Klasa, masa të kuptojnë, pse ato i kuptojnë dhe i zbatojnë taktikën dhe strategjinë revolucionare.

Shumë gjëra mësova nga kontaktet me korçarët. Shumë mendime më dhanë, shpesh gjëra të tyre do të më ndihmojnë në punën time. Ata më folën dhe u folën, por më komunikuan në radhë të parë entuziazmin e tyre të madh, besimin se do të ecin për para, se do të thyjnë rekordet e arritura. Mbi çdo gjë entuziazmin tim e gjej dhe e shoh te njeriu i mrekullueshëm që po kalit Partia, te populli ynë i mrekullueshëm i lidhur aq ngushtë me Partinë. Kjo është fitorja jonë më kolosale. Ky unitet i çeliktë i klasës dhe i popullit me Partinë është si mali i Tomorit, i fortë në shekuj. Ky unitet s'do të ketë mortje kurrë, vetëm të ruajmë të pastër ideologjinë marksiste-leniniste, ta bëjmë gjak, mish dhe kockë të klasës dhe të masës, bazë dhe udhëheqje në çdo veprim.

Po i hedh të gjitha këto përshtypje e mendime në letër këtu në Korçë dhe akoma më tepër më shtohen respekti, admirimi e dashuria për këtë qytet, për njerëzit e tij punëtorë; përparimtarë e revolucionarë. Në gjithë ç'kemi arritur në vitet e Partisë. në tërë transformimet e fitoret historike anembanë Shqipërisë, Korça ka rolin e vendin e saj të veçantë, si djep i parë i lëvizjes punëtore e komuniste në Shqipëri, si qendër ku për herë të parë nisi të hedhë rrënjë ideologjia komuniste, marksizëm-leninizmi, që sot është bërë ideologji sunduese në vendin tonë. Dhe më vjen mirë e ndihem krenar që pata nderin e fatin të jem edhe unë, bashkë me gardën e vjetër të punëtorëve komunistë korçarë, ndër ata që qysh në fillim u mëkua e u rrit në këtë djep të revolucionit. E quaj rider e fat të veçantë që Korça më dha mundësinë e më krijoi kushtet ta njoh e ta përshkoi procesin e madh të zhvillimit të revolucionit në Shqipëri që nga hapat e parë, që nga çastet kur «fantazma e komunizmit» të Marksit nisi të shfaqet edhe në Shqipëri, e, gjer sot, kur ajo është bërë ideologji sunduese, udhëheqje për veprim. E për të gjitha këto u jam e do t'u jem mirënjohës gjer në vdekje Korçës, popullit të saj, proletarëve korçarë, mësuesve e shokëve të mi të parë të komunizmit.